

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

**Projekt i Përbashkët mes Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës i titulluar
“Përforcimi i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Kosovë*”**

PROPOZIME REFORMIMI PËR FUQIZIMIN E INSTITUCIONEVE JOGJYQËSORE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË

**mbi bazën e ekspertizës së z. Jeremy McBride, të ngritur mbi hulumtimin e ndërmarrë
nga konsulentët: znj. Gülcan Yeröz, z. Arben Hajrullahu, znj. Natyra Avdiu dhe
z. Bardhyl Hasanpapaj**

dhjetor 2013

Opinionet e dhëna në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk paraqesin përgjegjësitë e

Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian.

Drejtoria e përgjithshme për të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit
Këshilli i Evropës
www.coe.int

©Këshilli i Evropës, 2013
Shtypur në Kosovë, 2014

PËRMBAJTJA	
LISTA E SHKURTIMEVE.....	5
PËRMBLEDHJE.....	6
HYRJE.....	7
2.METODOLOGJIA.....	8
3.STRUKTURAT EKZISTUESE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT.....	8
4.ZHVILLIMI I POLITIKAVE.....	14
5. ZBATIMI.....	20
6.PROMOVIMI.....	23
7. REPARACIONI.....	26
8. MONITORIMI.....	32
9. RAPORTIMI.....	38
10.PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	41
SHTOJCA I.....	58
SHTOJCA II.....	82
SHTOJCA III.....	116
SHTOJCA IV.....	134
SHTOJCA V.....	169



LISTA E SHKURTIMEVE

ABGj	Agjencia për Barazi Gjinore
BPMShCK	Bordi i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
ESK	Enti Statistikor i Kosovës
GPKK	Grupi Punues Komunal i Kthimeve
GjK	Gjykata Kushtetuese
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës
KiE	Këshilli i Europës
KKK	Këshilli Konsultativ i Komuniteteve
KKSK	Këshilli Komunal mbi Sigurinë e Komuniteteve
KLSP	Komiteti Lokal për Sigurinë Publike
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MAShT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MFSK	Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
MIE	Ministria e Integritetit Europian
MKK	Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSh	Ministria e Shëndetësisë
NjDNj	Njësi(-të) e të Drejtave të Njeriut
OSBE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë
OShC	Organizata(-t) e Shoqërisë Civile
PK	Parlamenti i Kosovës
PKBGj	Programi Kosovar mbi Barazinë Gjinore
PVPE	Plani i Veprimit të Partneritetit Europian
RAP	Reforma e Administratës Publike
SPVDNj	Strategjia dhe Plani Veprues mbi të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës 2009-2011
UNDP	Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZBE/PPBE	Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë/Përfaqësuesi Special i Bashkimit Europian në Kosovë
ZBGj	Zyra për Barazinë Gjinore
ZÇK	Zyra për Çështjet e Komuniteteve
ZKGj	Zyra e Komisionerit të Gjuhës
ZKKK	Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZKKKK	Zëvendës-Kryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitetet
ZKLDNj	Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZL	Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës
ZP	Zyra e Presidentit
ZPK	Zyra e Planifikimit Strategjik
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim
ZShK	Zëvendës-shëf për Komunitetet
ZShPL	Zyra e Shërbimit të Përkrahjes Ligjore

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Ky raport shqyrton marrëveshjet ekzistuese jogjyqësore që lidhen me të drejtat e njeriut me qëllim që ta qartësojë dhe/ose thjeshtësojë kompozicionin institucional si dhe t'ia shtojë efektshmërinë. Metodologjia e raportit përbëhet nga një shqyrtim në zyrë dhe analizim i legjislacionit e i strukturave ekzistuese, një konsultim të vazhdueshëm komunal dhe nga vlerësimet e gjysmëstrukturuara të kapaciteteve dhe të efektshmërisë së strukturave jogjyqësore të të drejtave të njeriut. Raporti u përgatit bashkë me tri ekspertiza (të bashkëngjitura) mbi legjislacionin ekzistues dhe atë të propozuar lidhur me Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë, barazinë gjinore dhe mbrojtjen kundër diskriminimit. Shpjegohen fillimisht strukturat ekzistuese, të cilat pastaj shqyrtohen duke iu referuar gjashtë veprimtarive diskrete, por të ndërlidhura, që përfshihen në sigurimin e të drejtave të njeriut, të tilla si zhvillimi i politikave, zbatimi, promovimi, reparacioni, monitorimi dhe raportimi. Për secilën nga këto veprimtari, ky shqyrtim u drejtohet institucioneve përgjegjëse specifike, arritjeve dhe mangësive të tyre. Raporti përmbyllet me vlerësimin e përgjithshëm të problemeve që prekin strukturat ekzistuese – më hollësisht ato të kapacitetit, të besueshmërisë, të fokusit dhe të thjeshtësisë – dhe jep një varg rekomandimesh për rikonfigurimin e strukturave dhe të përgjegjësive të tyre.

1. HYRJE

1. Me kërkesën e Zyrës Ligjore në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës (ZL), në dhjetor të vitit 2012, Këshilli i Europës ofroi një Mendim (Mendimi i Këshillit të Europës) lidhur me Projekt-Rregulloren mbi Mekanizmat për Bashkëpunimin, Bashkërendimin, Monitorimin, Raportimin, Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut (Projekt-Rregullorja). Ky mendim u përgatit nën Projektin e Përbashkët mes Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës, të titulluar “Përforcimi i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Kosovë” (Projekti i Përbashkët).
2. Mendimi i Këshillit të Europës përcaktoi se kishte pasur mangësi për sa i përket fokusimit, rrezes së veprimit dhe qëllimit të Projekt-Rregullores, dhe rekomandonte kryerjen e një analize të gjithanshme të strukturave aktuale jogjyqësore të të drejtave të njeriut, përpara se të ndërmerren hapa të mëtejshëm për zhvillimin e tyre. Kjo qasje u pranua nga ZL dhe u miratua nga Komiteti Drejtues i Projektit të Përbashkët, gjë që ia siguroi mandatin Projektit të Përbashkët për të dhënë mbështetje aktive për këtë proces, brenda kufizimeve të kapaciteteve të tij operacionale dhe fiskale.
3. Në bazë të këtij mandati, u vendos të shqyrtohen, me ndihmesë vendore dhe ndërkombëtare, përparësitë dhe dobësitë e marrëveshjeve jogjyqësore që lidhen me të drejtat e njeriut, qoftë në nivel qendror a lokal, në mënyrë që të formulohet një propozim reformimi i cili jo vetëm do të qartësonte a thjeshtëzonte kompozicionin institucional, por do të çonte edhe në përforcimin e efektshmërisë së tij. Për më tej, u pa e arsyeshme që kjo analizë të lidhej me dispozitën e ekspertizës legislative për Ligjin Nr. 03/L – 195 mbi Avokatin e Popullit, Projekt-Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L – 195 mbi Avokatin e Popullit – korrik 2013, Projekt-Ligjin mbi Barazinë Gjinore dhe Projekt-Ligjin mbi Mbrojtjen nga Diskriminimi, me qëllimin për t’u siguruar se strukturat që do të përdoreshin për zbatimin e tyre të ishin të adaptueshme me reformën që po propozohej.
4. Ky raport është rezultat i shqyrtimit të marrëveshjeve ekzistuese jogjyqësore që lidhen me të drejtat e njeriut. Kapitulli pasues shpjegon metodologjinë e adoptuar dhe kapitulli pas tij përviçon gamën dhe përgjegjësitë e strukturave të ndryshme jogjyqësore që ekzistojnë aktualisht. Pastaj vijojnë gjashtë kapituj të tjerë që merren radhazi me elemente të ndryshme të veprimtarive të ndërmarra nga strukturat jogjyqësore për sa u përket të drejtave të njeriut, duke i shqyrtuar institucionet përgjegjëse, si dhe arritjet e mangësitë e tyre. Gjashtë elementet janë: zhvillimi i politikave, zbatimi, promovimi, reparacioni, monitorimi dhe raportimi. Ndonëse trajtohen si veprimtari të ndara, në raport njihet ndërthurja e pashmangshme mes aspekteve të ndryshme të tyre. Megjithatë, synimi i ndarjes të tyre ishte që të mundësohej analizimi i fuqive dhe dobësive të tyre ndryshme të strukturave individuale jogjyqësore lidhur me gjashtë temat e lartpërmendura që ato të identifikohen më qartësisht.
5. Pas këtyre kapitujve ka edhe një kapitull përfundimtar që parashtron përfundimet e arritura dhe jep rekomandime mbi reformat që konsiderohen të nevojshme në dritën e këtyre përfundimeve me qëllim që ta thjeshtësojë dhe ta përforcojë efektshmërinë e strukturave jogjyqësore të të drejtave të njeriut, veçmas nëpërmjet fuqizimit të fokusimit të aktorëve individualë, ndërsa promovohet një integrim më i madh mes tyre për kryerjen e roleve përkatëse. Raporti përmban edhe shtojcat që janë ekspertiza ligjore lidhur me Ligjin mbi Avokatin e Popullit dhe tri projekt-ligjet, si dhe agjendat për misionet vlerësuese të ndërmarra gjatë përgatitjes së raportit dhe të ekspertizave, si dhe agjenda për tryezën e rumbullakët ku edhe është diskutuar një version paraprak i këtij raporti.

2. METODOLOGJIA

6. Nën udhëheqjen e përgjithshme të një eksperti të lartë ndërkombëtar¹, dy ekipe ekspertësh ndërkombëtarë dhe vendorë ishin përgjegjës respektivisht për formulimin e propozimit të reformës institucionale² dhe për përgatitjen e ekspertizës legjislativë mbi legjislacionin përkatës për të drejtat e njeriut³. Të dy ekipet bashkëpunuan ngusht mes qershorit dhe gushtit, duke shkëmbyer informacionin e mbledhur (si përmbledhje intervistash, analiza, raporte dhe materiale të tjera) dhe duke ia shqyrtuar e komentuar sugjerimet njëri-tjetrit ku ishte e nevojshme. Ekipi që u mor me propozimin për reformën e filloi punën tri javë më përpara se ekipi që përgatiti ekspertizën legjislativë, në mënyrë që ky i fundit t'i merrte parasysh gjetjet paraprake dhe rekomandimet e ekipit të parë.
7. Metodologjia e të gjithë propozimit për reformë përbëhej nga:
 - **Shqyrtimi në zyrë dhe analizimi** i ligjeve përkatëse ekzistuese për të drejtat e njeriut dhe i akteve nënligjore, për sa u përket efektshmërisë së tyre për rregullimin e strukturave ekzistuese të të drejtave të njeriut në Kosovë, duke marrë parasysh punën tashmë të kryer përmes Projektit;
 - **Konsultimi i vazhdueshëm komunal** që përfshinte një varg pyetjesh të shkurtra të përgatitura paraprakisht nga ekspertët për t'iu drejtuar Njësive për të Drejtat e Njeriut dhe udhëheqësve të lartë në nivelin komunal (Kryetarit të Komunës ose zëvendësit të tij) lidhur me funksionimin dhe sfidat e këtyre njësive. Këto pyetje u përgatitën dhe u shpërndanë në bashkëpunim me ekipet në terren të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE); dhe
 - **Vlerësimet e gjysmëstrukturuara** të kapaciteteve dhe të eficiencës së strukturave të të drejtave të njeriut, të bazuara në intervista dhe në vlerësime të performancave gjatë orarit të punës për të gjitha strukturat përkatëse në nivelin qendror dhe për një mostër përfaqësuese të komunave, duke përfshirë edhe punën e konsiderueshme të bërë nga OSBE-ja.
8. Ekspertët e përgjegjshëm për ekspertizën legjislativë morën në konsideratë gjetjet përkatëse të aktorëve të tjerë ndërkombëtarë si dhe ato të Këshillit të Europës, të përmbledhura në raportet e botuara më parë, ndërkohë që përpunonin gjetjet e propozimit për reformë dhe të vlerësimeve të tjera të legjislacionit në shqyrtim. Përveç kësaj, ekspertët ndërmorën një mision vlerësues në Kosovë, gjatë të cilit takuan aktorët përkatës të të drejtave të njeriut.
9. Përgatitja e këtij raporti dhe i ekspertizave u bashkërendua nga eksperti i lartë ndërkombëtar.

Një version jopërfundimtar i këtij raporti u diskutua edhe tryezën e rrumbullakët të datës 4 tetor, në të cilën zyrtarët publikë nga nivelet qendrore e lokale, shoqëria civile dhe përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare e morën raportin. Raporti u përfundua pas marrjes në konsideratë të shumë komenteve dhe sugjerimeve të dobishme, të bëra gojarisht gjatë tryezës dhe më pas me shkrim.

¹ Jeremy McBride (Avokat, Monckton Chambers, Londër, Profesor Vizitues, Universiteti Qendror Europian, Budapest dhe ish-Kryetar i Komitetit Shkencor të Agjencisë së Bashkimit Europian për të Drejtat Themelore).

² Natyra Avniu (konsulente e pavarur me përvojë të gjerë në fushën e të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë në çështjet e antidiskriminimit), Arben Hajrullahu (konsulent i pavarur me doktoraturë në Shkencat Politike, dhe përvojë të gjerë në fushën e të drejtave të njeriut), Bardhyl Hasanpapaj (konsulent i pavarur me përvojë të gjerë në fushën e administratës publike) dhe Gülcan Yeröz (konsulente e pavarur me diploma universitare në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut, e cila ka punuar më parë me Misionin e OSBE-së në Shqipëri dhe Kosovë).

³ Jelena Besedic (konsulente e pavarur me master në ligjin mbi të drejtat e njeriut dhe me përvojë të gjerë në zhvillimet post-konfliktuale, duke përfshirë edhe çështjet gjinore), Dejan Palic (Anëtar i Komisionit Europian kundër Racizmit dhe Mostolerancës si dhe ish-Zëvendës i Avokatit të Popullit të Kroacisë (2004-2013), Jørgen Steen Sørensen (Avokat i Popullit të Danimarkës dhe Anëtar, Komisioni Europian për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias)) dhe George Tugushi (Anëtar, Komisioni Europian kundër Racizmit dhe Mostolerancës, Komiteti Europian për Parandalimin ose Ndëshkimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor e Degradues dhe të Komitetit të Kombeve të Bashkuara kundër Torturës si dhe ish-Mbrojtës Publik (Avokat i Popullit) i Gjeorgjisë).

3. STRUKTURAT EKZISTUESE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT⁴

10. Kosova ka një mori të gjerë strukturash gjyqësore dhe jogjyqësore në nivelet qendrore dhe lokale, mandati primar i të cilave është t'i promovojë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të përcaktuara me Kushtetutë, ligjet dhe legjislacion dytësor. Përveç këtyre strukturave, ekzistojnë edhe institucione e organe të tjera, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë duhet të jenë në gjendje t'i kontribuojnë plotësisht të detyrimeve të ndryshme për përmbushjen e standardeve të parashkruara të të drejtave të njeriut, si për shembull, në fushat e qeverisjes së mirë, të drejtave të minoriteteve dhe të drejtave normale gjinore.
11. Ky raport merret vetëm me strukturat jogjyqësore, por është ende me rëndësi të kihen parasysh strukturat gjyqësore ekzistuese, sepse ato janë pjesë kyçe e kontekstit në të cilin funksionojnë strukturat jogjyqësore. Për më tej, ka raste kur strukturat jogjyqësore mund të përfitojnë nga ato gjyqësoret, ose mund t'u ofrojnë përkrahje atyre që mund t'ua kërkojnë, prandaj strukturat jogjyqësore janë qartazi relevante për mënyrën se si duhet të funksionojnë strukturat jogjyqësore. Strukturat jogjyqësore dhe ato gjyqësore të të drejtave të njeriut mund të luajnë kështu një rol të rëndësishëm shtesë për njëra-tjetrën në kryerjen e funksioneve të tyre përkatëse.
12. Strukturat gjyqësore përbëhen si nga gjykatat e rregullta – juridiksioni i të cilave shtrihet në fushën e të drejtës civile, penale e publike, dhe funksionimi i të cilave mund të ndikojë drejtpërdrejt në gëzimin e të drejtave të njeriut, por mund të jetë edhe mjet për sigurimin e këtyre të drejtave – ashtu edhe Gjykata Kushtetuese (GjK)⁵.
13. Sistemi i gjykatave të rregullta përbëhet nga një Gjykatë Supreme, si autoriteti më i lartë gjyqësor, duke përfshirë edhe Panelin e Apeleve të Agjencisë Kosovare të Pronave si dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, Gjykatën e Apelit, shtatë Gjykatat Themelore dhe 20 Degët e Gjykatave Themelore nëpër të gjithë Kosovën⁶.
14. Juridiksioni i GjK është i dyfishtë. Së pari, ajo ka autoritetin për të vendosur mbi përputhshmërinë kushtetuese të ndonjë ligji, dekreti, rregulloreje dhe statuti komunal me kërkesën e Parlamentit të Kosovës (PK), Presidentit të Republikës, Qeverisë dhe të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës (IAP)⁷. Për më tej, GjK mund të vendosë mbi çështje që lidhen me zgjedhjet, emergjencat, referendumet e traktatet (me kërkesën e Parlamentit të Kosovës, Presidentit të Republikës dhe të Qeverisë)⁸, pastaj mbi kushtetutshmërinë e ligjeve a akteve që i ndikojnë komunat (me kërkesën e komunës)⁹, mbi kushtetutshmërinë e një ligji brenda 8 ditësh nga miratimi i tij (me kërkesën e 10 a më shumë deputetëve të Parlamentit)¹⁰, mbi pandehmat për shkelje të rënda të Kushtetutës nga Presidenti (me kërkesën e 30 a më shumë deputetëve të Parlamentit)¹¹, mbi

⁴ Ky kapitull përdor informata nga Mendimi i Këshillit të Europës; Komisioneri për të Drejtat e Njeriut, Raporti nga Misioni Special në Kosovë i Komisionerit për të Drejtat e Njeriut nga Këshillit i Europës, (CommDH(2009)23), (2009); Misioni i OSBE-së në Kosovë, Ushtroni të Drejtat Tuaja! një Katalog Mjetesh Ligjore dhe Asistence për Anëtarët e Komunitetit, (data nuk specifikohet); Zyra për Çështje Komunitare, Buletini Vjetor – Projektet dhe veprimtaritë në vitin 2012, (data nuk specifikohet); dhe legjislacioni përkatës i cituar në paragrafët në vijim.

⁵ 61 persona.

⁶ Ligji Nr. 03/L-199 mbi Gjykatat, (2010) dhe ndryshimet e tij, Ligji Nr. 04/L-171, (2012). Që nga data 4 janar 2013, sistemi gjyqësor në Kosovë është ristrukturuar. Shihni Rregulloren e re mbi Organizimin e Brendshëm të Gjykatave. http://www.kgjk/ks.org/repository/docs/REGULATION_ON_INTERNAL_ORGANISATION_OF_THE_COURTS_and_Decion_40_270759.pdf si edhe raportin e KGjK 'Statistika mbi Gjykatat e Rregullta – Tremujori i Parë i vitit 2013', fq.2, http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/RAPORTI-I-PERGJITHSHEM-TREM-I-2013_ANGLISHT_769601.pdf (të dyja janë shfrytëzuar më datën 2 nëntor 2013). Janë 345 gjyqtarë dhe 1437 vetë si personel mbështetës sipas raportit të KGjK 'Statistika mbi Gjykatat e Rregullta – Tri-Mujori i Parë i vitit 2013', f. 3, http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/RAPORTI-I-PERGJITHSHEM-TREM-I-2013_ANGLISHT_769601.pdf (shfrytëzuar më datën 2 nëntor 2013)), plus 561 prokurorë shteti, 24 vetë personel në Institutin Gjyqësor të Kosovës.

⁷ Neni 113.2 i Kushtetutës.

⁸ Neni 113.3 i Kushtetutës.

⁹ Neni 113.4 i Kushtetutës.

¹⁰ Neni 113.5 i Kushtetutës.

¹¹ Neni 113.6 i Kushtetutës.

rastet e shkeljeve të pandehura prej autoriteteve publike të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë që i referohen nga individë pas shterimit të të gjitha mjeteve ligjore të ofruara me ligj¹² si dhe mbi mosmarrëveshjet gjatë procedurave gjyqësore lidhur me përputhshmërinë kushtetuese të ndonjë ligji (nga ana e gjykatës përkatëse)¹³.

15. Gama e strukturave jogjyqësore që trajtojnë çështjet e të drejtave të njeriut është shumë më e zgjeruar se strukturat gjyqësore. Fushat që mbulohen nga këto struktura shtrihen që nga zhvillimet e politikave, zbatimi, promovimi, monitorimi, reparacioni dhe raportimi. Përgjithësisht secila strukturë mbulon më shumë se vetëm njërin prej këtyre fushave.
16. Vetëm një përlllogaritje e përafërt mund t'i bëhet numrit të personelit që punon për institucione të ndryshme jogjyqësore të të drejtave të njeriut, por edhe kjo mund të mos e pasqyrojë tërësinë e të gjithë atyre që e kryejnë këtë punë. Veçanërisht duhet pasur parasysh se numrat e siguruar gjatë punës në terren e që shfaqen nëpër raporte, nuk nënkuptojnë që të gjithë këta persona merren kryesëpari me detyrat e përcaktuara (siç vihet re te shembulli i NjDNj-ve). Përveç kur specifikohet ndryshe, numrat e dhënë në fusnota për nëpunësit e organizmave specifike që përmenden më poshtë janë marrë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për vitin 2013¹⁴.
17. Nga të gjitha strukturat e ndryshme, IAP (Institucioni i Avokatit të Popullit), Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mosdiskriminim (ZQM) si dhe Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj), mund të shihen si organizma me mandatet më të rëndësishme. Megjithatë, nga të tria këto institucione, vetëm Institucioni i Avokatit të Popullit është i pavarur, meqë dy të tjerët janë ente brenda Zyrës së Kryeministrit (ZKM).
18. Institucioni i Avokatit të Popullit mandatohet nga Kushtetuta dhe ligji për të monitoruar, ruajtur dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë e individëve nga aktet e paligjshme a të padrejta, si dhe prej mosndërhyrjes së autoriteteve publike. IAP kryen hetime, lëshon raporte publike ose ngre shqetësime nëpërmjet mediave, ofron shërbime ligjore dhe përfshihet në avokimin publik¹⁵. Institucioni merret me ankesa individuale që dorëzohen drejtpërdrejt në zyrat e tij, dhe mund të veprojë edhe me pavarësi për të hapur një hetim edhe pa marrë ankesë (p.sh., *ex officio*). Nëse gjatë hetimeve identifikon shkelje të të drejtave të njeriut, IAP mund të kërkojë mjete ligjore nëpërmjet një morie kanalesh, si duke u rekomanduar veprimeve autoriteteve, dhe duke ndërmjetësuar konteste ndërmjet palës ankuese dhe autoriteteve. Në raste ekstreme, ka kompetencën të lëshojë kërkesë për ndonjë masë të përkohshme për ta siguruar mbrojtjen e palës ankuese. Për t'u siguruar qasje të gjithëve, përfshirë edhe komunitetet pakicë, juristët e IAP vizitojnë rregullisht komunat, burgjet dhe qendrat e paraburgimit¹⁶. Siç u përmend më lart, IAP mund të kërkojë edhe aktvendim nga Gjykata Kushtetuese mbi përputhshmërinë kushtetuese të ndonjë ligji, dekreti, rregulloreje dhe statuti komunal.
19. ZQM, siç u përmend tashmë, funksionon brenda Zyrës së Kryeministrit¹⁷ dhe ka rol shqyrtues e këshillues lidhur me punën e qeverisë në katër fushat e përmendura në titullin e saj¹⁸. Ka edhe rolin e ndërtuesit të kapaciteteve dhe rol këshillues që i mundëson ZQM-së të themelojë mekanizma shtesë, të organizojë fushata për vetëdijesimin e publikut dhe të bashkëpunojë me shoqërinë civile. Për më tej, ZQM supozohet të shërbejë edhe si një Sekretariat dhe Njësi Bashkërendimi për organizma dhe mekanizma të ndryshëm qeveritarë, si dhe si Sekretariat për

12 Neni 113.7 i Kushtetutës.

13 Neni 113.8 i Kushtetutës. Përveç kësaj, Kryetari të Parlamentit të Kosovës i kërkohej t'i referohej ndryshimit e propozuara kushtetuese përpara miratimit nga ana e Parlamentit, që të konfirmojë se ndryshimi i propozuar nuk i zbehet të drejtat dhe liritë e garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës; Neni 113(9). Edhe Zëvendëskryetari i Kuvendit Komunal për Komunitetet mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. shih par. 32. Juridiksioni i GjK rregullohet më tej me Ligjin Nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese, (2008).

14 <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Laë%20on%20Budget%20of%20Kosovo%202013.pdf>

15 55 anëtarë personeli.

16 Nenet 132-135 të Kushtetutës; Ligji Nr. 03/L-195 mbi Avokatin e Popullit, (2010).

17 633 anëtarë personeli.

18 Përbëhet nga një Drejtor dhe 7 anëtarë personeli mbështetës.

një varg të gjerë komisionesh dhe këshillash kombëtarë në fushën e të drejtave të njeriut dhe të qeverisjes së mirë¹⁹, megjithëse jo të gjitha mblidhen shpesh. Roli i ZQM-së përfshin edhe përgjegjësinë për ta udhëhequr punën e Njësive të të Drejtave të Njeriut (NjDNj), në nivelin qendror dhe atë komunal²⁰.

20. Agjencia për Barazi Gjinore, një tjetër organ nën Zyrën e Kryeministrit, monitoron zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore, duke zhvilluar dhe propozuar politika për institucionet e nivelit qendror, dhe duke kryer fushata vetëdijesimi publik për të siguruar barazinë dhe përfaqësimin gjinor²¹. Shefi Ekzekutiv i ABGj kryeson edhe Këshillin Ndërmintor për Barazi Gjinore, që përbëhet nga Zyrtarët për Barazi Gjinore (ZBGj) nga të gjitha ministritë. Ky Këshill ka mandatin të monitorojë zbatimin e Programit Kosovar për Barazi Gjinore (PKBGj) si dhe duhet të japë rekomandime mbi projekt-ligjet që ndikojnë në barazinë gjinore²².
21. Përveç këtyre tri organeve, ka mjaft struktura të tjera që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut.
22. NjDNj-të janë themeluar brenda shumicës së ministrive²³ dhe komunave²⁴ me përgjegjësinë që të hartojnë dhe të zbatojnë politika e veprimtari, ndërkohë që monitorojnë zbatimin e duhur të ligjeve, për të siguruar promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Disa prej këtyre njësive shërbejnë edhe si pika kontakti për parashtrimin e ankesave nga banorë dhe zyrtarë dhe kryejnë veprimtari për vetëdijesimin e publikut mbi të drejtat e njeriut.
23. Megjithatë, në përputhje me Reformën e Administratës Publike (RAP), Qeveria ka lëshuar së fundmi një rregullore për ta standardizuar skemën e ministrive ashtu që të lejojë të mbeten vetëm Zyra e Ministrit, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, departamentet dhe divizionet²⁵. Rrjedhi-

19 Këshilli për Mbrojtjen dhe Drejtësinë për Fëmijët, Grupi Ndërmintor kundër Korrupsionit, Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, Këshilli Kombëtar për Bashkëpunimin mes Qeverisë dhe Shoqërisë Civile, Grupi Drejtues mbi Monitorimin e Zbatimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, Grupi i Punës mbi kthimin e Gjuhës së Shenjave në gjuhë Zyrtare në Kosovë, Grupi i Punës mbi Monitorimin dhe Vlerësimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve, si dhe Grupi i Punës për Monitorimin e zbatimit të Konventës së të Drejtave të Fëmijëve.

20 ZQM u themelua me anë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 19/2001 mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë, (2001) dhe me mendimin e tij, Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 15/2005, (2005). Deri para pak kohësh ajo quhej 'Zyra Këshillimore e Qeverisjes së Mirë, të Drejtave të Njeriut, Mundësive të Barabarta dhe Çështjeve Gjinore', dhe mandatohej të asistonte me zhvillimet e politikave edhe në fushën e barazisë gjinore. Kjo fushë është tashmë në përgjegjësinë e Agjencisë për Barazinë Gjinore. Shih Rregulloren Nr. 16/23 mbi Strukturën Organizative të Zyrës së Kryeministrit, për detyrat dhe përgjegjësitë e reja të ZQM, (2013).

21 18 anëtarë personeli.

22 Agjencia për Barazinë Gjinore u themelua në shkurt 2005 si 'Zyra për Barazinë Gjinore' në përputhje me Ligjin Nr. 2004/2 mbi Barazinë Gjinore në Kosovë, (2004). Zyra u shndërrua në agjenci nga data 1 shtator 2006. Shih Rregulloren Nr. 16/23 mbi Strukturën Organizative të Zyrës së Kryeministrit, (2013), për detyrat dhe përgjegjësitë aktuale të ABGj.

23 Themeluar me Udhëzimin e Kryeministrit Nr. 04/2007 (2007, duke përforcuar vendimet e mëparshme të vitit 2005). Shih Udhëzimin Administrativ të Kryeministrit Nr. 8/2005 mbi Termat e Referencës për Njësitë e të Drejtave të Njeriut, (2005), Seksionin 7 për përgjegjësitë dhe detyrat e tyre. Ka – duke u bazuar në intervistat e bëra gjatë Misionit të Parë Vlerësues – 51 anëtarë personeli në këto këshilla, të ndarë si më poshtë: Ministria e Financave – Zyra e BNj: 4; Ministria e Administratës Publike: 5 (pa buxhet të veçantë); Ministria e Bujqësisë, e Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural – Zyra e BNj: 3; Ministria e Tregtisë dhe Industrisë: pa buxhet të veçantë dhe e padisponueshme meqë anëtarët e NjDNj ishin me leje); Ministria e Infrastrukturës: 2 (pa buxhet të veçantë); Ministria e Shëndetësisë: 4 (pa buxhet të veçantë); Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit: 4 (pa buxhet të veçantë); Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë: 3 (pa buxhet të veçantë); Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale: 3 (pa buxhet të veçantë dhe posti i Koordinatorit është aktualisht i lirë); Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Mjedisor – Njësia e BNj: 3; Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit: 4 (pa buxhet të veçantë); Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal: 5 (pa buxhet të veçantë/Divizioni për Promovimin e të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna); Ministria e Zhvillimit Ekonomik: 4 (pa buxhet të veçantë); Ministria e Punëve të Brendshme: 3 (pa buxhet të veçantë); Ministria e Drejtësisë: pa buxhet të veçantë dhe anëtarët e NjDNj nuk ishin në dispozicion, sepse ishin jashtë shtetit në një seminar); Ministria e Punëve të Jashtme: pa buxhet të veçantë/nuk ekziston; Ministria e Forcës së Sigurisë për Kosovën: 2 (pa buxhet të veçantë); Ministria e Integritit Europian: asnjë anëtar për shkak të ristrukturimit (pa buxhet të veçantë); dhe Ministria e Diasporës: 2 (pa buxhet të veçantë).

24 Themeluar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAQV) me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2008 mbi Njësitë e të Drejtave të Njeriut, (2008), dhe amendimet e tij sipas 01/2011 dhe 04/2011, (2011). Ekzistojnë 85 anëtarë personeli në këto njësi (30 vetë me orar të plotë dhe 55 me orar të pjesshëm (sipas informacionit të ekipeve në terren të OSBE-së për Pyetësorët mbi Njësitë e të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna).

25 Rregullorja Nr. 09/2012 mbi Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimit të Vendeve të Punës në Administratën

misht, ish-strukturat e njësive do të shpërbëhen nga organigrami i ministrive. E njëjta rregullore e detyron secilën administratë shtetërore të hartojë e të dorëzojë rregulloret e veta të brendshme mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e punëve që qeveria ta miratojë brenda katër muajsh nga data e nxjerrjes²⁶. Deri më tani qeveria ka miratuar vetëm pesë rregullore që janë dorëzuar nga ministritë përkatëse²⁷. Ka shumë të ngjarë që personeli i NjDNj-ve ministrore ose do të shkrihet tek burimet njerëzore/departamentet e personelit, ose do të mbetet nën Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm si një person (vetëm Koordinatori), varësisht nga nevojat e veçanta të secilës ministri²⁸, duke lënë të paqartë rolin e tyre në të ardhmen.

24. Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) është institucion qendror parësor që ngarkohet me zhvillimin e politikave, zbatimin, monitorimin dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, përfshirë të drejtën për kthim²⁹.
25. Zyra për Çështjet e Komuniteteve (ZÇK) brenda Zyrës së Kryeministrit, ka një rol bashkërendues, këshillues dhe promovues në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet³⁰.
26. Një organ tjetër, Këshilli Konsultativ për Komunitetet (KKK) shërben si mekanizëm konsultativ brenda Zyrës së President (ZP) dhe përbëhet nga përfaqësues të komunitetit dhe të qeverisë, qëllimi i të cilëve është që të lehtësojnë qasjen dhe pjesëmarrjen e pjesëtarëve të komunitetit në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore³¹. KKK përbën një forum për komunitetet që të komentojnë në fazë të hershme mbi iniciativat politike e legjislative që mund t'i ndikojnë, dhe të sigurohen se pikëpamjet e tyre përfshihen në projektet dhe programet përkatëse³².
27. Një mekanizëm relativisht i ri, Zyra e Komisionerit të Gjuhës (ZKGj) është themeluar vetëm për ruajtjen, promovimin dhe mbrojtjen e gjuhëve zyrtare dhe të gjuhëve në përdorim zyrtar, si dhe të statusit të tyre të barabartë, siç përcaktohet në Ligjin mbi Përdorimin e Gjuhëve³³. ZKGj u themelua në prill të vitit 2012, duke zëvendësuar ish-Komisionin e Gjuhës, të themeluar më 2007, por që kishte qenë mjaft pasiv, kryesisht për shkak të mungesës së personelit të përhershëm dhe buxhetit në kryerjen e veprimtarive, dhe meqë nuk kishte marrë asnjë ankesë. Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve parashikon një ZKGj krejtësisht të mbuluar me personel dhe financiarisht të mbështetur, si dhe dy mekanizma që të mbështesin punën e Komisionerit të Gjuhës: Bordin Gjuhësor të Politikave dhe Rrjetin Gjuhësor të Politikave. Është ende mjaft herët që të bëhet një vlerësim i punës së ZKGj, kështu që funksionimi faktik i këtij mekanizmi nuk analizohet në këtë raport.
28. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticionet është njëri nga nëntë komisionet funksionale në Parlamentin e Kosovës i mandatuar nga Rregullat e Procedurës së Parlamentit³⁴. Përveç rolit për hartimin e projekt-ligjeve dhe monitorimin e zbatimit të tyre, Komisioni mund të paraqesë çështje dhe tendenca të të drejtave të njeriut në Parlament dhe është në gjendje të përcjellë tek organi përkatës ankesa/peticione individuale që i

Shtetërore, 25 prill 2012.

26 Përkatesisht në Ministrinë e Administratës Publike (MAP) për verifikimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërinë me zhvillimin dhe politikën e administratës publike, në Ministrinë e Financave (MeF) për verifikimin e vlerësimit të ndikimit financiar, dhe Qeverisë për miratimin dhe botimin Në Gazetën Zyrtare dhe në faqen e internetit të ministrisë përkatëse (shih Nenet 23 dhe 25 të Rregullores 2012/09).

27 Informacioni i dhënë nga Drejtori i Zyrës Ligjore.

28 Intervistë me përfaqësues të MAP, Misioni i Parë Verifikues.

29 Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/15, (2005), Shtojca XII; Ligji Nr. 03/L-047 mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të tyre në Kosovë, (2008), dhe ndryshimet të tij, Ligji Nr. 04/L-020, (2011).

30 Themeluar me anë të Vendimit të Kryeministrit më datën 03/49, (2009). Për një listë më të azhurnuar të përgjegjësive, shih Rregulloren Nr. 16/23 mbi Strukturën Organizative të Zyrës së Kryeministrit, (2013). Ka 7 vetë personel.

31 Ka 26 anëtarë dhe 7 vetë personel.

32 Neni 60.3(2) i Kushtetutës; Ligji Nr. 03/L-047 mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të tyre në Kosovë, (2008), me ndryshimet e tij, Ligji Nr. 04/L-020, (2011).

33 Ligji Nr. 02/L-37 mbi Përdorimin e Gjuhëve, (2006); Rregullorja Nr. 07/2012 mbi Zyrën e Komisionerit të Gjuhës, (2012). Ka 8 vetë personel.

34 9 vetë personel (<http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,110,109>).

adresohen Parlamentit të Kosovës, nëse kjo shihet si e përshtatshme³⁵.

29. Komisioni mbi të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthimeve, një nga katër komisionet e përhershme të Parlamentit, shqyrton çdo ligj të propozuar dhe jep rekomandime lidhur me to brenda dy javësh pas marrjes së tyre³⁶. Komisioni mund t'i dorëzojë edhe rekomandime një komisioni tjetër përkatës ose Parlamentit të Kosovës, të propozojë iniciativat e veta ligjore dhe masa të tjera të tilla brenda përgjegjësive të Parlamentit të Kosovës, dhe të lëshojë mendime/raporte individuale për të adresuar shqetësimet e komuniteteve³⁷.
30. Ekziston edhe një mekanizëm tjetër jogjyqësor në nivelin qendror që ka një ndikim të tërthortë mbi organet e administratës shtetërore që merren me të drejtat e njeriut. Ky është Bordi i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (BPMSHCK), përgjegjës për mbikëqyrjen e funksionimit të administratës publike për të siguruar përgjegjshmërinë dhe ligjshmërinë e saj³⁸.
31. Në komunat ku komunitetet pakicë përbëjnë të paktën 10% të popullatës, janë vënë mekanizma shtesë për mbrojtjen e komunitetit, të tillë si Zëvendës-shëf për Komunitetet (ZShK) dhe Zëvendës-Kryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitetet (ZKKKK). Përveç rolit këshillues dhe shqyrtues, ZKKKK vepron si pikë kontakti për ankesa kundër akteve a vendimeve të marra nga kuvendi komunal që përbëjnë shkelje të pandehur të të drejtave të komuniteteve sipas garancive kushtetuese. Nëse Zëvendës-Kryesuesi është i mendimit se çështja kërkon hetim të mëtejshëm, është përgjegjësia e vet t'ia referojë atë çështje kuvendit komunal për shqyrtim. Në rast pakënaqësie me përgjigjen e kuvendit komunal, ai/ajo mund t'ia dorëzojë një ankesë drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese për shqyrtim³⁹.
32. Komisioni i Komuniteteve⁴⁰ (një nga dy komisionet e përhershme të secilit kuvend komunal), Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK)⁴¹, Grupi Punues Komunal për Kthimet (GPKK)⁴², Këshilli Komunal për Sigurinë e Komuniteteve (KSKK)⁴³, Komiteti Lokal për Sigurinë Publike (KLSP)⁴⁴ dhe komisione të tjera komunale (pra, komisionet *ad hoc* të themeluara nga kuvendi komunal mbi arsimin, shëndetësinë, të drejtat e fëmijëve, etj; Komisionet Konsultative⁴⁵) ofrojnë një platformë për pjesëtarët e komuniteteve dhe shoqërisë civile për të shqyrtuar dhe këshilluar lidhur me projekt-aktet komunale, vendimet dhe legjislacionin, duke pasur kështu potencialin e fuqizimit të pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës.
33. Përveç kësaj, ka edhe disa struktura që fokusohen veçanërisht në të drejtat e fëmijëve, siç janë, Komisioni Ndërmnistror për të Drejtat e Fëmijëve dhe Këshilli për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Drejtësinë për Fëmijë⁴¹. Megjithatë, puna e tyre nuk është shqyrtuar për qëllimet e këtij raporti,

35 Rregullat e Procedurës së Parlamentit të Republikës së Kosovës, (2010), Shtojca Nr. 2, Neni 12.

36 12 vetë personel (<http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,110,97>).

37 Neni 78 i Kushtetutës; Rregullat e Procedurës së Parlamentit të Republikës së Kosovës, (2010), Shtojca Nr. 2, Neni 2.

38 Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/36, (2001), Kapitulli III; Ligji Nr. 03/L-192 mbi Bordin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, (2010).

39 Nenet 62.1-62.4 të Kushtetutës; Ligji Nr. 03/L-040 mbi Vetë-Qeverisjen Lokale, (2008), Neni 54 dhe 55.

40 Ligji Nr. 03/L-040 mbi Vetë-Qeverisjen Lokale, (2008), Neni 53.

41 Zyra e Kryeministrit, Rregullorja Nr. 02/2010 për Zyrat Komunale të Komuniteteve dhe të Kthyerve, (2010).

42 Siç sigurohet me anë të Manualit të Rishikuar për Kthimin e Qëndrueshëm të vitit 2006 (fq. 13), GPKK përbëhet nga zyrtarë të qeverisë, përfaqësues të komuniteteve, persona të zhvendosur, organizata të shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare, dhe ai vepron si forum koordinimi dhe zbatimi vendor për të gjitha çështje, projektet dhe veprimtaritë që kanë të bëjnë me të kthyerit.

43 Ligji Nr. 04/L-076 mbi Policinë, (2012), Neni 7(4); Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2009 Min. e Pun. të Brend. - 02/2009 MAPL për Këshillat Komunalë të Sigurisë për Komunitetet, (2009); Udhëzimi Administrativ Nr. 27/2012 Min. e Pun. të Brend. - 03/2012 Min. e Pun. të Brend. për Këshillat Komunalë të Sigurisë për Komunitetet, (2012).

44 Kushtet e Përgjithshme për Themelimin dhe Funksionimin e Komiteteve Lokale të Sigurisë Publike, Neni 2.

45 Ligji Nr. 03/L-040 mbi Vetë-Qeverisjen Lokale, (2008), Neni 73.

46 Komisioni u themelua me qëllim që të komunikojë e të koordinojë politikën, programet e proceset mbi të drejtat e fëmijëve mes institucioneve kosovare dhe për të lehtësuar realizimin e të drejtave të fëmijëve, si edhe të mbrojtjeve dhe promovimeve të drejtave të fëmijëve në Kosovë. U themelua në dhjetor të vitit 2008 e megjithëse supozohej të mblidhej dy herë në vit sipas Strategjisë dhe Planit të Veprimit mbi të Drejtat e Fëmijëve, kuptohet që është mblidhur vetëm dy herë që nga themelimi i tij. Këshilli u themelua në vitin 2011 me mandatin e mbrojtjes e të drejtësisë, të përcaktojë prioritetet dhe masat e nevojshme

dhe siç shënohet në Kapitullin 10, duhet t'u kushtohet më shumë vëmendje vendit të organeve të specializuara për të drejtat e fëmijëve, procedurave dhe ekipeve brenda reformës së propozuar për strukturat jogjyqësore të të drejtave të njeriut.

4. ZHVILLIMI I POLITIKAVE

4.1 Institucionet Përkatëse

34. Në Kosovë, administrata publike është përgjegjëse për propozimin, zhvillimin dhe hartimin e të gjitha politikave të brendshme e të jashtme në gjithë gamën e veprimtarive qeveritare. Kjo përgjegjësi shpërndahet nëpërmjet institucioneve të ndryshme qendrore dhe lokale.⁴⁷
35. Në fushat e veçanta të qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut, mundësive të barabarta dhe anti-diskriminimit, organi kryesor në nivelin qendror që supozohet të kryesojë hartimin e politikave është ZQM, e cila pritet ta bëjë këtë gjë në bashkëpunim, bashkërendim dhe këshillim me organe të ndryshme qeveritare, mekanizma përkatës dhe shoqërinë civile. Përveç kësaj, NjD-Nj-të nëpër ministri kanë disa përgjegjësi për hartimin e politikave dhe udhëzimeve që lidhen me të drejtat e njeriut përbrenda kompetencës së ministrisë së tyre përkatëse, ndonëse roli i tyre është më shumë i natyrës së reagimit ndaj propozimeve që vijnë nga ministrinë e tyre sesa t'i iniciojnë ato. ABGj ka përgjegjësinë e veçantë për hartimin e politikave promovuese të barazisë gjinore dhe bashkërendimin e përgatitjeve të Programit Kosovar mbi Barazinë Gjinore me anë të një grupi pune të përfaqësuesve të ministrive, komunave, institucioneve publike, shoqërisë civile dhe ekspertëve të tjerë.
36. Përveç kësaj, dy komisionet e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Parlamentit të Kosovës mbi të drejtat e njeriut dhe ato të komuniteteve, potencialisht do të jenë në pozitën të ushtrorë njëfarë ndikimi mbi zhvillimin e politikave nëpërmjet prezentimit të raporteve të veta vjetore ose raporteve *ad hoc*, meqenëse këto mund të identifikojnë nevojat që duhen adresuar.
37. Për më tej, megjithëse jo drejtpërdrejt të përfshira në zhvillimin e politikave, dy zyrat brenda Zyrës së Kryeministrit, pra Zyra e Planifikimit Strategjik (ZPS) dhe Zyra Ligjore (ZL), po ashtu luajnë rol këshillues dhe bashkërendues në identifikimin dhe dhënien e prioritetit të atyre çështjeve që kërkojnë vëmendjen e qeverisë për zhvillimin e politikave të nevojshme, dhe mbështesin institucionet në procesin e hartimit të legjislacionit⁴⁸.
38. Në fushën e veçantë të të drejtave të komuniteteve, ekzistojnë një numër institucionesh specifike të ngarkuara me zhvillimin e politikave në nivelet qendrore dhe lokale.
39. Kështu, Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit mandatohet të zhvillojë politika për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë edhe hartimin e strategjisë së rrezes së veprimit të qeverisë që lidhet me komunitetet dhe kthimin. Po ashtu, ZÇK brenda ZKM-së jep kontributin e vet në këtë proces duke dhënë këshilla dhe rekomandime mbi draft-dokumentet e politikave dhe projekt-ligjet. Po ashtu, Këshilli Konsultativ mbi Komunitetet në ZP përbën një forum ku komunitetet mund të komentojnë në fazë të hershme mbi iniciativat politike a legjislative që mund t'i ndikojnë, si dhe t'i përfshijnë pikëpamjet e tyre në projektet dhe programet përkatëse.
40. Në nivelin lokal, Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim kanë për detyrë të zhvillojnë strategjitë e planet e veprimit, në bashkëpunim me GPKK, për të zbatuar ligje dhe politika

për të përmirësuar situatën e fëmijëve, të lehtësojë e të monitorojë zbatimin e politikave, programeve dhe masave të tjera dhe të analizojë e të vlerësojë zbatimin e politikave zhvilluese dhe legjislacionit. Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos-Diskriminim ka shërbyer si Sekretariati i Këshillit.

47 Ligji 03/L-189 mbi Administratën Shtetërore të Kosovës, (2010).

48 Për më shumë informacione mbi detyrat e këtyre dy zyrave, shih Rregulloren Nr. 23/16 mbi Strukturën Organizative të Zyrës së Kryeministrit, (2013).

qeveritare, ashtu që t'i pajisin institucionet komunale me një kornizë pune që t'ua udhëheqë veprimtaritë në këtë fushë. Përveç kësaj, Këshilli Komunal mbi Sigurinë e Komuniteteve dhe Komiteti Lokal për Sigurinë Publike kanë mandatin të identifikojnë shqetësimet lokale të komuniteteve që lidhen me sigurinë publike dhe të propozojnë plane veprimi që synojnë adresimin e këtyre shqetësimeve.

41. Zhvillimi i përgjithshëm i politikave që lidhen me të drejtat e njeriut në nivelin komunal është në duart e ekzekutivit të komunës. NjDNj-të nuk kanë detyrimisht ndonjë përgjegjësi të veçantë në këtë drejtim, por ekzistenca e tyre mund t'ua sigurojë mundësinë të ndikojnë tek vendimmarrësit.

1.2 Arritjet

43. Deri tani, shumica e dokumenteve kryesore të politikave mbi të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore janë hartuar nën bashkërendimin e ZQM-së dhe ABGj-së, nëpërmjet një procesi pjesëmarrës dhe konsultativ me të gjithë hisedarët. ZQM mund të shihet edhe si përfituese nga përkrahja e Zyrës Ligjore, veçanërisht në procesin e hartimit të strategjive dhe të planeve të veprimit mbi të drejtat e njeriut⁴⁹.
44. Shembuj të dokumenteve kryesore të politikave të përgatitura me procesin dhe mbështetjen e sapopërmendur, përfshijnë “Barazia” e Programit Kosovar mbi Barazinë Gjinore (2008-2013); Strategjia dhe Plani i Veprimit mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë (2009-2011); Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara për Republikën e Kosovës (2009-2011); Strategjia dhe Plani i Veprimit mbi të Drejtat e Fëmijëve në Republikën e Kosovës (2009-2013); Progami Kosovar kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit (2011-2014); Strategjia dhe Plani i Veprimit mbi Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve në Kosovë (2011-2016); Strategjia mbi Integrimin e Komuniteteve të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve në Kosovë (2009-2015), dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj. Së fundmi, qeveria e Kosovës* miratoi një Strategji të re dhe një Plan të ri Veprimi kundër Korrupsionit (2013-2017), një Strategji të re dhe një Plan të ri Veprimi për Rininë (2013-2017), Strategjinë dhe Planin e Veprimit mbi Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (2013-2017), Strategjinë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2023) dhe Planin e saj të Veprimit (2013-2015)⁵⁰.
45. Megjithatë, në gusht të vitit 2013, ZQM përgatiti një projekt-plan fillestar të Strategjisë dhe të Planit të Veprimit për të Drejtat e Njeriut (2013-2017) pa ndjekur paraprakisht procesin e mëparshëm pjesëmarrës dhe konsultativ. Ky dokument mund të gjendet në faqen e internetit të Zyrës së Kryeministrit⁵¹ dhe aktualisht është i hapur për konsultim publik.
46. Sipas termave të tyre të referencës, NjDNj nëpër ministri kanë për detyrë të zhvillojnë politika për të drejtat e njeriut. Megjithatë, deri më tani ato kanë kontribuar në këtë proces vetëm nëpërmjet pjesëmarrjes në grupet Ndërmnistrorë të punës, për çështje dhe strategji të ndryshme⁵² dhe duke dhënë komente e rekomandime të projekt-dokumenteve, nëse dhe kur këto dokumente u ofrohen. Në përgatitjen e tyre, shumica e NjDNj duket se mbështeten në departamentet ligjore të ministrive, kryesisht për shkak të mungesës së tyre të ekspertizës ligjore.
47. Megjithatë, ka disa shembuj të mirë të kontributit të dhënë nga NjDNj-të. Kështu, me kërkesë

⁴⁹ Takim me Drejtorët e ZQM dhe ZL, Misioni i Parë Vlerësues.

⁵⁰ Komisioni Europian, Dokument Punues i Personelit të Komisionit Kosova* 2013 Raporti i Progresit që shoqëron dokumentin Komunikim nga Komisioni për Parlamentin dhe Këshillin Europian, Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2013-2014 {COM(2013) 700 versioni përfundimtar}, 16 tetor 2013 (SËD (2013) 416). Gjendet në faqen e internetit http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/ks_rapport_2013.pdf (shfrytëzuar më datën 9 nëntor 2013).

⁵¹ http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Pjesa_Narrative_e_Draft-Strategjise_per_te_Drejttat_e_Njeriut_%282013-2017%29_05_gusht_2013_EN.pdf (në anglisht) (shfrytëzuar më datën 8 nëntor 2013).

⁵² Për shembull, strategjitë kombëtare dhe planet e veprimit mbi dhunën në familje, anti-trafikimin, integrimin e komuniteteve të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve në Kosovë.

të Divizionit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), është shtuar edhe një paragraf në Nenin 17 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, me qëllim që të theksohet më tej përgjegjësia e qeverisë lokale për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut, si një garanci shtesë e Kushtetutës. Po ashtu, një rekomandim i NjDNJ të Ministrisë së Financave (MF), për të përfshirë të drejtën e ankesës për kontestet e tatimit të pronës, u pranua kur u hartua edhe udhëzimi administrativ përkatës. Për më tej, NjDNJ-të e Ministrisë së Administratës Publike (MAP) dhe të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), mblodhën statistika në nivel kombëtar mbi nëpunësit civilë dhe të tjerë në fuqinë punëtore, të zbërthyer p.sh. mbi baza gjinore, nga zyrat e tyre të personelit dhe e ndanë këtë informacion me ZQM, ABGj dhe institucionet e tjera përkatëse. Të dhëna të tilla bazë janë qenësore për analizimin e plotë të situatës, si dhe për identifikimin e problemeve të qasjes së barabartë në punësim në shërbimin civil dhe tregun e punës në përgjithësi, duke zhvilluar pastaj politika korrigjuese që mund të nevojiten. Mbledhja dhe ndarja e të dhënave të ngjashme lidhur me regjistrimin nëpër shkolla dhe ndjekjen e shkollave është ndërmarrë edhe nga NjDNJ në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)‘ së bashku me Entin Statistikor të Kosovës (ESK)⁵³.

48. Zhvillimi i politikave në fushën e të drejtave të njeriut që lidhen me komunitetet dhe kthimin, po ashtu kishte rezultate pozitive. Për shembull, MKK si ministria përgjegjëse e linjës, mori në dorë bashkërendimin për procesin e hartimit dhe për miratimin e strategjive përkatëse e të planeve të veprimit.⁵⁴ Një iniciativë tjetër pozitive mund të vihet re në kontributin e Zyrës për Çështjet e Komuniteteve lidhur me procesin e reformës për Komisionin e Gjuhës në vitin 2011 dhe 2012, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në takimet e grupit të punës në nivelin qendror, si dhe duke luajtur rolin e bashkërenduesit mes institucioneve përkatëse me qëllim që të sigurohej se përfaqësuesit e saj ishin emëruar në Rrjetin e Politikave të Gjuhës⁵⁵. Këshilli Konsultativ i Komuniteteve ofroi edhe një mundësi për komunitetin kroat të Kosovës për të ndikuar qasjen e politikave në promovimin e identitetit të komuniteteve joshumicë. Si rezultat i avokimeve të suksesshme, komuniteti kroat i Kosovës njihet tani si një nga komunitetet joshumicë në Ligjin mbi Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Komuniteteve dhe të Drejtave të Pjesëtarëve të tyre në Kosovë.⁵⁶
49. Koordinatorët e NjDNJ-ve komunale kanë vënë re disa shembuj të suksesshëm të përfshirjes në zhvillimin e politikave deri aty sa koordinatori, me iniciativën e vet ose me mbështetjen e menaxhmentit të lartë komunal dhe të shoqërisë civile, ka vendosur të luajë rol aktiv. Kjo është vënë re në veçanti në fushën e barazisë gjinore nëpër komuna, aty ku ZBGj komunale është edhe koordinatorë e NjDNJ-së. Për shembull, në Prizren NjDNJ mori në dorë rolin bashkërendues, e në disa raste drejtues, në hartimin e planit komunal të veprimit mbi barazinë gjinore 2012-2014 (fillimisht i planifikuar si strategji) që u miratua nga kuvendi komunal. Një kontribut të ngjashëm në hartimin e planit vendor të veprimit për komunitetet e Romëve, Ashkalijve dhe Egjiptianëve, është dhënë edhe nga NjDNJ në Fushë Kosovë. Po ashtu, ZBGj komunale në Dragash, që është anëtare e NjDNJ, inicoi miratimin e strategjisë komunale më 2012 nga kuvendi komunal⁵⁷. Koordinatori i NjDNJ në Prizren deklaroi se të dhënat mbi braktisjen e shkollës ishin përdorur si bazë për këto strategji dhe se këto të dhëna ishin mblodhur përmes pyetësorëve, në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile. Një shembull tjetër i cituar është ai mbi zhvillimin e politikave që lidhen me projekt-Rregulloren komunale mbi Gjobat, Taksat dhe Bizneset, me ç’rast edhe koordinatori i NjDNJ-së, që është edhe pjesëtar i komisionit mbi taksat komunale, kishte propozuar përjashtimin e bizneseve në pronësi të grave nga gjoba të caktuara. Megjithatë, ky sugjerim përfundimisht u hodh poshtë, meqë komuna pati frikë se bizneset do ta ndryshonin pronësinë e tyre të gratë, të paktën nëpër dokumente, me qëllim që të përfitonin nga ky përjashtim dhe se mbledhja e taksave komunale nëpërmjet gjobave do të dëmtohej. Koordinatorët e NjDNJ

53 Informacioni u sigurua nga koordinatori të NjDNJ dhe/apo anëtarët gjatë Misionit të Parë Vlerësues.

54 Për shembull, Strategjia për Komunitetet dhe Kthimin e MKK 2009–2013, (2010).

55 Buletini Vjetor i Zyrës për Çështjet Komunitare, (data nuk është specifikuar), f. 5-7.

56 Shih Ligjin Nr. 04/L-020 ndryshimi i Ligjit Nr. 03/L-047 mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të tyre në Kosovë, (2011), Neni 1.4.

57 Raportimet e ekipeve në terren të OSBE-së lidhur me Pyetësorin mbi Njësitë e të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna, përshkrim i përgjithshëm rajonal për Prizrenin, (qershor 2013).

shihet se kontribuojnë edhe në procesin e zhvillimit të politikave përmes pjesëmarrjes së rregullt në takimet e menaxhmentit të lartë komunal dhe të grupeve të ndryshme ndërkomunale të punës, ku koordinatorët japin këshilla për rezultatet përfundimtare të këtij procesi, p.sh., me idetë mbi politikat, projekt-aktet komunale, vendimet dhe legjislacionin. Megjithatë, përfshirja e tyre në procesin e politikëbërjes mbështetet shumë në perceptimin/sjelljen e zyrtarëve individualë të komunës ndaj tyre, pra kjo përcakton nëse ata marrin pjesë për të marrë pjesë në takimet e rregullta të organeve ekzekutive të komunës, (në të cilat diskutohen edhe strategjitë dhe veprimet e veçanta në fusha të caktuara). Për shembull, anëtari i NjDNj në Dragash ka informuar se zyrtari komunal ligjor dhe/ose zyrtarët e tjerë përkatës të komunës hartojnë dokumente komunale të të gjitha llojeve, pa e konsultuar NjDNj-në si organ⁵⁸. E njëjta çështje është ngritur edhe nga koordinatori i NjDNj në Kaçanik⁵⁹. Në rajonin e Prishtinës, vetëm në Komunën e Shtimjes, NjDNj jep kontributin e vet në procesin hartues të akteve dhe politikave komunale, sepse zyrtari komunal ligjor, është edhe koordinator i NjDNj⁶⁰. Po ashtu, në rajonin e Pejës, Istogu është komuna e vetme ku NjDNj jep kontributin e saj për përgatitjen e akteve komunale. Së fundmi, ata kanë mbështetur zyrtarin ligjor komunal për hartimin e rregullores mbi punën e kuvendit komunal dhe të rregullores mbi disiplinën dhe kodin e sjelljes në shkollë⁶¹. Në rajonin e Gjilanit paraqitet një situatë e ngjashme, meqë përpjekjet e NjDNj për të dhënë kontributin e vet në legjislacionin komunal zakonisht injorohen, me përjashtim të rastit të hartimit të dokumenteve mbi barazinë gjinore⁶². Pavarësisht prej kësaj, një shembull pozitiv është vënë re në Prizren, ku koordinatorja e NjDNj vlerësoi se e gëzonte përfshirje të mjaftueshme në punën komunale, dhe ndihej e respektuar nga drejtorët komunalë dhe kryetari i komunës. Këtë e konkretizoi duke përmendur ftesat e rregullta për pjesëmarrje në takimet e kryetarit të komunës me drejtorët komunalë, me ç'rast rekomandimet e saj merren në konsideratë nga menaxhmenti i lartë⁶³. Ngjashëm, në Gjakovë, Mitrovicë dhe Suharekë, koordinatorët e NjDNj përpiqen të marrin pjesë në sesionet e kuvendit komunal dhe të dy komisioneve të rregullta të tij, për të vëzhguar dhe reaguar kur ndonjë vendim shkel parimet e të drejtave të njeriut. Ata japin edhe komente mbi projekt-aktet komunale dhe vendimet aty-për-aty gjatë këtyre takimeve.⁶⁴

4.3. Mangësitë

50. Ka një përzierje faktorësh të përgjithshëm dhe specifikë për institucionet, që kanë rezultuar me mangësi në zhvillimin e procedurave në fushën e të drejtave të njeriut.
51. Faktori i parë është pa dyshim arsimimi i dobët ligjor dhe njohuritë e pamjaftueshme mbi standardet e të drejtave të njeriut tek shumica e politikëbërësve. Me gjithë mundësitë e trajnimeve të shumta të ofruara kryesisht nga organizatat ndërkombëtare, jo të gjithë zyrtarët qeveritarë në nivel qendror e lokal që janë në krye të zhvillimit të politikave, mund të konsiderohen si të pajisur me një mirëkuptim të nocioneve të të drejtave të njeriut dhe aplikimit praktik të tyre në punën e tyre të përditshme. Për më tej, çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut shpesh konsiderohen si përgjegjësi e organeve të caktuara, p.sh. NjDNj, në vend se të kthehen në qendër të vëmendjes në

58 Raportimet e ekipeve në terren të OSBE-së lidhur me Pyetësorin mbi Njësitë e të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna, përshkrim i përgjithshëm rajonal për Prizrenin, (qershor 2013).

59 Raportimet e ekipeve në terren të OSBE-së lidhur me Pyetësorin mbi Njësitë e të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna, përshkrim i përgjithshëm rajonal për Gjilanin, (qershor 2013).

60 Raportimet e ekipeve në terren të OSBE-së lidhur me Pyetësorin mbi Njësitë e të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna, përshkrim i përgjithshëm rajonal për Prishtinën, (qershor 2013).

61 Raportimet e ekipeve në terren të OSBE-së lidhur me Pyetësorin mbi Njësitë e të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna, përshkrim i përgjithshëm rajonal për Pejën, (qershor 2013).

62 Raportuar nga NjDNj në Kaçanik, Novobërdë, Ranilluge dhe Han të Elezit. Raportimet e ekipeve në terren të OSBE-së lidhur me Pyetësorin mbi Njësitë e të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna, përshkrim i përgjithshëm rajonal për Gjilanin, (qershor 2013).

63 Takim me Koordinatorin e NjDNj të Prizrenit, Misioni i Parë Vlerësues. Një qasje e tillë nuk rezultoi përherë me sukses. Për shembull, koordinatori i NjDNj në Mitrovicë deklaroi gjatë Misionit të Parë Vlerësues se jo të gjitha rekomandimet ishin marrë në konsideratë nga ana e menaxhmentit të lartë komunal. Megjithatë, në Prizren, është shënuar një shembull modest pozitiv kur rekomandimet e koordinatorit të NjDNj bëri që zyrtarët e komunës të konsideronin një balancim gjinor lidhur me emërimin e anëtarëve të komisioneve komunale.

64 Raportimet e ekipeve në terren të OSBE-së lidhur me Pyetësorin mbi Njësitë e të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna, përshkrim i përgjithshëm rajonal për Prizrenin, (qershor 2013).

punën e përgjithshme të institucioneve. Gjithashtu, mospërputhja e kualifikimeve të personelit të ri me kërkesat për vendet e caktuara të punës, si dhe lëvizjet e shpeshta të nëpunësve, i kontribuojnë këtij problemi⁶⁵.

52. Së dyti, politikat e veçanta të të drejtave të njeriut zhvillohen me pak ose pa konsideratë ndaj kontributit të tyre në kornizat më të gjerë të politikave, të tilla si: Plani i Veprimit të Partneritetit European, Plani Vjetor i Punës së Qeverisë dhe strategjitë e sektorëve. Lidhja mes politikave të veçanta të të drejtave të njeriut dhe përmbushjes së detyrimeve ndaj organeve ndërkombëtare, është po ashtu mjaft e varfër. Për shembull, statusi i veçantë i Kosovës do të thotë që raportimi tek organet e traktatit të OKB-së është kryer zakonisht nëpërmjet Misionit të Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) sesa nga ndonjëra prej strukturave të të drejtave të njeriut në nivelin qendror⁶⁶ dhe, megjithëse kjo nuk duhet të jetë relevante sa i përket cilësisë së raportit, duket se ka pasur njëfarë efekti negativ në zhvillimin e aftësive dhe përvojës së personelit të këtyre strukturave⁶⁷.
53. Së treti, zhvillimi i politikave nuk bazohet mbi vlerësimin e nevojave aktuale apo mbi analizimin e situatës. Për më tej, institucionet nuk mbledhin sistematikisht të dhëna të brendshme as nuk përdorin statistika si një mjet politikash, edhe kur këto janë të disponueshme.⁶⁸ Për shembull, Enti Statistikor i Kosovës prodhon dhe publikon të dhëna përkatëse, duke përfshirë gjininë, arsimin, shëndetësinë dhe punën, në faqen e internetit, si dhe në formën e raporteve publike. Megjithatë, me përjashtim të MASHT-it, nuk ka bashkëpunim zyrtar mes ESK-së dhe institucioneve të tjera qeveritare lidhur me mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave⁶⁹. Ka disa statistika të disponueshme në mënyrë të brendshme, që mbahen nëpër departamentet e personelit të institucioneve, dhe ka pasur raste kur NjDNj-të ose ZBGj-të nëpër ministri dhe komuna i kanë zbërthyer ato sipas gjinisë dhe etnisë dhe i kanë ndarë rezultatet me ZQM, ABGj dhe institucione të tjera sipas kërkesave. Megjithatë, edhe kur kërkesa të tilla arrijnë, vihen re ende mungesa e bashkërendimit dhe dyfishime mes institucioneve të tilla si: ZQM, ABGj dhe MAPL-së⁷⁰. Për më tej, nuk mbahen shënime të sakta mbi gjetjet e procesit të monitorimit – pavarësisht se cilat janë mangësitë e tij – në procesin e planifikimit të politikave.
54. Së katërti, dokumentet mbi politikat, të tilla si strategjitë dhe planet e veprimit ndonjëherë janë të paqarta dhe nuk ofrojnë synime realiste për t'i arritur qëllimet brenda afateve kohore dhe me burimet njerëzore e financiare në dispozicion. Për shembull, Strategjia dhe Plani Veprues mbi të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës, 2009-2011, është instrument veçanërisht i rëndësishëm për qasjen e politikave të përgjithshme ndaj të drejtave të njeriut dhe duhet të lidhet ngushtë me detyrimet për t'i zbatuar instrumentet ndërkombëtare e rajonale, si dhe me përmbushjen e legjisacionit të BE-së dhe kriteret e përafritim për të drejtat e njeriut dhe mundësitë e barabarta. Megjithatë, këtij instrumenti i mungon analizimi i duhur i situatës, objektivat e qartë, treguesit e matshëm, standardet statistikore, synimet e pritshme dhe mjetet financiare për zbatimin e tij. Po ashtu, Programi Kosovar mbi Barazinë Gjinore – që duhet të jetë po aq i rëndësishëm për çështjen gjinore – vuan nga përkufizimi jo i qartë i masave që kanë ndikim të konsiderueshëm në identifikimin e duhur të institucioneve zbatuese dhe kostove preventive. Asnjëri nga të dy dokumentet nuk e adreson çështjen e kapacitetit metodologjik të institucioneve përkatëse (p.sh. ministrive të linjës) për t'i vlerësuar në mënyrë efektive perspektivat e të drejtave

65 Intervistë me Divizionin për Avancimin e të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna, Ministria për Administrimin e Qeverisjes Lokale (MAQL), Misioni i Parë Vlerësues. Po ashtu siç përmendet edhe në raportin e M A Jones dhe I Roagna, Raport Vlerësues (Shtojca V për rigjenerimin e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Kosovë, Projekti i Përbashkët i Bashkimit European/Këshillit të Europës Raporti Fillestar), (2012), lidhur me Institucionin e Avokatit të Popullit dhe personelin e NjDNj.

66 Por shih para. 164.

67 Për një diskutim të plotë mbi këtë çështje, shih FRIDOM, Rishikimi Funkcional i të Drejtave të Njeriut dhe Sistemit të Barazisë Gjinore, (2010), f. 16-14. Çështja e raportimit tek institucionet ndërkombëtare, është ngritur po ashtu, edhe gjatë një interviste me Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) Zyra e Përfaqësuesit të Vetëm në Kosovë, Misioni i Parë Vlerësues.

68 Raporti i ZQM (2012), f. 23-25.

69 Intervistë me Drejtorin e Entit të Statistikave të Kosovës, Misioni i Parë Vlerësues.

70 Intervista me koordinatoret dhe personelin e NjDNj, Misioni i Parë Vlerësues.

të njeriut dhe ato gjinore në procesin e hartimit të politikave të tyre.⁷¹

55. Së pesti, ndërkohë që duhet vlerësuar qasja transparente dhe përfshirëse e ABGj dhe ZQM, ekzistojnë edhe disa mangësi që lidhen me kapacitetin e tyre (si burimet e kufizuara njerëzore⁷², mungesa e ekspertizës së kërkuar për përgatitjen e dokumenteve të cilësisë së lartë⁷³ dhe një mandat tejet i zgjeruar⁷⁴) që kanë rezultuar në varësinë e tyre më të madhe nga asistenca e jashtme në aspektin afatgjatë. Si pasojë, ato ose kanë mbetur vetëm si koordinatorë mes hisedarëve të ndryshëm – dhe kështu kanë bërë shumë pak punë vetë për zhvillimin e politikave – ose në disa raste edhe kanë dështuar që të zbatojnë funksionet e zhvillimit të politikave në të gjitha fushat e mandatit të tyre. Për shembull, siç ka theksuar edhe ZQM “përkrahja e jashtëzakonshme dhe kontributi i vlefshëm nga organizatat ndërkombëtare dhe ato të shoqërisë civile” (OShC) kanë qenë jetike për përgatitjen e Strategjisë dhe Planit të Veprimit mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë (SPVDNj) 2009-2011.⁷⁵ Mbështetja në kontribute të tilla vazhdon të ketë një efekt pasiv ndaj çdo përpjekjeje të bërë për fuqizimin e kapacitetit institucional të ZQM. Në kohën e hartimit të këtij raporti, kanë kaluar pothuajse dy vjet nga skadimi i SPVDNj 2009-2011 dhe ZQM mbështetjet në asistencë të jashtme për ta kryer zëvendësimin. Po ashtu, me mbështetjen financiare të Programit Zhvillimor të Kombeve të Bashkuara (UNDP), ABGj ka caktuar një OShC, Rrjeti Kosovar i Grave (RrKG), që të kryejë një kërkim mbi Strategjinë e parë Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër Dhunës në Familje në Kosovë, për ta përdorur atë si studim bazë për zhvillimin e politikave të veta mbi dhunën në familje.⁷⁶ Paaftësia e ABGj-së që të prodhojë një dokument të tillë kyç, vë në pah mungesën e kapaciteteve të saj dhe të personelit të kualifikuar.
56. Së fundmi, struktura me shumështruar e mekanizmave të të drejtave të njeriut mund të çojë në konfuzion mbi përgjegjësitë e veçanta institucionale për zhvillimin e politikave. Për shembull, deri para do kohësh edhe ZQM edhe ABGj ishin në krye të barazisë gjinore, duke krijuar strukturë dyshe në bashkërendimin dhe zhvillimin e politikave. Për më tej, mungesa e vetëdijesimit të publikut lidhur me mandatin dhe punën e mekanizmave të të drejtave të njeriut, po ashtu pengon kontributin e mundshëm dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin e politikëbërjes. Për shembull, shumica e OShC-ve thanë që nuk ishin në dijeni të ekzistencës dhe punës së strukturave të NjDNj në nivelet qendrore dhe lokale.
57. Në përgjithësi, ka mungesë qartësie lidhur me atë se cilat institucione kanë për detyrë të trajtojnë aspektet e veçanta të zhvillimit të politikave, si dhe lidhur se cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të sakta. Për më tej, fusha e tyre e përgjegjësisë, siç shihet në rastin e ZQM, mund të jetë e stërmadhe dhe e vështirë për t’u përbushur, sidomos kur merren në konsideratë burimet njerëzore që kanë në dispozicion. Anëtarët e personelit që punojnë për këto institucione nuk i kanë njohuritë dhe aftësitë përkatëse për politikëbërjen e të drejtave të njeriut. Kjo shpesh çon te një mbështetje e madhe në asistencën e jashtme dhe një dështim për të marrë pronësinë lidhur me zbatimin dhe monitorimin e politikave në një të ardhme, pasi të jenë miratuar ato. Së bashku me mungesën e detyrimeve mbi raportimin e duhur të instrumenteve/standardeve të të drejtave të njeriut, shpesh nuk është e mundur që këto institucione të mbahen përgjegjëse për plotësimin e detyrimeve të tyre mbi zhvillimin e politikave. Mungesa e presionit publik dhe e kryerjes së rolit mbikëqyrës nga shoqëria civile, u kontribuojnë këtyre mangësive.

⁷¹ Për një vlerësim të detajuar, shih raportin FRIDOM, (2010), f. 9-10.

⁷² Në kohën e raportimit, ZQM kishte vetëm 8 vetë personel (Drejtorin dhe 7 zyrtarë të lartë), dhe ABGJ kishte 17 vetë personel (bazuar në organogramin e faqes së internetit të ABGJ).

⁷³ Për shembull, një konsultant i paguar nga UNICEF-i u integrua në strukturë me qëllim që të siguronte asistencë në përcaktimin e një kornize të re monitoruese që e ndryshon metodologjinë dhe metodën e mbledhjes së të dhënave lidhur me zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve (2013-2009). Për më shumë informacion, shih Raportin e ZQM mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës (2011-2009), Periudha janar-dhjetor 2012, 2011, fq. 18.

⁷⁴ Që kur është themeluar, Drejtori i ZQM gradualisht ka okupuar edhe postet shtesë, duke vepruar edhe si koordinatori kombëtar për të drejtat e njeriut, anti-korrupsionit, të drejtat e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara.

⁷⁵ SPVDNj 2009-2011, f. 5 dhe 6.

⁷⁶ ABGJ, Siguria fillon në Vend: Kërkim për informimin e Strategjisë së Parë Kombëtare dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje në Kosovë, (2008).

5. ZBATIMI

5.1 Institucionet përkatëse

58. Përgjegjësia kryesore për zbatimin e politikave dhe ligjeve që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut bie qartë mbi ministrinë dhe komunat përkatëse, meqë këto politika dhe ligje përshkruajnë veprimtarinë që duhen ndërmarrë, si dhe standardet që duhen pasur parasysh prej tyre. Kjo mund të nënkuptojë kërkesa të karakterit pozitiv për ministrinë dhe komunat (të tilla si ofrimet e standardeve të caktuara të arsimit dhe shëndetësisë), si dhe të karakterit negativ (të tilla si detyra për të mos diskriminuar dhe detyra për të mos ndërhyrë në liritë dhe privacinë e individit).
59. Ndonëse përgjegjësitë e veçanta lidhur me zbatimin bien mbi ministrinë dhe komunat, strukturat jogjyqësore të të drejtave të njeriut si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal, luajnë po ashtu një rol në sigurimin dhe lehtësimin e ushtrimit të këtyre përgjegjësive. Megjithatë, ky është një rol që përfshin më shumë ofrimin e përkrahjes, inkurajimit dhe të nxitjes, sesa të ofrimit të drejtimeve.
60. Në nivelin qendror, ZQM është organi kryesor bashkërendues për zbatimin e strategjive të veçanta dhe të planeve të veprimit të të drejtave të njeriut, të tilla si SPVDNj nëpër ministri, qeverinë lokale dhe institucionet e tjera. Po ashtu, NjDNj gëzojnë mandatin që të sigurojnë zbatimin e ligjeve të miratuara nga Parlamenti dhe qeveria e që bien nën përgjegjësitë dhe kompetencat e ministrive dhe të komunave përkatëse. Për këtë qëllim, NjDNj-të marrin pjesë në takimet e rregullta të procesit të vendimmarrjes dhe ofrojnë këshilla mbi standardet e të drejtave të njeriut që duhen repektuar dhe përmbushur nga ministrinë dhe komunat në fjalë.
61. Megjithatë, roli lidhur me zbatimin e Ligjit mbi Barazinë Gjinore i është caktuar një institucioni të veçantë brenda Zyrës së Kryeministrit, ABGj-së, e cila synon të promovojë, mbrojë dhe të çojë përpara pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Për ta arritur këtë, ABGj bashkërendon zbatimin e Programit Kosovar mbi Barazinë Gjinore 2008-2013. Ky Program, si instrumenti kryesor i politikës mbi barazinë gjinore, synon të ofrojë një orientim për ABGj, duke i lidhur objektivat strategjike me masat për zbatimin dhe kostot buxhetore të tyre në Planin e Veprimit. ZBGj nëpër ministri dhe komuna e ndihmojnë ABGj të arrijë integrimin e perspektivës së barazisë gjinore në zhvillimet e përgjithshme institucionale, duke dhënë rekomandime dhe komente mbi projekt-aktet, vendimet dhe legjislacionin.
62. Ministria për Komunitete dhe Kthim ka disa përgjegjësi për zbatimin e legjislacionit, të strategjisë dhe të planit të veprimit në promovimin dhe mbrojtjen e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre. Kjo detyrë kryhet, ndër të tjera, edhe me anë të dizajnit të projekteve, të planifikimit dhe zbatimit të kthimeve të organizuara dhe individuale, si dhe me anë të përkrahjes së përpjekjeve të personelit komunal dhe të iniciativave të shoqërisë civile për adresimin e çështjeve të komuniteteve dhe atyre të kthimeve.
63. Në nivelin lokal, Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthime merren me zbatimin e iniciativave riintegruese dhe zhvillimore që synojnë të krijojnë kushte të përshtatshme për kthimet e qëndrueshme, siç janë garantimi i qasjes në të drejtat dhe shërbimet themelore, duke përfshirë të drejtat e pronës, të kujdesit shëndetësor, të arsimit dhe të punësimit. Detyrat e ZKKK përfshijnë këshillimin dhe asistencën e dhënë për institucionet përkatëse komunale dhe siguruesit e shërbimeve të tjera publike për zbatimin e politikave qeveritare mbi komunitetet joshumicë, duke përfshirë edhe çështjet që lidhen me të kthyerit dhe riintegrimin⁷⁷. Gjithashtu ato kanë detyrën e zhvillimit të strategjive ose planeve të veprimit komunale për kthimet me qëllim të zbatimit të

⁷⁷ Si shembull pozitiv, anëtarët e Zyrës Komunale për Komunitetet dhe Kthimet në Dragash, kanë raportuar ndërhyrje kur kanë vënë re shkelje të të drejtave të njeriut, veçanërisht në fushën e gjuhës së përdorur nga institucionet publike. Raportimi i ekipeve në terren të OSBE-së për Pyetësorin mbi NjDNj nëpër komuna, përshkrim i përgjithshëm për Prizrenin, (qershor 2013).

ligjeve dhe të politikave qeveritare, për t'ua ofruar institucioneve komunale një kornizë pune që t'ua udhëheqë veprimtaritë në këtë fushë⁷⁸.

5.2. Arritjet

64. NjDNj nëpër komuna duket se janë përfshirë në zbatimin e kornizave kyç të politikave vetëm në disa fusha, të tilla si, barazia gjinore, qasja e barabartë në mundësitë e punësimit, dhe të drejtat e fëmijëve e të personave me aftësi të kufizuara, si dhe ato të nëpunësve civilë. Megjithatë, koordinatorët e NjDNj, në përgjithësi, e konsiderojnë rolin e tyre si këshillues dhe jo si ekzekutiv në zbatimin e politikave, të legjislacionit dhe të strategjive të të drejtave të njeriut⁷⁹. Për shembull, koordinatorët e NjDNj që janë edhe ZBGJ, kanë insistuar në zbatimin e shifrës dyzet për qind të standardit të përfaqësimit gjinor në shërbimet komunale dhe në procesin e vendimmarrjes⁸⁰. Po ashtu pjesëmarrja e NjDNj në komisionet disiplinore⁸¹, si dhe ndërhyrja e tyre me qëllimin e nxjerrjes në pah të shkeljeve dhe gabimeve potenciale të disave prej tyre në panelet e rekrutimit, ndoshta ndihmon në sigurimin e zbatimit të kornizës së punës për çështjet e antidiskriminimit dhe barazisë gjinore në praktikë⁸².
65. Tablo e ngjashme vihet re edhe me NjDNj nëpër ministrinë e ndryshme, të cilat sigurohen për përputhshmërinë e ministrive me të drejtat e njeriut, duke u dhënë këshilla departamenteve përkatëse të të drejtave të njeriut dhe duke ushtruar presion për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në rastet kur janë konstatuar shkelje të tilla. Për më tej, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) ka marrë parasysh një raport të ankesave të personelit lidhur me çështjet e diskriminimit apo ngacmimit mes pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës⁸³.
66. Një instancë e zbatimit nga ana e MKK në vitin 2012, ishte edhe krijimi i fondit të përbashkët për ndërtimin e 75 shtëpive në vende të ndryshme me synimin e përkrahjes së familjeve të kthyer. Po ashtu, MKK ka ndihmuar Komunën e Klinës në riparimin e shtëpisë së një personi të kthyer në fshatin Drenovc, e cila kishte marrë flakë⁸⁴.

5.3. Mangësitë

67. Ka disa faktorë që kanë një impakt negativ në zbatimin e politikave dhe ligjeve në përgjithësi, e le më pastaj atyre politikave dhe ligjeve të veçanta që merren me të drejtat e njeriut.
68. Së pari, mungesa e vullnetit politik dhe/ose një prioritet i ulët për një çështje në programin e qeverisë mund të çojë në mosshpërndarjen e nevojshme të burimeve njerëzore dhe të buxhetit për realizimin e strategjive dhe planeve të veprimit që lidhen me të drejtat e njeriut, veçanërisht kur nuk ka pasur një përfshirje të mjaftueshme në procesin që ka çuar në miratimin e tyre.
69. Për më tej, kornizat e miratuara për veprim mund të mbeten të pazbatuara kur zyrtarët në krye të zbatimit të tyre kanë mangësi njohurish të politikave dhe të legjislacionit përkatës ose kur nuk

78 Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Një Vlerësim i Procesit të Kthimeve Vullnetare në Kosovë*, (2012), f. 8-9.

79 Sipas koordinatorit të NjDNj në Malishevë, zyrtarët e komunës nuk e kuptojnë rëndësinë e rolit të NjDNj; si rezultat ata nuk ndajnë informacionin, nuk e përfshijnë apo nuk e kërkojnë mendimin e NjDNj përpara zbatimit të politikave dhe legjislacionit. Raportimi i ekipeve në terren të OSBE-së për Pyetësin mbi Njësitë Komunale të të Drejtave të Njeriut, përkrahim i përgjithshëm rajonal për Prizrenin, (qershor 2013).

80 Në vitin 2010, koordinatori i NjDNj në Fushë Kosovë ka luajtur një rol proaktiv kur i ka kërkuar kryetarit të komunës mbështetje për pjesëmarrjen e grave në dy komisione të detyrueshme të kuvendit komunal me prezantimin e kuotave. Raportimi i ekipeve në terren të OSBE-së për Pyetësin mbi Njësitë Komunale të të Drejtave të Njeriut, përkrahim i përgjithshëm rajonal për Prishtinën, (qershor 2013).

81 Për shembull, përbërja e panelit komunal të intervistës dhe komisionit të ankesave përfshin një anëtar të NjDNj në Malishevë. Në mënyrë të ngjashme, koordinatori i NjDNj në Fushë Kosovë merr pjesë rregullisht në panelet e rekrutimit të komunës. Raportimi i ekipeve në terren të OSBE-së për Pyetësin mbi Njësitë Komunale të të Drejtave të Njeriut, përkrahim i përgjithshëm rajonal për Prizrenin dhe Prishtinën, (qershor 2013).

82 Siç është raportuar nga NjDNj në ZQM në raportin e vitit 2011 mbi zbatimin e SPVDNj, f. 153-232.

83 Intervistë me NjDNj në ministri gjatë qershorit të vitit 2013, Misioni i Parë Vlerësues

84 MKK, Objektivi 6, (data e paspecifikuar).

ushtrohet presion për të vepruar nga publiku i gjerë sepse ai (publiku) nuk ka besim në kapacitetin dhe vullnetin e zyrtarëve për të kryer përgjegjësitë e tyre.

70. Në çdo rast, për zbatimin e çdo kornize pune, politika duhet të jetë e menduar mirë dhe e planifikuar sipas një procesi të gjithanshëm e transparent duke i përfshirë të gjithë aktorët përkatës. Mjetet e zbatimit duhet të identifikohen qartë dhe të reflektohen në dokument, duke detajuar hapat e mëtejshëm (pra aprovimin e legjislacionit dytësor, strategjitë dhe planet e veprimit; caktimin e institucioneve zbatuese, kostot buxhetore, afatin ligjor dhe rezultatet e pritshme). Megjithatë, siç e thekson edhe raporti FRIDOM, SPVDNj për vitin 2009-2011, që presupozohet të përcaktojë edhe qasjen kryesore të politikës ndaj të drejtave të njeriut dhe përmbushjes së tyre, sjell një vlerë të paktë në mekanizmat kompleksë ekzistues të të drejtave të njeriut në Kosovë. Dokumentit i mungojnë disa elemente të caktuara që janë mjaft të nevojshme për zbatimin e tij: caktimi i qartë i përgjegjësisë institucionale, përcaktimi i një afati kohor për analiza krahasuese (p.sh. formularët e raportimit, mbledhja e të dhënave, etj...), standardi matës apo synimi i pritshëm, planifikimi financiar.
71. Mandati i ZQM, si një organ bashkërendues për zbatimin e Strategjisë sjell një shtresë tjetër në natyrën e saj të komplikuar, dhe i pengon aktorët përkatës të marrin pronësinë e plotë të zbatimit të saj⁸⁵. Raporti i ZQM i vitit 2011 mbi zbatimin e SPVDNj 2009-2011 e mbështet këtë analizë, sepse paraqet një listë të paintegruar veprimtarish të kryera nga institucionet për të zbatuar dokumentin strategjik.
72. Për më tej, disa ministri dhe komuna i shënojnë donatorët e jashtëm ose organizatat e shoqërisë civile, si aktorët përgjegjës për realizimin e objektivave që janë në qendër të mandatit të tyre. Partneri zbatues i një veprimtarie projekti duket se ngatërrohet me institucionet e shumta të cilat kanë për detyrë të zbatojnë objektivat e përcaktuara nga SPVDNj⁸⁶.
73. Një mangësi e ngjashme mund të diktohet gjithashtu edhe lidhur me zbatimin e Strategjisë së Integritetit të Komuniteteve të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve në Kosovo (SKRAE) 2009-2015, dhe Planin e saj të Veprimit. Dedikimi i një institucioni për zbatimin e saj u rrit vetëm kur një pjesë e veçantë (dhe më e menaxhueshme) e kësaj strategjie iu la ministrisë së caktuar. Për shembull, MASHT kryesoi hartimin, zbatimin dhe monitorimin e komponentit të Strategjisë të arsimit.
74. Për më tej, për shkak të mungesës së qartësisë së institucioneve përgjegjëse dhe mandatit të tyre, hisedarët duket se nuk i caktuan burimet për zbatimin e dokumenteve strategjike. Kjo është vënë re veçanërisht në raportin e ZQM të vitit 2011, mbi zbatimin e SPVDNj. Në të vërtetë, vetëm disa institucione kanë raportuar mbi burimet/fondet në dispozicion për të realizuar objektivat dhe për të zbatuar veprimtaritë. Shpesh ato duket se mbështeteshin tek donatorët e jashtëm (organizatat ndërkombëtare, ambasadat, etj..) për të kryer përgjegjësitë e tyre primare. Kjo përbën një mangësi në procesin e zhvillimit të politikave, që domosdoshmërisht ka një efekt të kundërt në zbatimin e politikave në fjalë.
75. Së fundmi, personeli i caktuar për zbatimin e SPVDNj, po ashtu, duket se ka mangësi mjetesh dhe aftësish për të realizuar detyrat e tyre. Për shembull, NjDNj në shumicën e komunave nuk e kanë e personelin të plotë, dhe nuk kanë linjat e veta buxhetore për të zbatuar planin e vet të punës, nëse e kanë⁸⁷. Nga ana tjetër, NjDNj në nivelin ministror, pavarësisht se kanë personel dhe buxhet të mjaftueshëm, nuk duket se fokusohen në rolin e tyre për të siguruar zbatimin e politikave dhe të legjislacionit për të mirën e njerëzve. Fokusi është disi i zbehtë nga banorët tek

⁸⁵ Për një vlerësim të detajuar, shih raportin FRIDOM, (2010), fq. 10-9.

⁸⁶ Raporti i ZQM mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës (2009-2011), Periudha janar-dhjetor 2011, (2012), f. 27-239.

⁸⁷ Ministria e Administrimit të Qeverisjes Lokave (MAQL) Divizioni mbi të Drejtat e Njeriut, Promovimi i të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna në Republikën e Kosovës, (2013); pyetësorët e plotësuar nga koordinatorët e NjDNj në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Kosovë.

kolegët e tyre ministri. Atëherë kur u kërkohet, ata hartojnë të dhëna dhe statistika, aty ku janë në dispozicion, nga departamentet/organet përkatëse dhe sigurojnë një imazh thuajse përshkrues të nivelit të zbatimit të politikave dhe legjislacionit. Varësia e të gjitha NjDNj tek menaxhmenti i lartë (p.sh. tek kryetari i komunës/drejtori i administratës dhe sekretari i përhershëm) për shkak të vlerësimit të tyre të punës, shkakton padyshim rezultate penguese për të bërë vlerësime krejtësisht objektive për nëpunësit e tyre⁸⁸.

6. PROMOVIMI

6.1 Institucionet Përkatëse

76. Aspekte të veçanta të përgjegjësisë për të promovuar të drejtat e njeriut i janë dhënë një numri specifik institucionesh, por kjo është gjithashtu diçka që pritet nga të gjitha institucionet publike sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.
77. Prandaj, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka përgjegjësinë e veçantë të promovimit të të drejtave të njeriut duke bërë edhe evokimin publik në mbështetje të tyre. Megjithatë, promovimi është po ashtu një efekt anësor i pashmangshëm i raporteve që IAP lëshon, dhe shqetësimeve që ngrihen nëpërmjet shtypit.
78. Për më tej, një kapacitet specifik ndërtimi dhe rol avokues i është dhënë edhe ZQM, që i mundëson asaj, në veçanti, të organizojë fushata për vetëdijesimin e publikut dhe të bashkëpunojë me shoqërinë civile.
79. Për më tej, ABGj është bërë përgjegjëse për kryerjen e fushatave të vetëdijesimit për të siguruar barazinë gjinore dhe përfaqësimin⁸⁹. Po ashtu, ZBGj nëpër ministri dhe komuna kryejnë veprimtari promovuese që synojnë në normalizimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut.
80. NjDNj nëpër ministri dhe komuna kanë, po ashtu, disa përgjegjësi në promovimin e të drejtave të njeriut, siç ka dhe Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit (në lidhje me komunitetet dhe kthimet), Zyra për Çështjet e Komuniteteve (për çështjet që lidhen me komunitetet), si dhe Zyra e Komisionerit të Gjuhës (lidhur me gjuhët zyrtare dhe ato në përdorim zyrtar).
81. Njëkohësisht, të gjithë administratës i kërkohet të promovojë si parimin e shoqërisë multi-etnike, ashtu edhe atë të drejtave të barabarta gjinore⁹⁰. Për më tej, ekziston edhe kërkesa për promovimin e të drejtave të njeriut në nivelin lokal⁹¹.

6.2 Arritjet

82. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka kryer fushata të vetëdijesimit të publikut, ka printuar dhe shpërndarë pamflete në bashkëpunim me zyrtarin për informacionin për publikun brenda ministrisë⁹². Këto veprimtari kanë pasur të bëjnë me, për shembull, regjistrimin civil të komuniteteve të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve, në luftën kundër dhunës në familje dhe martesave të parakohshme, duke e inkurajuar publikun të ankohet për shkeljen e të drejtave të njeriut (përmes tabelave me mbështetjen e OSBE-së) si dhe duke shënuar data të veçanta të të drejtave të njeriut.
83. Disa NjDNj nëpër ministri janë më aktive sesa disa të tjera në promovimin e të drejtave të njeriut.

⁸⁸ Intervista me NjDNj nëpër ministri, Misioni i Parë Vlerësues.-kapitulli "Metodologjia" duhet të shpjegojë se c'do të thotë "Misioni i parë vlerësues".

⁸⁹ Ligji 2004/2 mbi Barazinë Gjinore në Kosovë, Nenet 4.4, 4.7, 5.2 (c).

⁹⁰ Ligji Nr.03/L-189 (2010) mbi Administratën Shtetërore në Republikën e Kosovës, Neni 18.1.6.

⁹¹ Ligji Nr. 03/L-040 Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale, Neni 17 (i).

⁹² Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Raport Përmbledhës, Promovimi i të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna në Republikën e Kosovës, Prishtinë, shkurt 2013.

Për shembull, NjDNj në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka qenë e përfshirë në një numër të madh veprimtarish promovuese të të drejtave të njeriut, të tilla si promovimi i arsimit gjithëpërfshirës, botimi i broshurave dhe materialeve të tjera promovuese, si dhe mbajtja e ditëve të shënuara për sa i përket të drejtave të njeriut⁹³. Përveç kësaj, kjo NjDNj synon, që përmes rolit të saj këshillues lidhur me ankesat e personelit brenda në ministri, të promovojë të drejtat e njeriut për këta persona. Për më tej, personeli i NjDNj në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka përgatitur broshura mbi të drejtat e njeriut në periudhën 2008/2009 dhe ka dhënë kontributin e saj në fushatën 16 Ditë Aktivizimi për t'i Dhënë Fund Dhunës kundër Grave, e cila udhëhiqej nga Zyra e Grave të OKB-së.

84. Praktika të tjera të mira janë më shumë të lidhura me kapacitetin e rrezes së veprimit të NjDNj, si dhe mbështetjen e brendshme që u ofrohet atyre. Për shembull, NjDNj MZHE ka kryer një fushatë promovimi duke vizituar bizneset e vogla dhe planifikon që të vizitojë ndërmarjet në pronësi shoqërore, pavarësisht se kjo nuk u miratua nga Sekretari i Përgjithshëm⁹⁴.
85. NjDNj nëpër komuna kanë ndërmarrë, po ashtu, disa veprimtari promovuese. Megjithatë, këto veprimtari duket se organizohen mbi baza *ad hoc*, zakonisht rreth datave që shënojnë ditët ndërkombëtare, p.sh. ditën e të drejtave të njeriut, ditën e fëmijëve, javën e luftës së dhunës kundër grave, dhe janë mbështetur/financuar nga organizata të tjera. Për shembull, NjDNj në Fushë Kosovë është përfshirë, me një organizatë ndërkombëtare, në veprimtari të vetëdijesimit të publikut për të mbështetur grupet e pambrojtura dhe të personave në disavantazh, personave me aftësi të kufizuara, minoritetet e grave dhe fëmijët. Po ashtu, NjDNj në Prishtinë është përfshirë në zbatimin e fushatave të vetëdijesimit kundër trafikimit⁹⁵, mbrojtjes së mjedisit, të drejtave trashëguese të grave, martesave të parakohshme dhe mundësive të punësimit të personave me aftësi të kufizuara. NjDNj në Malishevë, ka marrë pjesë edhe në një debat në radio, ka hedhur pamflete dhe ka mbajtur leksione për fëmijët e moshës shkollore mbi të drejtat e fëmijëve, dhe ka organizuar fushata për ndërgjegjësimin e publikut për masat parandaluese të kancerit të gjirit dhe të etheve hemorragjike⁹⁶.
86. Për më tej, ZBGj në Prizren, me mbështetjen dhe asistencën e OSBE-së, ka organizuar çdo vit fushata vetëdijesimi për publikun kundër dhunës në familje, dhe në vitin 2012 NjDNj, ka organizuar edhe një fushatë anti-trafikimi për rritjen e vetëdijesimit të publikut. Përveç kësaj, NjDNj në Prizren organizon takime të rregullta me organizatat e shoqërisë civile dhe në periudhën 2010-2011 ajo ka mbështetur debatet në radio mbi çështjet gjinore si dhe ka marrë pjesë në një program televiziv të titulluar 'Bukuria dhe Fuqia', që synonte të fuqizonte gratë udhëheqëse në shoqëri.

6.3 Mangësitë

87. Qeveria ka miratuar disa instrumente të të drejtave të njeriut që synojnë në promovimin e të drejtave të njeriut. Megjithatë, siç thekson edhe raporti FRIDOM "mangësitë kryesore mbeten në lidhjen e dobët me dokumentet që përcaktojnë politikën e përgjithshme të Qeverisë, dhe në mungesën e specifikave lidhur me objektivat, përgjegjësitë dhe ndikimin buxhetor."⁹⁷ Veprimtaritë mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin qendror mbeten të kufizuara dhe janë përgjithësisht mbi baza *ad hoc*, e nuk janë të ndjekura më tej në përcaktimin e efektit të tyre, si dhe për të përcaktuar fushëveprimin e tyre për shkak të çështjeve të gjera që mbulohen. Përpjekjet për të rritur vetëdijesimin e publikut për sigurimin e të drejtave të njeriut, mbeten të minuara për shkak të mungesës së vullnetit të institucioneve dhe kompetencave të

93 Shih <http://www.masht-gov.net/advCms/?id=51&lng=Alb#id=51.,&limitId=0> (shfrytëzuar më 27 korrik 2013).

94 Intervistë me NjDNj MED, Misioni i Parë Vlerësues.

95 Organizuar dhe mbështetur nga OSBE-ja.

96 Raportimi i ekipeve në terren të OSBE-së për Pyetësin mbi Njësitë Komunale të të Drejtave të Njeriut, përshkrim i përgjithshëm rajonal për Prizrenin (qershor 2013).

97 FRIDOM, Rishikimi Funkcional i Sistemit të të Drejtave të Njeriut dhe Barazisë Gjinore, 2010, fq. 3. http://map.rks-gov.net/userfiles/file/FRIDOM/Fridom_en/Horizontal_Review/Functional_Review_of_Human_Rights_and_Gender_Equality_System_211e.pdf (shfrytëzuar më 21 gusht 2013).

ngjashme në bashkëpunimin mes tyre.

88. Për më tej, edhe fondet e pamjaftueshme mund të pengojnë pa dyshim ndërmarrjen e veprimtarive promovuese. Prandaj, NjDNj në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale deklaroi se mungesa e një buxheti të destinuar nënkuptonte pamundësinë për të organizuar fushata të rritjes së vetëdijesimit të publikut ose ndonjë veprimtari tjetër promovuese për të drejtat e njeriut në ministri. Megjithatë, duket se ekziston edhe një mungesë e ndonjë iniciative për të përdorur materialet që mund të jenë në dispozicion. Prandaj, të dhënat mbi gjininë e të dhëna të tjera ta painteguara që janë marrë nga raportet e ABGj dhe ZQM, nuk janë përdorur asnjëherë nga NjDNj në MPMS për qëllime promovuese. Në një kohë kur NjDNj në MESP mendonte se një fushatë për informimin e publikut mbi rolin e tyre do të ishte e dobishme, kjo nuk u ndërmor asnjëherë dhe nuk u përcaktuan as arsyet për dështimin e saj.
89. Ka, edhe mungesë të bashkëpunimit të mirëfilltë e afatgjatë mes institucioneve që kryesojnë promovimin e të drejtave të njeriut dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe perceptimit të përgjithshëm se strukturat e të drejtave të njeriut janë vetëm një mjet për të promovuar qeverinë dhe jo të drejtat e qytetarëve. Kjo e fundit, pa dyshim përforcohet edhe më tej, nga dështimi për të zbatuar rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit, që sigurisht e minon besueshmërinë e përpjekjeve të tij në promovimin e të drejtave të njeriut.
90. Të marra së bashku, përpjekjet vendore dhe ndërkombëtare nëpërmjet fushatave, trajnimeve dhe shpërndarjes së materialeve promovuese të të drejtave të njeriut, deri më tani, nuk duket se kanë çuar në ndonjë përmirësim të dukshëm të njohurive të popullatës dhe të vullnetit për t'i përdorur të drejtat e veta, të paktën nëse merret si tregues vëllimi i ankesave apo proceseve ligjore për shkeljen e të drejtave të njeriut.

7. REPARACIONI

7.1 Institucionet Përkatëse

91. Kushtetuta siguron për mbrojtjen e një morie të drejtash të njeriut, duke përfshirë edhe të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve ligjore kundrejt vendimeve gjyqësore dhe administrative⁹⁸. Po ashtu, Ligji mbi Procedurën Administrative⁹⁹ thotë që çdo qytetar që beson se të drejtat i janë shkelur, ka mundësi të kërkojë reparacion nëpërmjet mjeteve administrative përkatëse. Si rezultat, ekzistojnë një mori mjeteve gjyqësore dhe administrative, në varësi të vendimit që do të sfidohet.
92. Megjithatë, një numër institucioneve përveç gjykatave gëzojnë mandatin për të siguruar reparacionin për ata që aludojnë shkeljen e të drejtave të tyre njerëzore.
93. Nga këto institucione, Institucioni i Avokatit të Popullit është i vetmi organ i pavarur që u siguron qytetarëve reparacion në të gjithë Kosovën lidhur me aludimet e të gjitha formave të shkeljes së të drejtave të njeriut nga administrata publike. Puna e tij në trajtimin e ankesave asistohet potencialisht edhe nga roli i NjDNj në nivelet e ministrive dhe komunave, si duke u shkruar viktimave, ashtu edhe duke i referuar ankesat potenciale të tyre në Institucionin e Avokatit të Popullit.
94. Në Parlament, Komisioni i të Drejtave të Njeriut, Barazinë Gjinore, Personat e Zhdukur dhe Peticionet, është paraparë, po ashtu, të luajë një rol në reparacionin ndaj qytetarëve, meqë mund të dërgohen peticione nga qytetarët lidhur me të drejtat e njeriut që aludohet të jenë shkelur.
95. Për më shumë, Bordi i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mund të jetë në gjendje të sigurojë reparacionin e atyre nëpunësve civilë që aludojnë se të drejtat e tyre janë shkelur nga administrata shtetërore, që mund të përfshijë edhe çështje të të drejtave të njeriut siç është ndalimi i diskriminimit mes të tjerëve.
96. Megjithatë, ka edhe institucione të caktuara që fokusohen në një fushë të veçantë. Këto përfshijnë Zyrën e Komisionerit të Gjuhës, që është përgjegjëse për t'u marrë me ankesat lidhur me shkeljen e Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve dhe Këshillin Konsultativ të Komuniteteve, i cili herë pas here ka lëshuar rekomandime që lidhen me të drejtat e personave që u përkasin komuniteteve.
97. Njëkohësisht, NjDNj mund të luajnë një rol në lehtësimin e reparacionit duke i tejkualuar institucionet ose duke arritur reparacionin joformal, pavarësisht nga fakti që ato nuk kanë ndonjë mandat të veçantë në këtë drejtim.

7.2 Arritjet

98. Institucioni i Avokatit të Popullit e përmbush rolin e tij nëpërmjet zyrës qendrore të tij si dhe 5 zyrave rajonale,¹⁰⁰ edhe me një zyrë tjetër rajonale që po hapet¹⁰¹ dhe me një tjetër që planifikohet të hapet.¹⁰² Përmes këtyre pikave të kontaktit, IAP është në gjendje të arrijë deri tek qytetarët. Ankesat mund të dërgohen drejtpërdrejt në secilën prej zyrave të IAP, ose gjatë ndonjërit prej vizitave të Zëvendës-Avokatit të Popullit nëpër komuna (ditët e vizitave). Bazuar në Ligjin mbi Barazinë Gjinore¹⁰³ dhe Ligjin mbi Avokatin e Popullit¹⁰⁴, IAP ka themeluar edhe Njësinë e Barazisë Gjinore (NJBGJ), që gëzon mandatin të shqyrtojë ankesat që lidhen me shkelje mbi baza gjinore dhe për të promovuar e monitoruar barazinë gjinore.
99. Në këtë kuptim, në vitin 2011 u morën një numër i përgjithshëm prej 1453 ankesash, që rezultuan

⁹⁸ Neni 32 i Kushtetutës.

⁹⁹ Ligji Nr. 02/L-28

¹⁰⁰ Gracanicë, Pejë, Prizren, Gjiilan, Mitrovicë (një zyrë tjetër në Mitrovicën e Veriut)

¹⁰¹ Ferizaj

¹⁰² Gjakovë

¹⁰³ Nr. 2004/2 mbi Barazinë Gjinore në Kosovë, (2004), Neni 6.

¹⁰⁴ Ligji Nr. 03/L-195 mbi Avokatin e Popullit, (2010), Neni 31.

me 546 hetime.¹⁰⁵ Ndërkohë që subjekti i lëndës së ankesave ka qenë i ndryshëm, tri të paditurit kryesorë në rastet e hetimeve ishin gjykatat (31%), ministrinë (21%) dhe komunat (17%). Në përgjithësi IAP raportoi se 60% e rasteve të përfunduara janë zgjidhur pozitivisht, ndërsa 32% u shpallën të papranueshme¹⁰⁶. Për më tej, gjatë kësaj periudhe, zyra rajonale e Prizrenit deklaroi se në vitin 2011 ata pranuan afërsisht rreth 270-300 raste, nga të cilat 120 ishin të pranueshme dhe 100 prej të cilave janë trajtuar¹⁰⁷.

100. Statistikat për vitin 2012¹⁰⁸ tregojnë një rritje të numrit të ankesave të marra – 1670 – me një rritje të vogël – deri në 33% – të atyre ankesave që janë konsideruar të papranueshme, me mbi gjysmën e tyre që kanë rezultuar nga mospërdorimi i mjeteve ligjore¹⁰⁹. Subjekti i lëndës për ankesat vazhdoi të varionte, por tri të paditurit kryesorë vazhduan të mbeteshin të njëjtë si në vitin 2011, pavarësisht se ka pasur më shumë ankesa lidhur me komunat dhe ministrinë¹¹⁰. Vetëm mbi 51% të rasteve janë zgjidhur me një përfundim pozitiv¹¹¹ dhe një pjesë prej 16.5% të rasteve u mbyllën për shkak të mosinteresimit të paditësit¹¹².
101. Sipas Avokatit të Popullit¹¹³, ka pasur një rritje prej 60% në numrin e ankesave të marra në pesë muajt e parë të vitit 2013, krahasuar me vitin 2012. Kjo duket se ka dalë në bazë të informacionit të zyrave rajonale. Kështu, zyra e Gjilanit raportoi se kishte marrë një numër të përgjithshëm prej 138 rastesh deri më tani¹¹⁴, ajo e Pejës që kishte pranuar një numër të përgjithshëm prej 144 rastesh që mbulonin një mori çështjesh, të tilla si gjatësia e proceseve gjyqësore, shkelje të aludurara nga qeveria lokale dhe mosmarrëveshjet private, si divorcet¹¹⁵ dhe zyra e Mitrovicës kishte pranuar një numër të përgjithshëm prej 98 ankesash, nga të cilat 58 ishin të papranueshme dhe 40 vazhduan me fazën hetimore. Po ashtu, edhe numri i rasteve *ex officio* është dyfishuar. IAP e ka shpjeguar këtë tipar si rritje të interesit të publikut ndaj institucionit, veçanërisht duke pasur parasysh injorancën e përgjithshme të institucioneve publike për ankesat e individëve. Për më tej, në përmbushjen e rolit të saj, zyra rajonale e IAP në Pejë e kupton që pasja e një marrëdhënieje pune me aksionerët e tjerë, si organizatat e shoqërisë civile dhe NjDNj nëpër komuna, është tejet e rëndësishme¹¹⁶.
102. Shumica e këndvështrimit të NjDNj nëpër ministri për reparacionin e rastit të personit që aludon shkelje të të drejtave të njeriut nga një ministri e veçantë, konsiderohet si një prej kompetencave dhe arritjeve të tyre¹¹⁷. Ankesa të tilla janë dorëzuar nga pjesëtarë të publikut ose nga nëpunësit civilë të ministrive; dhe subjekti i lëndës së ankesave varion mjaft. Kështu NjDNj në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal raporton se është marrë me rastet e dy ankesave individuale nga trafikimi i qenieve njerëzore, të cilave nuk iu ishte siguruar strehë për më shumë se gjashtë muaj¹¹⁸. Po ashtu, NjDNj në Ministrinë e Punës dhe Mirëqënies Sociale, raporton për një rast për aplikim pensioni, që u refuzua. NjDNj e hetoi rastin dhe hartoi një referim tek departamenti përkatës, duke theksuar se ishte bërë një shkelje dhe duke bërë edhe rekomandime për veprime korrigjuese që duheshin ndërmarrë nga ministria.¹¹⁹ Po ashtu, NjDNj në MZHe iu referua 14-15 ankesave që kishin marrë nga qytetarët e që lidheshin me mosmarrëveshje pune në sektorin e energjisë, pavarësisht nga fakti që nuk u dhanë detaje të tjera¹²⁰.

105 *Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, Raporti Vjetor 2011, Prishtinë 2012, fq. 138.*

106 *Ibid, p. 148.*

107 *Intervistë me Zyrën e Institucionit të Avokatit të Popullit në Prizren, Misioni i Parë Vlerësues.*

108 *Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, Raporti Vjetor 2012, Prishtinë 2013.*

109 619 raste.

110 *Nga 610 raste të hetuara, 215 kishin të bënin me gjykatat, 137 me komunat dhe 105 me ministrinë.*

111 276 raste nga 538.

112 89 raste nga 538.

113 *Intervistë me Avokatin e Popullit, Misioni i Parë Vlerësues.*

114 *Intervistë me Zyrën Rajonale të IAP në Gjilan, Misioni i Parë Vlerësues*

115 *Intervistë me Zyrën Rajonale të IAP në Pejë, Misioni i Parë Vlerësues*

116 *Intervistë me Zyrën Rajonale të IAP në Pejë, Misioni i Parë Vlerësues*

117 *Intervistë me NjDNj në ministri gjatë datave 24-28 qershor 2013, Misioni i Parë Vlerësues*

118 *Intervistë me NjDNj në MAQV, Misioni i Parë Vlerësues*

119 *Intervistë me NjDNj në MPMS, Misioni i Parë Vlerësues*

120 *Intervistë me NjDNj në MED, Misioni i Parë Vlerësues*

103. Edhe një grup tjetër rastesh ku NjDNj nëpër ministri kanë kontribuar në reparacionin e çështjeve, përbëjnë rastet e ankesave të nëpunësve civilë nëpër ministrinë përkatëse, pas pranimit të ankesave të tyre, në më të shumtën me gojë. Kështu NjDNj në MASHT kujtoi një rast ku aludohej diskriminimi mbi bazën e moshës gjatë procesit të rekrutimit në ministri, dhe ku NjDNj dha rekomandimet e veta për ministrinë¹²¹. Ndërsa NjDNj në Ministrinë e Punëve të Brendshme gjatë vitit 2012 trajtoi rreth 3-4 raste në lidhje me të cilat rekomandoi që rrogat e personelit në ministri duheshin harmonizuar. Ndërsa NjDNj në MeF citoi praktikën që të siguroheshin se i gjithë personeli kishte kontrata të vlefshme pune¹²². Përveç kësaj, NjDNj në MKRS kishte ndërhyrë me sukses në një rast kur një nëpunëseje së ministrisë po i ndërpritej kontrata gjatë lejes së shtatëzatisë¹²³. Në këtë rast NjDNj i dha rekomandim ministrisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rezultoi në faktin që ministria e tërhoqi ndërprerjen e kontratës dhe nëpunësja vazhdoi në pozitën e saj. NjDNj në MAP po ashtu kishte marrë tri ankesa nga nëpunësit e ministrisë; meqë ishin anonime, NjDNj nuk mund të procedonte me rastet. Përveç kësaj, NjDNj të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ka monitoruar dhe ka zgjidhur një rast të mohimit të pensionit. Pas marrjes së fakteve përkatëse nga ankuesi dhe departamenti përkatës, NjDNj hartoi një letër për Sekretarin e Përgjithshëm të ministrisë duke vënë në pah shkeljen e të drejtës së pensionit dhe duke kërkuar ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese nga ana e ministrisë¹²⁴.
104. Në nivelin komunal, edhe NjDNj trajton ankesa dhe këto nuk janë zakonisht nga nëpunësit nëpër komuna. Kështu, NjDNj në Pejë raportoi se zyra e tyre trajton afërsisht 10 ankesa të shkeljes së të drejtave të njeriut në muaj¹²⁵. Në Mitrovicë është raportuar se pjesëtarët e publikut janë në gjendje t'i drejtohen NjDNj lidhur me çdo çështje të shkeljes së të drejtave të njeriut dhe se të gjitha ankesat që i adresohen në përgjithësi komunës, futen në një databazë qendrore të komunës, e cila mund të shfrytëzohet nga të gjithë nëpunësit e komunës¹²⁶. Në të kaluarën NjDNj në Mitrovicë kishte marrë një numër ankesash lidhur me asistencat shoqërore që po merrnin individët, por që u ishte ndaluar. Kjo ndodhi sepse paditësit nuk i përmbushën kushtet, veçanërisht kërkesa për ta pasur një fëmijë nën moshën pesëvjeçare. Megjithatë, NjDNj e ngriti çështjen me ZQM, dhe që atëherë çështja ka mbetur të trajtohet nga MPMS.¹²⁷
105. Përveç kësaj, NjDNj në Prishtinë ka marrë një ankesë nga një qytetare turke e Kosovës lidhur me shkrimin e emrit të saj në dokumentet zyrtare, me ç'rast ajo u udhëzua që të ndiqte një procedurë tjetër. NjDNj ka marrë edhe disa ankesa nga nëpunësit e komunës, por këto kanë qenë të komunikuar vetëm me gojë dhe në kohën e komunikimit u është dhënë edhe këshilla përkatëse. NjDNj në Ferizaj kujton një numër rastesh që trajtonin mosmarrëveshjet e punës, mungesën e zbatimit të vendimeve të gjykatës dhe mosmarrëveshjet lidhur me faturat e dritave/lidhjes së elektrikut. Në një rast të veçantë, NjDNj ka ndërhyrë pozitivisht që një nxënëse shtatzanë ta vazhdonte shkollën. Një shembull tjetër pozitiv është dhënë nga NjDNj në Podujevë lidhur me ankesën e një banori më 2013. Pas ndërhyrjes së suksesshme të NjDNj, kryetari i komunës caktoi fonde komunale për paditësin që t'i ndërtohej shtëpia e re¹²⁸.
106. Megjithatë, ka edhe raste të ndërhyrjes së pasuksesshme të NjDNj në varësi të sjelljes negative të zyrtarëve komunalë ndaj tyre. Për shembull, në Lipjan në tetor të vitit 2012, NjDNj ndërmori veprime në bazë të disa ankesave nga nxënësit e shkollës së mesme që ishin përjashtuar nga shkolla. Pavarësisht nga kërkimet e NjDNj, asnjë nga institucionet përkatëse komunale (drejtori i arsimit dhe ai i shkollës) nuk e mori në konsideratë mendimin e NjDNj, e madje nuk dhanë as

121 Intervistë me NjDNj në MESP, Misioni i Parë Vlerësues

122 Intervistë me koordinatoren e NjDN në MeF, Misioni i Parë Vlerësues.

123 Intervistë me NjDN në MKRS, Misioni i Parë Vlerësues.

124 Intervistë me NjDNj në MPCs, Misioni i Parë Vlerësues.

125 Intervistë me NjKDNj në Pejë, Misioni I Parë Vlerësues.

126 Nuk është e qartë nëse implikimet e mbrojtjes së të dhënave të jenë marrë në konsideratë në mënyrë të kënaqshme në këtë rast.

127 Intervistë me NjKDNj në Mitrovicë, Misioni I Parë Vlerësues.

128 Raportimi i ekipeve në terren të OSBE-së për Pyetëtorin mbi Njësitë Komunale të të Drejtave të Njeriut, përshkrim i përgjithshëm rajonal për Mitrovicën (qershor 2013).

ndonjë shpjegim¹²⁹.

107. Nga ana tjetër, në vitin 2009 Zëvendëskryetari i Kuvendit Komunal për Komunitetet në Prizren dorëzoi një ankesë kundër vendimit të kuvendit komunal lidhur me emblemën/logon e tij në Gjykatën Kushtetuese, e cila rrjedhimisht vendosi se emblema e komunës kishte qenë anti-kushtetuese, sepse nuk reflektonte aspektin multi-etnik të komunës¹³⁰. Pas një debati të ndezur dhe disa ditësh në kuvendin komunal, emblema u ndryshua.
108. Për më tej, pas marrjes së peticionit nga qytetarët, Komisioni mbi të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, Personat e Zhdukur dhe Peticionet ka bërë disa rekomandime dhe ka theksuar edhe problemet specifike me të cilat përballen individët¹³¹. Pavarësisht se Zyra e Komisionerit të Gjuhës ka marrë disa ankesa, ato deri më tani kanë mbetur të patrajtuara për shkak të ristrukturimit të brendshëm¹³².
109. Së fundmi, Këshilli Konsultativ i Komuniteteve, nëpërmjet grupeve të tij të punës, ka lëshuar një numër rekomandimesh. Për shembull, në maj të vitit 2013 Komunës së Prizrenit iu dërgua një rekomandim që u tërhiqte vëmendjen organeve përgjegjëse të merrnin masat e nevojshme për të zbatuar Ligjin mbi Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare për Gjuhët Boshnjake dhe Turke në të gjitha dokumentet zyrtare të komunës. Po ashtu, lidhur me shkollat në dy komuna të tjera (Gjakovë dhe Fushë Kosovë), KKK ka lëshuar rekomandime lidhur me ndarjen e nxënësve Romë nga komunitetet e tjera. Gjithashtu KKK ka rekomanduar që Ligji mbi Pushimet Zyrtare të përmbajë edhe ditën përkujtimore për komunitetin kroat. Megjithatë, për shumicën e rekomandimeve, KKK nuk ka marrë asnjëherë përgjigje¹³³.

7.3 Mangësitë

110. Ndërkohë që mundësia e pasjes së reparacionit është veçanërisht e rëndësishme për të siguruar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut, pasja e një strukture komplekse institucionesh mund të krijojë pengesa, që i pengon qytetarët të kenë qasje në mjete efektive korrigjuese.
111. Edhe aftësia e IAP për të trajtuar ankesat individuale ndikohet nga një varg mangësish.
112. Së pari, njëra nga sfidat më të mëdha të identifikuar është se institucionet publike kanë bashkëpunim me IAP në fazën hetimore, por jo në zbatimin e rekomandimeve të tij, meqë shumica e tyre – veçanërisht për sa i përket problemeve të përgjithshme – nuk janë zbatuar¹³⁴. Ndërkohë që nuk mund të pritët të zbatohen të gjitha rekomandimet, kushtimi i vëmendjes ndaj tyre ka një ndikim mbi institucionin, si dhe mbi individin, i cili po e adreson çështjen që ajo të zgjidhet.
113. Së dyti, mungesa e dukshmërisë së IAP dhe vetëdijesimi i publikut për rolin që ka, përbën edhe një mangësi tjetër¹³⁵. Kjo reflektohet nga numri relativisht i ulët i ankesave ta pranuar dhe nga numri edhe më i vogël i ankesave të pranuar. Përveç kësaj, kjo ushtron ndikim edhe në zyrat rajonale; duke rezultuar në paefektshmëri sepse ndonjëherë ankesat që marrin janë jashtë mandatit të IAP¹³⁶.
114. Së treti, IAP është përballur edhe me një numër pengesash operacionale dhe financiare. Për

¹²⁹ Raportimi i ekipeve në terren të OSBE-së për Pyetësorin mbi Njësitë Komunale të të Drejtave të Njeriut, përshkrim i përgjithshëm rajonal për Prishtinën (qershor 2013).

¹³⁰ <http://eudo-citizenship.eu/caselaëDB/docs/KOS%2001%2009%20vendimi%20%28English%29.pdf> (shfrytëzuar më 11 nëntor 2013).

¹³¹ Lutemi vini re që nuk ka të dhëna të botuara lidhur me numrin e peticioneve të marra ose lidhur me rezultatin e rekomandimeve

¹³² Intervistë me OJQ-në Qendra për Paqe dhe Tolerancë, Misioni i Parë Vlerësues

¹³³ Intervistë me Këshillin Konsultativ për Komunitetet, Misioni i Parë Vlerësues

¹³⁴ Intervistë me Zyrën Rajonale të Avokatit të Popullit në Prizren, Misioni i Parë Vlerësues

¹³⁵ Këshilli i Europës, Mendim mbi Projekt-Rregulloren et al, fq. 14

¹³⁶ M A Jones dhe I Roagna, Raporti Vlerësues (Shtojca V për Gjallërimin e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Kosovë, Projekti i Përbashkët i Bashkimit Europian/Këshillit të Europës Raporti Fillestar), fq.27

shembull, institucioni nuk e ka të zgjidhur problemin e jetëgjatësisë së zyrës kryesore dhe as hapësirën adekuate të punës në një numër zyrash, veçanërisht në ato rajonale. Kohëve të fundit, IAP ka përfituar nga një rritje e konsiderueshme e buxhetit të vet, por nuk ka asnjë siguri nëse kjo situatë do të vazhdojë të mbetet e tillë. Përveç kësaj, mungesa e qartë e imunitetit për Avokatin e Popullit, zëvendësit dhe personelin e tij, pasi të largohen nga detyra, ndikon në besimin për t'i kryer detyrat e tyre duke minuar kështu pavarësinë e institucionit¹³⁷.

115. Së fundmi, rritja e centralizimit të operacioneve në vetë IAP, me personel me aftësi të specializuara të lokalizuara vetëm në zyrën në Prishtinë e jo nëpër rajone, është nënvizuar si mangësi që ndikon në mundësinë e institucionit për mbrojtje efektive të të drejtave të njeriut¹³⁸.

116. Pavarësisht se bazat ligjore për NjDNj në ministri nuk thonë që ato duhet të sigurojnë reparacion për qytetarët ose pjesëtarët e publikut në përgjithësi apo nëpunës civilë në veçanti¹³⁹, ato e kanë bërë një gjë të tillë në praktikë. Megjithatë, numri i rasteve të trajtuara është mjaft i ndryshëm dhe jo shumë i madh. Kështu, NjDNj në MKRS, mes periudhës 2006 dhe 2011 mori 17 ankesa, por në dy vitet e fundit nuk ka marrë asnjë¹⁴⁰. NjDNj në MeF deklaroi që, që kur është themeluar nuk ka marrë asnjë ankesë nga publiku¹⁴¹. Përveç kësaj, lidhur me shkeljet për ndalimin e diskriminimit në sektorin publik, është raportuar se në vitin 2011¹⁴² dhe 2013¹⁴³ shumica e NjDNj nuk kanë marrë asnjë ankesë lidhur me Ligjin mbi Anti-Diskriminimin¹⁴⁴. NjDNj në Pejë, nga ana tjetër, pranon rreth dhjetë ankesa në muaj, dhe vetëm i referon ato tek institucionet përkatëse (organet komunale ose IAP)¹⁴⁵.

117. Megjithatë duhet shënuar që nuk ekziston një databazë gjithëpërfshirëse lidhur me ankesat që merren nga NjDNj nëpër ministri, as nga publiku dhe as nga nëpunësit civilë, për çfarëdo çështje, pavarësisht nga raportimet e bëra dy herë në vit. Megjithatë, numri i vogël i ankesave është shpjeguar nga koordinatori i NjDNj në MKRS, për shkak të një numri arsyesh, duke përfshirë edhe mungesën e njohurive nga ana e publikut për të drejtat e tyre, mungesën e informacionit për rolin e NjDNj meqë informacioni për to nuk azhurnohet në faqen e internetit dhe mungesën e besimit në NjDNj meqë ato konsiderohen që nuk kanë kompetenca të marrin vendime detyruese. Njëkohësisht, NjDNj shpesh nuk e konsiderojnë trajtimin e ankesave individuale nga publiku si një nga kompetencat e tyre, por në fakt, si një çështje për IAP¹⁴⁶. Sipas koordinatorëve/personelit të NjDNj, numri i ulët, dhe herë pas here, mungesa e ankesave që i drejtohen drejtpërdrejt NjDNj nga qytetarët e provon këtë¹⁴⁷.

118. Në këto rrethana, nuk është për t'u habitur që shumica e NjDNj nuk kanë kryer ndonjë promovim a vetëdijesim për ta informuar publikun lidhur me disponueshmërinë e kësaj forme reparacioni.

119. Megjithatë, duhet vënë re se ata persona që punojnë në NjDNj kanë mungesë të madhe kapacitetesh me qëllim që të trajtojnë efektshmërisht ankesa të tilla. Përgjatë viteve NjDNj-të janë

137 Këshilli i Europës, *Mednim mbi Projekt-Rregulloren et al*, fq. 14

138 *Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë*, 'Një vështrim në punën e Institucionit të Avokatit të Popullit', qershor 2013, f. 29-30.

139 *Udhëzimet Administrativ i Kryeministrit Nr. 8/2005 mbi Termat e Referencës për Njësitë e të Drejtave të Njeriut*, Seksioni 7

140 *Intervistë me NjDNj në MKRS, Misioni i Parë Vlerësues*

141 *Intervistë me NjDNj në MeF, Misioni i Parë Vlerësues*

142 *Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë*, 'Ligji Anti-Diskriminim në Kosovë: pas shtatë vjetësh', dhjetor 2011, f. 164-65

143 *Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë*, 'Rastet e Diskriminimit në Kosovë – a ekzistojnë ato?', korrik 2013, f. 8-9

144 *Ligji Nr. 2004/03*

145 *Intervistë me NjDNj në Pejë, Misioni i Parë vlerësues*.

146 *Një përjashtim që është raportuar nga NjDNj të MASHK gjatë intervistave me Misionin e Parë Vlerësues. Kjo NjDNj, si një shembull unik mes NjDNj nëpër ministri kryesoi një komision ankesash për qytetarët. Megjithatë, ajo nuk pati mundësi të vlerësonte ndikimin e saj në një rol monitorues ka qaktiv, duke pasur parasysh faktin që Departamenti Ligjor i ministrisë e mori përsipër këtë rol të NjDNj. Dhe nuk është dhënë asnjë arsye specifike për një vendim të tillë.*

147 *Numri i ankesave të marra nga publiku varion mjaft, por në përgjithësi mbetet në nivel të ulët. Për shembull, NjDNj e MED ka raportuar që ka trajtuar vetëm 14-15 ankesa nga pjesëtarët e publikut, që kryesisht kishin të bënin me mosmarrëveshjet e punës në sektorin e energjisë (nuk është përcaktuar afat kohor).*

transformuar në pika kontakti dhe nuk ndihen rehat kur marrin një mori ankesash¹⁴⁸. Për më tej, meqë NjDNj-të nuk kanë kompetencë ekzekutive¹⁴⁹, kjo ndikon në aftësinë e tyre për të ofruar një zgjidhje për paditësin dhe, siç është vënë në pah tashmë, ndoshta kjo nuk i bind disa që të shkojnë e të bëjnë ankesa. Prandaj, zgjidhja e sukseshme e ankesave është kufizuar, meqë procedura e trajtimit të tyre nuk është e qartë dhe duket se rezultati varet nga individit që merret me ankesën, jo nga institucioni. Në raste të veçanta, ankesa vetëm i është referuar një institucioni tjetër, si Avokati i Popullit¹⁵⁰, që mbase është edhe qasja më e mirë duke pasur parasysh mungesën e ndonjë baze ligjore për NjDNj-të që të bëjnë reparacionin vetë.

120. Një mori mangësish ndikojnë në aftësinë e NjDNj nëpër komuna që ato të veprojnë si një mekanizëm reparacioni.
121. Së pari, kompetencat e tyre nuk janë veçanërisht të qarta, sepse Udhëzimi Administrativ 2011/04 nuk e specifikon që këto NjDNj duhet të trajtojnë ankesat individuale.¹⁵¹ Një mangësi tjetër kryesore që ndikon në shumicën e NjDNj ka të bëjë me personelin e tyre, sepse shumica e tyre nuk kanë një ekip të konsoliduar, siç kërkohet me anë të Udhëzimit Administrativ 2011/04¹⁵². Për shembull, NjDNj komunale në Prizren ka të punësuar me kohë të plotë vetëm koordinatoren dhe zyrtarin e komuniteteve, ndërsa dy nëpunës të tjerë që janë caktuar në njësi kryejnë detyra të tjera primare në komunë, dhe si të tillë i dedikojnë kësaj njësie vetëm rreth 2% të kohës së tyre¹⁵³. Kjo situatë vihet re edhe në NjDNj të tjera të ngjashme komunale. Kështu, në NjDNj në Ferizaj është koordinatori me një nëpunës, që punën në njësi e ka punë të dytë.
122. Numri i ankesave të marra nga NjDNJ komunale është përgjithësisht i ulët, dhe pavarësisht nga kjo asnjëra prej këtyre njësive nuk ka kryer ndonjë veprimtari për vetëdijesimin e publikut dhe për informimin mbi mundësinë e zyrës së tyre si mekanizëm reparacioni. Thuhet që kjo ushtron ndikimin e saj edhe në perceptimin e publikut për NjDNJ-të komunale, me shumë pak besim që iu vihet atyre lidhur me mundësinë për të zgjidhur probleme me të cilat mund të përballen pjesëtarët e publikut.¹⁵⁴ Ndërkohë që, kapacitetet në dispozicion të NjDNj nëpër komuna nuk janë krejtësisht adekuate, që ato të merren në mënyrë të efektshme me ankesat individuale, shumë nga nëpunësit në këto njësi nuk kanë përvojën apo aftësitë për një detyrë të tillë¹⁵⁵.
123. Për më tej, edhe Komisioni mbi të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, Personat e Zhdukur dhe Peticionet përballat me mangësi. Së pari, ai nuk ka një procedurë që të trajtojë peticionet që merr dhe Organizatat e Shoqërisë Civile kanë sugjeruar se kjo rezulton me hezitime për mënyrën se si duhen trajtuar peticionet gjatë takimeve të komisionit¹⁵⁶. Një shqetësim tjetër i mangët ka të bëjë me kapacitetet brenda PK dhe në veçanti me mungesën e përkrahjes së mjaftueshme profesionale për trajtimin e peticioneve të tilla.
124. Lidhur me Zyrën për Komisionerin e Gjuhës, meqë ky mekanizëm aktualisht po rikonsolidohet, nuk është e mundur të identifikohet nëse ekzistojnë mangësi. KKK po ashtu po përballat me sfida për sa u përket kushteve të përshtatshme të punës. Problemi kryesor është që zakonisht ata nuk marrin ndonjë përgjigje nga institucionet përkatëse lidhur me rekomandimet që bëjnë¹⁵⁷.

148 Raporti FRIDOM, fq. 13

149 M A Jones dhe I Roagna, Raport Vlerësues (Shtojca V për Gjallërimin e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Kosovë, Raport Fillestar mbi Projektin e Përbashkët të Bashkimit Europian/Këshillit të Europës)

150 Këshilli i Europës, Mendim mbi Projekt-Rregulloren et al fq. 16

151 MAQV mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ 2011/01 mbi Krijimin e Njësive të të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna, Neni 7

152 MAQV mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ 2011/01 mbi Krijimin e Njësive të të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna

153 Intervistë me NjKDNj në Prizren, Misioni i Parë Vlerësues

154 M A Jones dhe I Roagna, Raport Vlerësues (Shtojca V për Gjallërimin e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Kosovë, Raport Fillestar i Projektit të Përbashkët të Bashkimit Europian/Këshillit të Europës), fq. 26

155 Ibid, fq.25

156 Intervista me OSHC, Misioni i Parë Vlerësues

157 Intervistë me Këshillin Konsultativ për Komunitetet, Misioni i Parë Vlerësues

8. MONITORIMI

8.1 Institucionet përkatëse

125. Ashtu si me rolet e tjera, aspekte të ndryshme të detyrës së monitorimit të përmbushjes së standardeve të të drejtave të njeriut, i janë besuar një morie të gjerë organesh jogjyqësore.
126. Kushtetuta i jep IAP detyrën e monitorimit, por edhe atë të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të individit. Kështu IAP mund të lëshojë rekomandime dhe të propozojë veprime kur vihen re shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e administratës publike dhe të autoriteteve të tjera shtetërore.
127. Përveç kësaj, NjDNj nëpër ministri janë të detyruara të bashkëpunojnë me IAP dhe të mbikëqyrin zbatimin e rekomandimeve të tij. Më tej, nga ato gjithashtu pritet të vlerësojnë zbatimin e të drejtave të njeriut nëpër ministri.
128. Përveç kësaj, PK ka rolin e përgjithshëm mbikëqyrës për respektimin e të drejtave të njeriut, dhe në veçanti përmes dy komisioneve të tij mbi të drejtat e njeriut dhe komunitetet, ai mund të mbikëqyrë ruajtjen e të drejtave të njeriut nga ana e institucioneve publike, duke ndihmuar kështu potencialisht ose duke e plotësuar punën e IAP.
129. Për më tej, MAPL (nëpërmjet Divizionit të vet për Promovimin e të Drejtave të Njeriut në Komunë dhe NjDNj) supozohet të monitorojë zbatimin e saktë të ligjeve që lidhen me të drejtat e njeriut dhe përmbushjen e tyre të plotë nga ana e autoriteteve në nivelin lokal. Divizioni i ministrisë për Monitorimin e Komunave, nëpërmjet Departamentit të saj për Çështjet Ligjore dhe Monitorimin e Komunave, është në pozitë edhe për veprimtari monitoruese, qoftë me përdorimin e kamerave speciale të instaluar nëpër korridoret e shumicës së kuvendeve komunale, ose me pjesëmarrjen e këshilltarëve të saj monitorues gjatë seancave të kuvendeve komunale.
130. ZQM është veçanërisht përgjegjëse për të monitoruar zbatimin e masave të parapara nga SPVDNj 2008-2011. Përveç kësaj, ZQM është përgjegjëse jo vetëm për bashkërendimin, por edhe për monitorimin e zbatimit të të dy Planeve Kombëtare Strategjike të Veprimit mbi të Drejtat e Fëmijëve 2009-2013 dhe të Strategjisë së Integritit të Komuniteteve të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve në Kosovë (SIKRAE) 2009-2015. Megjithatë, Ministria e Integritit Europian (MIE) gradualisht ka ndërmarrë monitorime në fushën e të drejtave të njeriut, si pjesë e detyrimeve të saj për të raportuar në progresin e bërë në kornizën e Planit të Veprimit të Partneritetit Europian (PVPE) dhe dokumenteve të tjera. Në një shembull të kohëve të fundit, MIE ndërmori monitorimin e zbatimit të SIKRAE 2009-2015 nga ZQM¹⁵⁸.
131. Monitorimi i zbatimit të Ligjit mbi Barazinë Gjinore dhe politikave gjinore kryhet nga një organ tjetër në Zyrën e Kryeministrit, që është ABGj, e cila kryen detyrën e përkrahjes së ZQM nëpër ministri dhe komuna. Përveç kësaj, ABGj – nëpërmjet kryesimit dhe bashkërendimit të Këshillit Ndërmintor për Barazinë Gjinore – luan një rol monitorues për sa i përket zbatimit të Programit Kosovar mbi Barazinë Gjinore 2008-2013.
132. Në fushën e të drejtave të komuniteteve ekzistojnë një numër institucionesh të cilat kryejnë veprimtaritë monitoruese.
133. Për shembull, MKK gëzon mandatin të mbikëqyrë zbatimin e strategjisë së qeverisë që lidhet me komunitetet dhe kthimet. Gjithashtu ajo është e përfshirë edhe në monitorimin e politikave dhe të programeve të kthimit. MKK i përmbush këto përgjegjësi me mbështetjen e Zyrate Komunale për Komunitete dhe Kthime, të cilat kryejnë monitorime të rregullta dhe i raportojnë ministrisë mbi progresin. Po ashtu, Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthime mbikëqyrin zbatimin e të

¹⁵⁸ Intervistë me përfaqësuesit e MIE, Misioni i Parë Vlerësues.

gjitha projekteve që kanë lidhje me kthimet.

134. Komisioni i Komuniteteve, njëri nga dy komisionet e përhershme të kuvendeve komunale, është një organ tjetër përgjegjës për monitorimin e përmbushjes së standardeve të të drejtave të komuniteteve dhe legjislacionit ekzistues nëpërmjet shqyrtimit të projekt-akteve, vendimeve dhe të legjislacionit komunal. Me qëllimin e sigurimit të respektimit të plotë të të drejtave dhe interesave të komunitetit, komisioni po ashtu mund t'i rekomandojë kuvendit përkatës komunal ndonjë masë e cila do të siguronte zbatimin e dispozitave që lidhen me nevojën e personave që u përkasin komuniteteve.
135. Përveç MKK, Zyra për Çështjet e Komuniteteve monitoron efektet e masave të ndërmarra nga secili institucion për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve. Lidhur me të drejtat e gjuhës, Zyra e Komisionerit të Gjuhës ka kompetencën të monitorojë përmbushjen e Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve nga ana e institucioneve.
136. Po ashtu, ka mjaft organizata të shoqërisë civile që po punojnë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht ato organizata të cilat e vënë theksin në të drejtat e fëmijëve, grave, komuniteteve pakicë dhe personave me aftësi të kufizuara. Ashtu siç është njohur edhe nga SPVDNj 2009-2011, mjaft nga këto organizata monitorojnë përmbushjen e standardeve të të drejtave të njeriut nga ana e institucioneve dhe lëshojnë raporte publike mbi çështjet tematike lidhur me konkluzionet e tyre.

8.2 Arritjet

137. IAP monitoron përmbushjen e standardeve të të drejtave të njeriut dhe të legjislacionit përkatës nga ana e autoriteteve publike, duke trajtuar ankesa të pranuar nga individët, si dhe duke i filluar hetimeve mbi rastet e dyshuara të shkeljes së të drejtave të njeriut me iniciativën e vet (*ex officio*). Si pjesë e procesit hetimor, personeli i IAP po ashtu monitoron edhe rastet nëpër gjykata. Tri temat kryesore të rasteve hetimore ishin drejta për një gjykim të drejtë e të paanshëm, drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit dhe mbrojtja e pronës. Palët përgjegjëse në rastet e hetuara ishin kryesisht gjykatat (31%), ministritë (23%) dhe komunat (17%). IAP lëshoi pesë raporte mbi rastet, katër raporte *ex officio*, dy rekomandime dhe një kërkesë për masë të përkohshme.¹⁵⁹ Sipas Ligjit mbi Avokatin e Popullit, zyrtarët e IAP monitorojnë edhe insitucionet e paraburgimit në çdo kohë dhe pa paralajmërim¹⁶⁰.
138. Nëpërmjet zyrave të veta rajonale IAP kryen vizita monitoruese në qendrat e paraburgimit, burgjet, stacionet e policisë dhe qendrat psikiatrike për të vlerësuar trajtimin e personave të privuar nga liria. Sipas gjetjeve, IAP i adreson rekomandimet e veta për institucionet përkatëse (p.sh. Shërbimi Korrektues i Kosovës, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, etj..). Si një rezultat pozitiv i veprimtarive në terren, është nënshkruar edhe një marrëveshje bashkëpunimi për themelimin e Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës, mes IAP dhe dy organizatave lokale të shoqërisë civile: Qendra Rehabilituese për Viktimat e Torturës (QRVT) dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), me mbështetjen e OSBE-së. Mekanizmi synon të inspektojë rregullisht të gjitha vendet dhe zonat ku mbahen personat me liri të kufizuar lëvizjeje dhe veprimi.¹⁶¹ Kjo praktikë e mirë është veçanërisht e rëndësishme në përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në procesin e monitorimit dhe përfton nga ekspertiza e tyre, të dhënat e brendshme dhe burimet në dispozicion.
139. Po ashtu, IAP monitoron procesin hartues legjislativ dhe paraqet rekomandime në fushat që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Këto rekomandime bëhen personalisht, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në takimet e komisioneve të PK, debatit publik mbi projekt-ligjet dhe raporteve vjetore të tij. Për shembull, komentet e IAP për projekt-ligjin mbi Mbrojtjen e Dëshmitarëve janë marrë

¹⁵⁹ IAP, Raporti Vjetor 2011, (korrik 2012), f. 135-145.

¹⁶⁰ Ligji Nr. 03/L-195 mbi Avokatin e Popullit, (2010), Seksioni 16.7.

¹⁶¹ IAP, Raporti Vjetor 2011, (2012), fq. 15 dhe f. 28-31.

pjesërisht parasysh nga PK.¹⁶² Megjithatë, rekomandimet e tij shpesh neglizhohen nga disa institucione.¹⁶³

140. Në nivelin qendror, NjDNj ministrORE kanë për detyrë të kryejnë veprimtari të ndryshme monitoruese për të siguruar përmbushjen e standardeve të të drejtave të njeriut, dokumentet mbi politikat dhe legjislacionin. Pavarësisht se termat e tyre të referencës nuk përcaktojnë qartësisht fokusin e veprimtarive të tilla, ekziston një supozim i përbashkët mes personelit të NjDNj që kryesisht ata duhet të mbikëqyrin zbatimin e standardeve antidiskriminim dhe atyre të barazisë në mjedisin e punës, si dhe gjatë procesit të rekrutimit. Në varësi të këtij interpretimi, monitorimi i ndërmarrë nga NjDNj duket se është kryesisht i fokusuar në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të nëpunësve të ministrive, nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në panelet rekrutuese¹⁶⁴ dhe komisionet disiplinore, duke mbikëqyrur kështu përmbushjen e Ligjit mbi Nëpunësit Civilë nga ministroritë.

141. Megjithatë, NjDNj-të marrin pjesë dhe japin kontributin e tyre në takimet e grupeve të nivelit qendror të punës, komisioneve dhe task-forcave që kanë mandatin të monitorojnë legjislacionin, strategjinë dhe planet e veprimit që trajtojnë çështjet e të drejtave të njeriut. Në disa raste mund të vihet re edhe një qasje proaktive ndaj këtij procesi. Kështu, NjDNj në MASHT luajti një rol aktiv në monitorimin e dhunës dhe të braktisjes nëpër shkolla, nëpërmjet mbledhjes së të dhënave në bashkëpunim me Entin Statistikor të Kosovës dhe në bashkë-hartimin e raportit me ZQM. Po ashtu, u ngrit edhe një grup i veçantë pune që synonte monitorimin dhe adresimin e çështjeve të barazisë gjinore në arsimin fillor dhe të mesëm¹⁶⁵. NjDNj në MPB gjithashtu ka vizituar një qendër paraburgimi sipas kornizës së punës së një projekti, duke synuar monitorimin dhe kushtet e qendrës së paraburgimit¹⁶⁶.

142. Në nivelin lokal, NjDNj-të kanë përgjegjësinë të monitorojë veprimtaritë komunale dhe të këshillojë Drejtorin e Administratës mbi çështjet e të drejtave të njeriut. Në bazë të këtij përshkrimi të zbehtë në udhëzimin administrativ, koordinatorët e NjDNj duket se e interpretojnë rolin e tyre monitorues në mënyra të ndryshme. Për shembull, asnjëra nga NjDNj (me një përjashtim të vetëm¹⁶⁷) e intervistuar me ndihmën e OSBE-së nuk ka raportuar që ato, vetëm ose në bashkëpunim me të tjerë, kanë vlerësuar ndonjëherë përmbushjen e standardeve të politikave të të drejtave të njeriut, legjislacionit dhe strategjive të komunave. Sipas disave prej koordinatorëve të NjDNj¹⁶⁸, kjo është një detyrë e zyrtarëve ligjorë të komunave, dhe jo e këtyre njësive. Për disa të tjerë, NjDNj nuk kanë ndonjë kapacitet që të ndërmarrin veprimtari të tilla, dhe për këtë arsye kjo punë i duhet caktuar një njësie të veçantë në komunë¹⁶⁹. Nga ana tjetër, koordinatori i NjDNj në Prizren, që është edhe Zyrtari për Barazinë Gjinore të komunës, monitoron zbatimin e Planit Kombëtar mbi Barazinë Gjinore në nivelin lokal duke marrë pjesë në mënyrë proaktive në takimet e komunës, në mbikëqyrjen e projekt-akteve, vendimeve dhe legjislacionit, si dhe duke dhënë rekomandime¹⁷⁰. Në Ferizaj, NjDNj është anëtare e komisionit të auditimit, dhe monitoron proceset e rekrutimit, si dhe takimet e kuvendit komunal.

143. Përveç trajtimit të ankesave individuale, NjDNj në Prishtinë merr edhe kërkesa nga IAP për të

¹⁶² IAP, Raporti Vjetor 2011, (2012), fq. 15 dhe fq. 28.

¹⁶³ Ibid, fq. 18. Pavarësisht nga rekomandimet e IAP në raportin vjetor të 10të dhe të 11të, Dhoma e Posacme e Gjykatës Supreme vazhdon të mos respektojë përdorimin e gjuhëve zyrtare gjatë dorëzimit të padive.

¹⁶⁴ Me përjashtimin e NjDNj në MeF, sic është raportuar nga koordinatori i saj, Misioni i Parë Vlerësues.

¹⁶⁵ Intervistë me NjDNj në MASHT, Misioni i Parë Vlerësues.

¹⁶⁶ Takim me NjDNj në MPB, Misioni i Parë Vlerësues.

¹⁶⁷ I vetmi përjashtim u raportua në Gjakovë, ku NjDNj shfrytëzoi qasjen e personave me aftësi të kufizuara në ndërtesat publike. Raportimi i ekipeve në terren të OSBE-së për Pyetësin mbi Njësitë Komunale të të Drejtave të Njeriut, përshkrim i përgjithshëm rajonal për Pejën (qershor 2013).

¹⁶⁸ P.sh. Shtimje, Novobërdë dhe Hani i Elezi. Raportimi i ekipeve në terren të OSBE-së për Pyetësin mbi Njësitë Komunale të të Drejtave të Njeriut, (qershor 2013).

¹⁶⁹ Sugjeruar nga koordinatori i NjDNj në Pejë. Në Komunën e Istogut, është ngritur edhe një komision komunal mbia baza ad hoc për qëllime të tilla. Raportimi i ekipeve në terren të OSBE-së për Pyetësin mbi Njësitë Komunale të të Drejtave të Njeriut, përshkrim i përgjithshëm rajonal për Pejën (qershor 2013).

¹⁷⁰ Intervistë me NjDNj në Prizren, Misioni i Parë Vlerësues. Një shembull i ngjashëm raportohet edhe nga NDNj në Prishtinë.

dhëna dhe rekomandime nëpërmjet korrespondencës përkatëse që niset drejtpërdrejt nga IAP nëpër drejtoritë komunale. Koordinator i NjDNj monitoron nëse organi përkatës komunal merret me trajtimin e kërkesave/rekomandimeve të IAP¹⁷¹. Po ashtu, NjDNj në Mitrovicë, përmes databazës komunale, është në gjendje të monitorojë nëse ndonjë departament komunal po merret me trajtimin e ankesave individuale¹⁷², ashtu siç bën edhe NjDNj në komunën e Ferizajit.¹⁷³

144. Kur vjen puna në monitorimin dhe raportimin e dokumenteve specifike strategjike mbi të drejtat e njeriut, ZQM dhe ABGj veprojnë si organet bashkërenduese në krye të këtij procesi dhe përdorin NjDNj dhe ZBGj nëpër ministri dhe komuna. SPVDNj 2009-2011 udhëzon Qeverinë e Kosovës të përcaktojë dhe të forcojë mekanizmat monitorues dhe raportues, duke e vënë theksin në veçanti në raportimin për mekanizmat ndërkombëtarë, për periudhën tri-vjeçare që skadoi në fund të vitit 2011.¹⁷⁴ ZQM, si organi përgjegjës për monitorimin e SPVDNj, ka hartuar edhe një format raportimi të standardizuar si matriks për të lehtësuar monitorimin dhe raportimin efektiv mbi zbatimin e veprimtarive të parapara nga Plani i Veprimit. Institucionet përgjegjëse ose veprimtaritë e synuara raportohen tek ZQM në baza vjetore.¹⁷⁵ Bazuar në këto përpjekje, ZQM ka lëshuar deri më tani tri raporte konsektive që përmbledhin të dhënat e fundit mbi veprimtaritë e ndërmarrë nga institucionet kosovare, organizatat ndërkombëtarë dhe organizatat lokale të shoqërisë civile, lidhur me zbatimin e tij. Raporti i fundit që mbulon periudhën janar-dhjetor 2011 përmend disa hapa pozitivë të ndërmarrë nga ZQM për të ngritur mekanizma të rinj monitorimi dhe raportimi: finalizimi i matriksit për zbatimin e 40 rekomandimeve nga Komisioni Europian lidhur me integrimin e komuniteteve të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve; prezentimi i treguesve cilësorë dhe sasiorë nga NjDNj nëpër ministri, si mjete për të promovuar zbatimin dhe realizimin e të drejtave të njeriut (me mbështetjen e ZKLDNj); dhe teknikat e rishqyrtuara të monitorimit dhe të vlerësimit për përdorimin e NjDNj në nivelet qendrore dhe lokale në zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve.

8.3 Mangësitë

145. IAP e përmbush rolin e vet monitorues nëpërmjet personelit prej 48 vetash¹⁷⁶ që gjenden në zyrën kryesore, në pesë zyrat rajonale¹⁷⁷, me një tjetër zyrë rajonale që po hapet¹⁷⁸ dhe me një tjetër që po planifikohet të hapet¹⁷⁹. Duke pasur parasysh ndryshimet strukturore në vitin 2011 u emëruan pesë zëvendës avokatë të popullit, njëri prej të cilëve udhëheq edhe Departamentin e Antidiskriminimit, që mbulon një mori të gjerë çështjesh të të drejtave të njeriut: të drejtat e fëmijëve, barazinë gjinore, trafikimin e qenieve njerëzore dhe dhunën në familje, personat me aftësi të kufizuara, të drejtat e komuniteteve, çështjet sociale, dhe të drejtat e personave lesbikë, gej, biseksualë dhe ndërgjinorë¹⁸⁰.
146. Organizimi i çështjeve të të drejtave të njeriut në të njëjtin departament dhe të njëjtët zyrtarë të caktuar me përgjegjësi të fushave të ndryshme, së bashku me përpjekjet për të promovuar specializimin e juristëve të tyre, janë një hap pozitiv drejt krijimit të ekspertizës në zyrën qendrore të IAP¹⁸¹. Nga ana tjetër, struktura e zyrave rajonale nuk i reflekton këto ndryshime të reja. Secila zyrë rajonale mbetet e pajisur me dy zyrtarë ligjorë hetues, të cilët pritet të mbulojnë monitorimin, hetimin dhe raportimin për të gjitha çështjet që u adresohen atyre nga zyra qendrore e IAP, institucionet lokale dhe pjesëtarët e publikut. Së bashku me numrin e lartë të ankesave dhe mungesën e mundësive të trajnimit për çështje specifike, personeli i IAP në terren mbetet i përg-

171 Intervistë me NjDNj në Prishtinë, Misioni i Parë Vlerësues.

172 Intervistë me NjDNj në Mitrovicë, Misioni i Parë Vlerësues.

173 Intervistë me NjDNj në Ferizaj, Misioni i Parë Vlerësues.

174 SPVDNj 2009-2011, (2008), fq. 8 dhe 10.

175 Ibid, fq. 23.

176 Statistika të marra nga Raporti Vjetor i IAP, (2011), fq. 150.

177 Graçanicë, Pejë, Prizren, Gjiilan, Mitrovicë (zyra tjetër në veri).

178 Ferizaj.

179 Gjakovë.

180 Intervistë me Avokatin e Popullit, Misioni i Parë Vlerësues.

181 Pavarësisht se është kritikuar lidhur me dispozitën e reparacionit; shih para.116.

jithësuar e pa i pasur aftësitë dhe njohuritë e nevojshme, që do t'u kishin dhënë vlerë të shtuar monitorimit të çështjeve specifike (p.sh. të drejtat e pronës).

147. Mungesa e zbatimit të rekomandimeve të IAP përbën një shqetësim serioz. Për shembull, siç është raportuar nga IAP, 40% e rekomandimeve të tij nuk janë marrë parasysh në vitin 2011. Për më tej, niveli i bashkëpunimit mes IAP dhe NjDNj nëpër komuna është disi i ulët dhe luhetat shumë nga njëra komunë në tjetrën. Në rajonet e Gjilanit, Prizrenit dhe Mitrovicës, si zyrat e IAP ashtu edhe NjDNj-të kanë raportuar që nuk kanë bashkëpunuar me njëra-tjetrën në hetimet e ankesave individuale dhe në monitorimin e rekomandimeve të IAP¹⁸². Nga ana tjetër, marrëdhënia me NjDNj nëpër ministri është rrallëherë pozitive, pavarësisht se kjo varet nga marrëdhëniet institucionale dhe personale mes IAP, ministrisë përkatëse dhe personelit të tyre¹⁸³.
148. Përpjekjet e bëra nga NjDNj për të monitoruar vendimet dhe aktet e ministrive në publikun e gjerë, janë të kufizuara. Në përgjithësi, NjDNj nëpër ministri duket se kanë bashkëpunim dhe komunikim relativisht më të mirë me IAP në mbështetjen e rolit të tij monitorues dhe këshillues, krahasuar me NjDNj nëpër komuna. Disa nga NjDNj përfshihen nëpër korrespondencat mes IAP dhe ministrive, kur IAP kërkon të dhëna mbi raste të veçanta të shkeljeve të aluduara ose kur janë dhënë rekomandime për të zgjidhur situatën në të cilën IAP konstaton shkelje të të drejtave të njeriut nga ana e ministrive¹⁸⁴. Të tjerët e marrin këtë informacion nëse/kur ai ndahet së brendshmi me NjDNj.¹⁸⁵ Për shembull, NjDNj në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) monitoroi 15 rekomandime që ishin lëshuar nga IAP lidhur me ministrinë e tyre për dy vitet e kaluara, 8-9 prej të cilave ishin të vitit 2012¹⁸⁶. MKRS, po ashtu, ka raportuar mbi monitorimin e dy rekomandimeve nga IAP në vitin 2012¹⁸⁷. Në të tilla raste, NjDNj duket se e kanë të përkufizuar rolin e tyre të tre-fishtë: bashkërendimi (të dhënat e mbledhura nga departamentet përkatëse), identifikimi (nëse shkelja e aluduar e të drejtave të njeriut është e bazuar mirë në legjislacion), dhe këshillimi (dhënia e rekomandimeve Sekretarit të Përgjithshëm dhe departamenteve të tjera përkatëse ministrore). Një shembull pozitiv i bashkëpunimit me Departamentin/Zyrën Ligjore të ministrisë është vënë re këtu nga NjDNj në MPMS¹⁸⁸. Disa prej NjDNj komunikojnë drejtpërdrejt me IAP lidhur me rezultatet e veprimtarive të tyre, ndërsa të tjerët ndjekin një linjë strikte raportimi brenda ministrisë¹⁸⁹. Megjithatë, nuk është fare e qartë se sa pozitiv në përgjithësi është rezultati i monitorimeve të tilla.
149. Mbledhja e të dhënave specifike të të drejtave të njeriut, është, po ashtu, pjesë e veprimtarive monitoruese të NjDNj. NjDNj përpilojnë statistika e të dhëna të ndara në gjini, paafësi dhe prejardhje etnike të personelit të ministrisë, nga Personeli/Burimet Njerëzore apo departamentet e tjera përkatëse në ministri. Megjithatë, roli i tyre është ose kryesisht bashkërendues (p.sh. shpërndarja e kërkesës për informacion drejtuar departamenteve të tjera) ose vetëm reagues lidhur me kërkesat e institucioneve të nivelit qendror (p.sh., grupet Ndërminstrore të punës të ZQM, ABGj, MAPL mbi temat specifike të të drejtave të njeriut). Për shembull, NjDNj në MZhe ka plotësuar një pyetësor të dërguar nga Komisioni i Parlamentit të Kosovës për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, Personat e Zhdukur dhe Peticionet, në bazë të të dhënave të brendshme. Një shembull

182 Intervista me zyrat e NjDNj dhe të IAP në të pesë rajonet, Misioni i Parë Vlerësues.

183 Për shembull, NjDNj në MeF raportoi se qëkur ka pasur një mosmarrëveshje për buxhetin në vitin 2011, IAP e ka ndaluar bashkëpunimin me NjDNj dhe nuk i dërgon më informacione elektronike të korrespondencës për kërkesa mbi informacionin apo zbatimin e rekomandimeve të tij. Shihni më poshtë për një diskutim më të gjerë për këtë çështje.

184 Koordinator i NjDNj në MeF ka raportuar se pothuajse që prej një viti tashmë, IAP nuk e përfshin NjDNj në korrespondencat me ministrinë; nuk është dhënë asnjë justifikim.

185 Për shembull, NjDNj në MPCs, sic është raportuar gjatë Misionit të Parë Vlerësues.

186 Intervistë me NjDNj në MPB, Misioni i Parë Vlerësues.

187 Intervistë me NjDNj në MKRS, Misioni i Parë Vlerësues.

188 Sic është raportuar nga NjDNj në MPCs, mbi kërkesat e IAP për informacione mbi shkeljet e aluduara të të drejtave të njeriut, NjDNj në bashkëpunim me Departamentin Ligjor i kontrollon rastet e ankesave dhe koordinon me organin/departamentin përkatës, për të mbledhur të dhënat. Duke u bazuar në faktet në dispozicion dhe legjislacionin e aplikueshëm për këtë çështje, NjDNj ka hartuar letra të shkurtra (2-3 fjali) në emër të Sekretarit të Përgjithshëm, që do t'i dërgohen IAP apo individit në fjalë. Një shembull i thjeshtë është dhënë edhe nga NjDNj në MKRS, Misioni i Parë Vlerësues.

189 Kjo është dicka vecanërisht e zakonshme mes NjDNj që janë në Sekretarin e Përgjithshëm, sipas organogramit të ministrisë. Shembujt përfshijnë NjDNj në MASHT, MPCs dhe MKRS, sic është raportuar gjatë intervistave të Misionit të Parë Vlerësues.

tjetër është dhënë edhe nga NjDNj në MeF, lidhur me plotësimin e një pyetësori mbi numrin e personelit të paaftë në ministri¹⁹⁰.

150. Nuk duket se ekziston një formular i njëjtë mbi mbledhjen e të dhënave nga ndonjëra prej NjDNj, ose nga organi që bën kërkesën në nivelin qendror. Të dhënat ndahen mbi baza të rregullta (p.sh. raportimet vjetore dhe gjysmëvjetore tek ZQM dhe ABGj) ose mbi baza *ad hoc* sipas kërkesës së institucioneve (p.sh. vlerësimi për zbatimin e një strategjie apo plani veprimi, si një rezultat i takimeve të grupit të punës)¹⁹¹.
151. Megjithatë, duket se ekziston pak konfuzion për përcaktimin e roleve mes NjDNj të ndryshme, ZQM, ABGj dhe MIE. Për shembull, NjDNj në MAP raportoi se të gjitha statistikat e mbledhura nga ZQM ishin koordinuar aktualisht përmes tyre, duke pasur parasysh se kjo ministri ka një databazë të zgjeruar lidhur me nëpunësit civilë që punojnë në sektorin e administratës publike. Si rezultat, NjDNj në MAP e konsideron veten si institucioni më kompetent që mund të mbledhë statistika, për shembull, për çështjet e barazisë gjinore¹⁹². Po ashtu, NjDNj në MIE jep një interpretim të gjerë të rolit të saj monitorues, duke përfshirë në të bashkërendimin e mbledhjes së informacionit (p.sh., raporte dhe statistika) mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga raportet vjetore të progresit të BE-së për Kosovën. Nëpërmjet Planit të Veprimit të Partneritetit European, NjDNj në MIE kërkon informacione nga të gjitha NjDNj nëpër ministri dhe ZQM, të cilat duhen transmetuar në raportimet e qeverisë për Brukselin lidhur me progresin e bërë¹⁹³.
152. Me disa përjashtime, NjDNj nëpër ministri nuk kanë krijuar mekanizmin e tyre të brendshëm të mbledhjes së të dhënave, për shembull, për sa i përket informacionit për ankesat e marra nga nëpunësit dhe individët që punojnë nëpër ministri, si dhe shkallën e suksesit të zbatimit të rekomandimeve të IAP ose rekomandimeve të tyre për shkeljet e aluduara të të drejtave të njeriut. Mundësia për të krijuar sisteme të tilla monitorimi mbështetet fuqishëm në iniciativat dhe kapacitetet e koordinatorëve të NjDNj. Për shembull, koordinatorja në MPMS mban statistika për ankesat e marra, por, për shkak se nuk pati një proces dorëzimi pasi ajo u largua nga posti, si dhe për shkak të shkurtimeve aktuale të personelit, kjo praktikë nuk vazhdoi¹⁹⁴.
153. Asnjë nga NjDNj nëpër ministri nuk ka raportuar të përdorë përfundimet e veprimtarive monitoruese, statistikave dhe raporteve të përgatitura nga OShC, pavarësisht se kishin deklaruar se kishin marrëdhënie dhe bashkëpunim të mirë në përgjithësi¹⁹⁵. Megjithatë, asnjëra nga OShC të intervistuar nuk ishte në dijeni të punës dhe bashkëpunimit të NjDNj nëpër ministri me shoqërinë civile. Me të vërtetë, e disi për t'u habitur, disa nga OShC nuk e kanë konsideruar monitorimin e përbushjes së të drejtave të njeriut, si një pjesë të nevojshme të mandatit të NjDNj¹⁹⁶.
154. Vlen të përmendet roli i ish-NjDNj në MAPL në monitorimin e rekomandimeve të IAP nga komunat. Si një praktikë unike, IAP dorëzon kërkesa për mbledhjen e të dhënave dhe zbatimin e rekomandimeve të tyre për shkeljet e aluduara të të drejtave të njeriut, në Departamentin Ligjor të MAPL, duke ia përcjellë informacionin edhe Divizionit. Divizioni synon të ushtrojë presion mbi komunat që të përbushen rekomandimet e IAP¹⁹⁷ por herë pas here, monitorimi i përbushjes së këtyre rekomandimeve nga ana e tyre bëhet i vështirë. Kjo ndodh për shkak të ristrukturimit të kohëve të fundit të MAPL, që ka çuar edhe në krijimin e një Divizioni tjetër për Monitorimin

¹⁹⁰ Intervistë me NjDNj në MeF, Misioni i Parë Vlerësues.

¹⁹¹ Kjo e fundit është përmendur nga NjDNj në MeF dhe MED gjatë Misionit të Parë Vlerësues.

¹⁹² Intervistë me NjDNj në MAP, Misioni i Parë Vlerësues.

¹⁹³ Duhet shënuar se struktura e NjDNj në MIE ka ndryshuar në përputhje me rregulloren e brendshme, e cila ka hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2012. Si rezultat, është krijuar Departamenti për Kriterin Politik, nën të cilin funksionojnë Divizioni i Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë e të Drejtave Themelore. Ky divizion, është parashikuar të ketë edhe 3 ose më shumë vetë personel shtesë. Në kohën e Misionit të Parë Vlerësues, informacioni i mbledhur nga një punonjës në ministri, që nuk ka qenë duke punuar drejtëpërdrejtë në NjDNj.

¹⁹⁴ Intervistë me ushtruesin e detyrës së koordinatorit të NjDNj në MPMS, që gjithashtu është edhe zyrtari i mundësive të barabarta dhe barazisë gjinore, Misioni i Parë Vlerësues.

¹⁹⁵ Marrëdhëniet e mira raportohen veçanërisht nga NjDNj në MASHT dhe MeF.

¹⁹⁶ Intervistë me OShC në rajonin e Prishtinës, Misioni i Parë Vlerësues.

¹⁹⁷ Për shembull, rekomandimet e IAP lidhur me largimet nga shkolla në komunat e Mitrovicës, Vushtrisë dhe Skënderajt.

e Komunave nën Departamentin e Çështjeve Ligjore dhe Monitorimin e Komunave. Ky divizion i ri ka për detyrë kryesisht çështjet e përgjithshme të plotësimit të rekomandimeve, që shtrihen që nga monitorimi i seancës së kuvendit komunal e deri te zbatimimi i rekomandimeve të IAP. Raportohet që pas Reformës në Administratën Publike, ish-NjDNj janë transformuar në një divizion të ri, që ka qenë i shkëputur nga ky departament dhe është vënë nën strukturën ekzistuese. Aktualisht, divizioni koordinon punën me Departamentin Ligjor. Sipas Shefit të Divizionit, ky strukturim i brendshëm ka krijuar një fragmentim dhe struktura të shumëfishta, duke penguar përpjekjet e përgjithshme efektive të MAPL në monitorimin e veprimtarive të saj¹⁹⁸.

155. Divizioni Komunal për Promovimin e të Drejtave të Njeriut në MAPL, monitoron punën e NjD-Nj në komunë, si dhe mbledh informacionin për identifikimin e arritjeve dhe pengesave lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut. Përmes raportit të tij të fundit në vitin 2012¹⁹⁹ divizioni ka lëshuar përfundimet dhe rekomandimet e veta, duke dhënë edhe një listë statistikore mbi numrin e ankesave të marra nga NjDNj nëpër komuna. Pavarësisht nga përpjekja pozitive për të hartuar një raport analitik me të dhëna bazë, raporti është i bazuar vetëm në informacionin e siguruar nga koordinatorët e NjDNj dhe ZQM e ABGj, në bazë të pyetësorit të MAPL dhe jo të gjitha shifrat duket se janë plotësuar. Përfundimet shpesh i referohen deklaratave të zyrtarëve komunalë, pa paraqitur ndonjë provë.

156. Në përgjithësi, ekziston qartazi një mungesë përvojë mes personelit përgjegjës për monitorimin. Për shembull, raportet e ministrive, komunave dhe disa institucioneve të tjera e OJQ-ve, si shtojca të raportit vjetor të ZQM për vitin 2011, duken se janë përshkruese dhe nuk e sigurojnë të gjithë informacionin e saktë sipas kolonave të formularit (matriksit). Për më tej, rezultatet e veprimtarive nuk janë të matshme a të synuara drejt rezultateve. Shpesh, përfundimi i një veprimtarie, p.sh. organizimi i një tryeze të rrumbullakët, konsiderohet si sukses²⁰⁰. Institucionet raportuese nuk kanë përfshirë një përlllogaritje të saktë të buxhetit mbi fondet e përdorura për realizimin e veprimtarive apo të afateve të treguara specifiku. Për më tej, gjuha e raportit fokusohet vetëm në veprimtaritë e ZQM pa ofruar ndonjë vlerësim të raporteve të marra nga të gjitha institucionet përkatëse. Pa caktimin e resurseve të nevojshme (p.sh., personeli i kualifikuar) dhe trajnimin e përshtatshëm, kjo dobësi nuk ka gjasa të zgjidhet.

9. RAPORTIMI

9.1 Institucionet Përkatëse

157. Raportimi mbi të drejtat e njeriut ka disa dimensione. Pjesërisht, ai është thjesht rezultat i procesit të monitorimit. Megjithatë, raportet japin kontributin e tyre në mënyrë të ndryshme në rritjen e vetëdijesimit të publikut për të drejtat që supozohet të gëzojnë, pavarësisht prej problemeve që dalin. Kështu, ato mund të kenë një vlerë promovuese. Njëkohësisht, vetëdijesimi për problemet mund të çojë në përgjegjshmërinë, dhe ky mund të jetë një element në sigurimin e reparacionit për ato shkelje të caktuara.

158. Pavarësisht se raportimi është një tipar i strukturave të brendshme të të drejtave të njeriut, është po ashtu një aspekt i rëndësishëm për detyrimet e veçanta që ndërmerren kur ratifikohen shumë traktate të të drejtave të njeriut, sepse interesi në raporte të tilla nga komisionet e ekspertëve është njëri nga elementet e marrëveshjes për të siguruar zbatimin e dispozitave të këtyre traktateve.

159. Ekziston një varg institucioneesh në nivelin qendror dhe atë lokal, që përfshihen në raportimin e të drejtave të njeriut në Kosovë.

198 Intervistë me NjDNj në MPCPS, Misioni i Parë Vlerësues.

199 MPCPS, Promovimi i të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna në Republikën e Kosovës, (2013).

200 Qëkur filloi puna në terren, ZKM/ZQM ka përgatitur një «Korniza të re Monitorimi» me tregues specifike, të matshëm, të qëndrueshëm e relevantë, që është përdorur për të monitoruar zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit dhe të Drejtave të Fëmijëve. Nuk ka qenë e mundur të vlerësohen as treguesit dhe as efektshmëria e monitorimit që u bë.

160. Gjatë misionit vlerësues, disa nga institucionet, veçanërisht ato komunale, iu referuan raportimit që u bë vetëm në kontekstin e kërkesave për të raportuar lidhur me punën dhe veprimtaritë e tyre tek autoritetet mbikëqyrëse²⁰¹. Prandaj, vetëm disa prej tyre iu referuan raportimit mbi të drejtat e njeriut në kontekstin e raportimit të situatave dhe të shkeljeve të të drejtave të njeriut në komunën e tyre përkatëse, ose brenda institucioneve të tyre. Megjithatë, në këtë seksion, adresohen të dyja këto aspekte të raportimit.
161. Institucioni që është potencialisht më i rëndësishmi lidhur me përgatitjen e raporteve për zbatimin e të drejtave të njeriut dhe ekzistencën e shkeljeve të këtyre të drejtave, është pa dyshim, IAP. Kështu, ai është përgjegjës për përgatitjen e raporteve vjetore dhe të veçanta që lidhen me punën e tij, situatën e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe saktësinë e përgjigjeve ndaj rekomandimeve të bëra lidhur me një shkelje të caktuar, pas hetimit²⁰². Këto raporte shkojnë në PK, por në rast të përgjigjeve joadekuate, mund të shkojë gjithashtu edhe në autoritetin më të lartë kompetent dhe në media.
162. Përveç kësaj, çdo dy vjet supozohet që qeveria të raportojë në PK lidhur me arritjet e PKBGj²⁰³. Përgjegjësi të tjera raportuese i janë dhënë: ABGj (zbatimi i akteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të miratuara nga qeveria, mbi barazinë gjinore²⁰⁴); MAPL (përmbledhje e mekanizmave raportues mbi të drejtat e njeriut nëpër komuna); NjDNj nëpër komuna (veprimtaritë e tyre, duke përfshirë edhe situatën mbi të drejtat e njeriut²⁰⁵); ZQM (përfshirja e shoqërisë civile²⁰⁶); dhe ZKL (raportimet çdo dy vjet në Bord dhe raportet vjetore në qeveri dhe PK, si dhe raportet e veçanta në çdo kohë tek të tri organizmat, lidhur me natyrën urgjente apo rëndësinë brenda fushës së kompetencave dhe përgjegjësisive të saj²⁰⁷).
163. Deri kohëve të fundit, nuk ka pasur asnjë institucion në Kosovë që ka pasur përgjegjësinë për raportimin tek organizatat dhe organet ndërkombëtare, por praktikisht raportet përgatiteshin nga ZQM, me ndihmën e organizatave ndërkombëtare, dhe dorëzoheshin përgjithësisht nga UNMIK-u, pavarësisht se është kuptuar që vetë ZQM i dorëzon një raport Komisionit për të Drejtat e Fëmijëve në vitin 2011²⁰⁸. Tani përgjegjësia për të raportuar ka mbetur me ZQM²⁰⁹.

9.2 Arritjet

164. Sipas informacionit të marrë nga misioni vlerësues, shumica e institucioneve e përmbushin detyrimin e tyre të veçantë për të përgatitur raporte mbi baza periodike, pavarësisht se ato jo gjithmonë dorëzohen brenda afateve kohore të përcaktuara.
165. Kështu, IAP përgatit dhe dorëzon raporte vjetore, siç parashikohet me ligj, si dhe disa raporte të veçanta. Të gjitha këto raporte janë të shfrytëzueshme në mënyrë publike²¹⁰. Botimi i këtyre raporteve e ka rritur vetëdijesimin e publikut dhe të institucioneve përkatëse për situatën e të drejtave të njeriut, ashtu siç edhe ka ndihmuar në ndjekjen e trendeve.
166. Po ashtu, edhe ZQM përgatit raporte gjysmëvjetore mbi veprimtaritë, disa prej të cilave boto-

201 Intervistë me NjDNj nëpër ministri gjatë qershorit 2013, Misioni i Parë Vlerësues

202 Ligji Nr. 03/L-195 mbi Avokatin e Popullit, (2010), Neni 16.1.5, 22, 27 dhe 28.

203 Ligji Nr. 2004/2 mbi Barazinë Gjinore (Gazeta Zyrtare, Nr. 14, 1 korrik 2007), Seksioni 4, (paragrafi 6)

204 Ligji Nr. 2004/2 mbi Barazinë Gjinore (Gazeta Zyrtare, Nr. 14, 1 korrik 2007), Seksioni 5 (Paragrafi 5.2 (nënparagrafi e)

205 Udhëzimi Administrativ Nr. 2011/04 – MAQV mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ 2011/1 mbi Themelimin e Njësive të të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna, Neni 8, paragrafët 4,5 dhe 7.

206 Rregullorja Nr. 16/23 mbi Strukturën Organizative të Zyrës së Kryeministrit, përgjegjësitë e ZQM, Neni 40, paragrafi 1 (1.8) (2013)

207 Rregullorja Nr. 07/2012 mbi Zyrën e Komisionerit të Gjuhës, Neni 18

208 Megjithatë, kjo nuk është listuar në databazën e traktateve të Kombeve të Bashkuara (http://tbineternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/TBSearch.aspx?Lang=en). UNMIK-u ka dorëzuar një raport tek CEDAW në fillim të vitit 2013, por ai u kthye mbrapsht për shkak të mospërputhjes me udhëzimet.

209 Rregullore Nr. 16/23 mbi Strukturën Organizative të Zyrës së Kryeministrit (2013).

210 Për raportet vjetore shih <http://www.ombudspersonkosovo.org/?id=1,0,101,106.a> dhe për raportet e veçanta shih <http://www.ombudspersonkosovo.org/?id=2,0,151,157.a>.

hen edhe në internet²¹¹. Megjithatë, asnjë raport i tillë i rregullt nuk është vënë në dispozicion që nga ai i vitit 2008. Nga ana tjetër, ZQM lëshoi disa raporte tematike mbi çështje të ndryshme të drejtave të njeriut ose mbi zbatimin e dokumenteve specifike strategjike të drejtave të njeriut. Për shembull, raporti i fundit publik në faqen e internetit të ZQM 'Studim i Përgjithshëm i Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë*' u botua në dhjetor 2011, në bashkëpunim dhe me përdorim të fondeve të Programit Zhvillimor të Kombeve të Bashkuara (UNDP)²¹². Po ashtu, ZQM ka lëshuar tri raporte vjetore mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës* (2009-2011). Siç është deklaruar në raportin e saj të fundit vjetor (2011), ZQM në bashkëpunim dhe me mbështetjen e UNICEF-it në Kosovë* ka përgatitur dhe botuar raportin e parë mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve (2009-2010). Një mbështetje e ngjashme është dhënë kohëve të fundit edhe nga komuniteti ndërkombëtar, veçanërisht nga UNICEF-i dhe OSBE-ja mes organizatave të tjera, në përfundimin e shqyrtimit të gjysmës së punës për Planin e Veprimit të Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve (2009-2015) në korrik të vitit 2013.

167. Sipas informacionit të siguruar gjatë misionit të parë vlerësues, NjDNj dorëzojnë raporte të rregullta tek ZQM dhe ABGj, si dhe në MAPL. Raportet e NjDNj nëpër ministri u përfshinë si një pjesë e veçantë e raporteve të ZQM. Raporte të ngjashme me të fundit, me të njëjtin lloj informacioni nga NjDNj nëpër komuna, janë hartuar edhe nga MAPL²¹³.

168. ABGj nuk ka përgatitur deri më tani raporte vjetore lidhur me veprimtaritë e veta dhe veçanërisht lidhur me zbatimin e akteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të miratuara nga qeveria, mbi barazinë gjinore në Kosovë. Pavarësisht se buletinet në faqen e saj të internetit janë mjaft informative, kjo nuk duhet të zëvendësojë raportet përkatëse vjetore. Për më tej, ABGj nuk ka lëshuar ende ndonjë raport mbi zbatimin e PKBGj, ndërkohë që rrjeti i shoqërisë civile ka botuar një raport monitorues mbi Programin Kosovar* dhe Planin e Veprimit kundër Dhunës në Familje (2011-2014), Strategjia Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore (2011-2014), dhe Ligjin mbi Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje²¹⁴. Megjithatë, në aspektin pozitiv, ABGj ka përgatitur dhe ka botuar raporte që lidhen me vlerësimin e situatës së barazisë gjinore, duke përfshirë një numër studimesh për pozitën e grave përmes përdorimit të burimeve të jashtme (p.sh. shoqëria civile, komuniteti ndërkombëtar dhe agjensitë private konsultuese)²¹⁵.

9.3 Mangësitë

169. Institucionet që e mbajnë këtë përgjegjësi, zakonisht nuk i kanë aftësitë dhe kapacitetet për të përgatitur raporte të gjithanshme. Prandaj, edhe pse raportet e IAP duket se janë të hartuara mirë, përsëri ka vend për përmirësime. Pozicioni është edhe më i keq kur konsiderohen raportet tematike të ZQV, sepse ato kryesisht mbështeten në asistencën e dhënë nga organizatat e komu-

211 Shih raportet në dispozicion mbi të Drejtat e Njeriut në: <http://www.humanrights-ks.org/?cid=2,16>

213 Shih <http://www.humanrights-ks.org/repository/docs/Broad%20Survey%20of%20Persons%20with%20Disabilities%20in%20Kosovo.pdf> (shfrytëzuar më 5 nëntor 2013).

213 Shih, p.sh., Raportin Përmbledhës mbi Promovimin e të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna në Republikën e Kosovës 2012, <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/0480e499-435a-4882-9a5c-4655a9efe918/Raport---Promovimi-i-te-drejtave-te-njeriut-ne-Kom.aspx> (shfrytëzuar më 13 korrik 2013). MAQV lëshon raporte vjetore publike, duke përfshirë edhe sugjerimet e Divizionit për Promovimin e të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna në fushat e të drejtave të njeriut (p.sh. barazia gjinore, dhuna në familje, të drejtat e njeriut, të drejtat e komuniteteve, personat me aftësi të kufizuara, etj). Megjithatë, Divizioni i raporton Departamentit të Çështjeve Ligjore dhe Monitorimit të Komunave, mbi baza 6-mujore.

214 Shih http://www.ngozana.org/ngarkimet/dokumentet/UNDP_Final_Annual_Monitoring_Report_07%2012%202012_ENG%20%282%29_24.pdf, (dhjetor 2012) (shfrytëzuar më 7 nëntor 2013).

215 Shembujt përfshijnë 'Lejen e Shtatëzanisë, Kigjin e ri të Punës dhe të Punësimit të Grave' në <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Pushimi%20i%20Lehonis%20C3%AB,%20Ligji%20i%20ri%20i%20pun%C3%ABs%20dhe%20pun%C3%ABsimit%20i%20femrave%20n%C3%AB%20tregun%20e%20pun%C3%ABs%20-%20RAPORT%201.pdf>; 'Gratë në Sektorin e Punësimit dhe Vendim-Marrjen në Kosovë' në <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Raportit%20i%20hulumtimit%20%27%27Grat%C3%AB%20n%C3%AB%20procesz%20e%20pun%C3%ABs%20dhe%20Vendimarrjes%20%27%27shqip%20A5%20-%20088%20faqe.pdf>; 'Przantimi i Grave në Median e Shkruar' në <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/ABGJ-Hulumtimi%20Grat%C3%AB%20n%C3%AB%20Mediat%20e%20Shkruar%20%202011-20012.pdf> (e gjitha e shfrytëzuar më 8 nëntor 2013).

nitetit ndërkombëtar dhe projektet teknike. Për sa i përket raporteve tematike të ABGj që u ishin dhënë konsulantëve të jashtëm për t'u përgatitur, cilësia duket se është më e lartë, veçanërisht në rastet e përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile. Megjithatë, duhet vënë re se pronësia e këtyre raporteve dhe ndjekja e rekomandimeve të tyre kërkon një qasje më të afërt të organeve të qeverisë në procesin e hartimit. Mungesa e aftësive për të përgatitur raporte profesionale shumëfishohet në rastin e disa NjDNj, kur ato nuk janë tërësisht në dijeni mbi natyrën e mandatit të tyre.

170. Mungesa e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të mekanizmave jogjyqësorë të të drejtave të njeriut, e paraqitur edhe në pjesë të tjera të këtij raporti, reflektohet edhe në procesin e raportimit. Sigurisht, ekzistenca e një morie institucionesh ka krijuar një konfuzion lidhur me zinxhirin raportues²¹⁶.
171. NjDNj nëpër komuna i raportojnë strukturës së tyre të brendshme brenda komunës.²¹⁷ Të njëjtat njësi duhet të përgatisin raporte për MAPL, dhe përveç kësaj ato duhet t'i raportojnë ABGj për të gjitha çështjet gjinore. Po ashtu, ato duhet t'i raportojnë edhe ZQM për të gjitha veprimtaritë që lidhen me barazinë gjinore (duke përfshirë vetë barazinë gjinore). Kjo gjë ka krijuar konfuzion mes NjDNj nëpër komuna²¹⁸. Po ashtu, të gjitha NjDNj nëpër ministri duhet të dorëzojnë raportet e tyre në organet mbikqyrëse të ministrisë (që është Sekretari i Përgjithshëm i Drejtorit të Departamentit në të cilin ata punojnë); NjDNj-së në MAP kur kërkohet; ZQM dhe ABGj. Dorëzimi i këtyre raporteve mbi tema të ngjashme, por për institucione të ndryshme ka krijuar një dyfishim aspak të dobishëm, si dhe disa keqkuptime lidhur me atë që kërkohet.
172. Gjithashtu ka konfuzion edhe për rolet përkatëse dhe përgjegjësitë e NjDNj të MAP dhe ZQM. Disa herë nuk ka qenë e qartë se cili nga këto dy organe duhet të komunikojë me NjDNj-të nëpër ministri dhe se kujt duhet t'i raportojnë ato. Sipas NjDNj në MAP, ajo – si e vetmja ministri përgjegjëse për të gjithë administratën publike – duhet të presupozojë, ose të paktën të kishte presupozuar, një rol më të madh në lidhje me NjDNj-të nëpër ministrinë e tjera. Pavarësisht nga kjo, në bazë të informacionit të siguruar nga institucionet përkatëse, ZQM është konfirmuar si institucioni mbikqyrës që kryeson udhëheqjen në bashkërendimin e përpjekjeve të qeverisë në çështjet e të drejtave të njeriut, duke përfshirë raportimin mbi të drejtat e njeriut. Në fakt, të gjitha statistikat e mbledhura nga ZQV bashkërendohen nëpërmjet NjDNj në MAP. Kjo ka krijuar edhe më shumë konfuzion mes ministrive.
173. Sa për NjDNj nëpër komuna, është e paqartë se kujt duhet t'i qasen ato në nivelin qendror kur ngrihet një çështje e të drejtave të njeriut. Për shembull, disa koordinatorë të NjDNj nëpër komuna kanë deklaruar se nuk kanë marrë ndonjë koment, kur e kanë kërkuar atë nga Divizioni i MAPL për Promovimin e të Drejtave të Njeriut nëpër Komuna. Si pasojë shumica e NjDNj nëpër komuna menduan se MAPL ose nuk kishte personel të mjaftueshëm, ose se personeli i saj nuk ishte tërësisht i dedikuar për të punuar me NjDNj. Për më tej, të gjitha NjDNj që janë vizituar kanë konsideruar se raportimi në tri zyra të niveleve qendrore nga ana e tyre ka qenë krejtësisht i paefektshëm, dhe këto tri zyra janë ABGj, MAPL dhe ZQM. Sipas mendimit të tyre, procesi do të ishte edhe më i përsheptuar dhe do t'i shmangte keqkuptimet, duke qenë kështu një proces shumë më efikas (si dhe atyre do t'u lihej më shumë kohë të fokusoheshin në punën e vet), nëse ato do të duhej të raportonin vetëm tek një institucion i vetëm në nivelin qendror. Lidhur me këtë, është deklaruar se atyre shpesh u kërkohet t'i raportonin ZQM mbi një temë për të cilën tashmë i ishte raportuar ABGj, kryesisht sepse kishte pasur një mungesë komunikimi mes këtyre institucioneve të nivelit qendror.

10. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

216 Intervistë me NjDNj nëpër ministri gjatë qershorit të vitit 2013, Misioni i Parë Vlerësues

217 Pavarësisht se disa i raportojnë Drejtorit Komunal të Administratës dhe Personelit – që është në përputhje me UA 2011/04 – dhe të tjerët i raportojnë kryetarit të komunës.

218 Intervistë me NjDNj nëpër komuna gjatë qershorit të vitit 2013, Misioni i Parë Vlerësues

10.1 Përfundime

174. Strukturat jogjyqësore të të drejtave të njeriut kanë dhënë padyshim një kontribut në sigurimin e të drejtave të njeriut në Kosovë, veçanërisht lidhur me zhvillimin e strategjive dhe planeve të veprimit, si dhe me marrjen në konsideratë, në mos edhe zgjidhjen, e ankesave individuale. Megjithatë, mbetet një mori problemesh të të drejtave të njeriut, të cilat ose nuk janë adresuar fare, ose nuk u është dhënë një zgjidhje e duhur, si dhe një pamjaftueshmëri e njohurive të të drejtave të atyre individëve të cilët ndikohen nga këto çështje nga aspekti ligjor dhe kushtetues, ose i mekanizmave që ata mund të përdorin për t'i siguruar ato²¹⁹. Ndërkohë që jo të gjitha problemet mund t'i atribuohen dobësive në organizimin dhe funksionimin e strukturave jogjyqësore të të drejtave të njeriut, ekzistenca e tyre vë në pikëpyetje efektshmërinë e statusit aktual, por vetëm me idenë e marrjes në konsideratë të rrugëve të mundshme me të cilat ato mund të përmirësohen.
175. Mangësitë e identifikuar në këtë raport, ashtu si dhe në të tjerët para tij, janë kryesisht probleme që lidhen me kapacitetin, besimin, fokusin dhe thjeshtësinë. Të gjitha kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e strukturave jogjyqësore të të drejtave të njeriut, por funksionimi i tyre varet edhe nga mënyra se si perceptohen këto struktura nga individët të cilëve duhet t'u shërbejnë. Këto mangësi shumëfishohen nga mungesa e vetëdijesimit të publikut për të drejtat dhe mekanizmat, për të cilat strukturat jogjyqësore të të drejtave të njeriut duhet të përgjigjen në mënyrë të kënaqshme.
176. Kështu, strukturat jogjyqësore sigurisht kanë disa probleme që lidhen me burimet në dispozicion të tyre dhe me kompetencën e atyre personave që punojnë në to. E para ka të bëjë me ambientet adekuate të punës dhe të mbledhjes së të dhënave, si dhe me aftësitë e personelit të punësuar, ndërsa tjetra lidhet me cilësinë e personelit të tyre (duke trajtuar çështje të tilla si kuptimi i pamjaftueshëm i standardeve të të drejtave të njeriut, mungesa e një specializimi adekuat, mungesa e aftësive teknike të kërkuara për hartimin e strategjive të nevojshme dhe planeve të veprimit, si dhe matja e ndikimit të tyre, bashkë me një stërvarësi në mbështetjen ndërkombëtare për disa nga detyrat).
177. Çështja e besimit vjen nga mungesa e të marrit seriozisht të përpjekjeve të strukturave, dhe në veçanti të përkrahjes së funksionimit të tyre nëpërmjet dispozitës së burimeve dhe veprimit në bazë të këshillave dhe rekomandimeve të tyre. Kjo qasje në funksionimin e disa strukturave të të drejtave të njeriut, në fakt e minon besimin e publikut në aftësitë e tyre për të kryer rolet e shpallura publikisht dhe kjo, kuptohet, çon në një hezitim nga ana e publikut për t'iu adresuar atyre, me rezultatin që problemet e vërteta nuk zgjidhen por lihen të përkeqësohen. Rritja e numrit të ankesave tek IAP mund të tregojë një lloj zvogëlimi të mungesës së publikut në këtë institucion, por mosndjekja e një numri të konsiderueshëm ankesash të pranueshme, sugjeron që problemi nuk është zgjidhur. Për më tej, numri i përgjithshëm i ankesave ende duket relativisht i ulët, duke pasur parasysh pengesat në përdorimin e mekanizmave gjyqësorë.
178. Problemi i fokusit del nga një qasje jo sa duhet e përbashkët drejt (a) funksionimit të strukturave të ndryshme (p.sh. bashkëpunimi institucional), (b) ndikimi në planifikimin e problemeve që rrjedhin nga zbulimi i të dhënave të mbledhura (p.sh. përdorimi i të dhënave në dispozicion), (c)

²¹⁹ Shih më tej Mendimin e Këshillit të Europës, Komisionerit të të Drejtave të Njeriut, Raportin e Komisionerit të Këshillit të Europës për Misionin e Veçantë të të Drejtave të Njeriut në Kosovë, (CommDH(2009)23), (2009), Komisioni Europian, Dokumenti Punues i personelit të Këshillit që shoqëron dokumentin Komunikimi i Komisionit mbi një Studim të Mundshëm për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit mes Bashkimit Europian dhe Kosovës {COM(2012) 602}, 10 tetor 2012 (SËD(2012) 339), FRIDOM, Rishikim Funkcional i Sistemit të të Drejtave të Njeriut dhe Barazisë Gjinore, (2010), M A Jones dhe I Roagna, Raport Vlerësues (Shtojca V për Gjallërimin e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Kosovë, Raport Fillestar mbi Projektin e Përbashkët të Bashkimit Europian/Këshillit të Europës (2012)), Misioni i OSBE-së në Kosovë, Masat Zbatuese për Legjislacionin që Ushtrorjnë Ndikimin e tyre në të Drejtat e Njeriut në Kosovë, (shtator 2012), Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, Raporti Vjetor 2011 (2012) dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, Raport mbi Zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës (2009-2011) Periudha (janar 2011 - dhjetor 2011), (2012).

morja e strategjive dhe planeve të ndryshme të veprimit (p.sh. jo vetëm thjesht tentativa për të bërë shumë gjëra njëkohësisht, por bashkërendimi i efektshëm i veprimtarive që lidhen me njëra-tjetrën) (d) marrëveshjet për zbatimin e strategjive dhe të planeve të veprimit (p.sh. qëllimet që duhen arritur dhe teknikat për arritjen e tyre të cilat nuk janë mjaft të lidhura) dhe (e) masat e asaj që në fakt është arritur (p.sh., ndikimi i asaj që është bërë – që në fakt nuk është e pakonsiderueshme – nuk vlerësohet ashtu siç duhet, si për të vlerësuar efikasitetin, ashtu edhe për të identifikuar përmirësimet që mund të çojnë në rezultate më të mira).

179. Së fundmi, çështja e thjeshtësisë nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e shumëfishtë të aktorëve institucionalë të përfshirë (që krijon edhe konfuzion se kujt i duhet drejtuar, si për zyrtarët ashtu edhe për qytetarët, së bashku me dyfishimin e përpjekjeve) por edhe mbivendosjes e funksioneve, gjë e cila pa dyshim kontribon në problemin e fokusit që sapo u diskutua.

10.2 Rekomandime

180. Adresimi i mangësive të strukturave jogjyqësore të të drejtave të njeriut nuk do të sjellë ndonjë zgjidhje të problemeve të të drejtave të njeriut në Kosovë. Në të vërtetë, të presësh që ky synim do të jetë i menaxhueshëm këtu në krahasim me vendet e tjera, është krejtësisht joreale; nevoja që të bëhen përpjekje për t'i siguruar të drejtat e njeriut është e pafund. Megjithatë, duhen trajtuar edhe elemete të tjera që kontribuojnë në përpjekje të tilla, siç është funksionimi dhe besimi në sistemin gjyqësor. Strukturat jogjyqësore të të drejtave të njeriut përbëjnë tashmë një komponent të rëndësishëm, si për sa i përket burimeve dhe potencialit. Prandaj, synimi duhet të jetë të sigurohemi që ofrimi i funksionimit të mundësujë përmeshjen e besimit.
181. Prandaj, rekomandimet e mëposhtme bëhen duke pasur parasysh një rikonfigurim dhe rigjallërim të strukturave jogjyqësore të të drejtave të njeriut. Synimi është që kjo të bëhet duke përdorë më mirë burimet e caktuara për të drejtat e njeriut, sesa të ketë një rritje të numrit të tyre, pavarësisht se dokumenti shqyrtues që i parapriu këtij raporti nuk u përqëndrua në përcaktimin e kostos së rekomandimeve, dhe prandaj nuk është e mundur të thuhet që miratimi i tyre do të ketë një kosto neutrale. Pavarësisht nga kjo, siç e tregojnë edhe nivelet e personelit të strukturave të ndryshme, ekziston një sasi e konsiderueshme burimesh që po drejtohen në të gjitha aspektet e të drejtave të njeriut dhe shrytëzimi më i mirë i tyre duhet të shtojë vlerën e rezultatit të përfutur.
182. Deri më tani, një element i rëndësishëm i përkrahjes institucionale të strukturave jogjyqësore të të drejtave të njeriut është përkrahja e dhënë nga komuniteti ndërkombëtar, dhe ky raport nuk bën ndonjë supozim se do të ketë ndonjë ndryshim themelor të kësaj ndihme nga niveli aktual. Megjithatë, një përdorim më i mirë i burimeve duhet të nënkuptojë që në fund të fundit duhet të ketë një zvogëlim të përkrahjes institucionale të dhënë nga komuniteti ndërkombëtar. Atëherë mund të konsiderohet si e përshtatshme që të ridrejtohet ndonjë 'kursim' i përkrahjes së tillë në veprimtaritë programatike të strukturave jogjyqësore të të drejtave të njeriut, por sigurisht kjo do të jetë një çështje që do të konsiderohet nga donatorët individualë.
183. Këto rekomandime jepen jo vetëm duke pasur parasysh rekomandimet e raporteve të mëparshme, por ajo që është më e rëndësishmja, mbi iniciativat që po bëhen tashmë për të forcuar arkitekturën e të drejtave të njeriut në Kosovë. Bazuar në sa më sipër, përforsimi i pozitës së IAP dhe zgjerimi i mandatit të tij siç parashikohet në tri projekt-ligjet që janë edhe subjekt i ekspertizave të bashkëngjitura në këtë raport, si dhe ristrukturimi i propozuar i NjDNj sipas Reformës së Administratës Publike, janë veçanërisht të rëndësishëm. Për më tej, rekomandimet kanë marrë në konsideratë propozimet specifike të bëra në tri shtojcat e ekspertizës së këtij raporti dhe janë bërë mbi supozimin se edhe këto propozime do të miratohen.
184. Nuk supozohet që të gjitha rekomandimet do të mund të zbatohen me një hop të vetëm ose me 'big bang'. Ndryshimi ose zgjerimi i përgjegjësive do të kërkojë pa dyshim përgatitje (duke përfshirë edhe njëfarë riorganizimi administrativ) dhe – siç del edhe nga ekspertiza mbi legjislativonin

lidhur me IAP për sa i përket sugjerimit që mandatit të tij t'i shtohet roli i mekanizmit kombëtar parandalues – prezentimi i disa modifikimeve të propozuara do të duhet të bëhet përgjatë fazave të ndryshme, me qëllim që të bëhen dhe të zbatohen saktësisht ndryshimet e nevojshme. Për më tej, disa ndryshime tranzicionale mund të jenë me vend për sa u përket disa përgjegjësive që duhen rishpërndarë aty ku performanca e çështjeve të caktuara tashmë është vënë në binarë. Pavarësisht nga kjo, pjesa më e madhe e ndryshimeve që po propozohen duhet të jetë e arritshme maksimalisht brenda një periudhe prej dy vjetësh.

185. Rekomandimet fillimisht adresojnë çështjet që lidhen me kapacitetet dhe besueshmërinë, përpara se të kalojnë tek ato që lidhen me fokusin dhe thjeshtëzimin. Dy të parat mund të jenë më të lehtë nga të katërtat për t'u zbatuar, por dy të fundit janë ato ndryshime që në aspektin afatgjatë do të sjellin më shumë përfitime.

Kapaciteti

186. Çështja e kapacitetit duhet adresuar në mënyrë të kënaqshme nëpërmjet trajnimeve dhe rekrutimeve përkatëse si dhe resurseve më të mira të të gjitha veprimtarive të ndërmarra nga strukturat jogjyqësore të të drejtave të njeriut, që nuk d.m.th. domosdo ofrim i më shumë fondeve – ndonëse do të ketë raste ku kjo do të jetë e nevojshme – por shfrytëzim dhe shpërndarje më e mirë e burimeve ekzistuese (financiare dhe të personelit) dhe kjo është detyrë edhe për qeverinë, si siguroese, edhe për strukturat jogjyqësore, si përfituese.

187. Për sa i përket disponueshmërisë së personelit të përshtatshëm për detyrat që duhen kryer, çështjet e ndryshme të identifikuara lidhen me rekrutimin e personave pa kualifikimet dhe përvojën e nevojshme për detyrat që pritet të ndërmarrin, si dhe zhvillimin e pamjaftueshëm të kompetencës – qoftë kjo përmes shtimit të fushave të njohurive të specializuara, ose të mundësisë për t'i vlerësuar materialet e përgatitura nga të tjerët – si dhe dislokimin e duhur të personelit të kualifikuar që të sigurohet ndikimi maksimal, qoftë kjo në një nivel rajonal apo lokal, ose në organet që janë më të përshtatshme për funksionet që duhet të kryhen. Pavarësisht se pamundësia për të siguruar nivele të duhura të personalit me aftësi të përshtatshme përbën pengesën kryesore të resurseve që ndikon në strukturat jogjyqësore të të drejtave të njeriut, kapaciteti i tyre për funksionim mund të ndikohet edhe nga përshtatshmëria e mjeteve, shërbimeve dhe ambienteve në të cilat pritet të funksionojnë.

188. Më konkretisht, adresimi i kësaj mangësie kërkon që:

- specifikimet e punëve për pozitën në strukturat jogjyqësore të të drejtave të njeriut duhet të lidhen qartazi me detyrat që duhen kryer dhe përmbushja e këtyre specifikimeve duhet të jetë parakusht i panegociueshëm për çdo person që do të emërohet në këto pozita;
- caktimi i posteve në struktura të caktuara jogjyqësore të të drejtave të njeriut – për sa i përket funksioneve dhe numrave – duhet të udhëhiqet nga detyrat që priten të përmbushen nga këto struktura dhe të shkojë paralel me evolucionin e përgjegjësive;
- specializimi adekuat i personelit duhet të zhvillohet brenda këtyre strukturave që të jetë në përputhje me detyrat që duhen kryer prej tyre;
- organizimi i brendshëm i strukturave jogjyqësore të të drejtave të njeriut që synojnë t'i shërbejnë publikut të gjerë (p.sh., IAP) duhet të shmangë si centralizimin e panevojshëm ashtu edhe kontrollin e jashtëm të panevojshëm (p.sh., procesin për emërimin e zëvendës avokatëve të popullit);
- personeli duhet të ketë trajnim të vazhdueshëm, që duhet t'u drejtohet përgjegjësive të tyre të veçanta, duke mbuluar kështu jo vetëm aspektet teknike të standardeve të të drejtave të njeriut, por edhe politikëbërjen dhe zbatimin, menaxhimin e organizatës, monitorimin dhe raportimin; dhe
- strukturat jogjyqësore të të drejtave të njeriut duhet të pajisen me mjete, shërbime dhe lokale të përshtatshme për detyrat që pritet t'i kryejnë.

Besimi

189. Siguria e shtuar nga ofrimi i fondeve dhe mjeteve, shërbimeve dhe lokaleve, do të zgjidhë edhe një nga faktorët që dikton besimin e publikut në strukturat jogjyqësore e në veçanti tek IAP. Megjithatë, ekziston një nevojë edhe që roli i strukturave jogjyqësore të të drejtave të njeriut të merret më seriozisht nga ata që varen nga funksionimi i tyre, si dhe të njihet e të kuptohet më mirë nga publiku dhe OShC.
190. Çështja e besimit të publikut është veçanërisht e rëndësishme për ato struktura që supozohet t'i mbajnë autoritetet publike përgjegjëse në çdo nivel për mosrespektimin e standardeve të të drejtave të njeriut të cilat janë të aplikueshme në rastin e këtyre autoriteteve. Megjithatë, siç është parë, ka pasur probleme të përsëritura në implementimin e rekomandimeve nga IAP në veçanti, por edhe nga KKK. Kjo vë një përgjegjësi të veçantë mbi ato autoritete që t'i marrin më seriozisht këto rekomandime, si dhe që Parlamenti i Kosovës të sigurohet që kjo të ndodhë. Aty ku ka një mosmarrëveshje të bazuar lidhur me një rekomandim, ai duhet zgjidhur në një mënyrë konstruktive e të respektueshme dhe jo të injorohet. Autoriteti i institucioneve të pavarura varet nga disa garanci për ata që punojnë aty dhe aktualisht nuk ka mbrojtje të mjaftueshme për personelin e IAP. Njëkohësisht, besueshmëria e publikut në kapacitetet e strukturave jogjyqësore të të drejtave të njeriut kthehet pjesërisht në një rritje të vetëdijesimit për atë se çka mund të bëjë dhe ka bërë kjo strukturë, dhe kjo gjë ende mbetet në nivete të ulëta, prandaj edhe drejtimi i çështjeve tek këto struktura është më i ulët nga ç'pritet duke marrë parasysh problemet ekzistuese.
191. Më konkretisht, adresimi i këtyre mangësive kërkon që:
- të jetësohen rekomandimet e strukturave jogjyqësore të të drejtave të njeriut me mandatin që të sigurojë reparacionin dhe të identifikojnë problemet në sistem (p.sh. KKK dhe IAP), ashtu që çdo mosmarrëveshje me to të adresohet në mënyrën e duhur;
 - të gjithë ata që punojnë për IAP të gëzojnë imunitet funksional, si gjatë kohës që janë të punësuar, ashtu edhe më pas; dhe
 - veprimtaritë e shtrirjes së strukturave jogjyqësore të të drejtave të njeriut duhen shtuar, me qëllim që publiku dhe OShC të kuptojnë rolet e tyre të veçanta dhe fushëveprimin e përdorimit apo të bashkëpunimit me to.

Fokusi dhe thjeshtësia

192. Detyra e adresimit të nevojës për fokusim dhe thjeshtësi është domosdoshmërisht e lidhur me vetë strukturat jogjyqësore të të drejtave të njeriut si dhe me mënyrën në të cilën iu caktohen funksionet. Këto qëllime binjake duhet të jenë që të sigurojnë një thjeshtëzim të strukturimit institucional dhe të shmangin ndonjë konfuzion lidhur me përgjegjësitë e strukturave individuale jogjyqësore të të drejtave të njeriut.

Zhvillimet e politikave

193. Në rastin e zhvillimit të politikave lidhur me të drejtat e njeriut, këto qëllime do të arriheshin më mirë duke pranuar së pari se Kosova është mbingarkuar me politika, plane veprimi dhe strategji – duke mos folur këtu për meritat e konsiderueshme individuale të objektivave të ndryshme që ato ngërthejnë – dhe që këtej e tutje duke kërkuar të zvogëlohen disi numri dhe fushëveprimi i tyre. Sigurisht, një qasje që do të përfshinte identifikimin e prioritetëve më të pakta dhe më të arritshme për zbatim ka të ngjarë që të çojë në rezultate më pozitive në aspektin afatgjatë.
194. Për më tej, në ndjekjen e një qasjeje më të kufizuar, duhet siguruar që rezultatet e veprimtarive monitoruese – si nga organizmat qeveritare ashtu edhe nga organizmat e tjerë, si IAP dhe komisionet përkatëse të IAP – të merren plotësisht parasysh në zhvillimin e politikave, strategjive dhe planeve të ardhshme të veprimit. Aktualisht monitorimi dhe zhvillimet e politikave janë zakonisht veprimtari që nuk lidhen me njëra-tjetrën, gjë kjo që çon jo vetëm në dyshime për vlerat e tyre, por që ushtron edhe një ndikim në to.

-
195. Sigurisht, siç mund të shihet nga shembujt e SPVDNj dhe PKBGj, zhvillimi i politikave, planeve të veprimit dhe strategjive ka vuajtur nga mungesa e objektivave mjaftueshëm të matshme dhe nga një metodologji e duhur, që janë edhe jetike për zbatimin e strategjive të tilla dhe planeve të veprimit. Prandaj, është e domosdoshme që përpjekjet më të mëdha të bëhen në formulimin e politikave, të planeve të veprimit dhe strategjive në një mënyrë të tillë që ato të kenë tregues të vërtetë matës për zbatimin e suksesshëm të tyre, si për të lehtësuar atë zbatim ashtu edhe për të lehtësuar monitorimin efektiv që do të ndërmerret, dhe për të parë nëse kjo gjë në fakt është arritur. Aktualisht, vetë monitorimi vuan nga mungesa e treguesve të tillë²²⁰ dhe në këtë mënyrë përfundimet e arritura nëpërmjet tij nuk janë domosdo ndihmesë për zhvillimin e ardhshëm të politikave, planeve të veprimit dhe strategjive.
196. Këto ndryshime, pa dyshim, do të çonin në një fokusim më të madh në zhvillimin e politikave, por vetë thjeshtëzimi i procesit nuk është diçka që do arrihet vetë, sepse ka shumë aktorë, përfshirja e të cilëve në të kërkohet nga përgjegjësia që ata kanë për zbatimin e asaj që do të zhvillohet, pra minsitritë e linjës dhe komunat përkatëse.
197. Në të vërtetë, këto institucione duhet – në parim – të jenë të vendosura më së miri që të shtjellojnë detajet e politikave, planeve të veprimit dhe strategjive të veçanta, meqë ato do të kuptojnë më së miri atë që kërkohet duke pasur parasysh afatin kohor dhe kufizimet e burimeve që kanë në dispozicion. Njëkohësisht, duket se ekziston një nevojë për njëfarë zhvillimi kapacitetesh në mënyrë që të sigurohemi se ato në praktikë janë në gjendje të ndërmarrin këtë rol në mënyrë të suksesshme²²¹ dhe të sigurohemi që kjo gjë që ndodh duhet të jetë prioritet.
198. Megjithatë, ekziston qartazi një nevojë si për drejtim ashtu edhe për bashkërendim në zhvillimin e politikave. E para është thelbësore nëse politikat, planet e veprimit dhe strategjitë do të jetnë të përputhura me kërkesat në nivelin kushtetues dhe ndërkombëtar. Për më tej, për të dytën ekziston një nevojë për shkak se përmbushja e gjithë atyre kërkesave në shumicën e rasteve nuk do të përbëjë një detyrë vetëm për një ministri a komunë të vetme, por do të dalë nevoja e dhënies së kontributit të disave prej tyre.
199. Këto dy role duhet të kryhen nga ZQM sa u përket të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe nga ABGj dhe IAP, sa u përket dy aspekteve të specializuara në këtë fushë, që janë barazia gjinore dhe komunitetet. Megjithatë, është e rëndësishme që këto tri organe brenda Zyrës së Kryeministrit të koordinojnë plotësisht veprimtaritë e tyre lidhur me zhvillimin e politikave, meqënëse qartësisht ka vend që iniciativat e caktuara të mbulojnë fushat e përgjithshme dhe ato të specializuara, me një lloj ‘gare’ në këtë drejtim që ka qenë e pranishme në të shkuarën. Prandaj, ekziston nevoja e shkëmbimit të informacioneve kryesore mes tyre dhe një gadishmëri nga ana e ZQM që t’u drejtohet partnerëve specialistë, aty ku zhvillimet e politikave të ndryshme lidhen me përgjegjësitë e tyre. Për më tej, meqë zhvillimi i politikave në këtë fushë mund të ngrejë çështje të integritimit evropian, të trija këto organe brenda Zyrës së Kryeministrit duhet të sigurohen që të ketë gjithnjë bashkëpunim të efektshëm me MIE për këto çështje.
200. Se si do të kryhen saktësisht rolet e drejtimit dhe bashkërendimit, është një çështje që ka nevojë të qartësohet. Kështu, ZQM shërben si një sekretariat për një numër Këshillash Ndërministrorë dhe grupesh pune – me kryeministrin si kryesues të tyre – ndërsa ABGj kryeson Këshillin Ndërministror për Barazinë Gjinore²²². Nuk ka qenë e mundur të përcaktohet nëse ky dallim ka qenë dallim përmbajtjeje apo forme, por nëse ka të bëjë me të përmbajtjen, kjo mund të minojë mundësinë e ZQM për të siguruar udhëheqjen dhe bashkërendimin efektiv që kërkohet. Për më tej, këto organe nuk duket se takohen rregullisht dhe kjo mund të ndikojë në dobinë e tyre në këtë

220 Korniza Monitoruese e miratuar kohët e fundit ka monitoruar Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit të të Drejtave të Njeriut duket një lëvizje shpresëdhënëse për ta korrigjuar këtë mangësi; shih para. 157.

221 Shih Vlerësimi Sigma mbi Kosovën* (prill 2013) (http://www.sigmaweb.org/publications/KosovoAssessment_2013.pdf) dhe Prioritetet Sigma mbi Kosovën* (maj 2013) (http://www.sigmaweb.org/publications/Kosovo_Priorities_2013.pdf).

222 Shih parag. 20 dhe 21.

aspekt të zhvillimit të politikave. Prandaj, duhet të sigurohemi që ABGj, ZÇK dhe ZQM kanë nivelin e duhur të autoritetit që do të sigurojë se ato janë në gjendje të kryejnë siç duhet përgjegjësitë e tyre lidhur me zhvillimin e politikave.

201. Kur zhvillohen politikat, sigurisht duhet të ketë edhe konsultim përkatës me organe të tilla si KKK, Komisioni i Komuniteteve, Komisionet Konsultative, KLSP, KKSK, ZKKK dhe GPKK. Përgjegjësia për të siguruar që kjo ndodh duhet të bjerë mbi ABGj, ZÇK dhe ZQM, në varësi të fushës së zhvillimit të politikave në fjalë.
202. Pavarësisht nga kjo, duket se nuk ka nevojë që NjDNj-të (duke përfshirë edhe ZBGj) të ruajnë ndonjë rol diskret të zhvillimit të politikave. Nga ana tjetër, duhet të ketë një ri-emërim të personelit nëpër NjDNj me përvojën e duhur në këtë fushë (siç janë ZBGj) nëpër ato zyra apo departamente nëpër ministri e komuna ku kjo përvojë do të mund të përdorej më së miri (p.sh. Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, Departamenti i Zhvillimit/Bashkërendimit Strategjik apo Departamenti Ligjor në rastin e ministrive dhe zyrat ligjore të komunave). Njëfarë rikonsiderimi i procesit është tashmë në zhvillim e sipër, sipas Reformës së Administratës Publike, për të emëruar personel të NjDNj në departamentet e personelit ose të burimeve njerëzore nëpër ministri, mund të jetë i nevojshëm për t'u siguruar që nuk do të humbet një burim potencialisht i vlefshëm.
203. Nevoja tashmë e përmendur për trajnimet në raste të personelit të përshtatshëm, duhet fokusuar jo vetëm në aspektin teknik të të drejtave të njeriut, por edhe në aspektin e politikëbërjes dhe të menaxhimit të organizatës.
204. Ekziston një nevojë që të promovohet përfshirja e shoqërisë civile dhe e publikut të gjerë në procesin e zhvillimit të politikave. Për këtë gjë, duhen organizuar fushata informuese për të ngritur nivelin e vetëdijesimit të publikut mbi mandatet e ministrive dhe të komunave përkatëse. Për më tej, faqet e tyre të internetit duhet të azhurnohen rregullisht, duke dhënë informacione kontaktuese dhe raporte publike mbi punën e tyre. Përveç kësaj, ministrinë dhe komunat duhet të synojnë të zhvillojnë takime të rregullta që përfshijnë publikun e gjerë në procesin e vendimmarrjes.
205. Për ta përmbledhur:
 - duhet të ketë një zvogëlim të numrit të strategjive dhe planeve të veprimit, me prioritete më të pakta e më të arritshme që të identifikohen për hir të zbatimit;
 - gjetjet e veprimtarive monitoruese duhet të merren gjithnjë në konsideratë lidhur me zhvillimet e ardhshme të politikave;
 - përgjegjësia për detajet e zhvillimit të politikave duhet të bjerë mbi ministrinë dhe komunat përkatëse;
 - ABGj, ZÇK dhe ZQM duhet të luajnë një rol udhëheqës dhe bashkërendues lidhur me zhvillimin e politikave dhe duhet t'u jepet autoriteti për t'i hequr këto përgjegjësi;
 - personeli i përfshirë në zhvillimet e politikave duhet të ketë trajnimin adekuat mbi politikëbërjen dhe menaxhimin e organizatës; dhe
 - duhen ndërmarrë hapa të nevojshëm për të promovuar përfshirjen e shoqërisë civile dhe publikut të gjerë në procesin e zhvillimit të politikave.

Zbatimi

206. Lidhur me zbatimin, nuk ekziston nevoja që të ndryshohet përgjegjësia primare që ministrinë dhe komunat kanë për këtë, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të ndryshme të administratës që kanë në dispozicion. Në fund të fundit, kjo është edhe arsyeja primare e ekzistencës së tyre.
207. Megjithatë, përgjegjësitë specifike të tyre në këtë fushë – duke përfshirë edhe përgjegjësitë e ndryshme jo vetëm të ministrive të veçanta (ose komunave) por edhe të atyre që punojnë në seksione të veçanta të tyre – duhet të tregohen më qartë në dokumentet dhe legjislacionin përkatës të politikave që të mos ketë vend për dyshime se kush duhet të bëjë çfarë dhe kur. Për më tej, aty

ku zbatimi kërkon ndihmesën e donatorëve apo të aktorëve të jashtëm (të tillë si organizatat e shoqërisë civile), duhet të bëhet e qartë se kush është përgjegjës për t'u siguruar që kjo asistencë do të merret dhe kështu duhet të bëjë çka në rast se ajo nuk sigurohet. Aktualisht, duket se ka një tendencë që të krijohet përshtypja se përgjegjësia bie mbi donatorin apo aktorin e jashtëm dhe ministria apo komuna përkatëse nuk konsideron që i kërkohet të bëjnë ndonjë gjë për të siguruar zbatimin e qëllimit të politikës atëherë kur asistencë e synuar nuk mund të jepet.

208. Roli bashkërendues lidhur me zbatimin i është dhënë ZQM, dhe lidhur me çështjet e barazisë gjinore dhe të komuniteteve, i është dhënë ABGj dhe ZÇK. Përshtypja e krijuar nga puna në terren ka qenë që roli aktual bashkërendues i luajtur nga ZQM e ka rritur kompleksitetin e procesit dhe ka parandaluar ata që kishin një interes të drejtpërdrejt të krijonin një ndjesi realiste të përgjegjësive të tyre aktuale për zbatim. Pavarësisht nga kjo, duket qartë që do të ketë nevojë për bashkërendim aty ku zbatimi i një ligji apo politike të veçantë do të përfshijë më shumë se një ministri apo komunë dhe pozicioni qendror i ZQM-së brenda Zyrës së Kryesministrit e vë atë në një pozitë mjaft të mirë për të koordinuar punën e disa institucioneve. Megjithatë, duhet pritur që ZQM duhet të luajë vetëm një rol bashkërendues në situata të tilla, p.sh., aty ku zbatimi kërkon përfshirjen e dy apo më shumë institucioneve. Aty ku zbatimi është qartësisht një çështje për një institucion të vetëm, roli i duhur për ZQM nuk është më një rol bashkërendues (duke shtuar në këtë mënyrë një nivel shtesë të procesit përpara zbatimit faktik) por rol monitorues lidhur me atë se deri në ç' masë i ka përmbushur institucioni në fjalë përgjegjësitë e veta. Kjo do të bënte rolin e ZQM lidhur me çështjen e zbatimit më të krahasueshëm me atë të ABGj, përgjegjësia e të cilës për sigurimin e barazisë gjinore është kryesisht e shtrirë në shumë organe dhe prandaj nuk është e kufizuar në përgjegjësitë specifike të ndonjë institucioni individual.

209. Aktualisht këshillimi për zbatimin ofrohet nga NjDNj-të, MKK, ZKKK-të dhe ZBGj-të. Përshtypja e krijuar nga puna në terren është se ndikimi i NjDNj-ve nuk ka qenë përgjithësisht i konsiderueshëm, duke qenë më relevant ndaj zbatimit të çështjeve që lidhen me personelin brenda institucioneve në fjalë. Në këtë aspekt rivendosi e propozuar – sipas Reformës së Administratës Publike – e NjDNj-ve nëpër departamentet e personelit mund të jetë më e saktë, të paktën për disa nga anëtarët e personelit, por siç është shënuar ngjashëm për sa i përket politikëbërjes, kompetenca për të drejtat e njeriut duhet të përafrohet sa më shumë me procesin e zbatimit, në mënyrë që të merren në konsideratë standardet përkatëse. Njëkohësisht, do të ishte me vend të bëheshin marrëveshje mbi masat e detajuara të zbatimit që do të shqyrtoheshin nga personat me njohuri të specializuara, të cilët do të siguroheshin që nuk do të kishte probleme lidhur me përmbushjen e të drejtave të njeriut. Kjo mund të sigurohet nga këshilltarët – avokatët dhe/ose specialistët e të drejtave të njeriut – brenda ose jashtë institucionit në fjalë, varësisht se si organizohet kjo. Duke u siguruar që një këshillë e tillë do të jetë në dispozicion, do të jetë veçanërisht e rëndësishme aty ku komunat po zbatojnë politikat kombëtare dhe ku MAPL duhet të marrë përgjegjësinë për të lehtësuar qasjen në të. Për më tej, në fushat e veçanta të kthimeve të komuniteteve dhe barazisë gjinore, do t'ia vlente që institucionet në nivelin qendror dhe lokal të vazhdonin të merrnin parasysh këshillat e MKK, ZKKK dhe ZBGj (apo specialistëve të barazisë gjinore në institucione, nëse pozita e ZBGj nuk ekziston²²³) gjatë procesit të zbatimit.

210. Ndërkohë që ofrojnë bashkërendimin dhe udhëheqjen lidhur me zhvillimin e politikave dhe bashkërendimin për sa i përket zbatimit, ABGj, ZÇK dhe ZQM duhet të kenë edhe përgjegjësinë shtesë, që të sigurohen se logjika dhe politikat e caktuara, planet e veprimit dhe strategjitë e caktuara vlerësohen nga të gjithë ata që kanë përgjegjësinë për zbatimin e tyre. Kjo kërkon hapa jo vetëm për të informuar, por edhe për të ngritur nivelin e vetëdijesimit të një pjese të nëpunësve civilë individualë që duhet të luajnë një rol në arritjen e objektivave në fjalë. Pa kuptuar këta individë se ç' pritet nga ta, pa dyshim do të rritet rreziku që politikat, planet e veprimit dhe strategjitë të mos zbatohen tërësisht ose pjesërisht. Duke pasur parasysh përgjegjësitë e tyre për bashkërendimin dhe udhëheqjen, ABGj, ZÇK dhe ZQM janë mjaft mirë të pozicionuara për ndërmarrjen e kësaj detyre të komunikimit.

223 Shih *pars. 123-124 të ekspertizës së Projekt-Ligjit mbi Barazinë Gjinore*.

211. Qartësisht duhet të vihen në dispozicion burime të mjaftueshme (p.sh. si personel ashtu edhe buxhet) për institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe kërkesat specifike për këtë qëllim, duhen identifikuar sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që të bëhet një shpërndarje e duhur e burimeve kur të nisë zbatimi i një politike.
212. Për më tej, meqë punësimi i personelit me kapacitetet e nevojshme është po aq i rëndësishëm për zbatimin efektiv, sa edhe ofrimi i fondeve adekuate, kjo do të kërkojë ndërmarrjen e vlerësimeve të nevojave në ministritë dhe komunat përkatëse, si dhe ofrimin e trajnimeve përkatëse për plotësimin e këtyre nevojave. Detyra e sigurimit të vlerësimit të nevojave dhe pastaj të trajnimit të kërkuar mund të ndërmerret ose nga ZQM ose nga ABGj, në varësi të natyrës së veçantë të politikës apo ligjit që duhet zbatuar. Asnjëra prej tyre nuk duhet të kryejë vlerësimin apo trajnimin, meqë nuk i kanë burimet e nevojshme për këto, dhe kjo do të përbënte një dëvrijim prej përgjegjësive të tyre kryesore.
213. Për të përmbledhur:
- përgjegjësitë specifike të ministrive dhe komunave, si dhe të organeve brenda tyre, për zbatimin e politikave dhe të legjislacionit duhet saktësuar më tej;
 - roli bashkërendues i ZQM duhet të fokusohet në zbatimin që kërkon përfshirjen e dy apo më shumë institucioneve;
 - këshillat dhe vlerësimet përkatëse të specialistëve duhet të kërkojnë përgjatë gjithë procesit të zbatimit dhe qasja e komunave ndaj këtyre duhet të lehtësohet nga MAPL;
 - duhet të ketë një caktim të mjaftueshëm burimesh për qëllimet e zbatimit;
 - ABGj, ZÇK dhe ZQM duhet të jenë organet përgjegjëse për komunikimin e logjikës dhe të objektivave të politikave, planeve të veprimit dhe strategjive tek personeli përkatës nëpër ministri dhe komuna; dhe
 - ABGj dhe ZQM duhet të krijojnë premiset për nevojat e vlerësimeve dhe të trajnimeve për ta lehtësuar zbatimin që do të ndërmerret dhe më pas edhe ofrimin e ndonjë trajnimi që konsiderohet i nevojshëm.

Promovimi

214. Tashmë është vënë re se pjesëtarët e publikut duhet të kenë vetëdijesim më të madh për të drejtat e tyre dhe mjetet me të cilat mund t'i sigurojnë ato. Kjo situatë është befasuese duke pasur parasysh faktin që janë ndërmarrë disa veprimtari për rritjen e vetëdijesimit të publikut nga shumë struktura jogjyqësore të të drejtave të njeriut. Megjithatë, veprimtaritë promovuese që janë ndërmarrë kanë pasur mungesë të theksuar fondesh, mungesë të thellësisë dhe bashkërendim inekzistent ose të pamjaftueshëm të përpjekjeve strukturave të ndryshme jogjyqësore, si dhe vlerësim të kufizuar të efektshmërisë së tyre.
215. Problemi qëndron jo në numrin e aktorëve potencialë, sepse niveli i përpjekjeve të kërkuara për të sjellë ndryshimin e kërkuar, nënkupton që kjo nuk është ndërmarrje për të cilën përgjegjësia i duhet veshur vetëm një aktori. Në të vërtetë, duke pasur parasysh çështjet substantive dhe procedurale që kërkojnë promovim, është diçka në të cilën duhen përfshirë, drejtpërdrejt ose jo, të gjitha strukturat jogjyqësore të të drejtave të njeriut.
216. Megjithatë, pavarësisht se mund të dëshirohet një lloj rritjeje e burimeve të siguruar për veprimtaritë promovionale të të drejtave të njeriut, bashkërendimi më i mirë i këtyre veprimtarive të ndërmarrë nga strukturat e ndryshme jogjyqësore të të drejtave të njeriut, padyshim që mund të çojë në krijimin e një ndikimi më të madh dhe përdorimit më efektiv të burimeve që janë aktualisht në dispozicion për këtë qëllim.
217. Nevoja për njëfarë bashkërendimi mes atyre që ndërmarrin veprimtari promovionale që i dedikohen të drejtave të njeriut nga strukturat e ndryshme qeveritare – pa përjashtuar më parë

mundësinë e nisjes së iniciativave individuale – do të ishte veçanërisht e rëndësishme për të shmangur dyfishimin e panevojshëm si për tematikën e promovimit ashtu edhe për përftuesit e këtij promovimi, si dhe do të siguronte adresimin adekuat të nevojave të veçanta të një fushe të caktuar. Ky është një rol që i duhet besuar ZQM-së, përveç në fushën e barazisë gjinore, ku do të preferohej, duke pasur parasysh fokusin e veçantë mbi këtë çështje, që roli bashkërendues të kryhej nga ABGj.

218. Megjithatë, po ashtu duhet të ketë edhe përpjekje për të promovuar bashkëpunimin në këtë sferë mes strukturave qeveritare dhe strukturave të tjera jogjyqësore, të tilla si IAP, pa e minuar në ndonjë mënyrë mundësinë e IAP të bëjë vlerësimet e veta të pavarura për çështje të veçanta të cilave duhet t'u drejtohen përpjekjet promovionale.

219. Njëkohësisht, duket se ka vend për përmirësimin e cilësisë së veprimtarive promovionale, për të rritur efektshmërinë e tyre. Në mënyrë që të ndodhë kjo, është e domosdoshme që veprimtari të tilla të bazohen në objektiva me synime të përcaktuara qartë, të jenë të mirë-planifikuara dhe të jenë më sistematike e më të qëndrueshme. Aktualisht, kjo nuk ndodh gjithnjë sepse veprimtaritë shpesh janë mbi baza *ad hoc* dhe ato i përgjigjen ndonjë nevoje mjaft urgjente.

220. Pa dyshim, vendosja e disa kufijve – siç u sugjerua më sipër – lidhur me morinë e strategjive dhe planeve të veprimit që duhen miratuar në të ardhmen, duhet ta bëjë më të lehtë përqëndrimin e veprimtarive promovionale në një numër më të vogël problemesh, por që do të kenë një ndikim më të madh. Megjithatë, ndërkohë që ndërmerren këto veprime, duhet të ketë edhe një proces raportimi që do të përcaktojë ndikimin e tyre, si në aspektin afatshkurtër ashtu edhe në atë afatgjatë, duke pasur parasysh përpjekjet në bazë të mësimave të nxjerra për veprimtaritë në të ardhmen.

221. Për të përmbledhur:

- të gjitha strukturat jogjyqësore të të drejtave të njeriut mund të japin kontributin e tyre për promovimin e të drejtave të njeriut;
- bashkërendimi i veprimtarive promovuese brenda strukturave qeveritare duhet të ndërmerret nga ZQM, ndërsa për sa i përket barazisë gjinore, nga ABGj;
- bashkëpunimi lidhur me promovimin mes strukturave qeveritare dhe strukturave të tjera, nuk duhet të rrënojë pavarësinë e këtyre të fundit;
- të gjitha veprimtaritë promovuese duhet të kenë një mori objektivash të përcaktuara qartë, të jenë të planifikuara e të drejtuara mirë si dhe të përdorin mesazhe të kuptueshme dhe konkrete;
- veprimtaritë promovuese duhet të jenë më sistematike sesa të kohëpaskohshme; dhe
- ndikimi i veprimtarive promovionale duhet vlerësuar sistematikisht.

Reparacioni

222. Përveç atyre strukturave jogjyqësore me mandat të qartë për të ofruar reparacionin për individët të cilët janë viktimë të shkeljeve të të drejtave të njeriut, ka edhe struktura të ndryshme që ose mbështesin ose perceptohen se ofrojnë reparacion të tillë. Megjithatë, në praktikë, reparacioni i bërë nga strukturat e fundit është mjaft i kufizuar dhe nuk trajtohet në mënyrë të qëndrueshme. Njëkohësisht, struktura kryesore jogjyqësore që përbën në të vërtetë mekanizmin për ofrimin e reparacionit individual – pra IAP – është i gjymtuar në funksionimin e vet për shkak të faktorëve të ndryshëm organizativë (të brendshëm e të jashtëm), dukshmërisë së pamjaftueshme dhe mosveprimit gjithnjë në kohë lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e veta.

223. Lidhur me ofrimin e reparacionit, mbetet çështje esenciale fokusimi në fuqizimin e strukturave ekzistuese që ofrojnë mundësitë më të mira të gjetjes së zgjidhjeve për ankesat individuale. Kjo do të thotë kryesisht IAP, por potencialisht edhe ZKGj, funksionimi i së cilës në këtë aspekt mbetet ende për t'u testuar.

224. Lidhur me IAP, kjo do të thotë që qeveria dhe PK duhet të sigurohen që ai të përkrahet nëpërmes

fondeve adekuate dhe hapësirës së mjeftueshme të punës, si dhe me anë të aplikimit të rekomandimeve të tij, çështje këto të cilat janë përmendur si çështje përkatëse për të adresuar mangësitë lidhur me kapacitetin dhe besueshmërinë.

225. Megjithatë, ekziston edhe nevoja për t'u siguruar që IAP të ketë kompetenca të mjaftueshme për të trajtuar shkeljen e të drejtës së barazisë gjinore dhe të mbrojtjes nga diskriminimi, e kjo kërkon zbatimin e propozimeve të bëra në tri shtojcat e ekspertizës së këtij raporti.
226. Njëkohësisht, vetë IAP duhet të rrisë përpjekjet e tij me publikun – duke përfshirë edhe përdorimin e mediave sociale për të dhënë mesazhin tek brezi i ri – me qëllim që të sigurohet që kompetenca e tij të njihet, të kuptohet e të përdoret më mirë.
227. Për më tej, meqë institucioni tashmë po zgjerohet dhe do të vazhdojë edhe më tej pas miratimit të ligjeve që mbulojnë tri ekspertizat e këtij raporti, ai duhet të marrë në konsideratë strukturat e veta të brendshme për t'u siguruar që nuk ka centralizim të panevojshëm dhe që ka kapacitete të mjaftueshme për t'u dhënë ankuesve reparacione, duke përfshirë edhe disponueshmërinë e juristëve të specializuar mes personelit të tij.
228. Njëkohësisht, pa dyshim që ZKGj duhet të përkrahet në procesin e konsolidimit, me qëllim që të fillojë t'i trajtojë ankesat. Megjithatë, ajo duhet të sigurohet që publiku është mjaft i informuar për funksionet e saj, me qëllim që të përdoret nga personat në nevojë. Po ashtu, duhet të ketë vlerësim adekuat të efektshmërisë së saj, pasi kjo zyrë të jetë tërësisht operacionale, për të përcaktuar nëse kërkohet ndonjë përmirësim i kompetencave a i organizimit të saj.
229. Nuk ka asnjë të dhënë lidhur me efektshmërinë a trajtimin e ankesave nga zëvendës-kryesuesi i kuvendit komunal për komunitetet²²⁴ por njëlloj nuk ka asnjë arsye për të sugjeruar që kjo duhet përforcuar.
230. Megjithatë, nuk ka asnjë arsye të kërkohet të fuqizohen NjDNj-të si mekanizma reparues, meqë kjo gjë nuk është pjesë e mandatit të tyre, dhe në praktikë, ato funksionojnë kryesisht si një agjensi referuese për IAP – që edhe mund të bëhet duke i dhënë ministritë dhe komunat publicitet më të madh mundësinë së pasjes së një alternative ndaj IAP - dhe, në rastin e nëpunësve publikë, të veprojnë si një ndërmjetësues mes tyre dhe punëdhësve të tyre, diçka që do të kryhet edhe më mirë me anë të përdorimit të një procedure ankimore të brendshme²²⁵, krahas me alternativën e gjykatave për çështje që kanë të bëjnë me diskriminimin, barazinë gjinore dhe çështjet e punësimit²²⁶.
231. Ndërkohë që nuk ka asnjë arsye për Komisionin e të Drejtave të Njeriut, Barazisë Gjinore, Personavë të Zhdukur dhe Peticioneve që të mos marrë peticione, që është funksion tradicional parlamentar, ky është një aspekt mjaft përjashtimor i punës së tij që nuk duket se ia vlen të përforcohet.
232. Për të përmbledhur:
- rekomandimet e mësipërme lidhur me kapacitetin dhe besueshmërinë, veçanërisht kur kanë të bëjnë me IAP, duhen zbatuar;
 - kompetencat e IAP për të trajtuar çështjet e diskriminimit dhe barazisë gjinore duhen forcuar;
 - IAP duhet të rrisë përpjekjet për njohje më të gjerë nga publiku dhe gjithashtu të rrisë

²²⁴ Përveç një rasti të shënuar në para. 108.

²²⁵ E tillë si ajo nën Nenet 80-82 të Ligjit Nr. 03/L -149 mbi Shërbimin Civil në Kosovë (9 korrik 2010); <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-149-eng.pdf> (shfrytëzuar më datën 11 nëntor 2013). Kjo siguron që marrëveshjet për ankesat dhe apelet të kalojnë përmes Komisioneve të Mosmarrëveshjeve dhe Ankesave dhe BPMSHCK.

²²⁶ Punonjësit publikë mund të kenë një alternativë, p.sh., t'i drejtohen IAP, ZKGj dhe në rastin e komunave, zëvendës-shefit të kuvendit komunal për komunitetet.

- edhe nivelin e dukshmërisë;
- ZKGj duhet të përkrahet gjatë procesit të rikonsolidimit të saj, por ndikimi i saj duhet vlerësuar pasi ajo të jetë krejtësisht funksionale;
- trajtimi i ankesave nga ana e zëvendës-kryesuesit të kuvendit komunal për komunitetet nuk duhet përforcuar;
- NjDNj-të nuk duhen portretizuar si mekanizma riparues;
- procedurat e ankesave të brendshme brenda ministrive dhe komunave duhen shqyrtuar e fuqizuar nëse ekzistojnë, ose duhen prezantuar nëse nuk ekzistojnë; dhe
- procedura e peticionit të Komisionit të të Drejtave të Njeriut, Barazisë Gjinore, Personave të Zhdukur dhe Peticioneve nuk duhet përforcuar.

Monitorimi

233. Pavarësisht se plotësimi i detyrimit nga ana e administratës në fushën e të drejtave të njeriut është kryesisht çështje për udhëheqësit politikë dhe zyrtarët përgjegjës të ministrive dhe komunave përkatëse, është jetike që ofrimi faktik në këtë aspekt të mbahet nën shqyrtim, me qëllim që problemet të mund të identifikohen e të zgjidhen në mënyrën e duhur.
234. Kjo ndërmerret në tri mënyra, dy jashtë administratës dhe një brenda saj. Së pari, nëpërmjet organeve të tilla si IAP dhe, në një masë më të ulët, nga KKK (si dhe potencialisht nga ZKGj) nëpërmjet komunikimeve apo ankesave të marra, dhe në rastin e IAP, mundësinë e hetimit pa u bërë ankesa. Së dyti, me anë të auditimeve të ndërmarra nga PK ose nga vetë administrata, lidhur me atë se si i ka arritur kjo e fundit qëllimet e saj të përcaktuara në politika dhe legjislacion. Së treti, monitorimi nga vetë administrata përfshin një numër të konsiderueshëm organesh, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal.
235. Monitorimi nga ana e KKK, IAP dhe ZKGj përbën një nivel shtesë të roleve të tyre reparuese dhe duhet vazhduar. Megjithatë, pavarësisht se ka pasur sugjerime se monitorimi nga KKK dhe IAP është kryer në një mënyrë të parregullt ose të papërfillshme, efektshmëria e tij përkeqësohet nga mosmarrja parasysh e shumë prej rekomandimeve të tyre nga ana e administratës, për sa u përket problemeve që ata kanë identifikuar. Kjo situatë mund të korrigojë me anë të zbatimit të të dyja propozimeve për adresimin e mangësive lidhur me besueshmërinë dhe të rekomandimeve të bëra në ekspertizën mbi legjislacionit lidhur me IAP sa i përket prezentimit në PK të Raportit të tij vjetor. Përveç kësaj, nuk duket se ekziston nevoja që funksioni i veçantë të përforcohet në ndonjë mënyrë, pavarësisht se IAP dhe ZKGj pa dyshim do të përfitojnë nga përforcimi tjetër i propozuar lidhur për rolet e tyre si riparues.
236. Po ashtu monitorimi nga ana e PK e Komisionit mbi të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, Personat e Zhdukur dhe Peticionet dhe i Komisionit të tij mbi të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Kthyerve, është kyç për përgjegjshmërinë parlamentare të qeverisë dhe kjo gjë duhet të vazhdojë e pandryshuar.
237. Monitorimi i efektshëm nga ana e administratës kërkon linja të qarta raportimi, një metodologji të shëndoshë dhe një shmangie në dyfishimin e kërkesave dhe të vlerësimeve të të dënave që ajo pranon. Kjo gjë gjithashtu edhe një mirëkuptim nga ana e atyre që po monitorohen se ky proces nuk është funksion kontrollues a disiplinor, por proces i hartuar për të siguruar arritjen e qëllimeve të përbashkëta.
238. Duket se monitorimi i veçantë mbi qeverisjen e mirë (nga ana e MAPL), të drejtat e njeriut (nga ana e ZQM), barazinë gjinore (nga ana e ABGj) dhe integrimin europian (nga ana e MIE) në nivelin qendror ka çuar në konfuzion mes disa anëtarëve të personelit nëpër institucionet që monitorohen. Për më tej, duhet vënë re se monitorimi po bëhet edhe nga Komisioni i Komuniteteve, MKK, ZKKK dhe ZÇK. Pavarësisht nga kjo, ekzistenca e një numri kaq të madh organesh të përfshira në monitorimin e çështjeve të të drejtave të njeriut, nuk është vetvetiu problematik, për

sa kohë që ekziston një ndarje e qartë e çështjeve që duhen adresuar nga pranuesit e kërkesave, dhe ekziston një shmangie të dyfishimit të panevojshëm (e që merr kohë), asnjëra prej të cilave nuk duket se është onsistente.

239. Duke pasur parasysh se ekziston gjithnjë rreziku i një lloj dyfishimi në çështjet që duhen adresuar në monitorimin e kërkesave, duhet të jetë përgjegjësi e atyre autoriteteve që bëjnë monitorimin që ta konsiderojnë këtë mundësi përpara lëshimit të kërkesave të tilla, të konsultohen me organet e tjera monitoruese dhe ose ta lëshojnë kërkesën bashkërisht ose të përdorin të dhënat që tashmë janë mbledhur, sesa të lëshojnë një kërkesë tjetër. Qartazi, monitorimi i dyfishtë për barazinë gjinore që është ndërmarrë në të shkuarën nga ABGj dhe ZQM nuk duhet përsëritur në të ardhmen.
240. Një qasje e tillë e koordinuar e monitorimit nuk do të kërkojë vetëm komunikimin mes organeve përgjegjëse. Ajo kërkon gjithashtu që ato të miratojnë një metodologji të përbashkët që do të mundësojë shfrytëzimin e gatshëm të të dhënave të mbledhura nga organet e tjera përveç atij organi që i kërkon ato.
241. Për më tej, kjo metodologji kërkon që të përfshijë një fokus më të qartë si dhe të shfrytëzojë tregues që janë qartazi në gjendje të demonstrojnë deri në ç' masë ka ndikuar ajo që është bërë, p.sh., treguesit duhet të jenë të matshëm. Metodologjia nuk duhet të përfshijë vetëm kërkesa për detaje rreth veprimtarive të ndërmarrura. Një qasje e tillë do të lehtësohet duke u siguruar – ashtu siç është rekomanduar për i përket zhvillimit të politikave – që kërkesat për një monitorim të efektshëm të pasqyrohen si duhet në zhvillimin e politikave, strategjive dhe planeve të veprimit.
242. Për më tej, nuk ekziston nevojë për ndërmjetësues, siç janë NjDNj-të, mes organeve monitoruese dhe atyre përgjegjëse për zbatim nëpër ministri e komuna, si dhe e të tjerëve me njohuritë e nevojshme (veçanërisht zyrtarëve të statistikave nëpër ministri dhe ESK). Siç është parë, ky rol ndërmjetësues mund të çojë në atë që nëpunësit e NjDNj të anashkalojnë dhe të dhënat që ata dorëzojnë të 'censurohen'. Në mënyrë më thelbësore, një rol i tillë ndërmjetësuesi shton nivelin e administratës dhe pengon një marrëdhënie të drejtpërdrejtë mes atyre që po monitorohen dhe atyre që po bëjnë monitorimin, gjë kjo që ndikon në mungesën e kuptueshmërisë së vlerës së këtij funksioni.
243. Pavarësisht nga kjo, pa dyshim që të gjitha ministratë dhe komunat do të kenë nevojë për një pikë kontakti mes tyre dhe organeve që kryejnë monitorimin. Kjo pikë kontakti, në rastin e barazisë gjinore, duhet të ketë një ekspertizë të veçantë, sepse arritja e një gjëje të tillë është pjesë e përgjegjësisë funksionale për çdo pjesë të veçantë të një ministrie a komune. Megjithatë, pasja e zyrtarëve të caktuar nëpër ministri dhe komuna që kanë në dorë të dhënat për qëllimet e monitorimit, e specifikuar si pjesë e përgjegjësisë të tyre, nuk do të kërkojë vazhdimin e pozitës së ZBGj²²⁷.
244. Duke pasur parasysh rëndësinë e kuptimit të vlerës së këtij ushtrimi nga ana e atyre që po monitorohen, duhen bërë përpjekje për të shpjeguar se përse po ndërmerret monitorimi, si në rastet e përgjithshme ashtu edhe në ato të veçanta, si dhe duhet përmirësuar kontakti mes atyre që i kërkojnë dhe atyre që i japin të dhënat. ZQM duhet të ketë përgjegjësinë për bashkërendimin e përpjekjeve të tilla.
245. Përveç kësaj, OShC-të shpesh kanë të dhëna që janë relevante për procesin monitorues, dhe kjo duhet shfrytëzuar sa më shumë që të jetë e mundur në kohën që po ndërmerret monitorimi, para se të pritët që ato të komentojnë për ndonjë raport që eventualisht mund të përgatitet. Kjo do të kërkojë që OShC-ve t'i jepet njoftim me kohë për ushtrimet e monitorimit dhe që ato të bëjnë njëfarë trajnimi se si mund të kontribuojnë në ushtrime të tilla. Ky trajnim do të mund të bëhet nga ZQM, duke pasur parasysh përgjegjësitë që lidhen me sektorin e organizatave të shoqërisë civile.
246. Këto propozime nuk kanë asnjë ndikim për ushtrimin e mbikqyrjes së përgjithshme të adminis-

²²⁷ Shih parag. 210.

tratës publike nga ana e BPMSHCK.

247. Për të përmbledhur:

- roli i veçantë monitorues që kryhet nga KKK, IAP dhe (potencialisht) nga ZKGj, si dhe nga komisioni i PK, duhet ruajtur në formën ekzistuese;
- organet përgjegjëse për monitorimin e brendshëm të administratës duhet të miratojnë një metodologji të përbashkët monitoruese që ka një fokus të qartë dhe përdor tregues të matshëm;
- gjithashtu këto organe duhet të konsultohen me njëri-tjetrin përpara lëshimit të kërkesave dhe në rast se do të lindin çështje të përbashkëta, të lëshojnë ose kërkesa të përbashkëta, ose të përdorin të dhënat ekzistuese;
- kërkesat për monitorim, përveç atyre që lidhen me barazinë gjinore, duhet që të shkojnë drejtpërdrejt tek ata persona që janë përgjegjës për zbatimin e veprimtarive të monitorimit, siç janë zyrtarët e statistikave dhe ESK;
- duhen bërë përpjekje për t'u shpjeguar atyre që po monitorohen vlerën e këtij ushtrimi si dhe duhet përmirësuar kontakti mes atyre që kërkojnë dhe ofrojnë të dhëna, ndërkohë që kjo gjë duhet koordinuar nga ZQM; dhe
- duhet shfrytëzuar potenciali që OShC-të të japin kontributin e tyre në procesin e monitorimit, duke organizuar trajnime adekuate për ta lehtësuar këtë proces.

Raportimi

248. Raportimi që ndërmerret nga strukturat jogjyqësore të të drejtave të njeriut është pjesërisht vetëm dhënia e një aspekti të veprimtarive të ndërmarrë prej tyre. Megjithatë, një pjesë e raportimit të tyre synohet që të tërheqë vëmendjen ndaj problemeve dhe për këtë arsye, është një element tejet i rëndësishëm i procesit të monitorimit, duke pasur potencialin që të çojë në zgjidhje të kënaqshme, si dhe të rrisë nivelin e vetëdijesimit së publikut për çështjet që kërkojnë vëmendje. Përveç kësaj, një pjesë e raportimit nga strukturat jogjyqësore të të drejtave të njeriut, apo nga ato të cilave u kontribuonë, ka të bëjë me përmbushjen e detyrimeve sipas traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të aplikueshme në Kosovë.

249. Pavarësisht se forma e parë e raportimit mund të jetë një mjet për të siguruar përgjegjësinë e strukturave në fjalë, duket se ekziston një tendencë që disa prej tyre të fokusohen pikërisht në këtë gjë në vend që të tërheqin vëmendjen në problemet e të drejtave të njeriut që duhet të jenë pjesë e kompetencave të tyre. Prandaj, me qëllim që të forcohet roli i procesit të raportimit, duhet bërë një dallim i qartë mes raportimit mbi veprimtaritë e strukturave jogjyqësore të të drejtave të njeriut dhe raportimit të tyre mbi çështjet e të drejtave të njeriut, veçanërisht lidhur me rezultatin e monitorimit. Kjo kërkon që strukturat përkatëse të vlerësojnë qëllimin e këtyre formave të ndryshme të raportimit dhe kjo gjë duhet theksuar si në kërkesat për raporte, ashtu edhe në natyrën e marrësit të tyre.

250. Për këtë arsye, raportimi mbi veprimtaritë duhet t'i drejtohet organit përkatës mbikqyrës sipas rregullave të kornizës ligjore të administratës publike, ose në rastin e IAP, i duhet drejtuar PK me qëllim që të lehtësohet roli i tij për ta konsideruar qeverinë përgjegjëse. Pavarësisht se raportimi që bën IAP në PK mbulon si problemet ashtu edhe veprimtaritë, mes tyre nuk ka asnjëherë ndonjë konfuzion dhe asnjëri prej tyre nuk shpërfillet, e për këtë arsye struktura e përcaktuar për këtë lloj raportimi është e përshtatshme.

251. Sa për raportimin që lidhet me çështjet e të drejtave të njeriut dhe situatën e përgjithshme në Kosovë nga organet qeveritare (p.sh. atyre organeve të ndryshme nga KKK, IAP dhe ZKGj), ekziston nevoja si për ndarjen adekuate të përgjegjësive mes organeve në fjalë dhe shmangien e dyfishimit të panevojshëm në përgatitjen dhe dorëzimin e raporteve. Megjithatë, kjo duhet të jetë

lehtësisht e arritshme nëse propozimet që kanë të bëjnë me monitorimin miratohen, meqë kjo që do të çojë në qartësimin e çështjeve dhe temave të të drejtave të njeriut, të cilat pritet të kryesohen nga organe të ndryshme qeveritare. Prandaj raportet duhet të përbëjnë momentin kulminues të procesit të monitorimit.

252. Megjithatë, është themelore që të raportet të mos jenë thjesht vetëm ushtrime të marrëdhënieve me publikun dhe duhet të kihet parasysh që gjithnjë ekziston rreziku për këtë gjë pasi ato të përpilohen, në veçanti, nga organet qeveritare. Për këtë arsye, është e rëndësishme që raportet të kërkohen për të identifikuar mangësitë, po aq sa edhe arritjet.

253. Për më tej, duke pasur parasysh nevojën që në fund të fundit të raportohet mbi zhvillimet e të drejtave të njeriut në nivelin ndërkomëbëtar, përgatitja e raporteve për përdorim në Kosovë duhet të përpqet të arrijë sa më shumë që të jetë e mundshme strukturën dhe qasjen e kërkuar për ato raporte të nivelit ndërkombëtar, me qëllim që këto paastaj të përgatiten – pa shumë përpjekje të shtuara – mbi bazën e raporteve që tashmë janë përgatitur. Në veçanti, duhen pasur tërësisht parasysh udhëzimet e përgatitura nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara lidhur me formën dhe përmbajtjen e raportimit nga palët shtetërore në traktatet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.²²⁸

254. Po ashtu, ekziston nevoja që një organ i veçantë të ketë përgjegjësinë e veçantë për përgatitjen e raporteve që duhen dorëzuar në nivelet ndërkombëtare, meqë materiali i kërkuar për raporte të tilla do të përgatitet në bazë të kontributit të shumë organeve – duke përfshirë edhe ministrinë – me një rol të zbatimit të aspekteve të ndryshme të të drejtave në fjalë. Me të vërtetë, themelimi i një mekanizmi raportues dhe bashkërendues në nivel kombëtar për të drejtat e njeriut, është rekomanduar veçanërisht si një nga praktikat më të mira për t'u ndjekur, si pjesë e procesit që kërkon të fuqizojë sistemin e organeve të traktateve të OKB.²²⁹

255. Ndërkohë që po përgatitej ky raport, kjo ishte një detyrë që i ishte besuar ZQM²³⁰. Ky, fare mirë mund të jetë edhe organi më adekuat për ta ndërmarrë një detyrë të tillë, veçanërisht kur kihet parasysh përfshirja e tij në përgatitjen e raporteve për organet e traktateve. Megjithatë, ekziston nevoja për të shqyrtuar nëse, duke marrë në konsideratë burimet që ka aktualisht në dispozicion ZQM dhe përgjegjësitë e tjera ekzistuese të saj, e bën këtë organ më adekuat për të kryer këtë rol ndërkombëtar raportimi, pa bërë ndonjë ndryshim të këtyre burimeve apo përgjegjësisë. Një shqyrtim i tillë duhet të ketë parasysh rekomandimet e bëra lidhur me ZQM në këtë raport, zbatimin e të cilave, me të vërtetë, mund të ndihmojë performancën e saj në kryerjen e këtij roli. Sidoqoftë, ekziston nevoja që të sigurohemi që kushdo që e merr përsipër këtë rol, t'i referohet edhe përvojës së madhe të raportimit që tashmë është akumuluar, si pjesë e procesit të integritetit evropian.

256. Për të përmbledhur:

- duhet të ekzistojë një dallim i qartë mes raportimit mbi veprimtarinë institucionale dhe _____ raportimit mbi çështjet a problemet mbi të drejtat e njeriut;

²²⁸ Hartim i Udhëzimeve mbi Formën dhe Përmbajtjen e Raporteve që duhen dorëzuar nga Palët Shtete në Traktatet Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, HRI/GEN/2/Rev.2, 7 maj 2004. Rishikimi i këtyre udhëzimeve tashmë është duke u marrë në konsideratë; shih <http://www2.ohchr.org/english/bodies/treaty/CCD.htm>.

²²⁹ '...mekanizmi i qëndrueshëm kombëtar i raportimit dhe koordinimit duhet të analizojë me tej dhe të marrë në konsideratë rekomandimet nga të gjitha mekanizmat e të drejtave të njeriut, tematike dhe/apo funksionale (sipas përgjegjësisë/vetë institucionit/-eve për zbatimin e tyre), të identifikojë aktorët përkatës të përfshirë në zbatimin e rekomandimeve dhe t'i udhëheqë ato gjatë gjithë këtij procesi. Po ashtu, ky mekanizëm duhet të udhëheqë konsultimet periodike me NHRI, dhe aktorët e shoqërisë civile për të bashkëpunuar mbi proceset e raportimit dhe zbatimit. Në parlament, duhet të krijohen komisione adekuate të qëndrueshme apo organe të ngjashme, që duhet të përfshihen në monitorimin dhe vlerësimin e nivelit lokal të zbatimit të rekomandimeve, veçanërisht të atyre që lidhen me reformën legjislativë. SNRCM duhet të bashkëpunojë me anëtarët e Gjyqësorit për t'i informuar ata mbi rekomandimet e organeve të traktateve dhe duhet të mbledhin e të shpërndajnë vendime gjyqësore që lidhen me ligjet përkatëse ndërkombëtare të të drejtave të njeriut'; Fuqizimi i Sistemit të Organit të Traktatit të të Drejtave të Njeriut të OKB-së Raport nga Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (2012), seksioni 4.5.4.

²³⁰ Shih par. 164.

- raportimi nga ana e organeve qeveritare duhet të reflektojë një dallim të qartë të përgjegjësisë dhe të shmangë ndonjë dyfishim të mundshëm;
- raportet duhet të identifikojnë mangësitë, ashtu si dhe arritjet;
- struktura dhe qasja e raporteve duhet të tentojë të ndjekë kërkesat për raportime të nivelit ndërkombëtar;
- caktimi i përgjegjësisë së raportimit në nivelin ndërkombëtar te ZQM, duhet shqyrtuar; dhe
- raportimi në nivelin ndërkombëtar duhet të reflektojë përvojën e akumuluar gjatë procesit të integritit evropian.

10.3 Përfundimi i përgjithshëm

257. Cikli i funksionimit të strukturave jogjyqësore të të drejtave të njeriut që del nga përfundimet e mësipërme është si në vijim:

258. Efekti i propozimeve është që të hiqen NjDNj-të nga procesi dhe të rafinohet roli që luajnë të gjitha strukturat e tjera jogjyqësore të të drejtave të njeriut. Heqja e NjDNj nuk ka të bëjë me ndonjë kritikë ndaj rolit të tyre në të shkuarën apo me mosnjohjen e disa efekteve me përfitim gjatë ekzistencës së tyre. Megjithatë, shqetësimi aktual mbetet te krijimi i një zinxhiri institucional që jo vetëm do të ishte më i qartë e më i thjeshtë, por që do të ishte edhe më efikas se organizimi aktual. Ky synim qartazi kërkon një ristrukturim të përgjegjësisë të aktorëve të ndryshëm dhe nuk ka asnjë dyshim që personeli individual i NjDNj-ve do të vazhdojë të luajë një rol në sigurimin e të drejtave të njeriut, ndonëse në kornizë të ndryshme institucionale, përmes ricaktimit në seksione politikash dhe seksione operative nëpër ministri dhe komuna.

259. Sa për ndryshimet e tjera, synimet e kapaciteteve të shtuara, besueshmërisë, fokusit dhe thjeshtësisë kërkojnë domosdoshmërisht një ristrukturim të termave të veçanta të referencës për të siguruar që ndikimi i tyre do të ketë efektin maksimal. Përveç rishpërndarjes së roleve, është thelbësore që të ndryshohen praktikat brenda tyre me qëllim që rezultatet të jenë më të efektshme. Pavarësisht se ndryshimi mund të jetë i vështirë për t'u pranuar, është e rëndësishme të vlerësohet se reformat e propozuara janë të bazuara në vlerësime të gjera të strukturave aktuale dhe të ndikimit të kufizuar që kanë arritur ato. Pa dyshim, që një proces riformimi mund të jetë i dhimbshëm për individët që pritet të modifikojnë rolet e ndryshme, por synimi përfundimtar që duhet arritur, ka të bëjë me zbatimin më të mirë të standardeve, që përbën edhe logjikën e strukturave të ndryshme jogjyqësore në fjalë.

260. Rekomandimet e tri mendimeve në shtojcat e këtij raporti - mbi Ligjin Nr. 03/L – 195, mbi Avokatin e Popullit, Projekt-Ligjin mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L – 195 mbi Avokatin e Popullit në korrik të vitit 2013, Projekt-Ligjin mbi Barazinë Gjinore dhe Projekt-Ligjin mbi Mbrojtjen nga Diskriminimi – përputhen me qasjen se ky raport dhe zbatimet e tyre do të përbëjnë një plotësim të nevojshëm të rekomandimeve të bëra prej tij.

261. Fillimisht u konkludua se do të ishte më mirë nëse një përgjegjësi më e madhe për të drejtat e njeriut do të përqendrohej tek ministritë përkatëse përpara sesa t'u jepej zyrave të ndryshme të caktuara specifikisht. Sidomos u mendua se funksioni kyç i politikëbërjes së të drejtave të njeriut duhet të vendoset në ministritë përkatëse dhe jo në ZKM me personel të mangët. P.sh. një qasje e tillë duket se ka funksionuar mjaft mirë sa i përket luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore. Pavarësisht nga natyra ndërsektoriale dhe horizontale e çështjes, kryesimi për trajtimin e saj është marrë nga Ministra e Brendshme përpara se ndonjë zyrë e specializuar brenda ZKM-së, me një zyrtar që punon ngusht me Zëvendës-Ministrin e Brendshëm për të formuar sekretariatit in cili pastaj do t'i bashkërendojë rolet e luajtura nga ministritë e tjera të përfshira.

262. Megjithatë, për momentin duket se ministritë e tjera përgjithësisht ngurrojnë të bashkërendohen me një tjetër ministri. Ky ngurrim është tejkaluar për çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore

duke caktuar një kryesim rotacional mbi sekretariatit bashkërendues. Ky është modeli që duhet të ndiqet për aspektet e mëtejme të politikëbërjes së të drejtave të njeriut, duke bërë përpjekje të veçanta për të zhvilluar kapacitetet e ministrive që të luajnë një rol të tillë. Vërtet, duhet nënvizuar se në shumë vende roli udhëheqës në bashkërendimin e politikave të të drejtave të njeriut për ministrinë e tjera shpesh bie mbi Ministrinë e Drejtësisë.

263. Një qasje evolutive në këtë fushë duket të jetë ajo që kërkohet, meqë, ndonëse funksioni i nivelit më të lartë në ZKM për zhvillimin e politikave mund të ngjajë si mjet i dëshirueshëm për hartimin dhe zbatimin e politikave, duhet të përkujtojmë se shumë të intervistuar ishin kritikë ndaj performancës së sistemit aktual jogjyqësor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sidomos ndaj ZQM-së në ZKM. Nuk duket se modeli aktual ka funksionuar mirë deri më tani dhe ruajtja e tij po sugjerohet për shkak të dyshimeve lidhur me gatishmërinë e ministrive për ta marrë këtë rol politikëbërës.
264. Propozimet e tanishme, marrë bashkë me rekomandimet në tri opinionet e bashkëngjitura në këtë raport, duhet të shihen vetëm si hap i ndërmjetëm drejt vënies në efekt të detyrimit që del nga Studimi i Fisibilitetit i BE-së për hartimin e një Strategjie dhe Plani Veprimi të ardhshëm për strukturat e të drejtave të njeriut dhe në veçanti, për ta kanalizuar më mirë dhe thjeshtuar shumësinë e organeve që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Prandaj është e domosdoshme që gjetjet e raportit të studiohen mirëfilli nga ZKM, MIE, MD, MPM si dhe Komisioni i Parlamentit për të Drejtat e Njeriut, me synimin jo vetëm për t'i vënë në zbatim propozimet aktuale por për të parë se si mund të çohen më tutje. Për më tej, duhet t'i kushtohet vëmendje jo vetëm thjeshtëzimit dhe kanalizimit më të mirë të strukturave por edhe sigurimit të burimeve dhe të personelit të duhur.
265. Kjo është e vetmja mënyrë për ta adresuar me efektshmëri problemin e vazhdueshëm të moszbatimit të shumë prej standardeve dhe qëllimeve që janë miratuar në fushën e të drejtave të njeriut. Duhet pasur parasysh se qëllimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Europë është që të drejtat e garantuara të jenë praktike dhe efektive përpara sesa teorike ose iluzione.

**OPINION PËR LIGJIN NR. 03/L-195 MBI AVOKATIN E POPULLIT DHE PRO-
JEKTLIGJIN MBI NDRYSHIM-PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-195 PËR
AVOKATIN E POPULLIT**

PËRMBLEDHJE E PËRGJTHSHME

Ky opinion shqyrton bazën ligjore të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe përputhshmërinë e tij me standardet europiane dhe parimet e praktikave të mira që lidhen me institucionet e Avokatit të Popullit. Ai konstaton se ligji aktual për Avokatin e Popullit ka cilësi që bien në sy, por njëkohësisht, në të ka edhe disa probleme. Një numër dispozitash ngrenë çështje parimi që kanë të bëjnë kryesisht me përkufizimin e institucioneve që mbulohen nga kompetencat e Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës, me procedurën për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, me numrin dhe caktimin e zëvendësve të tij, imunitetin e Avokatit të Popullit dhe të stafit të vet, me largimin nga detyra të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij, ofrimin e një pune pas përfundimit të mandatit të Avokatit të Popullit, rolin dhe kompetencat e IAP-së në parandalimin e torturës dhe të trajtimit apo ndëshkimit çnjerëzor apo poshtëruës, qasjen në dosje dhe dokumente, raportimin dhe dëgjimin e raportit të Avokatit të Popullit në Kuvend, si dhe financimin dhe pavarësinë financiare të institucionit. Gjithashtu, një numër dispozitash kanë nevojë për përmirësime teknike – disa prej tyre duhet të jenë më të qarta dhe disa të tjera nuk janë në harmoni me njëra-tjetrën. Opinioni jep disa sugjerime për zgjidhjen e këtyre çështjeve.

1. HYRJE

1. Ky opinion ka të bëjë me Ligjin Nr. 03/L – 195 për Avokatin e Popullit (“Ligji aktual”) të Kosovës dhe Projektligjin për ndryshim-plotësimin e Ligji Nr. 03/L – 195 për Avokatin e Popullit të korrikut ۲۰۱۳ (“Projektligji amendues”) dhe për të vlerësuar përputhshmërinë e tyre me standardet europiane dhe parimet e praktikës së mirë që lidhen me institucionet e Avokatit të Popullit.
1. Opinioni është përgatitur nga Jorgen Steen Sorensen²³¹ dhe George Tugushi²³² (“autorët”) në kuadër të Projektit të Përbashkët të Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës “Shtimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë” (“Projekti”), si pjesë e një vlerësimi më të gjerë, që ka për qëllim të vërë në dukje pikat e forta dhe të dobëta të strukturave institucionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin ekzekutiv dhe në nivel lokal, dhe për të dhënë një ekspertizë legislative për Ligjin aktual, Projektligjin amendues, Projektligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Projektligjin kundër Diskriminimit”) dhe Projektligjin për Barazinë Gjinore, me qëllim që të vendosen lidhje midis këtyre ligjeve dhe organeve/strukturave monitoruese të ngritura në bazë të tyre²³³.
2. Opinioni është përgatitur pas një vizite në Kosovë në korrik të vitit 2013, gjatë të cilës u mbajtën takime me palë të interesuara kombëtare dhe ndërkombëtare Ai ka marrë parasysh edhe studime dhe raporte të mëparshme për Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë, dhe mbështetet në studimet e kryera në terren dhe raportin e përgatitur nga grupi i punës së Projektit me ekspertë ndërkombëtare dhe lokalë, që përgjigjen për hartimin e propozimit për reforma institucionale.
3. Opinioni është strukturuar si vijon: një përshkrim i standardeve të zbatueshme (Seksioni II); disa konsiderata bazë për Ligjin aktual për Avokatin e Popullit (Seksioni III); një renditje të disa çështjeve parimore dhe propozime për zgjidhjen e tyre (Seksioni IV); një koment nen për nen për Ligjin aktual dhe për ndryshimet që duhen bërë me anë të Projektligjit amendues në dispozitat e tij, apo në disa aspekte të tyre, që nuk trajtohen në Seksionin IV, duke u marrë sidomos me çështje të një natyre më teknike (Seksioni V); një përmbledhje të të gjitha rekomandimeve (Seksioni VI); dhe konkluzionet e opinionit (Seksioni VII).
4. Termi “IAP” do të përdoret kur flasim për Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës si të tillë, ndërsa termi “Avokati i Popullit” do të rezervohet për t’iu referuar vetë personit të Avokatit të Popullit.
5. Në rastet kur rekomandimet mbështeten në standarde evropiane etj., kjo vihet në dukje. Si rrjedhojë, në rast se nuk vihet në dukje, rekomandimet janë mbështetur në burime të tjera, për shembull, në parimet e qartësisë ligjore, praktikës më të mirë dhe përvojës profesionale në lidhje me menaxhimin e pavarur, profesional dhe efikas të Institucioneve të Avokatit të Popullit.

2. STANDARDE TË ZBATUESHME

6. Pavarësisht nga përdorimi i gjerë i termave “Avokat i Popullit” dhe “Komision për të Drejtat e Njeriut” etj, kur flasim për institucionet që përgjigjen për të drejtat e njeriut në nivel vendi, fakti është se organe të tilla ndryshojnë nga një vend në tjetrin për nga natyra, mandati dhe përgjegjësitë që kanë.

²³¹ Ombudsmani i Danimarkës.

²³² Ish Ombudsmani i Gjeorgjisë.

²³³ Bashkimi Europian i ka bërë thirrje Kosovës në kuadër të Procesit të Stabilizim Asociimit të pakësojë dhe thjeshtojë organet e shumta që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të sigurojë monitorim dhe zbatim efikas të kornizës ligjore përkatës.

7. Pavarësisht se nuk ka standarde të detyrueshme ndërkombëtare që zbatohen për institucione të tilla, shumica e tyre respektojnë parimet e Kombeve të Bashkuara që kanë të bëjnë me statusin e institucioneve kombëtare, të njohura përgjithësisht me emrin “Parimet e Parisit”²³⁴, duke qenë se deri më tani ato përfaqësojnë udhëzimet më të ndjekura, të cilat përcaktojnë elementët bazë të çdo institucioni kombëtar të të drejtave të njeriut.
8. Gjithashtu, Instituti Ndërkombëtar i Avokatit të Popullit (“INAP”) në aktet e tij nënligjore, ka renditur tipare të ndryshme tipike të institucioneve të Avokatit të Popullit²³⁵.
9. Komisioni Europian për Demokraci përmes Ligjit (“Komisioni i Venecias”) ka dhënë opinione në raste të ndryshme për institucionet e Avokatit të Popullit në Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, kështu që mund të thuhet se disa standarde europiane rrjedhin nga këto opinione. Ato janë përmbledhur në “Përmbledhjen mbi Institucionin e Avokatit të Popullit”²³⁶.
10. Përgjithësisht, Këshilli i Europës i ka kushtuar vazhdimisht një vëmendje të posaçme Avokatit të Popullit dhe institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut (“IKDNJ”). Kështu, ai ka nxjerrë një numër dokumentesh që pasqyrojnë praktikën më të mira për ngritjen e IKDNJ-ve në shtetet anëtare, duke u dhënë atyre mandat dhe burime të mjaftueshme. Në veçanti, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, në Rekomandimin e tij nr. R (97) 14²³⁷, u rekomandonte Shteteve anëtare të shihnin mundësinë e ngritjes së institucioneve efektive të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.
11. Për më tej, në Rekomandimin e saj nr. 1615(2003)1 për institucionin e Avokatit të Popullit, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, paragrafi 7, vjen në përfundim se veçori të caktuara janë thelbësore për funksionimin me efikasitet të çdo institucioni të Avokatit të Popullit:
 - i. Ngritja në nivel kushtetues me anë të një teksti që garanton thelbin e karakteristikave të përshkruara në këtë paragraf, duke i përpunuar dhe mbrojtur këto karakteristika me anë të ligjit dhe statutit mbi të cilin vepron kjo zyrë;
 - ii. Pavarësi e garantuar nga subjekti i hetimeve, duke përfshirë sidomos për sa i takon ankesave, vendimeve për t’i pranuar apo jo ankesat si të pranueshme, apo për të nisur hetime me iniciativë vetjake; për të marrë vendime se kur dhe si duhet të ndjekë hetimet, për të marrë parasysh dëshmi, dhe për të përgatitur dhe paraqitur rekomandime dhe raporte, dhe për të bërë publicitet;
 - iii. Procedura përjashtuese dhe transparente për caktimin dhe largimin nga Parlamenti, me shumicë të cilësuar votash, në numër mjaft të madh, aq sa për të nënkuptuar mbështetjen e partive jashtë qeverisë, sipas kriterëve strikte që padyshim provojnë se Avokati i Popullit është një individ i kualifikuar dhe me përvojë, me qëndrim të lartë moral dhe me pavarësi politike, për mandate të rinovueshme me kohëzgjatje të paktën sa mandati kohor i Parlamentit;
 - iv. Ndalimi i titullarit që të merret me aktivitete të tjera me pagesë dhe që të përfshihet personalisht në aktivitete politike;
 - v. Imunitet personal nga çdo procedurë disiplinore, administrative apo penale, apo nga dënime që kanë të bëjnë me zbatimin e përgjegjësive zyrtare, me përjashtim të heqjes nga Parlamenti për paaftësi apo për shkelje serioze të etikës;
 - vi. Caktimi i një zëvendësi të identifikuar me rekomandim të Avokatit të Popullit dhe me miratimin e Parlamentit, të aftë të veprojnë me zotësi të plotë si Avokat i Popullit në rast nevojë;
 - vii. Burime të mjaftueshme të garantuara për kryerjen e të gjitha përgjegjësive të caktuara institucionit, të dhëna pavarësisht nga çdo ndërhyrje e mundshme nga ana e subjektit të hetimeve, dhe autonomi e plotë për çështje që lidhen me buxhetin dhe stafin;
 - viii. Qasje të garantuar dhe të menjëhershme në informacione të nevojshme për hetime;
 - ix. Procedura të brendshme që garantojnë standardet më të larta administrative në punën e vetë institucionit, në veçanti, drejtësi, efikasitet, transparencë dhe mirësjellje;

234 http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/Status_of_National_Institutions.aspx

235 Shih <http://www.theioi.org/the-i-o-i/by-laws>.

236 CDL(2011)079 ([http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL\(2011\)079-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL(2011)079-e)).

237 <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&%20InstranetImage=567349%20%20&SecMode=1&DocId=578706&Usage=2>

- x. Bërjen publike (për sa i takon disponueshmërisë dhe gjerësisë) e informacionit për ekzistencën, identitetin, qëllimin, procedurat dhe të drejtat e Avokatit të Popullit, si dhe botimin në shkallë të gjerë dhe efikas të informacionit për aktivitetet, konstatimet, opinionet, propozimet, rekomandimet dhe raportet e institucionit;
 - xi. Procedurat e aplikimit, të cilat të jenë lehtësisht dhe gjerësisht të mundshme për t'u realizuar, të thjeshta dhe pa pagesë, dhe që të sigurojnë konfidencialitetin e tyre në të gjitha rastet;
 - xii. Fshehtësi e garantuar e hetimeve dhe, në raste kur bëhen publike, ruajtje e anonimitetit të tyre;
 - xiii. Të drejtën të japë opinione për reforma legjislative apo rregullatore të propozuara dhe me iniciativë të vet (*proprio motu*) të bëjë propozime të tilla me synim përmirësimin e standardeve administrative dhe, kur përputhet me mandatin e përgjithshëm, respektimin e të drejtave të njeriut;
 - xiv. Kërkesën që administrata të japë, brenda një kohe të arsyeshme, përgjigje të plota, duke përshkruar zbatimin e konstatimeve, opinioneve, propozimeve dhe rekomandimeve, apo të japë arsyet se përse ato nuk mund të zbatohen;
 - xv. Paraqitja nga Avokati i Popullit i një raporti vjetor përpara Parlamentit, si dhe e raporteve të posaçme për çështje që përbëjnë shqetësim të veçantë, apo kur administrata nuk i ka zbatuar rekomandimet e tij.
13. Në lidhje me kompetencat e Avokatit të Popullit ndaj gjyqësorit, paragrafi 6 thotë sa më poshtë:
- Asambleja beson se Avokati i Popullit duhet të ketë në rastin më të mirë të drejta të kufizuara mbikëqyrjeje ndaj gjykatave. Në rast se rrethanat e kërkojnë një rol të tillë, duhet të jetë i kufizuar në sigurimin e efektivitetit procedural dhe rregullsisë administrative të sistemit gjyqësor; si pasojë, aftësia për të përfaqësuar individët (me përjashtim kur nuk ka të drejtë individuale për qasje në një gjykatë të caktuar), për të filluar apo ndërhyrë në procedura, apo për të rihapur çështje gjyqësore duhet të përjashtohet.
14. Përveç burimeve të ligjit të sipërpërmendura, autorët e opinionit kanë përdorur parime të praktikave më të mira të vendeve Europiane si dhe përvojat e tyre personale në lidhje me administrimin e pavarur, profesional dhe efikas të institucioneve të Avokatit të Popullit.

2. KONSIDERATA BAZË PËR IAP-në DHE LIGJIN AKTUAL

- 15. IAP është një institucion i ri, i cili i është nënshtruar ndryshimeve institucionale disa herë.
- 16. Fillimisht IAP-ja u krijua nga UNMIK më 2000 dhe, deri në 2005, institucioni drejtohej nga një Avokat i Popullit ndërkombëtar, që ndihmohej nga tre zëvendës, një ndërkombëtar, dhe dy nga komunitetet me prejardhje etnike serbe dhe shqiptare, përkatësisht.
- 17. Në vitin 2006, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/06 solli dy ndryshime të mëdha në këtë institucion: ajo përcaktoi se Avokati i Popullit nuk do të ishte më një person i huaj, dhe se institucioni nuk do të mbikëqyrej më nga UNMIK-u. Megjithatë, periudha e transicionit zgjati më shumë se ishte parashikuar fillimisht.
- 18. Me shpalljen e pavarësisë dhe miratimin e Kushtetutës, Avokati i Popullit u bë një nga institucionet e pavarura në Kosovë²³⁸. Sipas Neneve 132-135 të Kushtetutës, detyra e Avokatit të Popullit është të monitorojë, mbrojë dhe mbështesë të drejtat dhe liritë e individëve nga akte të paligjshme apo të papërshtatshme, apo mosveprimet e autoriteteve publike.
- 19. Të drejtat e Avokatit të Popullit përfshijnë kryesisht bërjen e rekomandimeve dhe

²³⁸ Krahaso. Seksionin XII të Kushtetutës.

propozimin e veprimeve kur provohen shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike dhe autoritete të tjera shtetërore, dhe kundërshtimi në Gjykatën Kushtetuese të ligjeve, dekreteve presidenciale, rregulloreve të qeverisë dhe statuteve të komunave. Kompetenca e fundit, megjithatë, nuk përdoret për akte apo mosveprime nga ana e individëve apo autoriteteve shtetërore. Përveç dispozitave kushtetuese, aktualisht funksioni i IAP-së rregullohet me Ligjin aktual, i cili u miratua nga Kuvendi në 22 korrik 2012. Ligji aktual shfuqizoi të gjitha Rregulloret e mëparshme të UNMIK-ut për të njëjtën temë, si dhe çdo dispozitë tjetër që binte ndesh me të.

20. Bashkëbisedues të shumtë të intervistuar gjatë vizitës në Kosovë sugjeruan se IAP po demonstroi aftësi disi të kufizuara për t'u bërë trysni pushtetit qendror dhe Kuvendit. Ata vunë në dukje një numër arsyesh për këtë mosushtim të mandatit si duhet, të tilla si ndjeshmëria e dobët për të drejtat e njeriut dhe ndjenja e pandëshkueshmërisë nga ana e udhëheqësve dhe përfaqësuesve të qeverisë dhe politikës, si dhe paaftësia e publikut për t'i bërë përfaqësuesit e tyre të jenë realisht përgjegjës për veprimet e tyre, të cilat janë të lidhura me mungesën e një kulture kolektive²³⁹.
21. Gjithashtu, u tha se një numër çështjesh që ndikojnë negativisht në efikasitetin dhe nivelin e pavarësisë së IAP-së buronin nga mbrojtjet dhe të drejtat e pamjaftueshme ligjore që i ishin dhënë IAP-së në Ligjin aktual.
22. Sipas mendimit të autorëve, Ligji aktual ka cilësi të rëndësishme:
 - Ai trajton shumicën e çështjeve që duhet të trajtojë një ligj për Avokatin e Popullit;
 - Në shumë mënyra, ai është i mirë nga pikëpamja ligjore dhe teknike.
 - Shumë nga dispozitat e tij janë të qarta dhe i trajtojnë problemet në mënyrë logjike dhe të arsyeshme.
23. Njëkohësisht, Ligji aktual ka disa probleme të rëndësishme:
 - Një numër dispozitash të ligjit aktual ngrenë çështje të rëndësishme parimi. Kjo vlen kryesisht për përcaktimin e institucioneve që mbulojnë nga të drejtat e IAP-së, procedurën e zgjedhjes së Avokatit të Popullit, numrin dhe caktimin e zëvendësve të tij, imunitetin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të tij, ofrimin e një vendi pune Avokatit të Popullit pas përfundimit të mandatit të tij, rolin dhe kompetencat e IAP-së për parandalimin e torturës dhe trajtimin apo dënimin çnjerëzor dhe degradues, qasjen në dosje me materiale dhe dokumente, raportimin dhe dëgjimin e raportit të Avokatit të Popullit në Kuvend dhe pavarësinë financiare dhe të gjetjes së fondeve nga institucioni; dhe
 - Një numër dispozitash kanë nevojë për përmirësime teknike. Disa prej tyre duhet të jenë më të qarta, dhe disa të tjera nuk janë në harmoni me njëra-tjetrën.
24. Gjithashtu, ligji aktual duhet të harmonizohet me Projektligjin për Diskriminimin dhe Projektligjin për Barazinë Gjinore. Ligji aktual dhe dy projektligjet përmbajnë dispozita të ndryshme për kompetencat e IAP-së, dhe është thelbësore që këto tri ligje të merren në kontekst dhe jo si tre ligje të veçanta nga njeri tjetri.
25. Më përgjithësisht, ka rëndësi të vihet në dukje se ka një numër çështjesh thelbësore për institucionet e Avokatit të Popullit që nuk mund të rregullohen (dhe zgjidhen) me ligje. Kjo ka të bëjë, për shembull, me vullnetin e qeverisë për të respektuar thellësisht dhe zbatuar opinionet e Avokatit të Popullit, si dhe me nevojën që Avokati i Popullit të japë opinionet dhe të punojë me cilësinë më të lartë.

²³⁹ Konkluzione të ngjashme u nxorën nga Projekti i përbashkët i Bashkimit Europian me Këshillin e Europës "Rritja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë*", Raporti i Vlerësimit u përgatit nga Z. Mark Andrew Jones dhe Znj. Ivana Roagna.

-
26. Aspekte të tilla, si rrjedhje, nuk trajtohen në konsideratat e mëposhtme. Por ato janë shembuj të temave që megjithatë kanë rëndësi esenciale në çdo vend të përkushtuar vërtet ndaj idesë së Avokatit të Popullit.
 27. Konstatohet se gjuha e përdorur në ligjin ekzistues shpesh nuk merr parasysh gjininë në versionin në gjuhën angleze dhe kjo duhet trajtuar kur të bëhen ndryshimet e tjera të propozuara në këtë opinion²⁴⁰.

4. DISA ÇËSHTJE TË RËNDËSISHME PARIMORE

(a) Përcaktimi i institucioneve dhe personave që mbulohen nga kompetencat e IAP-së

28. Ligji aktual përdor terminologji të ndryshme kur përcakton institucionet e mbuluara nga kompetencat e IAP-së. Për shembull, Neni 1 flet për “autoritetet publike, organet dhe organizatat e tjera që ushtrojnë të drejta publike për llogari të tyre”, ndërsa Neni 3.2 u referohet “organeve të autoriteteve publike”, ndërsa Neni 16.2 i referohet “çdo personi fizik dhe ligjor”. Njëkohësisht, nga Neni 15.6 del se kompetencat e IAP-së nuk mbulojnë sistemin gjyqësor, me përjashtim të rasteve “të vonesave të paarsyeshme apo abuzimeve të dukshme të pushtetit”.
29. Me qëllim që të jetë i qartë, ligji aktual duhet të përmbajë, në një dispozitë të vetme, një formulim të qartë të institucioneve që mbulohen nga kompetencat e IAP-së.
30. Së pari, Neni 1 duhet që, në përputhje me Nenin 132.1 të Kushtetutës, t’u referohet kryesisht “autoriteteve publike”, duke treguar se ky term vlen edhe për autoritetet qendrore edhe për ato lokale.
31. Së dyti, pavarësisht se Neni 1 thotë se “autoritetet publike” mbulojnë gjithashtu edhe organet dhe organizatat private që ushtrojnë të drejta publike për llogari të tyre, nuk është e qartë se çfarë synon të arrijë konkretisht kjo shtesë, dhe gjatë vizitës në Kosovë, bashkëbiseduesit nuk ishin në gjendje të ofronin shembuj konkretë praktikë. Pra, për aq sa mendohet e nevojshme që Neni 1 të përfshijë disa organe private, ai duhet amenduar që të deklarojë më qartë se për cilat organe private e ka fjalën.
32. Së treti, Neni 1 duhet të thotë se gjykatat nuk mbulohen nga kompetencat e IAP-së me përjashtim të rasteve kur ka vonesa të paarsyeshme. Për më tej, duhet thënë se në raste të tilla IAP-ja duhet të ketë kompetencë vetëm të japë rekomandime të përgjithshme dhe jo të ndërhyjë në raste të veçanta. Kjo gjë do të përputhej edhe me doktrinën e Komisionit të Venecias, sipas të cilës:

Në përgjithësi, do të dukej e preferueshme t’i jepej Avokatit të Popullit e drejta për të bërë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit të gjykatave, por të përjashtohet nga e drejta për të ndërhyrë në raste individuale (madje as në lidhje me kohëzgjatjen e tyre); kjo gjë i duhet lënë vetë sistemit gjyqësor²⁴¹.

33. Neni aktual 15.6 po ashtu përfshin “abuzimin e pandehur të pushtetit” në listën e të drejtave të IAP-së ndaj gjykatave. Supozohet se kjo i referohet thelbit të vendimeve gjyqësore. Megjithatë, formulimi është shumë i paqartë dhe duket se mund të shkaktojë mosmarrëveshje. Po ashtu, çështjet e thelbit të vendimeve të gjykatave duhen trajtuar kryesisht përmes sistemit të apelimeve dhe jo me anë të institucioneve jo gjyqësore.

²⁴⁰ Autorëve iu është sugjeruar se kështu është edhe në versionin shqip, por autorët nuk janë në gjendje të verifikojnë nëse është kështu.

²⁴¹ Opinion CDL-AD(2007)024 për projektligjin për Avokatin e Popullit në Kosovë, para. 19.

34. Për këto arsye, “apo abuzimi i dukshëm i pushtetit” duhet të hiqet nga Neni 15.6. Kjo gjë padyshim do të përputhej më shumë me rekomandimin nr. 1615(2003)1 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për Institucionin e Avokatit të Popullit.
35. Duhet të kihet parasysh se nuk ka ndonjë kundërthënie nga njëra anë, midis kufizimeve të propozuara të juridiksionit të IAP-së ndaj gjykatave dhe, nga ana tjetër, kompetencave të IAP-së sipas Nenit 15 të Ligjit aktual, për të nisur çështje përpara Gjykatës Kushtetuese, dhe propozimeve në opinionin e Projektligjit për Diskriminimin në lidhje me kompetencat e IAP-së për të filluar procedura në gjykata. Ajo që thuhet në paragrafët më sipër ka të bëjë me kompetencat e IAP-së për të ndërrhyrë në mënyrën se si gjykatat i trajtojnë secila çështjet gjyqësore të tyre. Ajo që thuhet në Nenin 15 të Ligjit aktual, dhe në opinionin e Projektligjit për Diskriminimin ka të bëjë me të drejtat e IAP-së për të inicuar procedura gjyqësore (duke mos ndërrhyrë në asnjë mënyrë në to).
36. Së katërti, Neni 1 duhet të përmbajë një referencë të qartë ndaj kompetencave të IAP-së në lidhje me diskriminimin dhe barazinë gjinore sipas Projektligjit për Diskriminimin dhe Ligjit për Barazinë Gjinore, që u shtohen atyre që ka aktualisht ligji në fuqi. Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh se procedurat e shqyrtimit të ankesave në Kapitullin IV të Ligjit ekzistues mbulojnë vetëm autoritetet publike.
37. Vihet re se këto kompetenca do të lejonin ankesa kundër personave dhe organeve privatë po aq sa edhe ndaj institucioneve publike. Si të tilla, ka një çështje potenciale të përputhshmërisë së këtyre kompetencave me Nenin 132,1 të Kushtetutës, që përcakton se roli i Avokatit të Popullit lidhet me “autoritetet publike”. Kjo është një çështje që mund të duhet të zgjidhet në të ardhmen dhe padyshim nuk i përket këtij Opinioni. Megjithatë, nuk ka asgjë të papërshtatshme, në parim, që kompetenca të tilla t’i jepen institucionit të Avokatit të Popullit.
38. Së pesti, përcaktimi i institucioneve që janë kompetencë e IAP-së duhet të pasqyrohet gjithashtu edhe në formulimin e përdorur për organet dhe institucionet e përmendura në Nenet 22, 23.1, 24, 25 dhe 26.

(b) Procedurat për zgjedhjen e Avokatit të Popullit

39. Procedurat për propozimin dhe zgjedhjen e Avokatit të Popullit përshkruhen në Nenet 8 dhe 9.
40. Këto procedura duken të ndërlikuara pa nevojë. Duket sikur përmbajnë një risk të madh të bllokimit të situatave ku nuk ka një kandidat të vetëm të dukshëm për këtë post (një bllokim i tillë u duk në fakt se u krijua gjatë procesit të zgjedhjeve të fundit, që shpuri në zgjedhjen e Avokatit të Popullit aktual). Është me rëndësi që ato të thjeshtohen (dhe ndryshe të përmirësohen) në masën që është e mundshme.
41. Kështu, në ligjin aktual duhet të bëhen amendamentet e mëposhtme:
- Neni 8.1 duhet të deklarojë gjithashtu se procedurat e zgjedhjes po ashtu të nisin në kohën e dorëheqjes, largimit nga puna, apo vdekjes së Avokatit të Popullit;
 - Duke pasur parasysh paqartësinë relative (dhe ndoshta të paevitueshme) të disa prej kushteve të parashtruara në Nenin 6, Komiteti duhet të ketë të drejtë të hedhë poshtë kërkuesit që nuk i plotësojnë objektivistisht kushtet vetëm sipas Nenit 8.6 (p.sh. të jesh

- qytetar i Kosovës dhe të kesh diplomë universiteti);
- Duhet të deklarohet qartë në Nenin 8.9 se Kuvendi është i lirë të zgjedhë një kandidat i cili nuk ka dalë në listën e shkurtër të paraqitur nga Komiteti (por që plotëson në fakt kushtet objektive). Lista e shkurtër duhet të jetë një instrument praktik pune për Kuvendin, por jo një kufizim detyrues i kandidatëve, sepse në fakt ka rëndësi që të jetë i gjithë Kuvendi (dhe jo një komision) ai që merr përgjegjësi të plotë për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe që i jep atij apo asaj legjitimitet demokratik. Megjithatë, Kuvendit mund t'i jepet detyrë t'i referojë kandidatët që nuk janë në listën e shkurtër para Komisionit për kontroll të mëtejshëm në rast se Kuvendi po shqyrton mundësinë për të zgjedhur një kandidatë që nuk është në listën e shkurtër;
 - Neni 9.2 duhet të parashikojë që Avokati i Popullit të zgjidhet brenda 30 ditësh nga dita e propozimit të kandidatëve dhe që, në rast se ky afat nuk realizohet, kuvendi të votojë për zgjedhjen e Avokatit të Popullit në çdo seancë parlamentare për 30 ditët e ardhshme. Dispozita ekzistuese për një konkurrim të ri, kur Avokati i Popullit nuk zgjidhet brenda 60 ditëve, duhet të hiqet, duke qenë se nuk ka arsye të pritset se do të dalin kandidatë të tjerë (më) të kualifikuar. Neni 9.2 duhet që në këtë mënyrë thjesht të thotë se zgjedhja e një Avokati i Popullit të ri duhet të bëhet brenda 30 ditësh dhe se, gjithsesi, Avokati i Popullit aktual duhet të jetë i detyruar të rrijë në detyrë deri sa të vijë Avokati i Popullit i ri²⁴².

(c) Numri dhe caktimi i zëvendësve

42. Sipas 5.1.2, ka 5 Zëvendës Avokatë të Popullit. Kjo është një zgjedhje e bërë në ligjin aktual duke qenë se Neni 133.2 i Kushtetutës parashikon vetëm që duhet të ketë “një apo më shumë” zëvendës.
43. Për më tej, sipas nenit 9.3, jo vetëm Avokati i Popullit, por edhe zëvendësit duhet të zgjidhen nga Kuvendi. Kjo është edhe një zgjedhje e bërë nga Ligji në fuqi, duke qenë se kushtetuta nuk e kërkon zgjedhjen e tillë të zëvendësve, por i lejon Avokatit të Popullit të caktojë zëvendësit e vet.
44. Kjo çështje duhet shqyrtuar, duke qenë se, bazuar në përvojën profesionale dhe në praktikë, dhe në vendimet e shprehura nga palët e interesuara, 5 zëvendës duket tepër shumë, duke i komplikuar punët në IAP, dhe në njëfarë mënyre duke e bërë disi të paqartë përgjegjësinë për veprimet e institucionit dhe llogaridhënien e Avokatit të Popullit përpara Kuvendit.
45. Me qëllim administrimin më të mirë të mundshëm të institucionit, duhet t'i lihet në dorë vetë Avokatit të Popullit të përcaktojë numrin e zëvendësve të tij (duke respektuar padyshim Nenin 133.2 të Kushtetutës, që të ketë të paktën një zëvendës). Kjo gjë do të bënte të mundshme gjithashtu që Avokati i Popullit të ndryshonte numrin e zëvendësve në rast se do të kërkohej.
46. Në këtë kontekst, do të ishte me vend që e drejta për të caktuar zëvendësit e vet t'i lihej ekskluzivisht në dorë Avokatit të Popullit (dhe rrjedhimisht ata nuk duhet të zgjidhen nga Kuvendi). Është një parim bazë që drejtuesi, që përgjigjet për mbarëvajtjen e përgjithshme të një institucioni, të ketë të drejtë të vendosë për stafin e institucionit të vet, dhe në këtë drejtim, do të mjaftonte që zëvendësit të zgjidheshin me propozim të Avokatit të Popullit²⁴³. Gjithashtu, një ndryshim i tillë do të bënte të qartë llogaridhënien e Avokatit të Popullit pra Kuvendit, duke e lënë atë pa asnjë “justifikim” që ai ose ajo duhet të punonte me zëvendës të zgjedhur nga një organ

²⁴² Krahaso: Neni 13.3.

²⁴³ Neni 8.11.

tjetër. Neni 7 duhet në këtë mënyrë t'i referohet vetëm zgjedhjes së Avokatit të Popullit.

47. Neni 8.13 shpreh një parim diversiteti në stafin e IAP-së. Një parim i tillë duhet të mbrohet dhe pastaj a ka në dorë Avokati i Popullit të caktojë stafin (përfshirë zëvendësit) e vet në përputhje me kritere të tilla. Kalimi i një dispozite të tillë të Neni 7 do të siguronte respektim të plotë në të ardhmen të parimit të diversitetit midis stafit të IAP-së, zëvendësve të vet, si dhe të anëtarëve të thjeshtë të stafit, dhe në këtë mënyrë, ligji ekzistues do të amendohej përkatësisht. Megjithatë, do të ishte me rëndësi të merrej plotësisht në konsideratë shkalla e përfaqësimit etnik dhe gjinor në pozicione të nivelit të lartë gjatë caktimit të Avokatit të Popullit.
48. Megjithatë, është e kuptueshme në rast se Kuvendi i Kosovës dëshiron të ruajë njëfarë ndikimi në caktimin e zëvendësve (për shembull, për shkak se zëvendësit në rrethana të caktuara do të veprojnë në vendin e Avokatit të Popullit). Një mekanizëm i tillë mund të ngrihet ose duke e lejuar kuvendin të kundërshtojë (brenda një afati të caktuar) emërimin nga ana e një Avokati të zëvendësve të vet, ose duke i dhënë Kuvendit të drejtën të miratojë zyrtarisht kandidatin përkatës²⁴⁴. Në secilin rast, Kuvendi duhet t'i lejojë një hapësirë të madhe Avokatit të Popullit për të vendosur, dhe numri i zëvendësve gjithsesi t'i lihet atij në dorë për ta caktuar.
49. Si pasojë, dispozita në Nenin 5.1.2 – dhe kështu edhe amendamenti i propozuar në Nenin 1 të Projektligjit amendues – në lidhje me numrin e zëvendësve duhet të zëvendësohet nga një dispozitë që të përcaktojë se Avokati i Popullit duhet të caktojë të paktën një zëvendës, por që mund të caktojë më shumë se një në rast se e konsideron të nevojshme. Përveç kësaj, referencat ndaj zëvendësve të Avokatit të Popullit në Nenin 8, 9 dhe 10 duhet të hiqen, dhe Neni 13-14 dhe Neni 15, 16, 17 duhet të fshihen në tërësi, gjë që do të nënkuptonte edhe fshirjen e Neni 2 nga Projektligji amendues.

(d) Imuniteti

50. Sipas Neni 11.1, Avokati i Popullit dhe zëvendësit e vet gëzojnë imunitet nga procedimet, paditë civile dhe nga largimi nga detyra për aktivitete dhe/ose vendime që janë në gamën e përgjegjësive të IAP-së. Kjo gjë (për sa i takon Avokatit të Popullit) është pasqyrim i Neni 134.4 të Kushtetutës.
51. Kjo dispozitë ngre pikëpyetje të ndryshme.
52. Së pari, ky imunitet mund të përfshijë Avokatin e Popullit dhe zëvendësit, por jo stafin.
53. Në raste të ndryshme, Komisioni i Venecias ka deklaruar se imuniteti duhet të përfshijë edhe stafin e Avokatit të Popullit. Kështu Komisioni ka sugjeruar (në lidhje me Mbrojtësin e të drejtave njerëzore the lirive në Mal të Zi) se:

Jo vetëm Mbrojtësi dhe zëvendësit e vet, por edhe stafi duhet të ketë imunitet nga procese ligjore në lidhje me fjalë të thëna apo shkruara dhe akte të kryera më cilësinë e tyre zyrtare²⁴⁵.

54. Pra, imuniteti duhet që të përfshijë edhe stafin (kjo nuk duket se bie ndesh me Nenin

²⁴⁴ Krahaso, gjithashtu Rekomandimin nr. 1615(2003)1 p/r Institucionin e Ombudsmanit, paragrafi 7.

²⁴⁵ Krahaso. Opinioni CDL-AD(2009)043 për projektamendimet e loigjit për Mbrojtësin e të Drejtave të Njeriut në Mal të Zi, paragrafi 12, 27 dhe 29.

134.4 të Kushtetutës, megjithëse kjo dispozitë i referohet vetëm Avokatit të Popullit – ndryshe, mund të kishte një problem edhe në ligjin ekzistues që imunitetin e përfshin edhe për zëvendësit).

55. Në këtë kontekst, është me rëndësi të theksohet se si në rastin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të vet, imuniteti mund të përdoret për aktivitete dhe/ose vendime që janë në gamën e përgjegjësive të IAP-së. Në asnjë rrethanë nuk duhet të ketë imunitet për veprime jashtë gamës së përgjegjësive të tilla, për shembull, mos nxjerrja e informacionit që ka të bëjë me një hetim të IAP-së, vjedhja nga zyra, apo veprime krejtësisht të palidhura me punën e IAP-së.
56. Së dyti, është e paqartë nëse imuniteti për Avokatin e Popullit dhe zëvendësit vlen edhe pasi ata e përfundojnë mandatin. Në letrën e tij me datë 31 janar 2013, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Avokati i Popullit ka propozuar që “Imuniteti i funksionit duhet të jetë i vlefshëm edhe pas mbarimit të detyrës apo periudhës së punës në Institucionin e Avokatit të Popullit”. Propozimi nuk është përfshirë në Projektligjin amendues.
57. Gjithsesi, imuniteti mund të ketë pak rëndësi në rast se Avokati i Popullit do t’i trembej procedimit arbitrar, etj., me të mbaruar mandati i tij, dhe rekomandohet me forcë që imuniteti funksional, pra, imuniteti nga procesi ligjor në lidhje me fjalë të thëna apo të shkruara dhe për të gjitha veprimet e kryera prej tyre në cilësinë zyrtare dhe brenda kufirit të autoritetit të tyre, t’u jepej edhe pas mbarimit të këtij mandati. Në opinionin për Malin e Zi të citur më lart, Komisioni i Venecias guxoi të deklaronte që një:

Imunitet i tillë duhet të vazhdojë t’i jepe Mbrojtësit edhe pas përfundimit të mandatit, ose pasi anëtarët e stafit të mbarojnë së punuari në institucionin e Mbrojtësit.

58. Ligji aktual duhet pra të amendohet për ta bërë të qartë se imuniteti funksional mbetet në fuqi pas përfundimit të detyrës dhe punësimit përkatësisht të Avokatit të Popullit dhe stafit të vet.

(e) Largimi nga detyra i Avokatit të Popullit

59. Sipas Nenit 12.1, Avokati i Popullit si dhe zëvendësit e vet, mund të largohen nga detyra për arsyet e mëposhtme që kanë të bëjnë me:
- Paaftësi fizike apo mendore;
 - Kryerjen e një vepre penale;
 - Sjelljen personale; dhe
 - Veprime që bien ndesh me dispozita të ndryshme të ligjit aktual.
60. Dispozita duhet parë në kontekst me Nenin 8.14. Sipas kësaj dispozite, procedura për heqjen e Avokatit të Popullit (dhe aktualisht të zëvendësve të vet) duhet rregulluar me një rregullore të posaçme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
61. Sipas informacionit të dhënë, nuk ka rregullore të qarta në lidhje me Avokatin e Popullit dhe zëvendësit e vet.
62. Është një parim i zakonshëm europian që Parlamenti të ketë mundësi që në rrethana të jashtëzakonshme, të largojë nga detyra një Avokat i Popullit të zgjedhur. Nga ana tjetër, është me rëndësi që pasi të zgjidhet, Avokatit të Popullit të ketë mundësi t’i kryejë detyrat në mënyrë të pavarur, gjë që duhet të përfshijë ekzistencën e

mbrojtjes nga frika e heqjes nga puna për shkak të vendimeve që nuk i pëlqejnë Parlamentit. Parimi i fundit po ashtu shprehet në Nenin 137,7 të Kushtetutës, sipas të cilit Avokati i Popullit ushtron detyrat e veta në mënyrë të pavarur dhe nuk pranon asnjë udhëzim apo ndërhyrje nga institucionet e tjera.

63. Nuk është e kollajtë të vendoset një baraspeshë midis këtyre parimeve. Megjithatë, kombinimi i (a) kriterëve disi të mjegullta për largim nga detyra dhe (b) faktit që nuk ekzistojnë masa procedurale të posaçme, në parim e lë Avokatin e Popullit në një pozitë tepër problematike.
64. Mund të jetë e vështirë të hartohen kriteret për largim nga puna në mënyrë shumë të përcaktuar. Megjithatë, nocioni i “sjelljes personale” në Nenin 12.1.3 duket qartë se është tepër i gjerë, duke qenë se duhet të mbulojë të gjitha arsyet për të kërkuar të largosh një Avokat i Popullit nga detyra (duke përfshirë edhe arsye thjesht politike). Sugjerohet se kjo pjesë e dispozitave të hiqet. Në rast se nocioni i “sjelljes personale” ka për qëllim të mbulojë arsye specifike dhe të vlefshme për largim nga detyra, të pambuluara nga kriteret e mbetura në Nenin 12.1, arsye të tilla duhet të shpjegohen dhe të shtohen në dispozitë.
65. Gjithsesi, është me shumë rëndësi që të ketë procedura të cilat të parashikojnë mbrojtje nga shpërdorimi i të drejtës për ta larguar nga puna Avokatin e Popullit. Procedurat të tilla duhet të përfshijnë:
- Procedura të hapura dhe publike;
 - Garanci që Avokati i Popullit të dëgjohet publikisht;
 - Hetime dhe këshilla nga institucione të pavarura, të tilla si Gjykata Kushtetuese;
 - Nevojën për shumicë të cilësuar në Kuvend²⁴⁶.
66. Kjo përputhjet me standardet e Komisionit të Venecias²⁴⁷.
67. Rregulloret e hollësishme mund të përcaktohen në rregulloret e Kuvendit, sikundër parashikohet në dispozitën aktuale në Nenin 8.14, por parimet bazë, sikurse u paraqitën më lart, duhet t’i jepen Nenit 12 të vetë ligjit aktual, i cili duhet të amendohet përkatësisht.
68. Sikundër është sugjeruar ndërkohë që zëvendësit e Avokatit të Popullit të caktohen nga vetë Avokati i Popullit (dhe jo të zgjidhen nga Kuvendi), largimi i tyre nga detyra po ashtu duhet të jetë një çështje në kompetencën e Avokatit të Popullit dhe jo të Kuvendit. Ligji aktual duhet të përcaktojë kriteret në Nenin 30 për një largim të tillë – që duhet të jenë të njëjta si ato të aplikueshme për Avokatin e popullit – por Neni 12 duhet të amendohet për të trajtuar vetëm largimin nga detyra të Avokatit të Popullit.

(f) Sigurimi i një pune pas fundit të mandatit

69. Sipas Nenit 14.1, pas përfundimit të mandatit, Avokati i Popullit mund të kthehet në vendin e punës që ka pasur para zgjedhjes në këtë post. Në rast se kjo nuk është e mundshme, punëdhënësi i mëparshëm duhet t’i ofrojë një punë të përshtatshme, në varësi të aftësive dhe profesionit të vet.
70. Megjithatë, fjalia e dytë është problematike, të paktën në ato raste kur punëdhënësi i

²⁴⁶ Krahaso: Neni 134.5 I Kushtetutës.

²⁴⁷ Shih për shembull, *Opinion i përbashkët (CDL-AD(2004)041 për projektligjin për Ombudsmenin e Serbisë, paragrafët 12 dhe 9.*

mëparshëm është një institucion i mbuluar nga kompetencat e IAP-së, meqenëse ia lë punëdhënësit të mëparshëm të vendosë vetë si në lidhje me pozitën e mëparshme, nëse ajo duhet të ekzistojë ende, ashtu edhe për atë që duhet të jetë një punë e “përshatshme”. Ekzistenca e kësaj mundësie mund të shihet si një mundësi që ndikon në ushtrimin nga Avokati i Popullit të funksioneve të vet të mëparshme në lidhje me atë institucion.

71. Një zgjidhje do të ishte amendimi i Nenit 14 me qëllim që punëdhënësi i mëparshëm të sigurojë një post që të jetë të paktën në të njëjtën nivel, duke përfshirë kushtet financiare, në kohën që Avokati i Popullit është larguar nga ajo pozitë.
72. Ose Neni 14.1 ose Neni 3 i Projektligjit amendues (që amendon Nenin 14 të ligjit aktual) duhet të amendohen përkatësisht.

(g) Kompetencat e Avokatit të Popullit

73. Neni 15 i ligjit aktual parashikon listën e kompetencave që i jepen IAP-së. Mandati i IAP-së është mjaft i gjerë. Megjithatë nevoja për t'i dhënë IAP-së kompetenca shtesë vazhdon të ekzistojë.
74. IAP-ja, duke ushtruar kompetencën e vet, mund të trajtojë rastet kur kërkohet delegimi i rastit për hetim të mëtejshëm në organet e autorizuara për të kryer hetime penale. Neni 15 i ligjit aktual nuk i jep IAP-së autoritet të qartë për të dërguar kërkesa dhe materiale të posaçme në organet hetimore, me rekomandimin për të nisur hetime penale, kur ajo arrin në përfundimin se është kryer një krim. Duke qenë se IAP-ja nuk është institucioni që i është besuar e drejta për të kryer vetë hetime penale, Neni 15 duhet të amendohet për t'i dhënë IAP-së kompetenca të qarta për t'iu drejtuar organeve hetimore dhe procedurale me një kërkesë për të nisur një hetim penal. Këto të fundit duhet t'i trajtojnë kërkesat e IAP-së me vëmendjen e duhur.
75. Sipas Nenit 16.7 të Ligjit Aktual, Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e vet janë të autorizuar të hyjnë pa njoftim paraprak dhe të inspektojnë çdo vend të heqjes së lirisë në Kosovë.
76. Në praktikë, IAP-ja kryen monitorime të vendeve të privimit të lirisë në partneritet me dy organizata lokale jo qeveritare të specializuara në këtë fushë, bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar nga palët. Duke marrë në konsideratë një numër elementesh të rëndësishëm, përfshirë mandatin aktual, përvojën dhe kapacitetet e IAP-së, është e qartë se IAP-ja mund të veprojë si një Mekanizëm Kombëtar Parandalues (“MKP”) i parashikuar nga Protokollu Fakultativ i Kombeve të Bashkuara Kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese (“POKTTÇP) dhe do të ishte me vend të zgjerohej përkatësisht gama e aktiviteteve të IAP-së. Gjithsesi, duke pasur parasysh se IAP-ja do të marrë funksione të reja si pasojë e miratimit të Projektligjit për Diskriminimin, mund të ishte me vend të amendohej ligji me qëllim që IAP-ja të quhej Mekanizmi Kombëtar Parandalues dhe të shtyhej ngritja e tij, me qëllim që të përcaktohej përparësia e zbatimit të funksioneve që kanë të bëjnë me pjesën e diskriminimit. Kjo duhet të trajtohet si pjesë e dispozitave transitorë të projektligjit.
77. Procesi i amendimit të ligjit aktual duhet pra të përdoret për të trajtuar këtë problem të rëndësishëm, si dhe për të futur më ligj dispozitat e kërkuara për të përmirësuar rolin monitorues dhe parandalues të IAP-së në luftën kundër torturës dhe trajtimit apo ndëshkimit çnjerëzor apo poshtëruës në Kosovë.

78. Neni 16.7 duhet në këtë mënyrë të amendohet për të parashikuar që IAP-ja të ushtrrojë funksionin e një MKP -se.

79. Përveç kësaj, teksti i Nenit aktual 16.7 duhet të kalojë te Neni i futur rishtazi 16.7.1 me formulimin e mëposhtëm:

Zyrtarët e IAP-së mund që në çdo kohë dhe pa lajmëruar, të hyjnë dhe inspektojnë çdo vend ku mund të ketë persona të privuar nga liria dhe mund të jenë të pranishëm në takime apo seanca dëgjimore ku përfshihen persona të tillë. Zyrtarët e IAP-së mund të mbajnë takime me persona të tillë, pa praninë e zyrtarëve të institucioneve përkatëse. Çdo lloj korrespondence të këtyre personave me IAP-në nuk parandalohet apo kontrollohet.

(h) Qasja e IAP-së në informacion

80. Sipas Nenit 16.6, Avokati i Popullit mendohet të ketë qasje në dosje dhe dokumente të çdo institucioni të Republikës së Kosovës dhe mund t'i shqyrtojë ato për rastet që janë në shqyrtim. Dispozita përmban kufizime për një qasje të tillë dhe kështu duket se nënkupton se qasja është e pakushtëzuar, pavarësisht nga dispozitat e fshehtësisë së ligjeve të tjera.

81. Kjo përputhet me shumë ligje europiane për Avokatin e Popullit, meqenëse është një parim bazë që një Avokat i Popullit nuk mund të hetojë një rast pa pasur qasje në (të gjitha) dosjet dhe dokumentet e tij. Kjo përputhet gjithashtu edhe me Rekomandimin 1615(2003)1 për Institucionin e Avokatit të Popullit, paragrafi 7.viii, i cili kërkon “qasje të menjëhershme dhe të pakufizuar në të gjithë informacionin e nevojshëm për hetimin”.

82. Gjithsesi, në praktikë duket se nuk ka problem me këtë gjë. Autorëve iu thanë se ndodh që autoritetet, për shembull, policia, të refuzojë të paraqesë dosje, mbështetur në detyrën që ka për të ruajtur fshehtësinë.

83. Është thelbësore që ky problem të zgjidhet, meqenëse mund të minojë të drejtat dhe autoritetin e IAP-së.

84. Duhet që (në përputhje me formulimin e Nenit 16.6) IAP-ja të ketë qasje të pakufizuar në dosje dhe dokumente në çështje që heton. Si rrjedhojë sugjerohet që në Nenin 16.6, të shtohet një fjali specifike sipas të cilës, detyrimi i ruajtjes së fshehtësisë nuk mund të përdoret si arsye për të mos i dhënë IAP-së dokumentet dhe dosjet e kërkuara. Për më tej, ligji duhet gjithashtu t'i japë IAP-së, gjatë ushtrimit të kompetencave të saj si MMK, qasje në dosjet mjekësore të personave të privuar nga liria e tyre.

85. Pavarësisht nga ajo që është thënë më lart, duhet sigurisht që të ketë procedura për të siguruar që dosjet dhe dokumentet që IAP-ja merr për qëllime të hetimeve të saj të trajtohen me fshehtësi të mjaftueshme. Procedura të tilla mund të bëjnë që anëtarët e stafit të kenë qasje në dosje dhe dokumente përtej një niveli të caktuar fshehtësie. Ato mund të jenë gjithashtu të tilla që personeli i IAP-së mund t'i shqyrtojë dokumente të tilla vetëm në mjediset e autoriteteve përkatëse.

86. Gjithashtu vetëkuptohet se IAP-ja nuk duhet të ketë të drejtë të bëjë të njohur asnjë informacion për opinionet e saj, etj. Në Nenin 16.1.10, ka një dispozitë për detyrën e konfidencialitetit të Avokatit të Popullit, zëvendësve dhe stafit të tij. Në këtë dispozitë, duhet të shtohet se IAP-ja duhet t'u kushtojë vëmendje çështjeve të konfidencialitetit në bërjen e ditur të opinioneve të saj para publikut.

(i) Raportimi dhe dëgjimi i raportit të Avokatit të Popullit në Kuvend

87. Ligji aktual rregullon çështjet që kanë të bëjnë me paraqitjen dhe dëgjimin e raportit vjetor të Avokatit të Popullit. Kështu, Neni 27.2 parashikon që Avokati i Popullit duhet t'i paraqesë Kuvendit raportin për vitin e kaluar jo më vonë se 31 mars të vitit të ardhshëm. Në praktikë, Kuvendi mund ta shtyjë në mënyrë të paarsyeshme dëgjimin e Avokatit të Popullit. Sipas fjalëve të bashkëbiseduesve të shumtë, të intervistuar nga grupi i punës i Projektit me ekspertë ndërkombëtarë dhe vendas, që përgjigjen për hartimin e propozimit të reformës institucionale, kjo ka qenë praktika e Kuvendit në një numër rastesh. Kjo gjë ndikon negativisht në punën e IAP-së, e mban atë në gjendje pasigurie dhe ia ul rëndësinë raportit që mbulon vitin e kaluar.
88. Kjo çështje nuk trajtohet nga Projektligji amendues. Megjithatë, ligji aktual duhet të amendohet për t'i vendosur Kuvendit një afat të qartë për t'i lejuar Avokatit të Popullit të paraqesë raportin në seancë plenare. Duhet të parashikohet që Avokati i Popullit duhet të paraqesë raportin vjetor në Kuvend gjatë seancës së pranverës.
89. Ligji aktual nuk thotë gjë për përmbajtjen e përgjithshme të raportit vjetor të Avokatit të Popullit. Futja e një standardi të tillë do të vendoste kërkesa të përgjithshme për çdo Avokat i Popullit gjatë punës për hartimin e raportit vjetor. Sipas praktikave të mira, raporti i Avokatit të Popullit duhet të përfshijë informacion për këto organe dhe zyrtarët që janë gjetur se kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut dhe që nuk kanë vepruar sipas rekomandimeve të Avokatit të Popullit në lidhje me masat që duheshin marrë për t'i rregulluar këto çështje.
90. Raporti duhet gjithashtu të bëjë një vlerësim të përgjithshëm të gjendjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë, si dhe një përmbledhje të konstatimeve dhe rekomandimeve, me synimin për të adresuar problemet e identifikuara.

(j) Pavarësia financiare e IAP-së dhe në gjetjen e fondeve

91. Neni 34 i ligjit aktual merret me financimin e IAP-së. Miratimi i buxhetit ngre një numër shqetësimesh që lidhen me pavarësinë e IAP-së. Mënyra se si është formuluar tani, ligji aktual nuk parashikon një sistem kontrollesh dhe drejtpeshimesh të aftë të sigurojë që miratimi i buxhetit të mos përdoret si një mënyrë për t'i bërë presion institucionit. Duke marrë parasysh përpjekjet e kaluara të Qeverisë për të reduktuar buxhetin e IAP-së dhe efektet negative të atij procesi në efektivitetin dhe funksionimin e institucionit, duhen futur disa mbrojtje ligjore në ligj për të kufizuar që pushteti i ekzekutivit të ndikojë negativisht në pavarësinë financiare të IAP-së.
92. Ligji aktual duhet pra të parashikojë që buxheti i IAP-së të mos jetë më i vogël sesa ai që ishte miratuar vitin e kaluar. Duhet të ketë një parashikim që buxheti i IAP-së të mund të pakësohet vetëm me miratimin e Avokatit të Popullit.
93. Ligji aktual duhet të amendohet për të parashikuar që IAP-ja të marrë financimin e nevojshëm për zbatimin e kompetencave të tij të përfuara rishtazi. Më konkretisht, IAP-së duhet t'i jepen burime financiare shtesë për të mbuluar kostot e shtuara operative dhe kostot e burimeve njerëzore të gjeneruara nga përgjegjësitë e shtuara dhe detyrat e mishëruara në Projektligjin për Diskriminimin dhe për Barazinë Gjinore, pasi ato të jenë miratuar. Dhe vetëkuptohet që edhe funksionet e MMK -së po ashtu do të përftojnë fonde shtesë mbi ato të parashikuara. Një dispozitë e re duhet pra të shtohet në Nenin 34, ku të thuhet se IAP-së duhet t'i jepen burime shtesë financiare për të plotësuar kompetencat që i shtohen mandatit të tij.

94. Një tjetër çështje e rëndësishme e lidhur drejtpërdrejt me efektivitetin dhe cilësinë e punës të bërë nga IAP-ja lidhet me pagat e Avokatit të Popullit, zëvendësve dhe stafit të vet. Mospërputhja e pagës së Avokatit të Popullit me atë të zyrtarëve të lartë publikë, e parashikuar për nëpunësit e tjerë civilë, dhe përjashtimi arbitrar i stafit të IAP-së nga rritja e pagave e parashikuar për nëpunësit e tjerë civilë janë konsideruar si pengesat kryesore në ndjekjen e misionit nga ana e IAP-së si “Avokat i Popullit”.
95. Neni 9 i Projektligjit amendues propozon rregullimin e çështjes që lidhet me pagën e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të vet, në një mënyrë që rekomandohet nga vetë ai, ajo, edhe pse çështja e pagave të stafit mbetet e pazgjidhur. Pra, Projektligji amendues nuk parashikon një zgjidhje tërësore të problemin që është vënë në dukje.
96. Kështu, Neni 32 i ligjit aktual duhet të amendohet me qëllim që të parashikojë që niveli i pagës së Avokatit të Popullit të jetë i njëjtë me atë të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese dhe që pagat e zëvendësve të vet të jenë të barabarta me ato të gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese. Pagat e stafit hetues në IAP duhet të jenë fikse, të barabarta me ato të këshilltarëve të Gjykatës Kushtetuese.

5. KOMENTE PËR DISPOZITA TË VEÇANTA TË LIGJIT

97. Ka një numër fushash teknike në ligjin aktual të cilat kërkojnë ndryshime dhe amendamente të mëtejshme për ta bërë ligjin aktual të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat e mira. Ndryshimet e propozuara duhet t’i japin mundësi IAP-së të funksionojnë më me efikasitet dhe të prodhojnë punë me cilësi më të mirë.

Neni 3

98. Paragrafi 1 i kësaj dispozite thotë se IAP-ja është një institut i pavarur që drejtohet nga “parimet e paanësisë, konfidencialitetit dhe profesionalizmit”. Megjithatë, duke marrë parasysh qëllimin themelor të institucionit, “përparësia e të drejtave të njeriut” duhet të shtohet në listën e parimeve që drejtojnë aktivitetin e tij.
99. Parimi i pavarësisë së Avokatit të Popullit është themelor. Duke pasur këtë parasysh, sugjerohet që të futet një dispozitë me qëllim që ndikimi i parregullt (apo përpjekje për një ndikim të tillë) ndaj IAP-së në ushtrimin e detyrave të tij të jetë vepër penale. Autorët ua lënë autoriteteve të Kosovës që të vendosin nëse një dispozitë e tillë duhet teknikisht të futet në Ligjin për Avokatin e Popullit apo në Kodin Penal.

Neni 6

100. Kushtet e kësaj dispozite që rregullojnë zgjedhjen e Avokatit të Popullit duken të arsyeshme dhe proporcionale. Megjithatë, nuk është e sigurt nëse një dënim për një vepër penale duhet që në të gjitha rrethanat të përjashtojë një person nga kualifikimi si Avokat i Popullit. Si rrjedhojë, sugjerohet që Neni 6.1.5 të hiqet, me qëllim që të jetë Kuvendi ai që do të ketë të drejtë të vendosë nëse një vepër penale duhet ta diskualifikojë një kandidat. Gjithsesi, është me rëndësi të vihet në dukje se kandidati duhet të ketë “karakter, ndershmëri dhe moral të lartë”²⁴⁸ dhe se një kërkesë e tillë padyshim do të bëjë të mundshme që veprat penale të merren parasysh.

101. Amendamenti i sugjeruar po ashtu duket se është më në harmoni me Nenin 134.2 të Kushtetutës.

Neni 7

102. Sipas paragrafit 3 të kësaj dispozite, Avokati i Popullit dhe zëvendësit e vet nuk mund të ushtrojnë asnjë detyrë me pagesë, me përjashtim të “dhënies mësim në institucionet e arsimit të lartë”.

103. Kjo mund të ishte problem në situata të caktuara, për shembull, në rast se

²⁴⁸ *Krahaso: Neni 6.1.3.*

Avokati i Popullit do të marrë përgjegjësi për postin e vet, të tillë si anëtarësia në Komisionin e Faljeve, etj. Problemi mund të zgjidhet duke futur në ligj se kuvendi mund ta lejojë Avokatin e Popullit të ketë edhe poste të tjera. Një mekanizëm i tillë njihet në shumë vende europiane.

Neni 13

104. Dorëheqja apo largimi nga puna duhet të shtohet në rrethanat e parashikuara në paragrafin 2 kur Avokati i Popullit duhet të zëvendësohet nga njëri nga zëvendësit e tij. Kjo dispozitë duhet që, për shkak të kufizimit të sugjeruar të numrit të zëvendësve, t'i referohet gjithashtu edhe “zëvendësit apo zëvendësve apo anëtarëve të tjerë të lartë të stafit”.
105. Neni 13.3 duhet të amendohet për t'iu referuar vetëm Avokatit të Popullit dhe jo zëvendësve të tij, në përputhje me rekomandimin e bërë ndërkohë që ata të caktohen nga Avokati i Popullit dhe kështu nuk do të zgjidhen me një “mandat”.

Neni 15

106. Sipas paragrafit 2, IAP-ja mund të ofrojë shërbime të mira për “qytetarët e Republikës së Kosovës që përkohësisht jetojnë jashtë territorit të Republikës së Kosovës”. Megjithatë, sipas Nenit 17, “çdo person” mund të ankohet në IAP, kështu që parimi duket se është – dhe duhet të jetë - që çdo person, pavarësisht nga shtetësia, mund t'i drejtohet IAP-së. Për më tej, zakonisht nuk është kusht që, për t'u ankuar te Avokati i Popullit, pala ankuese duhet të jetojë në territorin e vendit në fjalë. Gjithashtu, në praktikë, duhet se ka një numër situatash të mundshme ku individët që jetojnë në mënyrë permanente jashtë territorit të Kosovës (qofshin apo jo shtetas kosovarë) duhet t'i drejtohen IAP-së, për shembull për çështje të tatimeve.
107. Duke pasur parasysh këtë, rekomandohet se Neni 15.2 të amendohet për të autorizuar ofrimin e shërbimeve të mira edhe për “personat që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Kosovës”.
108. Paragrafi 4 trajton nevojën për miratim në raste të caktuara, konkretisht, kur IAP-ja fillon një procedurë me iniciativë të vet, apo kur dikush tjetër nga personi i dëmtuar e bën ankesën. Megjithatë, duhet shtuar te kjo dispozitë se, kur personi i dëmtuar ka vdekur apo ndryshe është i paaftë të japë miratimin e vet, duhet të kërkohet një person ndër të afërmit e ngushtë të vet, por, kur të afërm të tillë nuk ekzistojnë apo nuk mund të arrihen, pëlqimi nuk është i nevojshëm.

Neni 16

109. Nga teksti në anglisht i Nenit 5 të Projektligjit amendues nuk është e qartë se po bëhet ndonjë ndryshim në tekstin e Nenit 16.1.8, kështu që zbatimi i tij nuk duket i nevojshëm.
110. Në vijim të rekomandimit të bërë më parë në lidhje me kompetencat e MMK-së, dispozitat shtesë më poshtë duhet të futen në Nenin 16:
- 16.7.2: “Institucioni i Avokatit të Popullit duhet të ndërmarrë vizita të rregullta në vendet e privimit të lirisë”;
 - 16.7.3: “Një degë e specializuar duhet të ngrihet në Institucionin e Avokatit të Popullit që të ketë për detyrë të kryejë funksionet e Mekanizmit Parandalues Kombëtar. Staf i kësaj dege do të përmbajë një numër profesionistësh, duke përfshirë mjekë me përvojë dhe ekspertizë”.
 - 16.7.4: “Specialistët dhe ekspertët e kontraktuar nga Avokati i Popullit në lidhje me funksionet e tij si Mekanizmi Kombëtar i Parandalimit do të ketë të njëjtat të drejta dhe detyra si dhe përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, duke përfshirë të drejtën për të vizituar

- vendet e privimit të lirisë dhe të drejtën për të marrë fotografi dhe bërë regjistrime me zë dhe figurë, për të
- gëzuar mbrojtje nga ndërhyrjet në aktivitetet e tyre, si dhe të drejtën për të dhënë dëshmi apo shpjegime për faktet që u bëhen të ditura në procesin e ushtrimit të funksioneve të tyre’;
 - 16.7.5: “Gjatë ushtrimit të funksioneve të Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit, Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e vet kanë të drejtë të kenë qasje në informacion në lidhje me gjendjen shëndetësore të çdo personi që mbahet i ndaluar në vendet e privimit të lirisë, duke përfshirë qasje në të dhënat përkatëse mjekësore, si dhe me pëlqimin e personit, ata duhet të kenë të drejtë të kenë qasje në të dhënat personale të vet”;
 - 16.7.6: “Avokati i Popullit mund të bëjë rekomandime për t’i bërë ligjet, projektligjet dhe rregulloret administrative, udhëzimet dhe praktikrat e Kosovës të jenë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe standardet ndërkombëtare në lidhje me parandalimin e torturës dhe trajtimeve dhe ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore apo poshtëruese”;
 - 16.7.7: “Avokati i Popullit duhet të çojë përpara bashkëpunimin me organe ndërkombëtare, rajonale dhe organe të tjera kombëtare që përgjigjen për parandalimin e torturës dhe trajtimeve dhe ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore apo poshtëruese “;
 - 16.7.8: “Avokati i Popullit mund t’u paraqesë vëzhgime dhe t’u bëjë rekomandime atyre që janë përgjegjës për personat e privuar nga liria në të gjitha llojet e objekteve dhe rrethanave për mënyrën e përmirësimit të trajtimit dhe kushteve të këtyre të fundit”.

Neni 19

111. Në përputhje me paragrafin 1, IAP-ja ka 30 ditë për të vendosur për pranueshmërinë e një rasti (ankese). IAP-ja duhet të japë shembullin për efikasitet dhe të ofrojë shërbime për palën ankuese në mënyrën dhe kohën e duhur. Duhet marrë parasysh se shumica e palëve ankuese në kohën që i drejtohen IAP-së janë të zemëruar për shkak të vonësës së shërbimeve nga organet e tjera. Ata presin që ankesat e tyre të trajtohen në kohën e dhe mënyrën e duhur nga IAP-ja. Me qëllim për të mos i mbajtur palët ankuese në gjendje pasigurie për një periudhë kohore të paarsyeshme, kjo dispozitë duhet pra të amendohet me qëllim për të ofruar një afat kohor prej maksimumi 10 ditë pune që IAP-ja të marrë vendim për pranueshmërinë ose jo të një ankese.
112. Megjithëse, paragrafi 1.3.3. i Nenit 19 të Ligjit aktual autorizon Avokatin e Popullit që të mos pranojë kërkesa anonime, kjo dispozitë nuk duhet të shihet sikur e pengon atë të shqyrtojë rastin për shkak të detyrës (*ex-officio*).
113. Neni 19 po ashtu rregullon procedurën pas marrjes së ankesës. Ai përcakton kriteret e pranueshmërinë së ankesave. Në praktikë, Avokatit të Popullit mund t’i drejtohesh me anë të një ankese që është shqyrtuar ndërkohë. Kjo mund të ndodhë sidomos pasi është zgjedhur një Avokat i Popullit i ri, dhe kur ka palë ankuese të pakënaqur me reagimin e paraardhësit të vet ndaj të njëjtës çështje.
114. Për këtë arsye, kësaj dispozite i duhet shtuar një paragraf që e autorizon Avokatin e Popullit të hedhë poshtë një ankesë, e cila ndërkohë është shqyrtuar dhe hedhur poshtë, me përjashtim të rasteve kur paraqiten prova të reja faktike në lidhje me ankesën.

Neni 20

115. Kjo dispozitë rendit kushtet për hedhjen poshtë të një ankese dhe paragrafi 1.3 parashikon që Avokati i Popullit mund të refuzojë të shqyrtojë një rast kur procedurat për atë rast ndodhen në organe të tjera kompetente gjyqësore apo organe të tjera për shqyrtim, “me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë Ligj”. Ky kufizim në lidhje me autoritetet gjyqësore është i pranueshëm dhe duhet të mbetet në ligjin aktual, por pjesa e këtij nën-paragrafi ku përmenden “autoritete të tjera kompetente”

është disi e paqartë dhe duhet të hiqet.

116. Në rast të një refuzimi, palët ankuese duhet që gjithnjë t'i jepet një arsyetim i qartë dhe shkaqet për një veprim të tillë dhe për këtë duhet të futet një paragraf në Nenin 20.

Neni 21

117. Kjo dispozitë parashikon që Avokati i Popullit nuk duhet të nisë procedura për hetimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut, në rast se paraqitet një ankesë në IAP-së pas më shumë se gjashtë muajve nga data kur një palë ka marrë vendimin e formës së prerë, apo është njoftuar për të.
118. Ky kufizim mund t'i lërë shumë raste jashtë shqyrtimit të IAP-së. Për më tej, duke marrë në konsideratë ngarkesën e punës aktualisht në IAP, nevoja për një kufizim të tillë nuk është aspak e justifikuar.
119. Duhet të theksohet se nuk ndodh shpesh që institucioneve të Avokatit të Popullit t'u vihen kufizime të tilla, prandaj ai rekomandoi që periodha 6-mujore të zgjatet deri në 3 vjet, afat që u sugjerua si i përshtatshëm.

Neni 22

120. Paragrafi 1 trajton procedurën pas nisjes së hetimit. Sipas kësaj dispozite, Avokati i Popullit ka për detyrë t'i komunikojë vendimin për nisjen e një hetimi autorit të ankesës dhe organit ndaj të cilit është bërë ankesa. Kjo dispozitë mund të krijojë një risk që organet përkatëse të orvaten ta pengojnë hetimin e IAP-së pas marrjes së njoftimit të ankesës së bërë ndaj tyre. Si rrjedhojë, koha e një njoftimi të tillë duhet t'i lihet në dorë IAP-së ta vendosë dhe nuk i duhet imponuar si një detyrim i menjëhershëm këtij institucioni.
121. Paragrafi 2 parashikon një numër ditësh për t'u përdorur nga IAP-ja në përcaktimin e periudhës kohore kur një organ përkatës duhet t'i paraqesë atij të gjithë informacionin e kërkuar në përputhje me paragrafin 1. Megjithatë, një qasje e njëjtë ndaj të gjithë institucioneve përkatëse do ta minimizonte riskun e vonësive në përgjigjet e tyre nda IAP-së duke bërë të mundshme si rrjedhojë që IAP-ja të kryejë të gjitha detyrat e saj në kohë dhe më me efikasitet.
122. Prandaj rekomandohet që kjo dispozitë të amendohet me qëllim për të vendosur një afat kohor prej 10 ditë pune për të gjitha organet me të cilat IAP-ja ka punë.

Neni 26

123. Kjo dispozitë trajton përgjigjet ndaj kërkesave të IAP-së. Ky nen duhet të riformulohet me qëllim që të përfshijë shprehimisht kërkesat/rekomandimet e IAP-së për autoritetet e akuzës, për nisjen e hetimeve penale në raste krimesh të pretenduara të gjetura nga IAP-ja në përputhje me Nenin e amenduar 15 të ligjit aktual.

Neni 28

124. Kjo dispozitë autorizon Avokatin e Popullit të botojë raporte të posaçme në media. Ky mund të jetë një instrument i mirë për të publikuar punën e bërë nga IAP-ja. Megjithatë, raportet e posaçme që trajtojnë probleme të caktuara të të drejtave të njeriut duhet njëkohësisht të përdoren për të shkaktuar debate në Kuvend dhe për të promovuar llogaridhënien nga ana e autoriteteve. IAP-ja duhet për këtë arsye të autorizohet t'ia dërgojë raportet e saj të veçanta të gjitha organeve përkatëse, përfshirë Kuvendin, dhe autoriteteve përkatëse shtetërore. Neni 28 duhet të amendohet përkatësisht.

Neni 29

125. Neni 7 i Projektligjit amendues propozon riformulimin e paragrafit 2 ekzistues të kësaj dispozite, si dhe futjen e një paragrafi të ri në të. I pari sqaron se, në përgjithësi, është Qeveria ajo që është përgjegjëse për ofrimin IAP-së të zyrave dhe pajisjeve të nevojshme për kryerjen e funksioneve të saj. Ky riformulim i paragrafit 2 është me vend. Paragrafi i ri flet për dhënien e zyrave rajonale dhe të mjeteve të duhura për punë pranë komunave. Padyshim që është me vend që t'u kërkohet komunave të ofrojnë hapësirën e punës për zyrat rajonale të IAP-së, por këto nuk duhet që patjetër të jenë të vendosura, sikundër propozon paragrafi i ri, në vetë ndërtesën e komunës. Në këtë drejtim, duhet kujtuar se IAP-ja në një numër rastesh i është nënshtruar kërcënimeve për largim nga Komunitatet e Gjilanit dhe Mitrovicës. Pra, me qëllim për të forcuar pavarësinë e IAP-së dhe për të siguruar kushte pune të përshtatshme, pronësia e zyrave që i ofrohen IAP-së, si në Prishtinë ashtu edhe në rrethe, duhet t'i transferohet asaj. Neni 29 duhet të amendohet përkatësisht.

Neni 30

126. Sipas kësaj dispozite, IAP-ja mund të zgjedhë personelin e vet vetëm nga qytetarët e Kosovës. Megjithatë, në praktikë, asaj mund t'i duhet të punësojë ekspertë dhe këshilltarë të huaj për ndihmë në aktivitete të ndryshme. Kjo dispozitë duhet pra të amendohet për t'i dhënë mundësi IAP-së të kontraktojë edhe qytetarë të huaj. Sidoqoftë, ata nuk duhen konsideruar si nëpunës civilë të Kosovës.

12. Për më tej, ky nen duhet të amendohet për ta kërkuar parimin e diversitetit që të respektohet jo vetëm në caktimin e personelit të IAP në përgjithësi por edhe edhe ndërmjet Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të vet.

Neni 31

127. Sipas paragrafit 1, IAP-ja duhet të nxjerrë rregullat e procedurës së saj. Megjithatë, autoriteti për të miratuar dhe nxjerrë rregulla të tilla duhet t'i jepet vetëm Avokatit të Popullit.

6. PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE

128. Ndryshimet e mëposhtme duhen bërë në Ligjin aktual (ose me anë të amendimit të Projektligjit amendues ose ndryshe):

1. Teksti duhet të amendohet për të siguruar që gjuha të jetë e ndjeshme ndaj gjinisë (para. 27);
2. Neni 1 duhet t'i përcaktojë qartë institucionet e mbuluara nga kompetencat e IAP-së dhe ky përkufizim duhet të pasqyrohet gjithashtu në Nenet 22, 23.1, 24, 25 dhe 26 (para. 29, 30, 31, 32, 36, 38);
3. Neni 1 duhet të kufizojë kompetencat e IAP-së për t'u marrë me gjykatat në raste të vonuara në mënyrë të paarsyeshme dhe pastaj të bëjë vetëm rekomandime të përgjithshme (para. 32);
4. Neni 1 duhet t'i referohesh shprehimisht kompetencave që do t'i jepen nga Projektligji për diskriminimin dhe Projektligji për barazinë gjinore (para. 36);
5. Parimet e renditura në Nenin 3 duhet të përfshijnë edhe "përparësinë e të drejtave të njeriut" (para. 98);
6. Neni 3 duhet të përfshijë një dispozitë e cila ta bëjë ndikimin e parregullt (ose orvatjet për një ndikim të tillë) ndaj ushtrimit të detyrave të veta nga IAP-ja një vepër penale (para. 99);
7. Neni 5.1.2 duhet të parashikojë një ose më shumë zëvendës të cilët caktohen nga Avoka-

-
- ti i Popullit (para. 49);
8. Neni 6 duhet të trajtojë vetëm zgjedhjen e Avokatit të Popullit (para. 46);
 9. Neni 6.1.5 duhet të hiqet (para. 100);
 10. Neni 7.3 duhet gjithashtu të autorizojë Kuvendin të lejojë Avokatin e Popullit të ketë edhe detyra të tjera që përputhen me këtë detyrë (para. 103);
 11. Neni 8.1 duhet të thotë se procedurat e zgjedhjes mund të fillojnë edhe në kohën e dorëheqjes, vdekjes apo largimit nga puna të Avokatit të Popullit (para. 41);
 12. Përmendja e “zëvendësve” në Nenet 8.2 dhe 8.14 duhet të hiqet (para. 41 dhe 49);
 13. Neni 8.6 duhet të lejojë vetëm refuzimin e kërkuesve që nuk i plotësojnë kushtet e deklaruara objektivisht (para. 41);
 14. Neni 8.9 duhet të autorizojë Kuvendin të shqyrtojë kërkues që nuk janë në listën e përgatitur nga Komisioni (para. 41);
 15. Neni 8.11-13 duhet të hiqet (para. 49);
 16. Neni 9.2 duhet të amendohet për të thënë që Avokati i Popullit duhet të zgjidhet brenda 60 ditësh (para. 41);
 17. Neni 9.3-5 duhet të hiqet (para. 41 dhe 49);
 18. Imuniteti në Nenin 11 duhet të zgjerohet për të përfshirë edhe stafin e IAP-së dhe të vazhdojë edhe pas përfundimit të mandatit të Avokatit të Popullit dhe punësimit të stafit (para. 54 dhe 58);
 19. Referenca ndaj “sjelljes personale” duhet të hiqet nga arsyet për largim nga puna në Nenin 12 (para. 64);
 20. Neni 12 duhet të parashikojë procedura të mjaftueshme për të përcaktuar largimin nga puna të Avokatit të Popullit (para. 65-68);
 21. Neni 13.2 duhet të përfshijë gjithashtu edhe dorëheqjen dhe largimin nga puna, në rrethanat që lejojnë zëvendësimin e Avokatit të Popullit dhe të parashikojë zëvendësimin e tij nga “zëvendësi apo zëvendësit, apo nga anëtarë të tjerë të lartë të stafit” (para. 104);
 22. Neni 13.3 duhet t’i referohet vetëm Avokatit të Popullit dhe jo zëvendësve të tij (para. 105);
 23. Neni 14.1 duhet të amendohet me qëllim që punëdhënësi i mëparshëm duhet t’i ofrojë një detyrë të paktën në të njëjtin nivel, duke përfshirë edhe kushtet financiare, si në kohën që Avokati i Popullit është larguar nga ai post (para. 70-72);
 24. Neni 15 duhet t’i japë IAP-së kompetenca të qarta për t’ju drejtuar organeve hetimore dhe të akuzës drejtpërdrejt me një kërkesë për të nisur hetime penale (para. 74);
 25. Neni 15.2 duhet të autorizojë ofrimin e shërbimeve të mira “personave që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Kosovës” (para. 106-107);
 26. Neni 15.4 duhet gjithashtu të parashikojë që pëlqimi nuk është i nevojshëm kur personi i dëmtuar ka vdekur apo ndryshe është i paafët të japë pëlqimin, pëlqimi duhet kërkuar nga të afërmit e tij të ngushtë dhe se, në rast se të afërm të tillë nuk ekzistojnë ose nuk mund të gjenden, pëlqimi nuk është i nevojshëm (para. 108);
 27. Neni 15.6 duhet të hiqet (para. 33-34);
 28. Neni 16.6 duhet t’i japë IAP-së, në ushtrimin e kompetencave të MMK-së, qasje në dosjet mjekësore të personave të privuar nga liria dhe të parashikojë që fshehtësia nuk mund të përdoret si një arsye për të mos dhënë ndonjë dosje apo dokument (para. 84);
 29. Neni 16.7 duhet të parashikojë që IAP-ja ushtron funksionin e MMK-së dhe teksti ekzistues me ndryshimet e sugjeruara duhet të bëhet Neni 16.7.1 (para. 76-79 dhe 110);
 30. Neni 16.1.10 duhet gjithashtu të kërkojë që IAP-ja t’i kushtojë vëmendje çështjeve të fshehtësisë në bërjen publike të vendimeve të tij, etj. (para. 86);
 31. Neni 19.1 duhet të parashikojë që procedura e pranimit të trajtohet brenda 10 ditësh (para. 111);
 32. Mospranimi i një ankese sipas Nenit 19.1.1.3 për shkaqe anonimiteti nuk duhet parë si diçka që e pengon Avokatin e Popullit nga trajtimi i saj *ex-officio* (para. 112);
 33. Neni 19 duhet të autorizojë Avokatin e Popullit që të mos pranojë ankesa të shqyrtuara më parë dhe të hedhura poshtë (para. 114);
 34. Referenca në Nenin 20 ndaj “organeve të tjera kompetente” duhet hequr (para. 115);

35. Neni 20 duhet të fusë edhe një detyrim për t'u dhënë palëve ankuese shkaqe të qarta për çdo mospranim të ankesave të tyre (para. 116);
36. Referenca ndaj "6 muajve" në Nenin 21 duhet të zëvendësohet nga një periudhë më e gjatë, ku periudha 3-vjeçare është sugjeruar si e përshtatshme (para. 118-119);
37. Neni 22.1 duhet të parashikojë se koha e njoftimit të organit ndaj të cilit është nisur një hetim duhet të lihet në gjykimin e IAP-së (para. 120);
38. Neni 22.2 duhet të parashikojë vetëm një afat prej 10 ditësh pune për paraqitjen e informacionit në IAP (para. 121-122);
39. Neni 26 duhet të përcaktojë që rekomandimet/kërkesat të përfshijnë ato që u janë bërë autoriteteve të akuzës (para. 123);
40. Neni 27 duhet të përcaktojë një afat kohor brenda të cilit Kuvendi duhet të dëgjojë Avokatin e Popullit në lidhje me kërkesat e përgjithshme të vet për të (para. 90-91);
41. Neni 28 duhet ta autorizojë IAP-në t'ua paraqitë raportet e saj të veçanta të gjithë organeve përkatëse, përfshirë Kuvendin (para. 124);
42. Neni 29 duhet të garantojë që IAP-së t'i jepet hapësirë e përshtatshme pune dhe që pronësia e ndërtesës në fjalë, si në Prishtinë, ashtu edhe rrethe, t'i transferohet asaj (para. 125);
43. Neni 30 duhet të përfshijë parimin e diversitetit që aktualisht gjendet në Nenin 8.13, në veçanti ndërmjet Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të vet, të ofrojë kritere për largimin e zëvendësve nga puna dhe t'i lejojë IAP-së të kontraktojë qytetarë të huaj (para. 47. 68. 126 dhe 127);
44. Neni 31.2 duhet të parashikojë që Avokati i Popullit (jo IAP-ja) të nxjerrë rregulloren e procedurave (para. 128);
45. Neni 32 duhet të parashikojë që shkalla e pagës së Avokatit të Popullit të jetë e barabartë me pagën e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, dhe pagat e Zëvendësve të Avokatit të Popullit të jenë të barabarta me ato të Gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese dhe pagat e hetuesve të IAP-së duhet të jenë fikse në shkallën e atyre të këshilltarëve të Gjykatës Kushtetuese (para. 96);
46. Neni 34 duhet të parashikojë që buxheti i IAP-së nuk duhet të jetë më i vogël se buxheti i miratuar për vitin e mëparshëm dhe që buxheti mund të shkurtohet vetëm me miratimin e Avokatit të Popullit (para. 92);
47. Neni 34 duhet të parashikojë gjithashtu se IAP-së i duhen dhënë burimet e nevojshme shtesë që kërkohen për të plotësuar mandatin e tij si MKP dhe sipas Projektligjeve për Diskriminimin dhe Barazinë Gjinore (para. 93); dhe
48. Duhet të shtohet një dispozitë transitorë për ta shtyrë për një vit fillimin e funksioneve të IAP-së si MPK, që nga hyrja në fuqi e versionit të amenduar të ligjit ekzistues (para. 76).

7. KONKLUZIONE

129. Pavarësisht se ligji aktual parashikon një bazë ligjore të konsiderueshme për funksionimin efikas të një institucioni të të drejtave të njeriut, ai kërkon amendime të mëtejshme me synimin për ta bërë kornizën ligjore të IAP-së që të jetë më pranë standardeve dhe praktikave më të mira që ekzistojnë në shtetet anëtare të Këshillit të Europës.
130. Rekomandimet e këtij opinion, të hartuara si rrjedhojë e një analize të gjerë të ligjit aktual dhe vlerësimit të sfidave me të cilat përballet IAP-ja në praktikë, nuk janë thjesht me natyrë teknike, por kërkojnë një numër ndryshimesh substantivë. Zbatimi i amendamenteve të propozuara do të kontribuonte në zgjerimin e mandatit të Avokatit të Popullit dhe rritjen e gamës së kompetencave të vet, me synimin për të vendosur një mekanizëm të fortë të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në vend.
131. Për më tej, duke marrë parasysh kompetencat dhe përgjegjësitë shtesë që i jepen IAP-së nga Projektligji për diskriminimin dhe Projektligji për barazinë gjinore, nevoja për forcim të mëtejshëm të institucioneve duket se është me rëndësi parësore. Amendamentet e propozuara duhet t'i japin mundësi IAP-së të merret realisht dhe me efikasitet me sfidat e reja që përmbajnë këto projektligje.
132. Prandaj, zbatimi i rekomandimeve të propozuara në këtë opinion do ta përmirësonin më tej kornizën ligjore për IAP-në, do të siguronin përputhshmërinë e ligjit aktual me standardet europiane, do të forconin aftësitë institucionale dhe funksionale, do të zhvillonin mbrojtje më të mira për pavarësinë e institucionit dhe do rrisnin rolin e tij në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Kosovë.
133. Autorët i kanë parë opinionet për Projektligjin për diskriminimin dhe Projektligjin për barazinë gjinore dhe i kanë miratuar konkluzionet dhe rekomandimet që ata përmbajnë.

OPINION PËR PROJEKTLIGJIN MBI BARAZINË GJINORE

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

Ky opinion vlerëson Projektligjin për Barazinë Gjinore përkundrejt standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut si dhe praktikave të mira. Ai diskuton gjithashtu efikasitetin e tij në rregullimin e organizimit institucional në kontekstin e kornizave ekzistuese legjislative dhe institucionale në fushën e të drejtave të njeriut, me synim për të siguruar që ky Projektligj, Ligji për Avokatin e Popullit dhe Projektligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi të jenë të harmonizuar në thelb dhe në organet/strukturat monitoruese që ata vendosin. Ndërsa Projektligji përpiqet të adresojë mungesat e identifikuara në ligjin aktual dhe, në pjesën më të madhe, pasqyron si duhet standardet europiane, megjithatë, ai ka nevojë për disa thjeshtime, si dhe një shpërndarje më të qartë të përgjegjësisë midis organeve publike dhe mekanizmave institucionalë të barazisë gjinore, kryesisht për përfshirjen e këndvështrimit gjinor dhe buxhetimin gjinor. Rekomandohet që nëpunësit ekzistues të barazisë gjinore të caktohen në pozita politike ose brenda njësisë qendrore të bashkërendimit të politikave apo në departamentet kyçe por që Agjencia për Barazinë Gjinore të mbahet në formën dhe pozitën që ka aktualisht. Ky opinion rekomandon më tej që të zgjerohen disa prej neneve për ta bërë Projektligjin pikë referimi për të gjitha çështjet e lidhura me gjininë. Ai rekomandon që dispozitat për mjetet rregulluese ekzistuese, duke përfshirë mbrojtjen ligjore, sanksionet dhe kompensimin, të ndjekin Projektligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por përmenden në projektligj për qartësi. Së fundi, me qëllim për të adresuar sfidat në zbatimin e Projektligjit, ky opinion bën thirrje për mbështetje të hapur politike në të gjitha nivelet, për përfshirjen e këndvështrimit gjinor në politikëbërje, shtimin e kapaciteteve të institucioneve për përdorimin e instrumenteve të përfshirjes së këndvështrimit gjinor, ngritjen e vetëdijesimit dhe përdorimin e qartë të të gjitha mjeteve që mund të përdoren.

1. HYRJE

1. Ky opinion vlerëson projektligjin për Barazinë Gjinore (“Projektligji”) përkundrejt standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut si dhe të praktikave të mira; dhe diskuton efikasitetin e tij në rregullimin e organizimit institucional në kuadër të kornizave ekzistuese legislative dhe institucionale në fushën e të drejtave të njeriut në Kosovë.
2. Opinioni është përgatitur nga Jelena Besedic²⁴⁹ në kuadër të Projektit të Përbashkët midis Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës “Shtimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë” (“Projekt”), si pjesë e një vlerësimi më të gjerë, që ka për qëllim të vërë në dukje pikat e forta dhe të dobëta të masave institucionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin ekzekutivi dhe lokal, dhe për të dhënë një mendim legjislativ ekspert për Ligjin Aktual, Projektligjin amendues, Projektligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Projektligjin kundër Diskriminimit) dhe Projektligjin për Barazinë Gjinore, me qëllim që të vendosjen lidhje midis këtyre tre ligjeve dhe organeve/strukturave monitoruese të ngritura në bazë të tyre²⁵⁰.
3. Në vlerësimin e Projektligjit, ky opinion mbështetet kryesisht në Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (“CEDAW”), si një ligj ndërkombëtar për të drejtat e grave dhe si një marrëveshje ndërkombëtare që gjen zbatim të drejtpërdrejtë në Kosovë sipas Nenit 22(6) të Kushtetutës së Kosovës (“Kushtetuta”).
4. Më tej, ai krahason Projektligjin me kërkesat e *acquis* të Bashkimit Europian për barazinë gjinore²⁵¹.
5. Përveç kësaj, ai merr në konsideratë Konventat e tjera përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe Rekomandimet e Këshillit të Evropës²⁵² dhe rekomandimet e Përgjithshme të bëra nga Komiteti i CEDAW-t.
6. Ky opinion së pari do të analizojë mjedisin rrethanor të Ligjit aktual nr. 2004/2 për Barazinë Gjinore në Kosovë (“Ligji aktual”) dhe rrethanat që kanë çuar në propozimin për zëvendësimin e tij. Ai do të japë një përshkrim të përgjithshëm të Ligjit aktual dhe do të bëjë një krahasim midis tij dhe Projektligjit. Opinioni pastaj do të diskutojë Projektligjin nën për nen dhe do të japë rekomandime konkrete për përmirësimin e tij. Një numër temash më të rëndësishme, të tilla si organizimi institucional, do të diskutohen më me hollësi dhe opinioni do të përmbyllet me disa shembuj nga rajoni, për më shumë qartësi. Së fundi, ai do të përmendë shkurtimisht zbatimin e Projektligjit.
7. Komentet për Projektligjin i referohen versionit të marrë në datën 22 korrik 2013 nga Zyra Juridike e Kryeministrit (“ZJKM”). Numri dhe emri i neneve përmenden në komentet për Projektligjin meqenëse janë rinumëruar vazhdimisht pas ndryshimeve të bëra në versionet e mëparshme.

249 Jelena Besedic është konsulente e pavarur me gradë Masters në Ligjin për të drejtat e njeriut dhe me përvojë të madhe në zhvillimet post konflikteve, duke përfshirë edhe për çështje gjinore.

250 Bashkimi Europian i ka bërë thirrje Kosovës, në kuadër të Procesit të Stabilizim dhe Asociimit, të të përmirësojë dhe thjeshtojë numrin e shumtë të organeve që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të sigurojë monitorim dhe zbatim efikas të kornizës ligjore përkatës.

251 Ligji i BE-së për Barazinë Gjinore: Përditësuar më 2010, dhjetor 2010.

252 Këshilli i Europës, Bëjeni barazinë me ligj një realitet në jetë: Përpilimi i rekomandimeve nga Komiteti i Ministrave në fushën e barazisë midis grave dhe burrave, nëntor 2011.

2. METODOLOGJIA

8. Ky opinion bazohet në një shqyrtim nga zyra të dokumenteve përkatës, ligjeve dhe raporteve, duke përfshirë edhe ato të institucioneve të Kosovës, organizatave ndërkombëtare dhe organizatave të shoqërisë civile, një vizitë vlerësuese që përfshiu takime me palë të interesuara, dhe organizimin e një grupi teknik pune për të diskutuar Projektligjin.
9. Autorja u takua me palë të interesuara vendore dhe ndërkombëtare sipas një plani takimesh të përgatitur nga ekipi i Projektit.
10. Grupi teknik i punës, i kryesuar nga autorja, mbajti takime me ekspertë përkatës nga organizata ndërkombëtare në Kosovë të cilët bënë komente të hollësishme për Projektligjin.
11. Ky opinion ka marrë parasysh edhe punën në terren të kryer si pjesë e studimeve për propozimin e reformës institucionale që merret me organet e të drejtave të njeriut në Kosovë.

3. MJEDISI RRETHANOR

12. Kushtetuta jep bazën për Ligjin aktual dhe Projektligjin, duke garantuar barazinë midis burrave dhe grave në Nenin 7.2:

Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.

13. Sikundër është vënë në dukje ndërkohë, Neni 22 i Kushtetutës po ashtu parashikon zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve të renditura në të, duke përfshirë Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (“CEDAW”). Këto marrëveshje dhe instrumente kanë përparësi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.
14. Neni 24 i Kushtetutës ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë dhe parashikon masa të posaçme për të trajtuar pabarazinë.
15. Megjithatë, pabarazitë vazhdojnë ende midis burrave dhe grave në Kosovë, duke bërë të nevojshme një instrument të fortë ligjor për barazinë gjinore. Sipas Entit të Statistikave të Kosovës²⁵³, vetëm 27.3% gra kanë përfunduar shkollën e mesme, krahasuar me 60.6% burra; një përqindje më e lartë grash janë të papuna; një përqindje më e lartë grash nuk dinë shkrim e këndim. Gratë janë gjithashtu të nënpërfaqësuar në pozicione vendimmarrëse në të gjitha nivelet e pushtetit. Për më tej, dhuna ndaj grave mbizotëron. Sipas vrojtimet të vitit 2008²⁵⁴, afërsisht 46% e grave të intervistuar kishin përjetuar dhunë në familje në një moment të jetës së tyre. Kosova është një vend tepër tradicional dhe një shoqëri patriarkale, ku pozita e grave është e lidhur ngushtë me shtëpinë. Tradicionalisht gratë kanë pasur qasje të kufizuar në trashëgimi dhe në pronat e përbashkëta martesore²⁵⁵.
16. Ligji aktual doli për herë të parë në vitin 2004 dhe u shpall me Rregullore të UNMIK-ut 2004/18²⁵⁶. Ai parashikonte ngritjen e Zyrës së Barazisë Gjinore “si një institucion i veçantë i qeverisë”, e cila u transformua në Agjencinë e Barazisë Gjinore nën Kryeministrin e Kosovës

²⁵³ Enti Statistikor i Kosovës, *Gratë dhe burrat në Kosovë, 2011*.

²⁵⁴ *Siguria fillon në shtëpi: Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër Dhunës në familje në Kosovë, nga Nicole Farnsworth dhe Ariana Qosaj-Mustafa, Agjencia për Barazi Gjinore, Kosovë, 2008, f.2.*

²⁵⁵ *Shoqata e Avokatëve Norma, Studime dhe Monitorim i zbatimit të Ligjit të Barazisë Gjinore, 2011.*

²⁵⁶ *Ligji për Barazinë Gjinore.*

në vitin 2007²⁵⁷. Agjencia është njësia qendrore bashkërenduese për çështje gjinore brenda qeverisë²⁵⁸.

17. Pastaj, Zyra këshillimore për qeverisjen e mirë, të drejtat e njeriut, mundësitë e barabarta dhe çështje gjinore ("ZQM")²⁵⁹, e ngritur brenda ZKM-së në vitin 2002 kishte disa kompetenca për çështje të barazisë gjinore si pjesë integrale e të drejtave të njeriut. Ligji aktual parashikon bashkërendimin e aktiviteteve midis Zyrës/Agjencisë për Barazi Gjinore dhe ZQM-së, por kompetencat e të dy zyrave ishin disi të mbivendosura dhe kjo shpuri në mosmarrëveshje dhe mungesë bashkëpunimi të duhur midis tyre.
18. Kosova ka një administratë relativisht të re dhe ka marrë përgjegjësi të plota për ligjëbërje vetëm duke filluar nga viti 2008, sepse deri atëherë, çdo ligj duhej shpallur dhe ndonjëherë amenduar në proces nga Përfaqësuesi i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Aktualisht, burimet e ligjit në Kosovë përfshijnë në mënyrë të paqartë ligje të miratuara nga Kuvendi, ligje të shpallura nga UNMIK-u dhe disa ligje të ish-Jugosllavisë. Autoritetet e Kosovës nuk kishin pronësi ndaj ligjeve të UNMIK-ut dhe disa nga ligjet e shpallura prej këtij të fundit kishin po ashtu numra reference nga procedura e Kuvendit, që ndryshojnë nga numrat e shpallur zyrtarisht të referencave, por që vazhdonin të preferoheshin nga autoritetet e Kosovës. Për shembull, Agjencia e Barazisë Gjinore në uebsajtin e vet i referohet numrave të referencës së Kuvendit për vendimet për ngritjen e Agjencisë, që nuk mund të ndiqen online duke qenë se dokumentet aktuale u shpallën me numra reference krejtësisht të ndryshme nga UNMIK-u.
19. Ka edhe një problem tjetër të përkthimit dhe ripërkthimit. Deri në vitin 2008, versioni zyrtar i ligjeve ishte ai në anglisht. Qysh atëherë, me amendamentet e bëra në to, ligjet janë përkthyer dhe ripërkthyer, kështu që versioni në anglisht u bë i panjohur në disa raste. Ligjet, duke përfshirë edhe projektligjin, shpesh nuk kanë asnjë shënim përmbledhës që të shpjegojë arsyet dhe justifikimet për miratimin apo amendimin e tyre²⁶⁰. Udhëzimet për hartimet e ligjeve kanë nevojë të jenë edhe më përshkruese dhe të hollësishme, sidomos duke marrë parasysh ndikimin e qasjeve të së drejtës anglosaksone dhe civile, në varësi të ekspertit të huaj që është marrë me to.

Projektligji dhe ligji aktual

20. Mjedisi rrethanor për përgatitjen e Projektligjit është disi i paqartë. Sikundër është vënë në dukje ndërkohë, nuk ka një përshkrim paraprak ku të jepen justifikime dhe arsye për zëvendësimin e ligjit aktual dhe, pavarësisht se disa raporte kanë identifikuar të meta në ligjin aktual, si Studimi gjinor i porositur nga SIDA²⁶¹, nuk është e qartë nëse ishin këto raporte ato që vunë në lëvizje procesin e amendimit. Bashkimi Europian ("BE") vlerësoi kornizën ligjore për mbrojtjen e të drejtave të grave si të papërshtatshëm, por theksoi si problem mungesën e zbatimit të tyre.
21. Ligji aktual është një instrument relativisht i mirë. UNIFEM-i (tani UN Women), e ka lavdëruar ligjin aktual në Kosovë si një praktikë të mirë për, ndër të tjera, dispozitat e tij të forta për masat e posaçme kalimtare për të arritur synimin prej 40% në organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, si dhe në partitë politike²⁶². Ka shumë të ngjarë që Ligji aktual të mos ketë dispozita

257 Me udhëzim administrativ nr. 2007/3, që zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2001/19 për Degën Egzekutive të Institucionit të Vetëqeverisjes.

258 Përgjegjësitë e tij jani janë të përcaktuar me Rregulloren Nr. 23/16 për Strukturën Organizative të Zyrës së Kryeministrit (2013).

259 Tani Zyra për qeverisje të mirë, të drejtat e njeriut, mundësi të barabarta dhe mosdiskriminim ('ZQM') pas miratimit të Rregullores Nr. 16/23 për Strukturën Organizative të Zyrës së Kryeministrit, (2013).

260 Sikurse kërkohet nga Neni 29 i Rregullores nr. 09/2011 të Rregullave dhe Procedurave të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Neni 54 i Rregullave të Procedurës së Kuvendit të Kosovës.

261 SIDA, nga Ulf Färnsveden and Nicole Farnsworth, Studim gjinor në Kosovë: shyrtime i zbatimit të ligjit dhe programit të barazisë gjinore në Kosovë, dhjetor 2012.

262 UNIFEM, Ligjet e barazisë gjinore: "Praktika globale e mirë dhe një vështrim i pesë vendeve të Azisë Juglindore," March 2009.

të qarta për mundësitë që mund të përdoren, duke përfshirë mbrojtjen ligjore, sanksionet dhe kompensimin. Gjithashtu ai nuk ishte mjaftueshëm i qartë në caktimin e përgjegjësive për të gjitha organet publike, duke përfshirë Agjencinë e Barazisë Gjinore, dhe nuk kishte dispozita të qarta për përfshirjen e këndvështrimit gjinor dhe buxhetimin gjinor, të cilat Agjencia i identifikoi si mungesë që duheshin trajtuar në Projektligj. Ai kishte gjithashtu nevojë të përshtatej me standardet europiane.

22. Grupi i Punës për përgatitjen e Projektligjit përfshiu Agjencinë për Barazinë Gjinore, Zyrën Juridike të ZPM-së, nëpunësit e barazisë gjinore të komunave dhe ministrive, IAP-në dhe përfaqësues të gjykatave dhe organizatave të shoqërisë civile²⁶³.
23. Seminari i fundit për Projektligjin u zhvillua në Shqipëri në mars të vitit 2013. Agjencitë e Kombeve të Bashkuara dhe Delegacioni i Bashkimit Europian dhanë komentet e tyre me shkrim. Zyra Juridike e ZKM-së ishte përgjegjëse për përgatitjen e tekstit dhe versioni i dërguar ekspertëve të Këshillit të Evropës nuk u ishte bërë i ditur homologëve përkatës. Megjithatë, Zyra Juridike ka dhënë siguri se konsultime të mëtejshme për Projektligjin do të zhvilloheshin pas marrjes së këtij opinioni.
24. Projektligji është një draft shumë i hershëm me një gjuhë jo të mirë në anglisht, si dhe në shqip dhe serbisht. Ai nuk është i qartë në disa pjesë dhe duket tepër i gjatë për t'u zbatuar në mënyrë të efektshme. Do të ishte mirë që ky Projektligj të thjeshtohej, edhe në përputhje me parimet e BE-së për thjeshtimin e legjislacionit duke "hequr prej tij gjërat e tepërta dhe duke zbatuar me rigozitet parimet e nevojës dhe proporcionalitetit"²⁶⁴. Terminologjia ka nevojë të jetë e njëjtë gjatë gjithë ligjit dhe dispozitat e tij duhet të harmonizohen me ligje të tjera, në veçanti, me Projektligjin për diskriminimin dhe Ligjin për Avokatin e Popullit. Përveç kësaj, ai duhet t'i nënshtrohet një procesi më të gjerë konsultimesh²⁶⁵.
25. Njëkohësisht, Projektligji përpiket të adresojë mungesat e identifikuara në ligjin aktual dhe, në pjesën më të madhe, ai pasqyron mirë standardet europiane. Megjithatë ka ende nevojë që të jetë shumë më i qartë për sa i takon ndarjes së përgjegjësive midis organeve publike dhe mekanizmave institucionalë të barazisë gjinore për të promovuar një zbatim më të mirë. Gjithsesi, ai duhet të bëhet një pikë referimi për të gjitha çështjet e lidhura me gjininë, në veçanti ato që prekin më shumë gratë sot në Kosovë.

4. DISKUTIM NEN PËR NEN

Neni 1, Qëllimi

26. Nenet 1 dhe 2 i referohen qëllimit dhe objektit të ligjit, po në gjuhën aktuale të projektligjit, nuk është e qartë kush është kush. Qëllimi duhet të jetë më i shkurtër dhe ndoshta më në përputhje me Nenin 7.2 të Kushtetutës²⁶⁶.
27. Paragrafi 1 e lë jashtë qëllimin e promovimit të barazisë gjinore, kështu që fjala "promovim" duhet të shtohet në të me qëllim që kjo dispozitë të lexojë:

Ky ligj duhet të mbrojë, garantojë dhe promovojë barazinë gjinore midis gjinive si një vlerë bazë e zhvillimit demokratik të shoqërisë.

28. Paragrafi 3 është përsëritës, i panevojshëm dhe i paqartë. Ai duhet të hiqet.

²⁶³ Partners Kosova dhe Qendra Kosovare për Studimet Gjinore.

²⁶⁴ Fjalorth Europa EU, http://europa.eu/legislation_summaries/glossary/legislation_simplification_en.htm, marrë më 2 shtator 2013.

²⁶⁵ Në tre gjuhë, në përputhje me Nenin 40 të Rregullores nr. 09/2011 të Rregullores së Procedurës së Qeverisë.

²⁶⁶ Shih para. 12.

29. Paragrafi 4 është tepër i gjatë dhe, duke qenë se të drejtat dhe përgjegjësitë e institucioneve do të përcaktohen më tej në pjesën kryesore të Projektligjit, gjithçka pas fjalës “kompetenca” mund të hiqet.

Neni 2 Objekti

30. CEDAW kërkon futjen e një detyre pozitive të shtetit për të arritur barazi thelbësore për burrat dhe gratë, ku të gjitha palët të jenë zotuar të marrin:

Të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin ndaj grave nga çdo person, organizatë apo ndërmarrje²⁶⁷

që bën të nevojshme që ligji ta bëjë të detyrueshme për shtetin, autoritetet publike dhe përfaqësuesit e tyre, si dhe organizatat private dhe individët.

31. Kështu, sipas Paragrafit 1, duhet të jetë më e qartë se Projektligji merret me sferat publike dhe private dhe se ai garanton mundësi të barabarta në:

Fushat publike dhe private të jetës shoqërore, duke përfshirë jetën politike dhe publike, punësimin, arsimin, shëndetësinë, përfitimet shoqërore, sportin dhe kulturën.

32. Në jurisprudencën e saj²⁶⁸, Gjykata Europiane ka vendosur se diskriminimi që rrjedh nga ndërrimi i gjinisë së personit konsiderohet diskriminim në bazë të seksit. Ndonëse ky lloj kuptimi i diskriminimit gjenet në fjalinë e dytë të Paragrafit 3 të Projektligjit, do të ishte më me vend që ai të kombinonte përkufizimin e objektit në Paragrafin 1, me qëllim që ai të lexonte kështu:

Ky ligj rregullon barazinë gjinore, mbrojtjen dhe trajtimin e barabartë të burrave, grave dhe personave që kanë një veçori të mbrojtur në ndryshimin e gjinisë

33. Paragrafi 3 duhet pastaj të hiqet.

34. Paragrafi 2 duhet të specifikojë që Projektligji duhet të përcaktojë kornizën institucionale të nevojshme për “zbatimin” dhe jo “mbikëqyrjen” e tij.

35. Duhet të ketë një paragraf shtesë të përfshirë në këtë Nen, i cili të parashikojë pak a shumë këtë:

Asgjë në këtë ligj nuk duhet të hartohet në mënyrë të tillë që të kufizojë apo pakësojë çdo të drejtë ekzistuese të parashikuar në ligje të tjera, ose në marrëveshje apo instrumente të zbatueshme ndërkombëtare,

Si një mbrojtje ndaj riskut që Projektligji të pakësojë gëzimin e këtyre të drejtave të cilat ka të ngjarë të jenë më mirë të rregulluara në ligje të tjera.

36. Komiteti CEDAW ka deklaruar se, pavarësisht se CEDAW i referohet vetëm diskriminimit me bazë seks, zbatueshmëria e saj në rast diskriminimi me bazë gjinore bëhet e qartë nga përkufizimi i diskriminimit që përmban Neni 1, së bashku me Nenet 2 (f) dhe 5 (a)²⁶⁹. Komiteti ka deklaruar më tej se termi seks:

I referohet dallimeve biologjike midis burrave dhe grave, dhe se termi gjini i referohet identiteteve, cilësive dhe roleve të krijuara shoqërisht për gratë²⁷⁰.

²⁶⁷ CEDAW, Neni 2 e).

²⁶⁸ P kundër S dhe Këshillit të Kontesë Cornwall, Lënda C-13/94, 1996 E.C.R. I-2143.

²⁶⁹ Komiteti i CEDAW-t, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 28 për Detyrimet Bazë të Shteteve Palë, sipas Nenet 2 të Konventës për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave, 19 tetor 2010, CEDAW/C/2010/47/GC.2 .

²⁷⁰ Po aty, në para. 5.

Gjithashtu, Projektligji duhet të konsiderohet shprehimisht se u referohet të dy seksve dhe gjinive dhe Neni 2 duhet të amendohet përkatësisht.

Neni 3, Përkufizime

37. Ndonëse përkufizimi i barazisë gjinore në Paragrafi 1.1 mbetet i njëjtë si dhe në Ligjin aktual, ripërkthimi i tij në anglisht nuk është më aq i qartë. Pjesa e fundit e Paragrafit (pas fjalës “të drejta”) duhet që në anglisht të lexojë përsëri:

Dhe të përdorë aftësitë e tyre individuale për zhvillimin e shoqërisë dhe për përfitime të barabarta nga rezultatet e një zhvillimi të tillë.

38. Nga ana tjetër, mund të përdoret edhe një përkufizim më i gjatë i OSBE-së²⁷¹:

Barazia gjinore është të gëzuarit e barabartë nga gratë dhe burrat e mundësive, burimeve, mallrave, të drejtave dhe shpërblimeve me vlerë shoqërore. Ajo është në fakt mungesa e diskriminimit dhe e dallimeve, në bazë të të qenit grua apo burrë, në mundësi, në shpërndarjen e burimeve apo përfitimeve, në qasjen në shërbime dhe në gëzimin e të drejtave. Pra, ajo është kështu, ushtrimi i plotë dhe i barabartë nga burrat dhe gratë i të drejtave të tyre themelore. Qëllimi nuk është që gratë dhe burrat të bëhen të njëjtë, por që mundësitë dhe përfitimet e tyre të bëhen dhe mbeten të barabarta.

39. Përkufizimet sipas këtij Neni përfshijnë pjesë që do të ishin më të përshtatshme në pjesën kryesore të Projektligjit, të tilla si ndalimi i diskriminimit bazuar në seks, dhe faktin që ngacmimet dhe ngacmimet seksuale përbëjnë diskriminim sipas këtij ligji. Kështu, nën-paragrafët 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 nuk janë përkufizime, por në fakt përbëjnë një pjesë qendrore të këtij ligji dhe i takojnë më mirë të jenë në Nenin 4 (aktualisht i titulluar “Ndalimi dhe Parandalimi i Diskriminimit Gjinor”). Po ashtu, nën-paragrafët 1.5 dhe 1.6 po ashtu duhet të futen në Nenin 4 dhe jo te përkufizimet²⁷².

40. Përkufizimi i trajtimit të barabartë te nën-paragrafi 1.2 duhet të reduktohet në:

Trajtim i barabartë duhet të thotë eliminimi i diskriminimit të drejtpërdrejt dhe të tërthortë për shkaqe seksi.

41. Neni duhet të përfshijë si paragrafë të parë, një përkufizim të gjinisë, seksit, dhe personave me karakteristika të mbrojtura të ndryshimit gjinor dhe mundësi të barabarta si më poshtë:

Seksi i referohet karakteristikave biologjike dhe psikologjike të cilat përcaktojnë burrat dhe gratë.

Gjinia i referohet roleve, sjelljeve, aktiviteteve dhe attributeve të krijuara shoqërisht, që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për burrat dhe gratë.

Personat me karakteristika të mbrojtura të ndërrimit të gjinisë i referohet personave që kanë propozuar, filluar apo përfunduar një proces (ose një pjesë të një procesi) të ndërrimit të seksit, duke ndryshuar atributet fiziologjike apo të tjera të seksit.

Mundësi e barabartë i referohet sigurimit të pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë të burrave dhe grave në të gjitha aspektet e jetës politike, sociale, kulturore dhe ekonomike.

Përkufizimet e propozuara më lart për “gjininë” dhe “seksin” janë përshtatur nga përkufizimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë; përkufizimi i propozuar për personat me karakteristika të mbrojtura të ndërrimit të gjinisë u përshtat nga Ligji i Barazisë i Mbretërisë së Bashkuar;

²⁷¹ Gjinia ka rëndësi në OSBE, Red. Jamila Seftaoui. Vjenë, 2010.

²⁷² Shih paragrafin 60 dhe paragrafët 64-68.

dhe përkufizimi i propozuar për “mundësi të barabarta” u përshtat nga Fjalorthi i OSBE-së për termat që lidhen me gjininë.

42. Përkufizimet janë harmonizuar me Projektligjin për diskriminimin, në veçanti, përkufizimin e diskriminimit të drejtpërdrejt dhe të tërthortë. Megjithatë, përkufizimi përkatës i diskriminimit të drejtpërdrejt dhe të tërthortë në bazë të seksit duhet të mbetet në Projektligj. Përkufizimet e këtij të fundit për diskriminimin e drejtpërdrejt dhe të tërthortë përputhen me direktivën 2006/54/EC.
43. Ndërsa përkufizimet për ngacmimin dhe ngacmimin seksual – në nën-paragrafët 1.6.1 dhe 1.6.2 – duket se ndjekin ato në Nenin 2) të Direktivës 2006/54/EC, gjuha në anglisht duhet të korrigjohet për ta bërë atë në përputhje të plotë me Direktivën.
44. Kështu, në nën-paragrafin 1.6.1, fjalët “për shkak të përkatësisë gjinore” duhet të hiqen dhe përkufizim duhet të korrigjohet në anglisht për të lexuar:

Ngacmimi është një situatë ku një sjellje e padëshiruar që lidhet me seksin e një personi ndodh me qëllim për të prekur apo shkelur dinjitetin e një personi, dhe për të krijuar një mjedis frikësues, armiqësor, degradues, poshtëruar apo fyes.

45. Në të njëjtën mënyrë, nën-paragrafi 1.6.2 duhet të korrigjohet dhe të lexojë kështu:

Ngacmimi seksual është një situatë ku ndodh çdo formë e një sjellje të pakërkuar verbale, jo verbale, apo fizike me natyrë seksuale, me qëllim apo pasojë preken apo shkeljen e dinjitetit të një personi, dhe për të krijuar një mjedis frikësues, armiqësor, degradues, poshtëruar apo fyes.

46. Përkufizimet e masave ligjore, masave të përgjithshme dhe masave të posaçme – në nën-paragrafët 1.7, 1.8 dhe 1.9 – janë kopjuar nga Ligji aktual. Megjithatë, përkufizimi i masave ligjore nuk është i qartë, duke qenë se përkufizimi i masave të përgjithshme duket se është më normativ, ndërsa masat ligjore nuk përmenden gjetkë në këtë Projektligj. Për më tej, masat e përgjithshme specifikohen në Nenin 5 dhe masat e posaçme duhet të përcaktohen dhe specifikohen në Nenin 6, duke i bërë përcaktime të mëtejshme të panevojshme. Si rrjedhojë, nën-paragrafët 1.7- 1.9 duhet të hiqen.
47. Nën-paragrafi 1.10 përcakton buxhetimin gjinor, por meqë ai i referohet përfshirjes së këndvështrimit gjinor të përcaktuar në nën-paragrafin 1.12, renditja e këtyre dispozitave duhet të përmbyset.
48. Komiteti i CEDAW-t ka deklaruar se dhuna ndaj grave është:

Një formë diskriminimi që pengon seriozisht mundësitë e grave për të gëzuar të drejta dhe liri në bazë barazie me burrat²⁷³.

Me qëllim për ta ndaluar këtë formë diskriminimi sipas Nenit 4²⁷⁴, dhuna ndaj grave duhet përcaktuar në këtë Nen si:

Të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore që rezultojnë apo kanë të ngjarë të rezultojnë në dëmtim apo vuajtje fizike, seksuale, psikologjike apo ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për akte të tilla, shtrëngim, apo heqje arbitrare të lirisë, qoftë kur kjo ndodh në jetën publike apo private.

Ky përkufizim i propozuar këtu është marrë nga Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

²⁷³ CEDAW Rekomandime të Përgjithshme nr. 19 dhe 20, miratuar në sesionin e tij të 11të, 1992, A/47/38.

²⁷⁴ Shih paragrafin 69.

49. Nën-paragrafi 1.12 është një përkufizim i përfshirjes së këndvështrimit gjinor dhe duhet të titullohet si i tillë në anglisht. Fillimi i përkufizimit duhet të lexojë:

Përfshirja e këndvështrimit gjinor është përfshirja e perspektivës gjinore në çdo fazë ...

Pjesa e fundit e fjalisë duhet të korrigojë në anglisht fjalën ‘ehnsing’ me ‘enhancing’.

Përfaqësimi 40%

50. Projektligji fut një përkufizim të përfaqësimit të pabarabartë – në nën-paragrafin 1.11 – duke thënë se kjo ndodh kur pjesëmarrja apo përfaqësimi i njërit seks është nën 40%. Kjo kërkesë përputhet me Rekomandimin e Këshillit të Europës Rec(2003)3 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për pjesëmarrjen e baraspeshuar të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike, që parashikon:

Pjesëmarrjen e baraspeshuar të grave dhe burrave (...), që do të thotë se përfaqësimi i grave dhe i burrave në çdo organ vendimmarrës në jetën politike apo publike nuk duhet të bjerë nën 40%²⁷⁵.

51. Vendet e rajonit kanë përfshirë një lloj kuote në ligjet e tyre të barazisë gjinore. Kështu Neni 20 i Ligjit të Barazisë Gjinore të Bosnjë dhe Hercegovinës përcakton se përfaqësimi i barabartë ndodh kur njëri prej seksëve përfaqësohet me të paktën 40%, por ai kufizon zbatimin e tij në institucionet publike, institucionet nën kontrollin e publikut dhe partitë politike. Përfaqësimi i pabarabartë konsiderohet diskriminim, por është e paqartë se si sanksionet për një diskriminim të tillë mund të zbatohen dhe kush mund të dënohet.
52. Ligji shqiptar për Barazinë Gjinore është i ngjashëm dhe përcakton “përfaqësimin e barabartë gjinor” si ato raste kur asnjëra nga gjinitë nuk është e përfaqësuar nga më pak se 30% në çdo institucion, rast hierarkik, organ të emëruar, apo parti politike.
53. Ligji serb për Barazinë Gjinore është më i kujdesshëm në zbatimin e tij dhe te Neni 14 parashikon masa të detyrueshme, afirmative vetëm kur ka një përfaqësim më të vogël se 30%. Ai kërkon që punëdhënësit me më shumë se 50 punëmarrës të kenë një plan veprimi²⁷⁶, parashikon që të paktën 30% më pak kandidatë të përfaqësuar të propozohen për borde drejtuese dhe borde menaxhimi në institucionet publike²⁷⁷, kërkon një përfaqësim 30% për delegacione²⁷⁸ dhe ka një kuotë prej 30% në ligjin e zgjedhjeve.
54. Ligji kroat i barazisë gjinore po ashtu i lidh masat specifike me rastet kur njëri seks është shumë i nën-përfaqësuar, dhe kjo gjë përcaktohet me më pak se 40% përfaqësues në organe politike dhe organe publike vendimmarrëse.
55. CEDAW parashikon që Neni 4 për miratimin nga Shtetet palë të masave të posaçme që synojnë përshpejtimin e barazisë *de facto* midis burrave dhe grave dhe Komiteti i CEDAW-t ka shpjeguar se termi “masa” përfshin “qëllime numerike të lidhura me afate kohore; dhe sisteme kuotash²⁷⁹. Për më tej, Këshilli i Europës bën thirrje për:

Vendosjen e objektivave dhe afateve kohore për zbatimin efikas të planeve dhe programeve të barazisë gjinore në të gjitha fushat përkatëse të politikave publike

Dhe ekzistenca e objektivave tregon një nevojë për realizimin e tyre progresiv²⁸⁰.

²⁷⁵ Miratuar në 12 mars 2003.

²⁷⁶ Neni 13.

²⁷⁷ Neni 32.

²⁷⁸ Neni 38.

²⁷⁹ Rekomandimi i Përgjithshëm i CEDAW-t nr. 25: Neni 4, paragrafi 1, i Konventës (Masat speciale të përkohshme), 2004.

²⁸⁰ Rekomandimi i Këshillit të Evropës CM/Rec(2007)17 i Komitetit të Ministrave ndaj shteteve anëtare për standardet dhe

56. Komisioni i Kuvendit për të Drejtat e Njeriut, Barazinë gjinore, Personat e Zhdukur dhe Petitionet ka monitoruar zbatimin e Ligjit aktual. Komisioni rekomandoi një kuotë prej 50% për Projektligjin për shkak të faktit se gratë përbëjnë gati 50% të popullsisë në Kosovë. Gjithsesi, objektivi prej 40% është më i mirë duke qenë se 50% nuk do të ishte më një kuotë dhe do të ofronte pak fleksibilitet për përfaqësim në profesione ku njëri seks është më i prirë se tjetri.
57. Një synim i përcaktuar është shumë i nevojshëm në Kosovë duke qenë se gratë janë të nën-përfaqësuar në poste pushteti. Ndërsa Kosova ka një presidente grua dhe 33.3% gra deputete në Kuvend, përqindja e grave në nivel vendimmarrjeje në Kuvend dhe Qeveri është i ulët. Në Kuvend, Kryetari dhe pesë nënkryetarët janë burra. Vetëm dy poste si kryetare komisionesh parlamentare, nga 13 i kanë gratë. Në Qeveri, dy nga gjashtë zëvendës kryeministra janë gra, dhe vetëm dy nga 19 ministra janë gra. Në komuna, ka vetëm një grua kryetare, në komunën e Mitrovicës së Veriut.
58. Duke qenë se Neni 6 (Masa të posaçme) të Projektligjit i referohen përfaqësimit të barabartë të burrave dhe grave, dhe masat e posaçme lidhen me arritjen e tij, përkufizimi i nën-paragrafit 1.11 duhet të ndjekë të njëjtin formulim – “Përfaqësim i barabartë i grave dhe burrave me të paktën 40%”.
59. Duke e përcaktuar përfaqësimin e barabartë të grave dhe burrave në mënyrën e propozuar në paragrafin 1.11, Kosova do të krijonte pritshmëri të realizimit progresiv të objektivit për të gjitha organet politike, publike dhe të kontrolluara publikisht, si dhe për strukturat e tyre udhëheqëse. Kështu, masa të posaçme do të hartohen duke pasur ndër mend kuotat e detyrueshme me ligj dhe do të zbatohen për aq kohë deri sa të arrihet kuota. Megjithatë, Projektligji duhet gjithashtu të përcaktojë disa objektiva të zbatueshme menjëherë, të tilla si kuota e zgjedhjeve, dhe kuotat për përfaqësim në organet ndërkombëtare²⁸¹.

Neni 4, Ndalimi dhe parandalimi i diskriminimit gjinor

60. Ky Nen duhet të jetë ai që të ndalojë hapur si diskriminimin e drejtpërdrejtë ashtu edhe atë të tërthortë, dhe të sigurojë që ndalimi i diskriminimit ndaj grave të përfshijë bazën e gjendjes martesore, shtatzëninë, racën, paaftësinë, orientimin seksual dhe shkaqe të tjera në përputhje me Projektligjin për diskriminimin.
61. Duke qenë se parandalimi i diskriminimit është një nga detyrat e institucionet e Kosovës dhe duhet përmendur te Neni 5 (Masa të përgjithshme për sigurimin e barazisë gjinore) dhe te Neni 12 (Funksionet dhe përgjegjësitë), dhe jo në këtë dispozitë. Neni 4 duhet pra të rrihet “Ndalimi i Diskriminimit”.
62. Paragrafët 1 dhe 2 i referohen detyrimit për të siguruar përfshirjen e këndvështrimit gjinor dhe buxhetimin gjinor, dhe kjo përbën një detyrë shumë të rëndësishme për autoritetet publike. Gjithsesi, detyrimet kryesore të autoriteteve publike duhet të mbulohen nga një Nen për të qenë plotësisht të qarta dhe, meqenëse ky do të jetë Neni 5 (Masa të përgjithshme për të siguruar barazinë gjinore), Paragrafët 1 dhe 2 duhet të bëhen pjesë e asaj dispozite²⁸², ndërsa paragrafi aktual do t’i kushtohet vetëm ndalimit të diskriminimit.
63. Paragrafët 3 dhe 4 i përsërisin ndërkohë përkufizimet e diskriminimit të drejtpërdrejt dhe të tërthortë që janë mbuluar tashmë në Nenin 3 dhe duhet për këtë arsye të hiqen.
64. Neni 3.1.2.1 duhet të futet në dispozitën aktuale si paragrafi 1. Arsye të tjera përkatëse duhen shtuar pas fjalës “lindje” dhe formulimi i sugjeruar duhet të përfshijë:

Statusin martesor, kombësinë, racën, paaftësinë, orientimin seksual, ose çdo bazë tjetër të përshkruar me ligj ose nga marrëveshje apo instrumente të zbatueshëm ndërkom-

mekanizmat e barazisë gjinore, 21 nëntor 2007.

281 Shih paragrafin 136 dhe paragrafin 72.

282 Shih paragrafin 72.

bëtarë.

65. Neni 3.1.2.2 duhet të futet këtu si paragrafi 2.
66. Ndërsa dispozita e përgjithshme e rekomanduar të shtohet në Nenin 2²⁸³ do të mbulonte përmbajtjen e Nenit 3.1.2.3, përfshirja e dispozitës së fundit këtu do t'i jepte asaj një theks të shtuar.
67. Neni 3.1.5 duhet të futet këtu si paragrafi tjetër.
68. Neni 3.1.6 duhet pastaj të futet si paragrafi vijues.
69. Komiteti i CEDAW-t ka përcaktuar se dhuna ndaj grave është:

*Një formë diskriminimi që i pengon seriozisht gratë të gëzojnë të drejta dhe liri në bazë barazie me burrat.*²⁸⁴

Megjithatë, ndërsa Kosova ka një Ligj për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, ai nuk bën lidhjen me diskriminimin, prandaj referimi i tij në Projektligj do të ishte një tregues i mirë për një ligj përfshirës të barazisë gjinore. Kështu do të shtohej një paragraf i ri në dispozitë aktuale, si paragrafi i sajë fundit, i cili do të thoshte:

Dhuna ndaj grave është një formë diskriminimi ndaj tyre dhe ndalohej.

Neni 5 Masa të përgjithshme për sigurimin e barazisë gjinore

70. Ky Nen duhet të ishte ai që të përcaktonte qartë përgjegjësitë e të gjithë institucioneve të Kosovës në lidhje me barazinë gjinore. Megjithatë, formulimi në Projektligj nuk është aq specifik sa të promovojë zbatimin e mirë dhe, siç është parë, kjo është një e metë e madhe në Ligjin aktual. Neni duhet të kombinojë logjikisht pjesë të Nenit 7, Nenit 8, Nenit 9 dhe Nenit 16, për të thjeshtuar Projektligjin, sepse ato merren veçan me disa nga të njëjtat masa të përgjithshme që kërkohen nga autoritetet publike. Elementët e nevojshëm që kërkohen nga të gjitha autoritetet publike duhet të përfshijnë analizën gjinore, plane konkrete veprimi, përfshirjen e këndvështrimit gjinor në të gjitha politikat dhe ligjet, punësimet dhe caktimet në punë, duke marrë parasysh gjininë, buxhetimin gjinor dhe mbledhjen e të dhënave të ndara sipas seksit²⁸⁵.
71. Komiteti i CEDAW-t ka bërë një dallim të qartë midis masave të posaçme të përkohshme që kanë për qëllim:

*Të përshpejtojnë arritjen e një qëllimi konkret të barazisë de facto apo substantive për gratë, dhe politika të tjera të përgjithshme sociale të miratuara për të përmirësuar situatën e grave*²⁸⁶.

Ky Nen duhet të merret me këtë të fundit.

72. Fjalja e parë e paragrafit të parë të kësaj dispozite duhet që të numërojë institucionet e Kosovës për të përfshirë (si për shembull, te Ligji aktual) “organet legjislative, ekzekutive, gjyqësore në të gjitha nivelet si dhe institucionet publike” dhe pastaj të vazhdojë kombinimin dhe zhvillimin e nën-paragrafëve ekzistues 1 dhe 2 për të parashikuar që ata të:

²⁸³ Shih paragrafin 35.

²⁸⁴ Rekomandimet e Përgjithshme të CEDAW-t nr. 19 dhe 20, miratuar në sesionin e tij të 11të, 1992, A/47/38.

²⁸⁵ Masat e përgjithshme mbështeten në Rekomandimin e Këshillit të Europës Rec(2003)3 të Komitetit të Ministrave, për pjesëmarrjen e ekuilibruar të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike, 12 mars 2003; Rekomandimi i Këshillit të Europës Nr. R (85)2 i Komitetit të Ministrave për mbrojtjen ligjore nga diskriminimi në bazë seksi, 5 shkurt 1985; dhe Rekomandimi i Këshillit të Europës CM/Rec(2007)17 i Komitetit të Ministrave për standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore, 21 nëntor 2007.

²⁸⁶ Rekomandim i Përgjithshëm i CEDAW-t Nr. 25: Neni 4, paragrafi 1, i Konventës (Masa të Përkohshme të posaçme), 2004.

Kenë përgjegjësi për të zbatuar masat legislative dhe masa të tjera të nevojshme, me qëllim mbrojtjen dhe promovimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e diskriminimit ndaj grave, duke përfshirë me anë të:

Analizës së statusit të grave dhe burrave në organizatat dhe fushat përkatëse;

Miratimin e planeve të veprimit për promovimin dhe vendosjen e barazisë gjinore;

Futjes së këndvështrimit gjinor në të gjitha politikat, dokumentet dhe ligjet;

Sigurimin që proceset e përzgjedhjes, punësimit dhe caktimit në punë, duke përfshirë edhe për pozicione drejtuese, të jenë në përputhje me kërkesën për përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave;

Përdorimit të buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në shpërndarjen dhe caktimin e burimeve;

Sigurimin e përfaqësimit të barabartë të grave dhe burrave në të gjitha delegacionet dhe forumet ndërkombëtare;

Caktimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare për programe, projekte, dhe iniciativa për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.

73. Këshilli i Europës²⁸⁷ dhe shumë rekomandime të Komitetit të CEDAW-t theksojnë rëndësinë që ka mbledhja dhe analiza e të dhënave dhe statistikave të ndara sipas seksit “në të gjitha fushat dhe në lidhje me të gjitha politikat dhe programet”, si mjete të domosdoshme për të monitoruar progresin drejt rrugës për arritjen e barazisë gjinore substantive. Neni 16.1 i Projektligjit duhet që të bëhet një nën-paragraf në këtë Nen dhe të riformulohet si më poshtë:

Duke ndarë sipas seksit të gjitha të dhënat dhe informacionin statistikor që mblidhet, evidentohet dhe përpunohet.

74. Nën-paragrafi 1.3 duhet të shqyrtohet në anglisht për të qenë në linjë me formulimin e mësipërm për të filluar me “duke ndryshuar apo shfuqizuar (...)”.

75. Neni 7.1.4 duhet të bëhet një nga paragrafët në dispozitën aktuale dhe duhet të riformulohet në anglisht si më poshtë:

Duke marrë parasysh gjininë në emërimin e institucioneve, shkollave dhe rrugëve.

76. Nën-paragrafi 1.4 nuk shton ndonjë gjë me rëndësi në këtë dispozitë dhe duhet hequr.

77. Nën-paragrafi 1.5 është i paqartë dhe, duke qenë se mbrojtja e gjykatës do të specifikohet në pjesën e fundit të Projektligjit, duhet hequr.

Neni 6 Masa të posaçme

78. Kushtetuta parashikon masa të posaçme dhe në Nenin 24 thotë se:

Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

79. CEDAW parashikon gjithashtu miratimin nga shtetet palë të masave specifike të përkohshme me synim përshpejtimin de facto të barazisë midis burrave dhe grave²⁸⁸. Komiteti i CEDAW-t e ka shpjeguar edhe më tej se:

termi “masa” përfshin një shumëllojshmëri të madhe instrumentesh, politikash dhe

²⁸⁷ Rekomandim i Këshillit të Europës CM/Rec(2007)17 i Komitetit të Ministrave për standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore, 21 nëntor 2007.

²⁸⁸ CEDAW, Neni 4.

praktikash legislative, ekzekutive, administrative dhe të tjera rregullatore, politika dhe praktika, të tilla si programe ndihme apo mbështetëse; shpërndarjen dhe/ose rishpërndarjen e burimeve; trajtimin preferencial; punësim të synuar, marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë; qëllime numerike të lidhura me afate kohore; dhe sisteme kuotash²⁸⁹.

80. Dispozita aktuale duhet pra që të përcaktojë masa të mundshme të posaçme, por duhet gjithashtu edhe të kombinohet me Nenin 7 (Barazia gjinore në institucione dhe organe menaxhuese) për të lidhur masat e posaçme me synimin e përfaqësimit të barabartë. Përkufizimi dhe disa masa të mundshme të posaçme këtu janë marrë nga Rekomandimi i Këshillit të Evropës Nr. R (85) 2 të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare për mbrojtjen ligjore nga diskriminimi në bazë seksi²⁹⁰.

81. Paragrafi i parë i kësaj dispozite duhet të përcaktojë masa të posaçme (duke përdorur një pjesë nga formulimi i Nenit 6.2) si:

Masa të përkohshme që synojnë përshejtimin e realizimit të barazisë reale midis grave dhe burrave në ato fusha ku pabarazitë ekzistojnë.

82. Paragrafi aktual 1 duhet të bëhet paragrafi i dytë dhe duhet riformuluar për të thënë:

Masat e posaçme mund të përfshijnë kuota për të arritur përfaqësimin e barabartë të grave dhe burrave, programe ndihme dhe mbështetjeje për të rritur pjesëmarrjen e seksit më pak të përfaqësuar në vendimmarrje dhe jetën publike, fuqizimin ekonomik dhe hapat për të përmirësuar pozitën e grave apo burrave në fushën e punës, përmirësimin e barazisë në arsim, shpërndarjen dhe/ose rishpërndarjen e burimeve, trajtim preferencial, rekrutimin, punësimin dhe ngritjen në detyrë, dhe masa të tjera në secilën fushë ku ka pabarazi.

83. Paragrafi 2 duhet të riformulohet në anglisht për të thënë:

Masat e posaçme nuk përbëjnë akte diskriminimi

Dhe të bëhen paragrafi i tretë.

84. Paragrafi 3 po ashtu duhet të riformulohet, për të siguruar lidhjen me synimin e përfaqësimit të barabartë, duke deklaruar se:

Organet ligjvënëse, ekzekutive, gjyqësore në të gjitha nivelet dhe institucionet publike duhet të jenë të detyruara të përshtatin dhe zbatojnë masa të posaçme për të rritur përfaqësimin e seksit të nën-përfaqësuar deri sa të arrihet përfaqësimi i barabartë i grave dhe burrave sipas kuptimit të këtij ligji.

Dhe të bëhet paragrafi i katërt.

Neni 7 Barazia gjinore në institucione dhe organet menaxhuese

85. Duke qenë se përmbajtja e kësaj dispozite është përfshirë ndërkohë në Nenet 5 (Masat e përgjithshme për sigurimin e barazisë gjinore) dhe 6 (Masa të posaçme), kjo dispozitë duhet të hiqet²⁹¹.

Mekanizmat institucionale të barazisë gjinore

86. Duke qenë se përgjegjësitë e të gjithë institucioneve në Kosovë në lidhje me barazinë gjinore janë përcaktuar në masat e përgjithshme dhe specifike, Kapitulli tjetër është më mirë që të titullohet “Mekanizmat institucionalë të barazisë gjinore” dhe logjikisht duhet të merren me mekanizmat specifikë institucionalë të barazisë gjinore, të cilët janë përcaktuar nga Këshilli i Evropës si:

²⁸⁹ CEDAW, Rekomandim i Përgjithshëm nr. 25: Neni 4, paragrafi 1, i Konventës (Masa të posaçme të përkohshme), 2004.

²⁹⁰ Miratuar më 5 shkurt 1985.

²⁹¹ Shih paragrafët 70, 72, 75, dhe paragrafin 80.

Struktura institucionale qeveritare dhe, në disa raste, si struktura parlamentare, të ngritura për të promovuar ecjen përpara të grave dhe për të siguruar gëzimin prej tyre të drejtave të njeriut. Funksioni i tij kryesor është të monitorojë dhe sigurojë zbatimin e ligjit, të parimit të mosdiskriminimit dhe barazisë midis grave dhe burrave²⁹².

Platforma e Pekinit për Veprim përfshin “mekanizmat institucionalë për avancimin e grave” si një nga 12 fushat e shqetësimeve të saj, dhe i quan ato:

Njësia qendrore e bashkërendimit të politikave brenda qeverisë. Detyra kryesore e saj është të mbështesë sjelljen në vëmendje të mbarë qeverisë së perspektivës së barazisë gjinore në të gjitha fushat e politikave²⁹³.

87. Detyrat kryesore që lidhen me gjininë të institucioneve të mbuluara në Nenet 8 (Kuvendi i Kosovës), 9 (Qeveria) dhe 10 (Organet vendore vetëqeverisëse) janë listuar ndërkohë në Nenet 5 (Masa të përgjithshme për sigurimin e barazisë gjinore) dhe 6 (Masa të posaçme). Përkufizim i mekanizmave institucionalë për këto organe duhet pra që të ndjekë përkufizimin e organit qendror bashkërendues të politikave për çështjet gjinore në Kosovë. Si rezultat, teksti i Nenit 11 (Agjencia për Barazinë Gjinore) duhet të jetë dispozita e parë në Kapitullin II të Projektligjit.

Neni 11 Agjencia për Barazinë Gjinore

Njësia qendrore e bashkërendimit të politikave të Barazisë Gjinore

88. Direktiva e BE-së 2002/73 kërkon ngritjen e një organi të barazisë:

Për promovimin, analizën, monitorimin dhe mbështetjen e trajtimit të barabartë pa diskriminim për shkak të seksit,

Duke bërë të detyrueshme ekzistencën e një njësie qendrore për bashkërendimin e politikave.

89. Megjithatë, është e nevojshme të merret një vendim sesa specifik duhet të jetë Projektligji dhe cilat çështje duhet të rregullohen me akte nënligjore, për të shmangur nevojën për të amenduar shpesh Projektligjin pas miratimit të tij. Më konkretisht, duhet të merret një vendim nëse Projektligji duhet në fakt të specifikojë titullin dhe pozicionin e njësisë qendrore të bashkërendimit të politikave. Një formulim alternativ për Nenin 11 mund të ishte “Njësia qendrore e bashkërendimit të politikave të barazisë gjinore duhet të jetë një organ qendror shtetëror i administratës, i ngritur në përputhje me një rregullore të qeverisë”. Në rastin e Kosovës, kjo do të thoshte Agjencia ekzistuese e Barazisë Gjinore.

90. Ka rëndësi të vihet në dukje se Platforma për Veprim e Pekinit bëri thirrje që një mekanizëm i tillë të ngrihet:

Në nivelin më të lartë të mundshëm të qeverisë, dhe të jetë nën drejtimin e një ministri të kabinetit²⁹⁴.

Raporti FRIDOM²⁹⁵ vuri në dukje se Agjencia, në mënyrën si është organizuar aktualisht nuk kishte:

Fuqi politike dhe aftësi teknike për të influencuar politikën në portofole të tjera.

Dhe ai propozonte që Agjencia të ishte ose nën vartësinë e një ministri të posaçëm pa portofol, ose të përfshihej në ministrinë ekzistuese.

²⁹² Këshilli i Europës, *Doracak për makinerinë kombëtare për të promovuar barazinë gjinore dhe planet e veprimit: Udhëzime për ngritjen e makinerisë kombëtare për të promovuar barazinë, me shembuj nga praktika të mira, maj 2001, EG (2001) 7.*

²⁹³ Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim, *Konferenca e katërt botërore për gratë, shtator 1995, paragrafi 201.*

²⁹⁴ *Po aty, paragrafi 201.*

²⁹⁵ *Projekti FRIDOM, Shqyrtimi funksional i sistemit të të drejtave të njeriut dhe i barazisë gjinore, 2010.*

91. Megjithatë, Komiteti i CEDAW-t, në komentet përmbyllëse të tij për një Raport periodik për Bosnjën dhe Hercegovinën, kritikonte faktin që Agjencia për Barazinë Gjinore në Bosnjë dhe Hercegovina ishte e vendosur brenda një ministrie në nivel shteti e cila mund:

Të krijonte pengesa për efektivitetin e punës së saj në punën me ministri të tjera,

Dhe ai rekomandonte se do të ishte më mirë për Agjencinë që të raportonte drejtpërdrejt në qeverinë shtetërore²⁹⁶, dhe Agjencia e Kosovës, e vendosur në ZKM, ka mundësi të raportojë në qeveri. Nuk është e sigurt nëse, po të ishte do të ishte nën vartësinë e një Ministrie tjetër, Agjencia e Kosovës do të mund të ndikonte më mirë në portofole të tjera sesa ashtu e vendosur në Zyrën e Kryeministrit, dhe krijimi i një ministrie tjetër do të ishte shumë e kushtueshme.

92. Me qëllim për të vazhduar trajtimin e pabarazive ekzistuese në shoqërinë kosovare sot, është shumë e rëndësishme që Agjencia për Barazinë gjinore të ketë mbështetje të mjaftueshme politike dhe që puna e saj të jetë e dukshme. Çdo ndryshim në organizimin e tanishëm do ta dobësonte Agjencinë. Si rrjedhojë, rruga më e mirë për të vepruar do të ishte të ngrihej statusi i Agjencisë, duke e përmendur me emër konkretisht në Projektligj.
93. Gjatë konsultimeve për Ligjin aktual, u bënë pyetje në lidhje me fjalën “agjenci” si një entitet, duke nënkuptuar njëfarë pavarësie nga qeverie, sidomos duke pasur parasysh dispozitën për “agjenci të pavarura” të Neni 142 i Kushtetutës. Pra, pozicioni i Agjencisë për Barazi Gjinore duhet të bëhet më i qartë, duke futur fjalën “qeveri” midis “ekzekutivit” dhe “agjencisë” në tekstin e Neni 11.
94. Neni 13 (Organizimi i agjencisë) parashikon hollësi që ekzistojnë ndërkohë si pjesë e Udhëzimit administrativ nr. 2007/3 dhe në fakt janë përgjithësisht me një natyrë kaq specifike sa që do të ishte më mirë të rregulloheshin me anë të një akti nënligjor. Neni 13.1-3 duhet pra të hiqet, ndërsa Neni 13.4 – pa fjalët “propozohet nga Agjencia” – duhet pastaj të bëhet paragrafi i dytë i Neni 11.

Neni 12 Funkcionet dhe Përgjegjësitë

95. Kjo dispozitë duhet të përcaktojë standardet e Agjencisë për Barazi Gjinore dhe të përcaktojë përgjegjësitë e saj. Pastaj, duhet të pasohet nga një Nen krejtësisht i ri, që të trajtojë Programin e Kosovës për Barazi Gjinore (‘KPGE’) dhe rolin e institucioneve të tjera në lidhje me këtë program. Më pas, Nenet vijuese duhet të trajtojnë mekanizmat e tjera institucionale që lidhen me barazinë gjinore.
96. Gjithsesi, paragrafi 1 është i përsëritur, nuk i shton ndonjë vlerë Projektligjit dhe duhet hequr.
97. Fjalët “zbaton dhe” duhen futur në fillim të paragrafit 2.1 duke qenë se Agjencia do të jetë përgjegjëse për zbatimin dhe jo për monitorim. Një formulim i tillë ekzistonte edhe në Ligjin aktual.
98. Paragrafi 2.2 duhet të jetë më i qartë në anglisht. Kjo duket se është e njëjta dispozitë si në Ligjin aktual. Ajo duhet të lexojë njëjloj:
Ti propozojë qeverisë amendamente të ligjeve dhe akteve nënligjore, dhe miratimin e masave të tjera për të zbatuar këtë ligj.
99. Platforma e Pekinit për Veprim e konsideron thelbësore që makineria e barazisë gjinore të ketë:

Mundësi të ndikojë në zhvillimin e të gjitha politikave të qeverisë²⁹⁷.

²⁹⁶ Komiteti i CEDAW-t, Komente përmbyllëse për raportin periodik të kombinuar fillestar, të dytë dhe të tretë të Bosnjës dhe Hercegovinës, 2006, CEDAW/C/BIH/CO/3.

²⁹⁷ Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit, Konferenca e katërt botërore për gratë, shtator 1995, paragrafi 201.

Ky Nen duhet të përmendë shprehimisht detyrimin e Agjencisë për të bërë një rishikim të ligjeve dhe të dokumenteve të tjera të politikave. Për këtë arsye, duhet të ketë një nën-paragraf që parashikon rishikimin e ligjeve, duke përdorur qasjet e përfshirjes së këndvështrimit gjinor dhe buxhetimin gjinor. Ai duhet të lexojë:

Të marrë pjesë në përgatitjen e ligjeve, akteve nënligjore, strategjive dhe programeve për të siguruar përfshirjen e këndvështrimit gjinor dhe buxhetimin gjinor.

100. Paragrafi 2.4 duhet të përfundojë pasi përmendet për herë të parë fjala “barazi” (dhe përpara fjalës “bashkërendon”). Formulimi:

Bashkërendon dhe përgatit raporte për zbatimin e Konventës CEDAW

Duhet të hiqet i tëri si një detyrim i përgjithshëm, duke qenë se detyrimi i përgjithshëm për të kontribuar në raportimin për detyrimet ndërkombëtare duhet të mbetet në paragrafin 2.5, më poshtë, por fjalia e fundit e paragrafit 2.4 duhet të bëhet një paragraf i veçantë në Nenin e ri të propozuar në KPGE²⁹⁸.

101. Paragrafi 2.5 duhet amenduar për të lexuar “kontribuon në raportimin për zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me barazinë gjinore”,²⁹⁹ për të bërë të mundshme kanalizimin e të gjithë raportimeve përpara organeve ndërkombëtare/rajonale përmes një organi të vetëm³⁰⁰.

102. Paragrafi 2.6 duhet të kalohet te Neni i ri për Programin e Kosovës për Barazinë Gjinore (PKBGJ-KPGE)³⁰¹.

103. Formulimi i paragrafit 2.7 duhet të kthehet përsëri te ai që është përdorur në Ligjin aktual dhe kështu të parashikojë që institucionet e tjera publike:

Të bashkëpunojnë me institucionet publike dhe me mekanizmat institucionalë të barazisë gjinore në ministri dhe në pushtetin vendor,

Duke qenë se Agjencia nuk duhet të bashkërendojë punën e tyre, duke qenë se kjo do të krijonte një hallkë të veçantë mbikëqyrjeje, e cila mund të pengonte punën e tyre, sidomos nëse vendosen, sikurse rekomandohet, në një pozitë që të ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e politikave³⁰².

104. Paragrafi 2.8 duhet t’i kushtohet bashkëpunimit me organizata jo qeveritare. Ai duhet të lexojë:

Të bashkëpunojë me organizatat jo qeveritare që veprojnë në fushën e barazisë gjinore.

105. Ligji aktual kërkon që Agjencia të ofrojë fonde të pjesshme për organizatat përkatëse jo qeveritare dhe institucionet publike. Megjithatë, nuk është e qartë sesa mirë funksionon kjo, dhe sipas Studimit të SIDA-s për gjininë³⁰³, mund të jetë përdorur vetëm në një numër shumë të kufizuar rastesh. Një konstatim i tillë mund të ishte një instrument i dobishëm për të promovuar programet e barazisë gjinore dhe masat e posaçme, por kjo do të kërkonte ose një buxhet më të madh (që nuk është i mundshme në rrethanat aktuale), ose do të kërkonte më shumë një instrument financiar me fonde nga donatorët (si ai që ekziston në Bosnjë dhe Hercegovinë). Ndonëse

298 Shih paragrafët 113-116.

299 Pra, mbi të zëvendësojë ‘për’.

300 Shih UNHCHR, nga Navanethem Pillay, Forcimi i sistemit të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, qershor 2012

301 Shih paragrafët 113-116.

302 Shih paragrafin 123, dhe paragrafët 127-129.

303 SIDA, nga Ulf Färnsveden dhe Nicole Farnsworth, Studim për Gjininë në Kosovë: Shqyrtimi i zbatimit të ligjit dhe programit të barazisë gjinore në Kosovë, dhjetor 2012.

dispozitat e Ligjit aktual e vënë si detyrim për Agjencinë, zbatimi nga ana e saj e programeve të tilla të financimit të pjesshëm mund të ndërmerrej, në rast se do të gjendeshin fonde, edhe pa pasur ndonjë dispozitë të posaçme për këtë në Projektligj. Në Projektligj, detyrimi për të parashikuar financim të pjesshëm u hoq, por paragrafi 2.9, ku Agjencia propozon kushte dhe kritere për financimin e pjesshëm, mbeti. Paragrafi 2.9 duhet të hiqet ose riformulohet për të shtuar marrësit e mundshëm të fondeve të pjesshme.

106. Duke qenë se masat e përgjithshme të parashikuara nga Projektligji përfshijnë përfshirjen e gjinisë në të gjitha aktivitetet nga institucionet e Kosovës³⁰⁴, ekziston çështja e kapaciteteve të tyre për të zbatuar procesin e përfshirjes së këndvështrimit gjinor. Raportet e Këshillit të Evropës nga puna në terren kushtuar propozimit për reformë për institucionet e të drejtave të njeriut në Kosovë tregojnë se kapaciteti i nëpunësve ekzistues që merren me barazinë gjinore është i ndryshëm³⁰⁵ dhe se pozicioni i disa prej tyre do të preket shumë nga Reforma në Administratën Publike. Komiteti i CEDAW-t³⁰⁶ i bëri thirrje mekanizmave gjinorë të ndërmerrnin:

Programe të posaçme edukative dhe trajnuese për parimet dhe dispozitat e Konventës që u drejtohen të gjitha agjencive të qeverisë, zyrtarëve publikë dhe, në veçanti, profesionit ligjor dhe gjyqësorit.

Duhet të jetë përgjegjësi e Agjencisë të rrisë kapacitetet e zyrtarëve publikë, përfshirë nëpunësit e caktuar për barazinë gjinore në ministri dhe komuna, dhe një trajnim i tillë duhet të përqendrohet në instrumentet e përfshirjes së këndvështrimit gjinor, në veçanti, në buxhetimin gjinor.

107. Megjithatë, pavarësisht se teksti i paragrafit 2.10 ekzistonte edhe në Ligjin aktual, formulimi i tij është shumë i paqartë. Prandaj, ai duhet të shqyrtohet dhe të thotë:

Të organizohet edukimi dhe trajnimi për përfshirjen e këndvështrimit gjinor dhe buxhetimit gjinor në institucionet publike dhe në veçanti, për nëpunësit e caktuar për barazinë gjinore në institucione.

108. Paragrafi 2.11 po ashtu ka nevojë të bëjë më të qartë se Agjencia për Barazinë gjinore përgjigjet për analizën e statusit të barazisë gjinore në Kosovë dhe duhet pra të riformulohet që të lexojë:

Të analizohet gjendja e barazisë gjinore në Kosovë, në bazë të raporteve, studimeve dhe monitorimit; dhe të paraqiten gjetjet në raporte vjetore, raporte të posaçme, udhëzime, kode sjelljeje, opinione dhe rekomandime për autoritetet përkatëse.

109. Formulimi i fjalisë së parë të Paragrafi 2.13 ishte më i qartë në tekstin në anglisht të Ligjit aktual:

Të raportojë në qeveri për aktivitetet e Agjencisë për vitin e shkuar, jo më vonë se fundi i marsit.

Dhe duhet përdorur edhe në Projektligj. Megjithatë, fjalia e fundit e paragrafit 2.13 duhet të hiqet, meqenëse, edhe pse Agjencia duhet të kryesojë Këshillin Ndërmnistror (jo ta drejtojë atë), kjo është diçka që duhet të rregullohet gjetiu³⁰⁷.

Neni 13 Organizimi i Agjencisë

³⁰⁴ Shih paragrafin 72.

³⁰⁵ Shih paragrafët 72 dhe 157 të raportit. Shih edhe, OSBE, Roli dhe funksionimi i punonjësve komunalë të barazisë gjinore në Kosovë, 2006.

³⁰⁶ Komiteti i CEDAW-t, Rekomandim i Përgjithshëm nr: 8 për detyrimet bazë të Shteteve Palë sipas Nenit 2 të CEDAW-t, CEDAW/C/GC/28, 2010.

³⁰⁷ Shih paragrafët 127-129.

110. Sikundër është rekomanduar ndërkohë, Paragrafi 4 duhet të bëhet pjesë e Nenit 11 dhe pjesa tjetër e kësaj dispozite duhet hequr³⁰⁸.

Neni 14 Financimi

111. Paragrafi 1.1. duhet të amendohet që të lexojë:

Buxheti i Republikës së Kosovës si burimi kryesor i financimit;

112. Paragrafët 1.2 dhe 2 rregullojnë të njëjtën gjë dhe njëri prej tyre duhet hequr, që në këtë rast duhet të jetë paragrafi i parë, në rast se shpjegimi më i gjatë në të dytin kërkohet vërtet.

Neni i ri, Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore

113. Në vitin 2004, Agjencia për Barazi gjinore zhvilloi PKBGJ-në 2008-2013, i cili mbulon gratë dhe ekonominë, arsimin, shëndetësinë, punën, ndihmën ekonomike, dhunën në familje dhe vendimmarrjen. PKBGJ-ja është dokumenti strategjik kryesor dhe më i dukshmi për veprim në fushën e barazisë gjinore. Projektligji duhet të rregullojë përgjegjësinë për përgatitjen e PKBGJ-së së re dhe të programeve të ardhshme. Këshilli i Evropës këshillon që:

Natyra globale dhe karakteri horizontal i objektivave të barazisë gjinore duhet pranuar dhe realizuar me anë të planeve të veprimit dhe programeve gjithëpërfshirëse që përfshijnë fusha të ndryshme dhe nivele të ndryshme të qeverisjes dhe që duhen monitoruar dhe vlerësuar me kujdes³⁰⁹.

114. Ligji aktual kërkon që çdo dy vjet Kuvendi i Kosovës të shqyrtojë dhe miratojë raportin e Qeverisë për zbatimin e PKBGJ-së, por kjo nuk është bërë deri më tani. Agjencia pretendonte se Kuvendi nuk e kish kërkuar kurrë një raport të tillë, por që Neni i ri duhet pa dyshim t'i caktojë përgjegjësi Agjencisë të monitorojë dhe raportojë për zbatimin e PKBGJ-së.

115. Neni 12.2.6 i Projektligjit duhet të bëhet paragrafi i parë i këtij Neni të ri dhe ai duhet riformuluar që të parashikojë:

Agjencia për Barazi gjinore duhet të bashkërendojë përgatitjen e Programit të Kosovës për Barazinë Gjinore, të monitorojë zbatimin e tij; dhe të raportojë çdo dy vjet në qeveri për zbatimin e tij.

116. Neni 9.2 i Projektligjit duhet të bëhet paragrafi i dytë dhe duhet të shqyrtohet që të lexojë:

Qeveria duhet të shqyrtojë dhe miratojë Programin e Kosovës për Barazi gjinore, të sigurojë buxhetin e tij, dhe të raportojë çdo dy vjet në Kuvend për zbatimin e tij.

Neni 8 Kuvendi i Kosovës

117. Neni 71 i Kushtetutës dekreton se përbërja e Kuvendit duhet të respektojë parimet e njohura ndërkombëtarisht të parimeve të barazisë gjinore.

118. Sikurse u vu në dukje më parë, Kuvendi ka një Komision për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, Personat e Zhdukur dhe Peticionet me kompetenca që lidhen me barazinë gjinore.

119. Si Ligji aktual ashtu edhe Projektligji përfshijnë një Nen të veçantë për Kuvendin. Megjithatë, kjo duket e panevojshme duke qenë se masat e përgjithshme për vendosjen e barazisë gjinore vlejné për Kuvendin, ndërsa detyrat që kanë të bëjnë me PKBGJ-në – sikurse rekomandohet më sipër – mbulohen nga një Nen i veçantë dhe përfshijnë një detyrë pozitive për Qeverinë për të paraqitur PKBGJ-në dhe raportet për të në Kuvend. Pra, Neni 8 duhet kështu të hiqet.

³⁰⁸ Shih paragrafin 94.

³⁰⁹ Rekomandimi i Këshillit të Europës CM/Rec(2007)17 i Komitetit të Ministrave për standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore, 21 nëntor 2007.

Neni 9 Qeverisja dhe Neni 10 Organet e Vetëqeverisjes lokale

120. Nenet 9 dhe 10 duhet të kombinohen dhe rititullohen “Mekanizmat institucionalë të barazisë gjinore në ministri dhe komuna”. Detyrat e ministrive dhe komunave janë numëruar tashmë te Nenet që përcaktojnë masat e përgjithshme dhe të veçanta, duke e bërë ekzistencën e dy neneve të veçanta të panevojshme³¹⁰.
121. Ky Nen i kombinuar duhet të përcaktojë mekanizmat institucionalë të barazisë gjinore në nivel qendror dhe lokal. Pavarësisht se ministrinë dhe komunat duhet të kenë të paktën një nëpunës të barazisë gjinore, duhet t’u lihet në dorë vetë ministrive dhe komunave përkatëse të përcaktojnë organizimin e saktë, për shkak se nevojat e tyre të veçanta duhet të jenë të ndryshme.
122. Një numër mekanizmash të barazisë gjinore janë ngritur në nivel ministrie dhe në nivele komunash me nëpunës gjinorë që shërbejnë si pika fokale, megjithatë, raportet e konsultuara tregojnë se ka të meta në funksionimin e strukturave ministrore dhe komunale. Të metat më të mëdha përfshijnë faktin që shumë nëpunës dhe njësi të barazisë gjinore janë jashtë procesit të politikave dhe të vendimmarrjes; ata janë të izoluar në Njësi të Drejtave të Njeriut me linja të dyfishta raportimi; niveli i aktivitetit të tyre varet nga personalitet e tyre vetjake; përkrahja për ta ishte e pamjaftueshme në pikëpamje të detyrave të qarta programatike; dhe kishin mundësi të pamjaftueshme për të gjetur fonde buxhetore për aktivitetet e tyre³¹¹.
123. Raporti FRIDOM³¹² me të drejtë këshillonte të mos mbaheshin njësitë aktuale të Drejtave të Njeriut, duke qenë se pasojat e këtyre organizimeve të ndarë nga njëri tjetri kish qenë kryesisht jo për t’i përfshirë, por për t’i ndarë të drejtat e njeriut dhe shqetësime gjinore nga qasja e përgjithshme ndaj politikave, dhe të kalonin nëpunësit e Barazisë gjinore në pozita politike, ose në njësitë qendrore të bashkërendimit të politikave ose në departamente kyçe. Më tej, ai rekomandonte që stafi i rishpërndarë të vazhdonte të shërbente si pika gjinore fokale në departamentet e tyre apo në komuna. Zbatimi i këtij propozimi do të siguronte zbatimin efikas të detyrimeve të përcaktuara nga Projektligji.
124. Qeveria ka nxjerrë ndërkohë Rregulloren nr. 1/2006 për ngritjen, kompetencat dhe detyrat e Këshillit Ndërminstros të Barazisë Gjinore, ndërsa Ministria e Pushtetit Lokal ka nxjerrë udhëzimin 2005/8 për përcaktimin e kompetencave dhe përshkrimin e detyrave të nëpunësve të barazisë gjinore në Komunitet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Këto nënakte ligjore duhet të mbeten në fuqi deri sa akte të reja – për ngritjen e strukturave institucionale gjinore apo nëpunësit gjinorë në ministri dhe komuna me detyra më të qarta, sikurse e kërkon Projektligji³¹³ - të jenë miratuar për t’i zëvendësuar ata.
125. Thelbi i Neneve 9.1 dhe 10.1 është përfshirë ndërkohë në qëllimin e Projektligjit³¹⁴ dhe në përcaktimin e masave të përgjithshme dhe masave të posaçme³¹⁵. Për këtë arsye, ato duhet të hiqen.
126. Neni 9.2 duhet, sikundër është rekomanduar ndërkohë³¹⁶, të hiqet nga Neni i ri për PK-BGJ-në.
127. Duhet të futet një paragraf i ri:

³¹⁰ Shih paragrafët 70-84.

³¹¹ Shih konstatimet e Këshillit të Evropës nga puna në terren kushtuar propozimit të reformës në institucionet e të drejtave të njeriut në Kosovë (paragrafët 69, 76, 120, 122 dhe 172 të raportit) dhe OSBE, “Roli dhe funksionimi i punonjësve komunalë të barazisë gjinore në Kosovë, 2006.

³¹² Projekti FRIDOM, Shqyrtimi funksional i sistemit të të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, 2010.

³¹³ Shih paragrafin 190.

³¹⁴ Neni 2.

³¹⁵ Shih paragrafët 27-30 dhe paragrafët 70-84.

³¹⁶ Shih paragrafin 116.

Të gjitha ministrinë dhe komunat duhet të jenë të detyruara të ngrenë mekanizma të përshtatshme institucionalë të barazisë gjinore, me burime të mjaftueshme të dhëna nga buxheti dhe me aftësi të mjaftueshme profesionale, për të bashkërenduar zbatimin e këtij ligji dhe për të siguruar respektimin e standardeve të barazisë gjinore.

128. Nenet 9.3, 10.2 dhe 10.3 duhet të shqyrtohen për të përcaktuar elementët e detyrave të tyre:

Detyrat e mekanizmave institucionalë të barazisë gjinore duhet të përfshijnë: bashkërendimin e zbatimit të këtij ligji dhe të Programit të Kosovës për Barazinë Gjinore; udhëzime për zhvillimin e politikave; bashkëpunimin me Agjencinë e Barazisë gjinore; përgatitjen e raporteve dyvjeçarë për zbatimin e Programit të Kosovës për Barazinë Gjinore dhe raporte të tjera që i paraqiten Agjencisë; dhe zbatimin e masave të tjera të përgjithshme të parashikuara nga ky ligj.

129. Nenet 9.4 dhe 10.4 duhet të shqyrtohen që të lexojnë:

Mekanizmat institucionale të barazisë gjinore duhet të veprojnë në përputhje me aktet nënligjore për ngritjen e tyre.

Neni 15 Njësia e barazisë gjinore në institucionin e Avokatit të Popullit

130. Kjo dispozitë duhet të përcaktojë IAP-në si një organ barazie që merret me ankesat për diskriminim. Ai duhet të jetë në përputhje me Ligjin për Avokatin e Popullit dhe meqë ky ligj nuk e përcakton strukturën e zyrës në mënyrë të tillë që të përfshijë njësinë e barazisë gjinore, as kjo nuk duhet të jetë pjesë e Projektligjit. "Njësia e barazisë gjinore në institucionin e Avokatit të Popullit" në këtë dispozitë duhet të zëvendësohet nga "Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë".

Neni 16 Mbledhja e informacionit dhe statistikave gjinore

131. Përmbajtja e këtij Neni është përfshirë tashmë në masat e përgjithshme që kërkohen nga të gjitha institucionet dhe kështu mund të hiqet³¹⁷.

132. Megjithatë, rëndësia që i jepet mbledhjes dhe analizës së të dhënave dhe statistikave të ndara sipas seksit nga Komiteti i CEDAW-t dhe Këshilli i Europës mund të kërkojnë një Nen të veçantë, për ta theksuar më shumë kërkesën për të ndërmarrë aktivitete të tilla. Në rast se zgjidhet të bëhet kjo gjë, ky Nen duhet të thjeshtohet duke kombinuar Nenin 16.1 dhe 16.2, që kryesisht kanë të njëjtin kuptim. Megjithatë, kjo dispozitë atëherë duhet konkretisht të përfshijë "buxhetin" në objektin e tij. Përveç kësaj, Neni 16.3, nëse do të mbahet, duhet të jetë më i qartë për çka do të thotë përfshirja e një "aspekti gjinor" ose "një treguesi gjinor".

133. Neni 16.4 nuk i takon Projektligjit dhe duhet të hiqet.

Neni 17 Partitë politike

134. Ndërsa kërkesa që partitë politike të nxisin përfaqësimin e barabartë të grave është për t'u lavdëruar, refuzimi i tyre për ta bërë këtë nuk shkakton sanksione, në rast se nuk lidhet me Ligjin e zgjedhjeve dhe Ligjin për financimin e partive politike. Përveç kësaj, kjo dispozitë me sa duket do ta bënte të paligjshëm, për shembull, krijimin e një Partie të Grave.

135. Megjithatë, kjo dispozitë duhet të lexohet edhe në përputhje me rrethanat aktuale të Kosovës, ku partitë politike janë plotësisht të dominuara nga burrat dhe një dispozitë e tillë e dobët për promovimin e barazisë gjinore në partitë politike mund të jetë akoma e dobishme si një kujtesë për politikën e partive.

136. Gjithsesi, partitë duhet të respektojnë kuotën 40% në paraqitjen e listave të kandidatëve

³¹⁷ Shih paragrafin 73.

gjatë zgjedhjeve dhe Ligji Elektoral duhet të amendohet për të pasqyruar një kërkesë të tillë dhe për të siguruar zbatimin me diskualifikim nga zgjedhjet të atyre partive që nuk e përmbushin këtë kuotë. Një paragrafi i ri duhet të shtohet për ta bërë këtë të qartë:

Partitë politike duhet të ndjekin parimin e përfaqësimit të barabartë gjinor në paraqitjen e listave të kandidatëve për zgjedhje në të gjitha nivelet e autoritetit shtetëror.

137. Versioni në anglisht i Nenit 17 duhet të redaktohet me qëllim për të përdorur “promovuar” në vend të “rritur”.

Neni 18 Shoqëria civile

138. Projektligji nuk duhet të parashikojë detyrime për organizatat e shoqërisë civile, por për mekanizmat institucionale të barazisë gjinore për të bashkëpunuar me shoqërinë civile. Kjo e fundit është ndërkohë e mbuluar te përgjegjësitë e Agjencisë së Barazisë Gjinore³¹⁸ por kjo ia vlen të nënvizohet në një Nen të veçantë. Do të ishte më e udhës që Neni i amenduar ta ndiqte atë që ka të bëjë me funksionet dhe përgjegjësitë e Agjencisë.

Neni 19 Ndalimi i diskriminimit gjinor në punësim dhe profesion

139. Kjo dispozitë është në përputhje me Direktivën 2006/54/EC.

Neni 20 Ndalimi i diskriminimit gjinor në skema profesionale të sigurimeve shoqërore

140. Kjo dispozitë është në përputhje me Direktivën 2006/54/EC.

Neni 21 Detyrimet e punëdhënësit në marrëdhëniet e punës

141. Kjo është një dispozitë shumë e hollësishme, një pjesë e të cilës është mbuluar ndërkohë nga Neni 19. Për shembull, përcaktimi i diskriminimit të tërthortë te paragrafi 1.1 dhe 1.7 është mbuluar ndërkohë nga ndalimi në Nenin 19.1.1 të diskriminimit të drejtpërdrejt dhe të tërthortë në qasjen në punësim, kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e punësimit. Në rast se qëllimi është të jepen më shumë hollësi për të siguruar më shumë qartësi, gjuha duhet të harmonizohet dhe redaktohet.

142. Kështu, pjesa e fundit e fjalisë së parë të paragrafit 1.1 në tekstin në anglisht duhet të redaktohet që të lexojë:

Dhe të sigurojë mundësi të barabarta për gratë dhe burrat për të bërë kërkesa për poste të lira.

Fjalja e dytë në tekstin në anglisht po ashtu duhet të redaktohet që të lexojë:

Nxitja e seksit të nën-përfaqësuar për të bërë kërkesë nisur nga njoftimi i një vendi të lirë pune, në rastet kur një post i lirë i takon një kategori pune pa përfaqësim të barabartë të burrave dhe grave, nuk duhet të përbëjë diskriminim.

143. Pjesa e fundit e këtij paragrafi 1.2 duhet të lexojë “personat e njërit seks”.

144. Paragrafi 1.4 duhet të përdorë “burrat dhe gratë” në vend të “meshkujt dhe femrat”.

145. Në paragrafin 1.8, fjala “gjinitë” duhet të hiqet.

146. Paragrafi 1.9 duhet të redaktohet që të lexojë “pagë e barabartë për punë të barabartë dhe punë me vlerë të barabartë” në përputhje me Nenin 141 të Traktatit të BE-së.

147. Paragrafi 1.10 është në përputhje me Direktivën 2006/54/EC.

148. Paragrafi 1.12 është në përputhje me Direktivën e KE-së 2006/54/EC, por në anglisht fjala “korrespondon” duhet të zëvendësohet me fjalën “kombinon”.

³¹⁸ Shih paragrafin 104.

149. Ndërsa paragrafi 1.13 është e njëjta dispozitë si në Ligjin shqiptar për Barazinë Gjinore në shoqëri, këtu është vetëm deklarues, duke qenë se dispozita që gra të tilla:

Duhet të përfitojnë nga shërbimet e komunitetit, politikat e punës dhe të punësimit dhe trajnimi profesional i bazuar në legjislacionin në fuqi.

nuk është marrë nga legjislacioni shqiptar. Po ashtu, Këshilli i Europës ka rekomanduar që:

Të gjithë personat e papaguar që i kushtohen punëve të shtëpisë, duhet të vihen në pozitë të barabartë me punëtorët në lidhje me mbrojtjen në raste pleqërie dhe paaftësie, ose duhet të kenë të drejtë për përfitime vjetërsie apo invaliditeti pa kontribuar, ose duhet të lejohen të futen në një skemë sigurimi vullnetare për moshë të vjetër ose për paaftësi në sistemin e sigurimeve shoqërore³¹⁹.

150. Megjithatë, duke qenë se paragrafi 1.13 nuk parashikon ndonjë detyrim për një punëdhënës, duhet të hiqet, ose të vihet gjetkë, vetëm nëse edhe ai do të përfshijë disa përfitime që kërkon “kontributi në zhvillimin e familjes dhe të shoqërisë”.

151. Paragrafi 2 është në përputhje me Direktivën e KE-së 2006/54/EC.

Neni 22 Ndalimi i diskriminimit gjinor në qasjen dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve

152. Kjo dispozitë është në përputhje me Direktivën e KE-së 2004/113/EC.

Neni 23 Përputhshmëria

153. Kjo dispozitë është marrë nga Direktiva e KE-së 2006/54/EC, por mund të jetë tepër e përgjithshme për Projektligjin. Ajo duhet të jetë pjesë e Projektligjit për diskriminimin ose e Kodit të Punës. Ndryshe, duhet të jetë pjesë e seksionit të mbrojtjes ligjore/sanksioneve.

Neni 24 Ndalimi i diskriminimit gjinor dhe trajtimit të pabarabartë

154. Kjo dispozitë, që trajton arsimin, është më pak e zhvilluar në krahasim me dispozitat që trajtonin punësimin. Ajo duket se ndjek Ligjin shqiptar për Barazinë Gjinore në shoqëri. Megjithatë, dispozitës i mungon një pjesë e rëndësishme nga Ligji shqiptar dhe Ligji aktual është më i qartë në disa pjesë. Kështu, atij i mungon dispozita e qartë për të drejtën e barabartë për arsim, e cila është thelbësore kur marrim parasysh gjendjen në Kosovë të evidentuar nga statistikat për regjistrimin në shkollë të vajzave. Për më tej, kjo dispozitë duhet të përputhet më shumë me Nenin 10 të CEDAW-t dhe të përcaktojë më tej se institucionet arsimore duhet të mos diskriminojnë në procesin e pranimeve, qasjen në shërbime, në objekte dhe përfitime, të tilla si bursa, rezultatet e vlerësimit, marrjen e diplomave dhe gradëve shkencore, qasjen në trajnim profesional, ndjekjen e arsimin, sporteve, etj.

155. Paragrafi 1 duhet të përfshijë “nga” dhe jo vetëm “në”. Ai duhet të deklarojë më tej përpara “ndalohej” dhe pas “në të gjitha nivelet”:

Përfshirjen në qasjen në arsim, procesin e pranimit, qasjen në shërbime, mjete dhe përfitime të tilla si bursa, rezultatet e vlerësimit, marrjen e diplomave dhe gradëve shkencore, qasjen në trajnim profesional, ndjekjen e arsimin, sporteve, etj.

156. Faza hapëse e Paragrafit 2, në tekstin në anglisht, duhet të deklarojë:

Sa më poshtë duhet të përbëjë diskriminim bazuar në seks.

157. Paragrafi 2.1 është i paqartë në anglisht dhe i paqartë në përkthimin në anglisht të tekstit shqip. Nëse interpretimi im është i saktë, ai duhet të ndalojë:

³¹⁹ Rekomandim i Këshillit të Europës nr. R (87) 5 të Komitetit të Ministrave për dërgimin e përfitimeve të vjetërsisë dhe të paaftësisë që gjenden përgjithësisht.

Çdo kufizim të bazuar në gjini apo barrierë për krijimin e mjeteve të nevojshme, për t'u arsimuar në institucione publike apo private, të cilat ofrojnë arsim apo kualifikime të tjera dhe shërbime trajnimi.

158. Paragrafi 2.2 është përsëri i paqartë dhe siç e lexoj unë, ai duhet të ndalojë:

Ofrimin e mundësive të ndryshme për burrat dhe gratë në zgjedhjen e fushës së veçantë të studimit, trajnim apo diplomim, dhe në lidhje me kohëzgjatjen e klasave, përveçse kjo përlligjet nga një qëllim i ligjshëm dhe mjetet për arritjen e atij qëllimi janë ato që duhen dhe të nevojshme.

Neni 25 Edukimi i barazisë gjinore

159. Në përdorimin e Ligjit për Barazinë Gjinore në shoqëri si një shembull, një element i rëndësishëm i tij që duhet vënë në dukje është që materialet edukative kanë një rol për:

Nxitjen dhe ndërtimin e një mentaliteti të barazisë dhe në parandalimin e diskriminimit gjinor, stereotipave negative, paragjyqimeve gjinore, dhe praktikave të kanunit ose çdo praktikë tjetër që shkel parimet e barazisë gjinore.

Gjithashtu, duhet të kihet parasysh se CEDAW bën thirrje për:

Eliminimin e konceptit stereotip të roleve të burrave dhe grave.³²⁰

Dhe që Këshilli i Evropës i ka ftuar Shtetet anëtare të tij të:

Përfshijnë në programet e shkollave aktivitete edukative dhe trajnuese që synojnë sensibilizimin e të rinjve për barazinë gjinore dhe përgatitjen e tyre për qytetari demokratike³²¹.

160. Paragrafi 1 duhet pra të zgjerohet dhe pas “barazisë gjinore” të thotë:

Dhe edukimi me barazinë gjinore duhet të përfshihet në programin e shkollave në të gjitha nivelet.

161. Po ashtu, paragrafi 2 duhet të zgjerohet për të përfshirë pas “perspektivës gjinore”:

Dhe eliminimin e stereotipave negative, paragjyqimeve, dhe praktikave tradicionale dhe praktikave të tjera që bien ndesh me barazinë gjinore.

Neni 26 Barazia gjinore në media

162. Neni 5 i CEDAW-t kërkon që të merren masa për të arritur:

Eliminimin e paragjyqimeve dhe të praktikave zakonore dhe të gjitha praktikave të tjera të bazuara në idenë e inferioritetit apo superioritetit të secilit prej sekseve ose të roleve stereotip të burrave dhe grave.

Për më tej, Komiteti i CEDAW-t bën thirrje për:

Përfshirjen e të gjitha formave të medias në programe të edukimit publik për cilësinë e grave dhe burrave, dhe për të siguruar në veçanti, që gratë të jenë të vetëdijshme për të drejtën e tyre për barazi pa diskriminim.³²²

Paragrafi 1 i kësaj dispozite shërben kështu si një kujtesë për median për rolin e tyre në eliminimin e diskriminimit.

³²⁰ CEDAW, Neni 10.

³²¹ Rekomandim i Këshillit të Europës Rec(2003)3 I Komitetit të Ministrave, për pjesëmarrjen e ekuilibruar të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike, 12 mars 2003.

³²² Komiteti i CEDAW-t, Rekomandim i Përgjithshëm nr. 28 për detyrimet bazë të Shteteve palë sipas Nenit 2 të CEDAW, CEDAW/C/GC/28, 2010.

163. Paragrafi 2 përmban ndalimin aktual. Çështja është se si mund të zbatohet një ndalim i tillë, sidomos në lidhje me burimet private të medias dhe nëse ky ndalim mund të ndikojë në të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes. Udhëzime për përdorimin e këtij ndalimi do të nevojiten dhe mund të merren nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për gjuhën e urrejtjes.

Neni 27 Pasuria e Përbashkët gjatë Martesës

164. Këshilli i Europës u rekomandon qeverive që të marrin në konsideratë mundësinë e miratimit të sistemeve të bashkëpronësisë dhe bashkëdhënies me qira si një nga mjetet për forcimin e të drejtës së zënies të shtëpisë familjare³²³. Përveç kësaj, Këshilli i Europës ka rekomanduar që,

*Asnjë traditë kulturore ose zakon shoqëror që ndikon negativisht, në veçanti, ndaj gëzimit të plotë nga gratë dhe vajzat të të drejtave të njeriut ose të dinjitetit të tyre njerëzor nuk duhet të pranohet apo tolerohet*³²⁴.

165. Kjo është një temë që është rregulluar mirë tashmë në Ligjin e Kosovës për Familjen dhe Ligjin për Trashëgiminë, i cili parashikon pronësinë e përbashkët të të dy bashkëshortëve. Megjithatë, zbatimi i këtij ligji mbetet problematik duke pasur parasysh traditën kulturore ku trashëgimia dhe e drejta e pronësisë ndjekin linjën mashkullore³²⁵. Pra, një i intervistuar i raportoi grupit të punës së projektit të përbërë nga ekspertë vendorë dhe të huaj që përgjigjen për hartimin e propozimit të reformës institucionale se ai ishte orvatur ta regjistronte pronën që ai dhe e shoqja e kishin blerë në emrin e të dyve, por nëpunësi i kadastrës nuk kish pranuar ta bënte këtë për shkak se kontrata e blerjes ishte vetëm në emrin e tij.

166. Titulli i kësaj dispozite duhet t'i referohet, në anglisht, "pronë e përbashkët" dhe jo "pasuri e përbashkët".

167. Dispozita duhet ndoshta së pari, të trajtojë më në përgjithësi barazinë e të gjithë personave, pavarësisht nga statusi familjar apo martesor (ajo mund të titullohet për shembull, "Marrëdhëniet martesore dhe familjare") duke parashikuar që "të gjithë personat duhet të jenë të barabartë, pavarësisht nga statusi familjar apo martesor". Përveç kësaj, ai mund të parashikojë që:

Bashkëshortët me martesë dhe me marrëdhënie faktike duhet të kenë të drejta dhe përgjegjësi të barabarta, duke përfshirë edhe në administrimin dhe transferimin e pasurisë së përbashkët në përputhje me ligjin.

168. Ligji për familjen në Kosovë parashikon mbrojtje ndaj martesave të hershme, por i lejon ato duke filluar nga moshë 16 vjeçe, pasi gjykata kompetente të jetë bindur se është arritur "pjekuria fizike dhe psikologjike" dhe pasi ka dëgjuar të miturit, prindërit dhe organin kujdestar³²⁶. CEDAW, në Nenin 16, parashikon anulimin e efektit ligjor të martesave të fëmijëve dhe bën thirrje që ligjet të specifikojnë një moshë minimale për martesë. Komiteti i CEDAW-t rekomandon që moshë minimale për martesë duhet të jetë 18 vjeçe³²⁷. Ligjvënësi duhet të ketë parasysh mundësinë për zgjerimin e mbrojtjes së Ligjit për familjen në moshën 18 vjeçe. Ky ligj mund të parashikojë më tej se,

Martesat e fëmijëve nuk lejohen dhe nuk do të kenë asnjë efekt ligjor.

323 Rekomandim i Këshillit të Europës nr. R (81) 15 për të drejtat e bashkëshortëve që lidhen me zënie e shtëpisë familjare dhe përdorimin e orendive të familjes, 16 tetor 1981.

324 Rekomandim i Këshillit të Europës nr. CM/Rec(2007)17 i Komitetit të Ministrave për standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore, 21 nëntor 2007.

325 Norma Lawyers Association, *Studimi dhe Monitorimi i zbatimit të Ligjit të Barazisë Gjinore*, 2011.

326 Ligji për Familjen në Kosovë 2004/32, *Nenet 15 dhe 16*.

327 Rekomandim i Përgjithshëm i CEDAW-t Nr. 21 për barazinë në martesë dhe marrëdhëniet familjare, CEDAW/C/GC/21,1994.

169. Paragrafi ekzistues mund të vendoset pas parashikimit më të përgjithshëm të posa sugjeruar për barazinë e bashkëshortëve, ku pjesa e fundit e Paragrafit 4 “dhe nuk duhet të tjetërsohet pa pëlqimin e bashkëshortëve” të shtohet në fund; dhe pas ndalimit të sugjeruar të martesave të fëmijëve.

170. Paragrafi 2 mbulohet ndërkohë nga Paragrafi 1 dhe duhet hequr.

171. Paragrafët 3 dhe 4 mbulohen nga Ligji për Familjen dhe duhen hequr.

172. Paragrafi 6 duhet të jetë më në përputhje me Ligjin për trashëgiminë, dhe duhet të jetë:

Gratë dhe burrat në të njëjtat kushte janë të barabartë në trashëgimi.

Nenet 28-37 në Kapitullin VIII

173. Teksti origjinal i Ligjit aktual parashikonte një Avokat të Përgjithshëm për të marrë ankesa që pretendonin diskriminim, por, gjatë procesit të shpalljes së tij, Përfaqësuesi i Posaçëm i UNMIKU-it i Sekretarit të Përgjithshëm e zëvendësoi Avokatin e Përgjithshëm me Institutin e Avokatit të Popullit për të mos lejuar mbivendosjen e juridiksioneve.

174. Projektligji parashikon në këtë dispozita vendosjen e një tjetër Përfaqësuesi ligjor në Agjenci për të marrë ankesa, por kjo përsëri do të shpinte në dyfishimin e të drejtave të Avokatit të Popullit, do të ishte e kushtueshme dhe nuk do të ishte në përputhje me Projektligjin për diskriminim. Për këtë arsye, Nenet 28-37 të Kapitullit VIII duhet të hiqen.

Mbrojtja ligjore

175. Direktiva e KE-së 2006/54/EC parashikon se ofrimi i procedurave të përshtatshme gjyqësore ose administrative të zbatimit është thelbësor për zbatimin efikas të parimit të trajtimit të barabartë. Këshilli i Europës parashikon që mjetet efikase rregulluese dhe sanksionet e shkruajnë diskriminim me anë të, për shembull,

Urdhrave për të parandaluar diskriminimin (ndalimin apo kërkimin e ndërprerjes së një akti, kryerjen e një akti të caktuar, lënien mënjantë të një vendimi me natyrë diskriminuese); sanksione të përshtatshme në rast mosrespektimi të urdhrave të tillë, sanksione administrative dhe, sipas nevojës, akte penale për të ndëshkuar akte diskriminimi (të tilla si gjokat, pezullimi i licencës, bërja e njohur publikisht e diskriminimit); dhe dëmshpërblime për të kompensuar viktimat e diskriminimit³²⁸.

176. Çështja e mbrojtjes ligjore është identifikuar si një e metë në Ligjin aktual dhe kështu Projektligji duhet të jetë më i qartë për mjetet rregulluese.

177. Mbrojtja ligjore që duhet garantuar nga ky Projektligj duhet të përfshijë ankesat te Avokati i Popullit, si dhe procedurat administrative, civile, penale, disiplinore dhe procedurat për vepra të lehta dhe së fundi apelimet në gjykatën kushtetuese. Megjithatë, jo të gjitha këto mjete rregulluese duhet të përcaktohet që të gjitha në Projektligj. Për këtë arsye, ky i fundit duhet të përfshijë një dispozitë të përgjithshme mbrojtëse se asgjë në Kapitullin VIII – i cili duhet shkruar me Kapitullin IX dhe t’i jepet titulli i këtij të fundit – nuk mund të interpretohet si një kufizim për të filluar procedura gjyqësore, duke lexuar,

Asgjë në këtë Kapitull nuk duhet interpretuar në mënyrë të tillë që të kufizojë të drejtën për të filluar procedura civile, penale apo për vepra të lehta për shkeljen e të drejtave të garantuara nga ky ligj.

178. Ligji për Avokatin e Popullit dhe Projektligji për diskriminim parashikojnë proce-

³²⁸ Rekomandim i Këshillit të Europës nr. R (85)2 i Komitetit të Ministrave për mbrojtjen ligjore nga diskriminimi në bazë seksuale, 5 shkurt 1985.

durën e ankimit te Avokati i Popullit, kështu që Projektligji duhet thjesht të parashikojë që kjo vlen për ankesat ndaj mospërputhshmërisë me dispozitat e tij.

179. Neni 193 i Ligjit Penal parashikon mbrojtje ndaj shkeljes së statusit të barabartë të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës dhe në Projektligj duhet të parashikohet se kjo mbrojtje duhet interpretuar në dritën e dispozitave të këtij Projektligji.

180. Ligji për veprat e lehta që nga koha e ish Jugosllavisë³²⁹ është ende i zbatueshëm në Kosovë për të udhëhequr procedurat e veprave të lehta. Zbatimi i këtij ligji duhet të përcaktohet qartë në Nenin 29 (Dispozitat për ndëshkimin)³³⁰.

181. Ligji për Procedurat Administrative rregullon procedurën për personat që preken negativisht nga një vendim administrativ dhe Projektligji duhet ta bëjë të qartë se ai është i zbatueshëm kur nuk respektohen dispozitat e tij.

182. Ligji për Inspektoratin e Punës parashikon mundësinë që nëpunësit të bëjnë ankesa në Inspektoratin e Punës për çështje që hyjnë në kompetencat e këtij organi. Konsiderata serioze duhet t'i jepet zgjerimit të juridiksionit të Inspektoratit të Punës ndaj dispozitave të marrëdhënieve të punës të Projektligjit, duke pasur parasysh mbrojtjen e madhe të ofruar nga këto dispozita dhe mjetet e efektshme që mund të sigurohen prej tyre në vendosjen e të drejtës. Megjithatë, kjo do të kërkonte konsultime të mëtejshme dhe amendamente në ligjet përkatëse.

Neni 38 Mbrojtje gjyqësore

183. Gjithsesi, procedurat civile janë ndoshta ato më të përdorura dhe do të ishte mirë që të përcaktohen të gjitha hollësitë e duhura – duke përfshirë barrën e provës, gjykatat që do të kenë juridiksion, personat që mund të nisin procedura dhe nëse çështja mund të përshpejtohet – qoftë në Projektligjin, apo në Projektligjin për diskriminimin. Në rast se procedura do të përcaktohej plotësisht në Projektligj, ligji serb i Barazisë gjinore mund të përdorej si një model i mirë.³³¹ Megjithatë, duke qenë se synimi është që Projektligji për diskriminimin do të përcaktojë procedurën që duhet ndjekur, do të ishte e mjaftueshme që Projektligji thjesht të specifikonte se kjo procedurë përdoret për ankesat që kanë të bëjnë me dispozitat e tij.

184. Neni 38 duhet si rrjedhojë të shqyrtohet që të thotë se:

Kur një person i cili e konsideron veten si viktimë të diskriminimit, konstaton se e drejta e tij për një trajtim të barabartë është shkelur bazuar në gjininë e vet, ai person duhet të ketë mundësi të kërkojë mbrojtje në një gjykatë kompetente në përputhje me procedurën për mbrojtje nga diskriminimi (duke përfshirë pagesën e kompensimit) janë përputhje me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Neni 39 Kompetencat rajonale

185. Kjo dispozitë duhet të bëhet pjesë e Nenit 38 me qëllim për të përcaktuar gjykatën kompetente, me përjashtim kur do të mjaftonte që për këtë të përdorej përsëri Projektligji për diskriminimin. Megjithatë, nëse mbetet, titulli në anglisht duhet të jetë “Kompetencat territoriale”.

Neni 28 Masa disiplinore (ky Nen nuk ishte rinumëruar në Projektligj)

186. Nuk është e qartë se përse masat disiplinore i referohen vetën Nenit Neni 21.1.8 (nuk ishte përdorur mosdiskriminimi në sistemin e klasifikimit të punëve). Po ashtu, është e paqartë nëse masat disiplinore të përmendura këtu janë të zbatueshme në përputhje me procedurën administrative apo procedurat e Inspektoratit të Punës. Kjo dispozitë duhet të hiqet.

Neni 29 Dispozitat e ndëshkimit (ky Nen nuk u rinumërua në Projektligj)

³²⁹ Gazeta Zyrtare e Kosovës, nr. 23/79.

³³⁰ Kjo dispozitë nuk është numëruar në Projektligj, shih paragrafët 188-189.

³³¹ Ligji i Barazisë Gjinore, Serbi, Nenet 43-51; shih Shtojcën.

187. Referencat në këtë dispozitë janë ngatërruar dhe kështu është vështirë të komentosh për to. Projektligji duhet të përcaktojë se shkelja e cilave dispozita do të përbënin një vepër të lehtë dhe të përcaktonte sanksionet e zbatueshme. Me qëllim për të qenë të qartë për sjelljen që sipas Projektligjit do të përbënte një shkelje të lehtë, sjellja duhet të përsëritet. Për shembull:

Një punëmarrës i cili përfshin elementë diskriminues në njoftimet për punë në shkelje të Nenit (...) të këtij ligji do të dënohet me gjobë nga (...) deri në (...).

188. Sasia e përcaktuar si e pagueshme për gjrobat po ashtu duhet të harmonizohet me Projektligjin për Diskriminimin.

Neni 31 Shfuqizime

189. Projektligji nuk duhet të shfuqizojë aktet nënligjore që kanë të bëjnë me çështje që duhet ende të rregullohen me akte nënligjore përpara se të miratohen aktet e reja që do të dalin në bazë të Projektligjit pas miratimit të tij. Paragrafi 3 duhet pra, të hiqet.

Rekomandime përmbyllëse

190. Ligjvënësit duhet të marrin parasysh përfshirjen në Projektligj të ndalimit të diskriminimi bazuar në seks në ushtrimin e të drejtave ndaj kujdesit shëndetësor, duke përfshirë parandalimin dhe zbulimin e hershëm të sëmundjeve, kujdesin për shëndetin riprodhues: gjatë shtatzënisë, ndenjes në shtëpi dhe lindjes, kujdesin shëndetësor në raste sëmundjesh dhe dëmtimesh dhe kujdesin shëndetësor në planifikimin familjar përveç mbrojtjes së përgjithshme nga diskriminimi të ofruar nga Projektligji për diskriminimin.

191. UNFPA-ja ka sugjeruar përfshirjen e ndalimit të aborteve pas përzgjedhjes së seksit të fëmijës dhe sanksioneve ndaj individëve dhe institucioneve shëndetësore. Megjithatë, një hetim për përshtatshmërinë dhe nevojën e një dispozite të tillë është përtej qëllimit të këtij opinioni.

5. PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE

192. Qëllimi i Projektligjit duhet t'i referohet edhe **institucioneve publike edhe atyre private**. Ai duhet të përfshijë personat me karakteristika të mbrojtura të ndërrimit të gjinisë.

193. Përkufizimet duhet të përfshijë **seksin, gjininë, personat me karakteristika të mbrojtura të ndërrimit të gjinisë, dhe dhunën ndaj grave**.

194. Përkufizimi i **përfaqësimit të barabartë të burrave dhe grave** duhet të formulohet në mënyrë pozitive dhe e njëjta terminologji duhet përdorur gjatë gjithë ligjit.

195. Projektligji duhet të përfshijë një **ndalim të qartë të diskriminimit të drejtpërdrejt dhe të tërthortë**, dhe duhet të sigurojë që ndalimi i diskriminimit ndaj grave të përfshijë bazën e statusit martesor, shtatzëninë, racën, paaftësinë, orientimin seksual, etj, në harmoni me Projektligjin për diskriminimin dhe CEDAW-n. Vetëm një Nen duhet t'i kushtohet kësaj teme.

196. Projektligji duhet të përcaktojë shumë qartë përgjegjësitë e të gjitha institucioneve të Kosovës në lidhje me barazinë gjinore. Kjo duhet të përbëjë pjesën kryesore të këtij ligji, dhe kjo mund të jetë pjesa e **masave të përgjithshme** që kërkohen nga të gjitha institucionet me qëllim për të dërguar mesazhin se respektimi dhe promovimi i barazisë gjinore është detyrë e të gjitha institucioneve dhe se përgjegjësitë e tyre duhet të përfshijnë analizën gjinore, plane specifike veprimi, përfshirjen e këndvështrimit gjinor në të gjitha politikat dhe ligjet, rekrutime dhe emërimet të ndjeshme ndaj gjinisë, buxhetimin gjinor dhe mbledhjen e të dhënave të ndara sipas seksit.

197. **Masat e posaçme (afirmative)** duhet të lidhen me synimin e përfaqësimit të barabartë

(të paktën 40% e seksit të nën-përfaqësuar).

198. Një kapitull i veçantë i duhet kushtuar **mekanizmit institucional të barazisë gjinore**.

199. Një vendim duhet marrë në lidhje me faktin se sa specifik duhet të jetë Projektligji dhe cilat çështje duhen rregulluar me akte nënligjore, për të shmangur nevojën për amendamente tepër të shpeshta. Përcaktimi i titullit dhe i pozitës së njësisë qendrore të bashkërendimit të politikave të barazisë gjinore mund të rregullohet me një akt nënligjor, por çdo ndryshim në organizimin aktual mund ta dobësonte **Agjencinë e Barazisë gjinore**, duke qenë se ajo është ndërkohë r vendosur mirë në nivelim më të lartë të mundshëm në qeveri, duke qenë kështu në gjendje të punojë me efektivitet me ministritë e tjera, dhe duke qenë se është shumë e rëndësishme që Agjencia të ketë mbështetje të mjaftueshme politike dhe të jetë sa më e dukshme më punën që bën. Rruga më e mirë e mundshme mund të ishte që të **specifikohet emri dhe pozita e Agjencisë** në Projektligj, por organizimi i saj duhet të rregullohet me një akt nënligjor.

200. Projektligji duhet të qartësojë funksionet dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Barazisë gjinore për të përfshirë **rishikimin e ligjeve dhe të dokumenteve të tjera të politikave; rritjen e kapaciteteve për standardet e barazisë gjinore**, duke përfshirë instrumentet e përfshirjes së këndvështrimit gjinor dhe buxhetimit gjinor për të gjitha institucionet, dhe të mos jetë e kufizuar vetëm te nëpunësit dhe njësitë e barazisë gjinore; dhe analizën e statusit të barazisë gjinore në Kosovë.

201. **Programi i Kosovës për Barazisë gjinore** është dokumenti kryesor dhe më i dukshëm strategjik për veprim në fushën e barazisë gjinore. Çdo mbledhje fondesh nga donatorët do të varet nga forca e këtij Programi. Për të qenë më i qartë, duhet të mbulohet në një Nen të veçantë, ku përgjegjësia për hartimin e Programit të ri dhe të programeve të ardhshme t'i caktohet Agjencisë së Barazisë gjinore dhe Qeverisë, nën mbikëqyrjen e Kuvendit, duke pasur përgjegjësi të plotë për të gjitha këto programe.

202. Në ndryshim nga pozita e Agjencisë së Barazisë gjinore, duhet t'u lihet në dorë **ministrive dhe komunave** që të përcaktojnë **organizimin e tyre institucional të barazisë gjinore**, sepse nevojat e veçante të çdo ministrie dhe komune do të jenë të ndryshme. Megjithatë, të gjitha ministritë dhe komunat duhet të kenë të paktën një nëpunës apo pikë fokale të barazisë gjinore, me buxhet të mjaftueshëm, ndërsa nëpunësit ekzistues të barazisë gjinore duhet të përdoren për shkak të trajnimit, përvojës dhe njohurive institucionale të kanë. Organizimi dhe detyrat e tyre duhet të përcaktohen në aktet nënligjore, por duhet të përfshijnë: bashkërendimin e zbatimit të këtij ligji dhe të PKBGJ-së; udhëzime për zhvillimin e politikave; bashkëpunim me Agjencinë e Barazisë Gjinore; përgatitjen e raporteve dy-vjeçare për zbatimin e PKBGJ-së dhe raporte të tjera të paraqitur në Agjenci; dhe zbatimin e masave të tjera të përgjithshme të parashikuara me këtë ligj.

203. **Institucioni i Avokatit të Popullit** në Kosovë duhet të mbetet **organi i barazisë** që merret me ankesa për diskriminim gjinor. Futja e një përfaqësuesi ligjor në Agjenci për të marrë ankesat, do të shpinte në dyfishim të të drejtave të IAP-së, që do të ishin të kushtueshme dhe jo në përputhje me Projektligjin për Diskriminimin.

204. **Partitë politike** duhet të respektojnë kuotën prej 40% në paraqitjen e listave të kandidatëve gjatë zgjedhjeve dhe Projektligji duhet të kërkojë që kjo të bëhet.

205. **Mbrojtja ligjore** ishte një nga aspektet e Ligjit aktual që nuk u kritikua se ishte i paqartë. Mbrojtja ligjore e barazisë gjinore duhet të përfshijë juridiksion administrativ, civil, penal, disiplinor dhe juridiksion të veprave të lehta, si dhe procedurën e ankimit të IAP-së, apelimet në Gjykatën Kushtetuese dhe mundësisht edhe në Inspektoratin e Punës. Megjithatë, të gjitha këto mjete rregulluese duhet të përcaktohen me hollësi në Projektligj. Procedura civile ka gjasa

të përdoret më shumë kështu që do të ishte me dobi që hollësitë përkatëse për këtë të përcaktohen ose në Projektligj, ose në Ligjin për diskriminimin.

206. Konsideratë serioze i duhet dhënë zgjerimit të juridiksionit të **Inspektoratit të Punës** ndaj dispozitave të marrëdhënieve të punës në Projektligj. Kjo do të kërkonte konsultime të mëtejshme dhe amendamente në ligjet përkatëse, por mund të pritet që të ofrojë zgjidhje efikase për shkelje të të drejtave në këtë fushë pa pasur nevojë për mbështetje vetëm në sistemin gjyqësor.

207. Projektligji duhet të përcaktojë qartë atë çka përbën veprë të lehtë sipas dispozitave të tij, si dhe të përcaktojë shkallën e gjobave dhe sasive të tjera të pagueshme për shkelje të këtyre dispozitave.

6. KONKLUZION

208. Miratimi i Projektligjit paraqet një rast për të pasur një instrument ligjor vërtet të mirë i cili duhet të përshtatet sipas rrethanave aktuale në Kosovë dhe të jetë në harmoni me ligjet e tjera, duke përfshirë Ligjin për diskriminimin dhe Ligjin për Avokatin e Popullit. Projektligji mund të adresojë sigurisht të metat e identifikuara në Ligjin aktual dhe të qartësojë funksionet dhe përgjegjësitë për të nxitur një zbatim më të shpejtë.

209. Gjithsesi, nuk ka gjasa që Projektligji të ketë ndikim të madh në problemet e zbatimit, të paktën fillimisht, në se nuk ka një mbështetje të qartë politike, nëse pronësia e nevojës për barazi gjinore nuk merret nga fushat e politikëbërjes, dhe kapacitetet e institucioneve që përdorin instrumente të përfshirjes së këndvështrimit gjinor nuk rriten. Zbatimi me sukses do të varet më shumë nga rritja e vetëdijesimit dhe vizibiliteti për përdorimin e mjeteve rregulluese ekzistuese.

210. Programi i ri i Kosovës i Barazisë gjinore është një mundësi që Agjencia e Barazisë gjinore të konsultohet dhe përfshijë të gjithë autoritetet përkatëse në procesin që shpie në miratimin e tij. Ky është një rast për të përcaktuar hapat që do të promovojnë zbatimin më të mirë të programit. Duke qenë se PKBGJ-ja mbaron këtë vit, procesi i zhvillimit duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur. Megjithatë, procesi duhet të jetë shumë realist për atë që mund të arrihet brenda kohës së përcaktuar dhe ndërtimi i PKBGJ-së duhet të mbështetet te ndikimi i tij. Në diskutimin e PKBGJ-së së re, do të ishte mirë të mbaheshin parasysh rekomandimet e Raportit FRIDOM se për zbatimin me sukses nevojiten përcaktimi i qartë i masave, treguesve të suksesit dhe të burimeve buxhetore.

211. Autorja ka parë opinionet për Ligjin nr. 03/L – 195 për Avokatin e Popullit dhe Projektligjin për Ndryshim-plotësimin e Ligjit Nr. 03/L – 195 për Avokatin e Popullit të korrikut 2013 dhe për Projektligjin për Mbrojtjen nga diskriminimi dhe miraton konkluzionet dhe rekomandimet e tyre.

SHTOJCA

1. Bosnja dhe Hercegovina, Ligji për Barazinë Gjinore

Neni 23

(1) Çdo person që e konsideron veten viktimë të diskriminimit apo që konstaton se një e drejtë e tij e caktuar është shkelur për shkak të diskriminimit, duhet të jetë në gjendje të kërkojë mbrojtje të asaj të drejte përmes një procedure me të cilën kjo e drejtë duhet të vendoset si një çështje kryesore, dhe duhet të jetë në gjendje të kërkojë mbrojtje përmes një procedure të veçantë për mbrojtjen nga diskriminimi në përputhje me Ligjin për ndalimin e diskriminimit ("Gazeta Zyrtare e Bosnjës dhe Hercegovinës" Nr. 59/09).

(2) Një viktimë e diskriminimit sipas dispozitave të këtij Ligji duhet të ketë të drejtë për kompensime sipas rregullave që përcaktojnë detyrimet.

(...)

2. Serbia, Ligji i barazisë gjinore

VI MBROJTJA GJYQËSORE

Mbrojtja sipas të drejtës civile

Neni 43

Çdo njeri të drejtat dhe liritë e të cilit pretendohet se janë shkelur për shkak të gjinisë, mund të nisë procedura përpara një gjykate kompetente dhe të kërkojë që:

- 1) të përcaktohet shkelja e pretenduar që rezulton nga trajtimi diskriminues;
- 2) të jepet një urdhër gjykate që ndalon kryerjen e akteve që shkaktojnë kërcënim për shkelje
- 3) të jepet një urdhër nga gjykata që ndalon kryerjen e mëtejshme dhe/ose përsëritjen e akteve që shkaktojnë shkelje
- 4) instrumentet dhe/ose objektet që janë mjetet e shkeljes (p.sh. tekste shkollore që përfaqësojnë gjininë në mënyrë diskriminuese dhe stereotipe, gazetat, botimet, lëndë për reklama dhe për publicitet) të tërhiqen nga qarkullimi);
- 5) shkelja të hiqet dhe gjendja të kthehet ashtu si ka qenë para se të kryhej shkelja;
- 6) humbja e paprekshme dhe e prekshme të riparohet dhe kompensohet;
- 7) aktgjykimi të bëhet i ditur në masmedia, ose të botohet me shpenzimet e të pandehurit;
- 8) informacioni për palë të treta të përfshira në shkeljen e të drejtave apo lirive të bëhet i ditur.

Sindikatat apo shoqatat që merren aktivisht me barazinë gjinore mundet që, me pëlqimin paraprak të personit të diskriminuar, në emër të këtij personi, të nisin procedurat e përmendura në paragrafin 1 këtu. Këto entitete mund të bashkohen me palën paditëse në cilësinë e palës ndërhyrëse.

Në rast diskriminimi që ka të bëjë me shkeljen e pretenduar të të drejtave të më shumë se një personi, entitetet e përmendura në paragrafin 2 të tij, mund të fillojnë procedura në emër të tyre. Çdo person të drejtat e të cilit pretendohet se janë shkelur mund të bashkohet me palën paditëse në cilësinë e palës ndërhyrëse.

Pas fillimit të proceduarave dhe ose nisjes së tyre, entitetet e përmendura në paragrafin 2 të tij duhet të autorizohen të informojnë, përmes mediave të komunikimi në masë apo në çdo formë tjetër të përshtatshme, palët e tjera të lënduara, sindikatat dhe shoqatat për fillimin e procedurave civile dhe duhet t'u bëjnë thirrje atyre të bashkohen me palën paditëse në cilësinë e palëve ndërmjetësuese ose kundërshtuese.

Një paditës i ri mund t'i bashkohet më pas çështjes përveç paditësit ekzistues pa pëlqimin e të pandehurit pas përfshirjes së të pandehurit në seancën dëgjimore kryesore.

Ligji i zbatueshëm

Neni 44

Përvese se kur ky Ligj e parashikon ndryshe, dispozitat e ligjit që rregullojnë procedurat civile do të zbatohet për procese gjyqësore që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga diskriminimi me bazë gjinore.

Fillimi i procedurave

Neni 45

Procedurat civile mund të fillojnë përpara përfundimit të një procedure të nisur përpara një autoriteti kompetent për mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga punësimi dhe në bazë të punës.

Juridiksioni

Neni 46

Gjykata e rrethit do të ketë juridiksion ndaj çështjeve civile të nisura për shkak të shkeljes së barazisë gjinore.

Gjykatat në territorin e të cilave pala paditëse ka vendbanimin, vendin ku jeton apo shtëpinë duhet të ketë juridiksion ndaj çështjeve civile të referuar në paragrafin 1 të tij, përveç gjykatës që ka juridiksion në mbarë territorin.

Emergjenca e procedurave

Neni 47

Procedurat civile të nisura për mbrojtjen nga diskriminimi me bazë gjinore duhet të kryhen me urgjencë jashtëzakonisht të madhe.

Seanca e parë duhet të dëgjohet brenda një përudhë prej 15 ditësh nga bërja e padisë civile. Koha për të reaguar ndaj padisë së bërë duhet të jetë tetë ditë.

Gjykatat duhet të marrin vendim për mocionin për të urdhëruar zgjidhjen e përkohshme brenda tri ditësh që nga marrja e mocionit.

Koha për t'u deklaruar ndaj vendimit për të urdhëruar zgjidhje të përkohshme do të jetë 48 orë pas marrjes së vendimit. Deklarimit duhet t'i përgjigjen brenda 48 orëve të ardhshme.

Koha për apelim ndaj aktgjykimit të formës së prerë do të jetë tre muaj që nga marrja e tij, në përputhje me ligjin që rregullon procedimin civil.

Përfundimi nga parapagimi i shpenzimeve të procedurave

Neni 48

Në çështje gjyqësore të filluara për mbrojtjen nga diskriminimi me bazë gjinore, një paditës duhet të përfundohet nga parapagimi i shpenzimeve të procedurave, të cilat do të paguhen nga burimet e gjykatës.

Supozimi i pafajësisë dhe barra e provave në proceset gjyqësore

Neni 49

Në rastet kur palët nuk kundërshtojnë apo gjykata ka vendosur se një akt diskriminimi i drejtpërdrejt është kryer, nuk do të shtrohet më çështja e provës kur diskriminimi i drejtpërdrejt i bazuar në gjini është bërë pa faj.

Nëse gjatë procedurave, pala paditëse ka treguar se ka pasur diskriminim të mundshëm, barra e provës i mbetet të pandehurit, i cili duhet të provojë se parimi i barazisë nuk është shkelur.

Zgjidhja e përkohshme

Neni 50

Përpara ose gjatë një rasti civil për mbrojtje nga diskriminimi i bazuar në gjini, pala e lënduar dhe ose entitetet e autorizuara të nisin procedura, mund të kërkojnë që të jepet një zgjidhje e përkohshme për të ndaluar trajtimin diskriminues deri sa të mbyllet përfundimisht procedurat.

Mbështetësi i kësaj mase duhet të provojë se ka gjasa të një kërcënimi real për shkelje të të drejtave për shkak të trajtimit diskriminues dhe se pa urdhër ndalimin do të ishte shkaktuar dëm i madh

i prekshëm ose i paprekshëm.
Gjykata mund të japë një urdhër ndalim me iniciativën e vet (ex officio) në kushtet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të tij.
Apelimi i vendimit për urdhërimin e zgjidhjes së përkohshme nuk do të shtyjë zbatimin e vendimit.

Procesverbale dhe dokumente për mbrojtjen

Neni 51

Gjykata duhet t'i komunikojë ministrisë përgjegjëse për barazinë gjinore të gjitha vendimet e formës së prerë të dhëna si rezultat i çështjeve penale të filluara për mbrojtje nga diskriminimi me bazë gjinore.

Dispozita e paragrafit 1 të këtij ligji do të jetë e zbatueshme edhe për procedurat që zhvillohen përpara autoriteteve administrative.

Ministria përgjegjëse për barazinë gjinore duhet të mbajë procesverbale për të dhënat e referuara në paragrafin 1 dhe 2, si dhe dokumente të tjera të organeve përgjegjëse për të vepruar në procedurat për mbrojtjen e barazisë gjinore.

Ministri përgjegjës për barazinë gjinore duhet të përcaktojë një metodë dhe mënyrë në të cilën duhen mbajtur procesverbalet dhe dokumentet.

**OPINION PËR PROJEKTLIGJIN MBI MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI**

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Ky opinion shqyrton Projektligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe përputhshmërinë e tij me standardet Evropiane dhe ndërkombëtare. Materiali përcakton se Projektligji mishëron pothuaj të gjitha standardet Evropiane për mbrojtjen e barazisë por e bën këtë vetëm në mënyrë deklarative. Pengesa për efektivitetin qëndron tek qartësia e pamjaftueshme e mënyrës sesi viktimat e diskriminimit do t'i mbrojnë të drejtat e tyre, format e kompensimit dhe dhënien e ndëshkimeve për veprat e paligjshme. Pavarësisht nga kjo e metë serioze, Projektligji me të drejtë i jep një rol qëndror Avokatit të Popullit në adresimin e ankesave kundër diskriminimit –të cilat mund të bëhen më të qarta – por efektshmëria varet edhe nga reformat në Ligjin ekzistues për Avokatin e Popullit. Është gjithashtu thelbësore që dispozitat e Projektligjit të harmonizohen me Projektin për Barazinë Gjinore. Krahas kësaj, është imperative që këto tre Ligje të konsiderohen si një paketë koherente masash dhe jo si tre pjesë të veçanta të legjislacionit.

1. HYRJJE

1. Ky opinion vlerëson Projektligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi ('Projektligji') përkundrejt standardeve Evropiane dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si dhe praktikave të mira. Ai diskuton gjithashtu efektshmërinë e Projektligjit në rregullimin e strukturës institucionale brenda kontekstit të kornizës ekzistuese legjislative dhe institucionale në fushën e të drejtave të njeriut në Kosovë.
2. Opinioni është përgatitur nga Dejan Palic³³² në kuadër të Projektit të Përbashkët ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Përmirësimi i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Kosovë" ('Projekti'), si pjesë e një vlerësimi më të madh, i cili ka synimin të specifikojë pikat e forta dhe të dobëta të marrëveshjeve institucionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelet qendrore dhe lokale, dhe të japë ekspertizë legjislative për Projektligjin, Projektligjin për Barazinë Gjinore ('Projektligji për Barazinë Gjinore'), Ligjin për Avokatin e Popullit dhe Projektligjin për Ndryshimet dhe Shtesat në Ligjin Nr. 03/L – 195 për Avokatin e Popullit të Korrikut 2013 me synimin e krijimit të lidhjeve ndërmjet tre ligjeve dhe monitorimin e organeve/strukturave të ngritura në bazë të tyre³³³.
3. Në vlerësimin e Projektligjit, ky opinion mbështetet tek Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa Evropiane), Direktivat e Bashkimit Evropian për diskriminimin³³⁴, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatës Evropiane të Drejtësisë si dhe Rekomandimet e Politikave të Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës të Këshillit të Evropës ('ECRI'). Krahas kësaj, merr në konsideratë raportet përkatëse nga institucionet e Kosovës dhe organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare. Opinioni shqyrton gjithashtu Projektligjin në dritën e praktikës sipas Ligjit Nr. 2004/3 "Ligjin kundër Diskriminimit" ('Ligji Ekzistues') dhe brenda kontekstit edhe të legjislacionit tjetër përkatës, sidomos Ligjin për Avokatin e Popullit, dhe kornizën e përgjithshme institucionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.
4. Ky opinion merr gjithashtu në konsideratë punën e kryer si pjesë e grupit të punës së Projektit me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë përgjegjës për formulimin e propozimit për reformat institucionale.
5. Gjatë përgatitjes së opinionit, autori është takuar me palë të interesuara kombëtare dhe ndërkombëtare në përputhje me programin e takimeve të përgatitur nga Grupi i Projektit.
6. Së pari, opinioni sheh kontekstin ku ndodhet Projektligji. Më pas bën një krahasim të përgjithshëm ndërmjet Projektligjit dhe Ligjit Ekzistues, dhe një analizë Nen për Nen të dispozitave të Projektligjit. Së fundi, ka një përmbledhje të të gjitha rekomandimeve të bëra dhe një konkluzion të përgjithshëm.

³³² Anëtar i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës dhe ish-Avokat i Popullit i Kroacisë (2004-2013).

³³³ Në kuadër të Procesit të Stabilizim Asocimit, Bashkimi Evropian i ka bërë thirrje Kosovës të riorganizojë dhe thjeshtojë shumëllojshmërinë e organeve që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe garantimin e monitorimit efektiv dhe zbatimin e kuadrit përkatës ligjor.

³³⁴ Direktiva e Këshillit 2000/43/EC e 29 Qershorit 2000 që implementon parimin e trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht nga origjina etnike ose racore ('Direktiva 2000/43/EC'); Direktiva e Këshillit 2000/78/EC e 27 Nëntorit 2000 që siguron kuadrin e përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion ('Direktiva 2000/78/EC'); Direktiva e Këshillit 2004/113/EC e 13 Dhjetorit 2004 që implementon parimin e trajtimit të barabartë ndërmjet meshkujve dhe femrave në qasjen dhe sigurimin e mallrave dhe shërbimeve ('Direktiva 2004/113/EC'); dhe Direktiva 2006/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 Korrikut 2006 për implementimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimin të barabartë për meshkuj dhe femra në çështjet e punësimit dhe profesionit (e rishkuar) ('Direktiva 2006/54/EC').

2. KONTEKSTI

7. Sistemi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut bazohet tek Kushtetuta e Republikës së Kosovës ('Kushtetuta') dhe legjislacioni i miratuar më pas por edhe legjislacioni i shpallur nga Misioni i Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Ndërmjetëm të Kosovës³³⁵ ('UNMIK'), si dhe disa ligje të pakta që datojnë që nga koha e Republikës Federale të Jugosllavisë.
8. Megjithatë, legjislacioni nuk është gjithmonë mjaft i qartë dhe ka mjaft vështirësi me procesin e garantimit të implementimit të tij, duke përfshirë vonesat në procedimet gjyqësore dhe mosekzekutimin e vendimeve administrative dhe atyre gjyqësore³³⁶.
9. I gjithë sistemi për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nuk është i balancuar mirë sepse disa organe merren me të njëjtën çështje ose të përafërta me to. Kjo mund të çojë në konfuzion ndërmjet organeve dhe potencialisht mund të minojë autoritetin e këtyre organeve me synimin e dhënies së mjeteve efektive, duke shkaktuar një efekt negativ në perceptimin e publikut.
10. Kjo ndodh sidomos në fushën e diskriminimit të gjykatave, ku Institucionit të Avokatit të Popullit ('IAP'), Agjencisë për Barazinë Gjinore ('ABGj') dhe Njësisë Komunale për të Drejtat e Njeriut iu jepen role të mbivendosura në lidhje me shqyrtimin e ankesave.
11. Për rrjedhojë është shumë e rëndësishme që të shfrytëzohet plotësisht reforma aktuale mbi legjislacionin për diskriminimin, barazinë gjinore dhe IAP për të garantuar maksimumin e sinergjisë të të gjithë këtyre institucioneve në trajtimin e diskriminimit.
12. Kjo është aktualisht e domosdoshme sidomos në Kosovë përderisa nuk është anëtare e Këshillit të Evropës dhe për rrjedhojë nuk ka asnjë mundësi qasjeje tek Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut³³⁷.
13. Përveç rolit që duhet të luajnë gjykatat, ka arsye të mira që Avokatit të Popullit t'i akordohen kompetenca shtesë për mbrojtjen e barazisë.
14. Së pari, një numër i madh qytetarësh i njohin tashmë faktet bazë për Avokatin e Popullit dhe për rrjedhojë zgjerimi i kompetencave të tij për garantimin e barazisë ka të ngjarë të shihet si një përmirësim i konsiderueshëm.
15. Së dyti, dispozitat që rregullojnë institucionin dhe shqyrtimin e ankesave – edhe pse kanë nevojë për përmirësime – ekzistojnë tashmë. Për rrjedhim, nuk është e domosdoshme ose e përshtatshme të ngrihet nga zeroja një sistem i tërë për mbrojtjen nga diskriminimi, veçanërisht duke pasur parasysh shpenzimet që do të kishte.
16. Së treti, IAP ka tashmë një grup të mirë ekspertësh në fushën e të drejtave të njeriut – megjithëse ka nevojë për përmirësim – i cili ka përvojë në shqyrtimin e ankesave dhe aftësinë të identifikojë probleme të sistemit nga çështjet individuale të ngritura në to.
17. Për rrjedhojë është shumë e dëshirueshme që Projektligji për Barazinë Gjinore të propozojë ngritjen e një Përfaqësie Ligjore brenda ABGj për marrjen e ankesave. Mund të preferohet modeli i

³³⁵ Mandati i UNMIK-ut u përcaktua nga Këshilli i Sigurimit në rezolutën e tij 1244 (1999). Misionit iu dha mandat për të ndihmuar Këshillin e Sigurimit për arritjen e objektivit të përgjithshëm të garantimit të kushteve për një jetë normale dhe në paqe për të gjithë banorët e Kosovës dhe përparimin e stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor.

³³⁶ Shih Raportin e OSBE-s "Ekzekutimi i Vendimeve" i vitit 2012 në adresën <http://www.osce.org/kosovo/87004>. Shihni gjithashtu deklaratën e mëposhtme në Raportin Vjetor të vitit 2011 të IAP: "Gjykata e Rrethit në Prishtinë, në përgjigje të letrës së Avokatit të Popullit në lidhje me vonesat në gjykimin e çështjeve, Zj. M. S., Kryetare e Komanduar e Gjykatës deklaroi se "Gjykata nuk është në gjendje të respektojë afatet kohore të përcaktuara me ligj dhe për rrjedhojë pretendimet e palëve. Gjykata ka 65.000 çështje civile dhe penale të prapambetura dhe nuk kemi aq gjyqtarë që t'i shqyrtojnë ato".

³³⁷ Megjithatë, procedurat e posaçme të Kombeve të Bashkuara janë të disponueshme dhe kuptohet se disa prej tyre janë përdorur me sukses.

-
- përcaktuar për Projektligjin që përdor kompetencat e Avokatit të Popullit.
18. Megjithatë, njohuritë e publikut për të drejtat e njeriut janë shumë të dobëta dhe janë thelbësore për përpjekjet për ta ndrequr këtë – veçanërisht për sa i takon ndalimit të diskriminimit. Megjithatë në këtë drejtim do të ishte shumë e dobishme të kishte një fokusim promovues të specializuar – si ai i propozuar për ABGj – si shtesë ndaj punës që duhet të ndërmerret nga IAP.
 19. Njëkohësisht, roli i parashikuar nga Projektligji për gjykatat – një rol që është tipar i të gjitha përpjekjeve në Evropë për trajtimin e diskriminimit – nënvizon nevojën për përpjekje të konsiderueshme për përmirësimin e efektivitetit të sistemit gjyqësor. Kjo do të sillte jo vetëm forcimin e gjyqësorit por edhe garantimin që viktimat të kishin ndihmë juridike falas, të siguruar nëpërmjet një procedure të shpejtë dhe të thjeshtë. Megjithatë këto janë çështje që nuk mund të adresohen në Projektligj por është një parakusht i sigurt për suksesin e tij.
 20. Është një akuzë serioze e kontributit të Ligjit Aktual në sfidën kundër diskriminimit që nëntë vjet pas miratimit të tij nuk kemi asnjë gjykim përfundimtar të një ankese sipas dispozitave të tij, si dhe ekzistencën e vazhdueshme të mosvajtjes së viktimave të diskriminimit në gjykatë për rivendosjen e të drejtës.
 21. Mbi të gjitha është e rëndësishme që Projektligji të harmonizohet me Projektligjin për Barazinë Gjinore dhe Ligjin për Avokatin e Popullit në mënyrë që të bëhet maksimal efekti i tyre në ofrimin e shërbimeve për publikun dhe garantimin e një funksionimi të mirë. Aktualisht, këto tre ligje përmbajnë dispozita të ndryshme për kompetencat e IAP dhe është thelbësore që të konsiderohen si një paketë koherente masash dhe jo si tre pjesë të legjislacionit. Krahas kësaj, përdorimi i terminologjisë tek të tre ligjet duhet të jetë tërësisht konsistent në mënyrë që të garantojë që kundërshtimet të mos minojnë mbrojtjen, që po përpiqen të ofrojnë ato.

3. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

22. Ka disa pika të përgjithshme që duhet të merren në konsideratë përpara se t'i drejtohem analizës së dispozitave individuale të Projektligjit.
23. Duhet të vërehet se ekziston një problem i mundshëm për kushtetutshmërinë në autorizimin e përcaktimit të ankesave për diskriminim të dhëna jo vetëm nga Projektligji por gjithashtu dhe nga Ligji Aktual për IAP. Ky autorizim lidhet edhe me sektorët publik por edhe me ato privat, por Neni 132.1 i Kushtetutës specifikon se roli i Avokatit të Popullit lidhet me “autoritetet publike”. Sigurisht, nuk ka asgjë të papërshtatshme që kompetenca të tilla t'i jepen Institucionit të Avokatit të Popullit. Kjo është një çështje, e cila ka të ngjarë të zgjidhet në të ardhmen me një amendament kushtetues – siç ka ndodhur në rastin e Kroacisë³³⁸ - por nuk mund të ndiqet më tej në këtë opinion. Një pengesë tjetër e mundshme që mund të merret në konsideratë ka të bëjë me parashikimin në Nenin 17.1 të Ligjit për Pushtetin Lokal dhe Vetëqeverisjes që komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut përderisa kjo çon në mospasjen e një niveli të barabartë të të drejtave të njeriut në të gjitha komunat dhe mospasjen e kompetencave të mjaftueshme për ndreqjen e kësaj situatë.
24. Së dyti, Ligji Ekzistues përmbush pothuaj të gjitha elementët e nevojshëm të kërkuar nga standardet ndërkombëtare. Pra, përmban parimet bazë kundër diskriminimit, rendit shkaqet e diskriminimit, parashikon gjokat dhe kompensimin për sjelljen diskriminuese dhe krijon organe të pavarura për hetimin e ankimeve.
25. Megjithatë, ka dy gjëra që mungojnë, dhe pikërisht, parashikimi i mbrojtjes efektive për viktimat e diskriminimit dhe dhënia e një rëndësie të mjaftueshme promovimit të kritereve të Ligjit

³³⁸ Fjalja e mëposhtme i është shtuar Kushtetutës: “Për mbrojtjen e të drejtave themelore kushtetuese, Avokatit të Popullit mund t'i jepen me ligj kompetenca që lidhen me personat fizik dhe juridik”.

Ekzistues.

26. Pra, për sa i përket mbrojtjes ligjore për viktimat, Ligji Ekzistues – dhe Projektligji gjithashtu – nuk përmban ndonjë dispozitë të qartë në lidhje me juridiksionin e organeve kompetente ose përmbajtjen e pretendimit dhe vendimin, dhe nuk ka arritur të krijojë marrëveshjet e duhura për rregullimin e dhënies së kompensimit dhe vendosjen e ndëshkimeve. Të gjitha këto të meta padyshim kanë kontribuar në mungesën e praktikës gjyqësore në zbatim të Ligjit Ekzistues.
27. Të meta të ngjashme mund të shihen në dispozitat e Projektligjit për procedimin gjyqësor, kompensimin për viktimat dhe ndëshkimet për keqbërësit. Kjo është e rëndësishme sepse viktimat duhet të kenë një panoramë të qartë për procedurën e përfitimit të mbrojtjes së të drejtave të tyre dhe keqbërësit duhet të jenë të ndërgjegjshëm për mundësitë reale të pasojave që rrjedhin nga sjellja e tyre. Vërtet, një kriter i rëndësishëm i të drejtës së Bashkimit Evropian është që sanksionet duhet të jenë *zhbindëse*³³⁹. Krahas kësaj, qartësia është e rëndësishme nëse gjyqtarët do të kenë një instrument të përshtatshëm për zbatim, që iu mundëson atyre mbrojtjen e viktimave të diskriminimit.
28. Dobësia e Ligjit Ekzistues për sa i takon promovimit është dështimi në besimin e këtij roli Avokatit të Popullit. Për rrjedhim, është i mirëpritur fakti se Projektligji nuk përfshin dispozita në lidhje me promovimin e tij dhe në veçanti ka përmirësuar dhe qartësuar rolin e Avokatit të Popullit në këtë drejtim.
29. Së treti, Projektligji lë jashtë dy dispozita të rëndësishme që gjenden në Ligjin Ekzistues, pikërisht ato që kanë të bëjnë me (a) pasojat e palëve që iu jepet një kontratë publike, hua apo grant, të cilët nuk veprojnë në përputhje me ligjin³⁴⁰ dhe (b) pazbatueshmërinë e barrës së provës për të paditurit në rastet e diskriminimit të pretenduar ku procedimet lidhen me vepra penale dhe kundërvajtje³⁴¹.

4. DISKUTIMI NEN PËR NEN

Neni 1

30. Përfshirja në këtë dispozitë e fjalëve që përcaktojnë synimin e Projektligjit:

Parimi i trajtimit të barabartë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës sipas shtetit ligjor

është në mospërputhje me Nenin 1 të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor dhe Nenit 3 të Direktivës 1978/3600/EC dhe Nenit 3 të Direktivës 2000/78/EC. Asnjë prej këtyre dispozitave nuk e përmend “shtetin e së drejtës” dhe të dyja e bëjnë të qartë lidhjen ndërmjet shkaqeve të diskriminimit dhe parimit të *trajtimit* të barabartë.

31. Teksti ekzistues është në fakt një interpretim i parimit të shtetit të së drejtës, gjë e cila nuk është e njëjtë me ndalimin e sjelljes diskriminuese. Në fakt, Neni 14 i Kushtetutës bën dallim ndërmjet termit ‘të barabartë përpara ligjit’ në paragrafin e parë të tij dhe ndalimit të diskriminimit në paragrafin e dytë.
32. Krahas kësaj, kjo dispozitë gabimisht i referohet ‘trajtimit të barabartë të të gjithë qytetarëve’ përderisa (a) Projektligji është i zbatueshëm për joqytetarët dhe (b) trajtimi i barabartë për të gjithë mund të çojë në diskriminim në kundërshtim me standardet Evropiane dhe ndërkombëtare.
33. Neni 1 duhet të riformulohet sipas shembullit të Nenit 1 të Direktivës 2000/78/EC dhe Nenit 1 të Direktivës 2000/43/EC por me të gjitha shkaqet e përmendura në Nenin 3 të Projektligjit të specifikuar, së bashku me katër shkaqe të tjera, pikërisht ‘seksin’, ‘mendimin politik ose mendim tjetër’,

³³⁹ Neni 15 i Direktivës 2000/43/EC, Neni 17 i Direktivës 2000/78/EC, Neni 14 i Direktivës 2004/113/EC dhe Neni 25 i Direktivës 2006/54/EC.

³⁴⁰ Neni 6.3.

³⁴¹ Neni 8.3.

'lindjen' dhe 'trashëgiminë gjenetike'. Përkufizimi i 'seksit'³⁴²si shkak diskriminimi shpjegohet në këtë Raport brenda analizës së Ligjit për Barazinë Gjinore. 'Mendimi politik ose mendimi tjetër' i referohet lirive të mbrojtura nga Nenin 9 dhe 10 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. 'Lindja' specifikohet në Nenin 14 të Konventës Evropiane dhe në dispozitat kryesore Evropiane dhe ndërkombëtare që ndalojnë diskriminimin, dhe 'trashëgimia gjenetike' gjendet vetëm në Nenin 11 të Konventës për të Drejtat e Njeriut dhe Biomjeksinë³⁴³ por është gjithashtu ndërmjet kritereve të kërkuara në itinerarin e vizave për Kosovën³⁴⁴. Krahas kësaj, në fushat e sigurimit shëndetësor dhe punësimit po dalin probleme që kanë të bëjnë me trashëgiminë gjenetike dhe mund të pritet që të dalin edhe më shumë në të ardhmen e afërt. Neni 1 duhet të jetë:

Synimi i këtij Ligji është përcaktimi i një kuadri të përgjithshëm për luftën kundër diskriminimit për shkaqe të kombësisë, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, paaftësisë, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me synimin e hyrjes në fuqi të parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 2

34. Tre paragrafët e parë të kësaj dispozite që trajtojnë fushëveprimin e Projektligjit janë formuluar në një mënyrë kaq të komplikuar saqë nuk është e qartë se cilët janë subjektet. Krahas kësaj, Projektligji nuk është vendi për shtjellimin e juridiksionit të sistemit ligjor të Kosovës. Është çorientuese të përmendësh që Projektligji do të zbatohet jashtë Kosovës dhe, siç përmendet tashmë³⁴⁵, është e pajustificuar referenca specifike për 'qytetarët'.

35. Për rrjedhojë, tre paragrafët e parë duhet të hiqen. Dispozita të përfshijë paragrafin ekzistues 4, me fjalinë e hapjes të riformuluar në një mënyrë më të thjeshtë si më poshtë:

Ky Ligj do të zbatohet për të gjithë veprimet dhe mosveprimet e të gjitha organeve lokale dhe shtetërore, personave fizik dhe juridik edhe në sektorët privatë edhe në ato shtetërorë, që shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik ose juridik, në të gjitha fushat e jetës, veçanërisht në lidhje me: ...

36. Megjithatë, disa fusha të jetës mungojnë tek ato të renditura në paragrafin 4 ekzistues, të tilla si shkenca dhe sporti, krijimet artistike dhe kulturore³⁴⁶. Këto fusha duhet gjithashtu të përmenden qartësisht, ndërmjet nën-paragrafëve 4.10 dhe 4.11, pavarësisht nga riformulimi i fjalisë së hapjes së paragrafit 4 për të shprehur se Projektligji është i zbatueshëm në të gjitha fushat e jetës.

Neni 3

37. Struktura e kësaj dispozite duhet të ndjekë qasjen e Nenit 2 të Direktivës 2000/78/EC, me titullin 'Koncepti i diskriminimit' dhe dy paragrafët pasues:

- Parimi i trajtimit të barabartë do të ketë kuptim se nuk duhet të ketë diskriminim direkt ose indirekt bazuar në shkaqet e përmendura në Nenin 1³⁴⁷.
- Diskriminimi është dallimi, përjashtimi, kufizimi ose preferenca, në bazë të shkaqeve të përmendura në Nenin 1 të këtij ligji, që ka synimin ose efektin të zhvlerësojë ose cenojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjeve të tjera të aplikueshme të Republikës së Kosovës.

342 'Seksi' është një prej shkaqeve të ndaluara të renditura në Nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

343 'Ndalohet çdo formë e diskriminimit kundër personit për shkaqe të trashëgimisë gjenetike të tij'.

344 BLOKU 4: Të drejtat themelore të lidhura me Lirinë e Lëvizjes i kërkojnë Kosovës të: 'Garantojë që liria e lëvizjes së qytetarëve të Kosovës të mos i nënshtrohet kufizimeve të pajustificuara, duke përfshirë masat e një natyre diskriminuese, në bazë të seksit, racës, ngjyrës, origjinës sociale dhe etnike, tipareve gjenetike, gjuhës, besimit fetar, mendimeve politike apo mendimeve të tjera, që i përkasin një minoriteti, pasurie, lindjeje, paaftësie, moshe apo orientimi seksual' (theksi i shtuar).

345 Shihni paragrafin 32.

346 Cf. Neni 15 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike dhe Social Kulturore.

347 Lista e shkaqeve që duhet të jenë në Nenin 1, siç rekomandohet në paragrafin 33.

Neni 4

38. Kjo dispozitë duhet të mbajë titullin ‘Llojet e trajtimit të pabarabartë’ por përkufizimi i diskriminimit në nën-paragrafin 1.1 duhet të hiqet sepse është e papranueshme vendosja e përkufizimit të diskriminimit tek llojet e diskriminimit. Nga ana tjetër, mbrojtja nga viktimizimi në nën-paragrafin 1.6 duhet të zgjerohet që të përfshijë mbrojtjen e çdo individ, që nuk merr pjesë në një ankim për diskriminim por që, i cili mendohet ta ketë bërë.
39. Megjithatë, lista e llojeve të trajtimit të pabarabartë nuk është e plotë. Pas ndarjes duhet të shtohen tre lloje të tjera të trajtimit të pabarabartë.
40. E para është se mosdhënia e një përshtatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat e paafte, në linjë me nevojat e tyre specifike, duhet të çmohet si diskriminim, përveçse kur është një barrë e paarsyeshme për personin që është i detyruar ta ofrojë duke marrë në konsideratë për këtë qëllim faktorë të tillë si përdorimi i burimeve të disponueshme publike, pjesëmarrjen në jetën sociale dhe publike dhe garantimin e qasjes në vendin e punës dhe kushte të përshtatshme pune³⁴⁸.
41. Së dyti, parandalimi është një funksion i rëndësishëm i Projektligjit dhe në vend që të lihet çështja fshehur nga referenca “reale apo e supozuar” në nën-paragrafin 1.2, duhet të parashikohet shprehimisht se:

Shkelja e parimit të trajtimit të barabartë bazuar në keqkonceptimin e ekzistencës së shkaqeve të përmendura në Nenin 1, në kuptim të këtij Ligji duhet të konsiderohet si diskriminim.

42. Së treti, duhet të ketë një paragraf në lidhje me diskriminimin e lidhur, d.m.th vendosjen në objektiv jo të personave që i përkasin një grupi të caktuar por personave të tretë që janë të lidhur ngushtë me ta dhe nuk i përkasin grupit³⁴⁹.

Forma të rënda të diskriminimit

43. Pas nenit 4, një nen i ri duhet të shtohet në Projektligj që ka të bëjë me mbrojtjen në rastet e formave më të rënda të diskriminimit.
44. Sjellja diskriminuese që motivohet nga më shumë se një shkak, kryhet më shumë sesa një herë, zgjat për një periudhë të gjatë kohe ose që ka pasoja veçanërisht të dëmshme për viktimën, duhet të konsiderohet një formë më e rëndë e diskriminimit³⁵⁰.

Neni 5

45. Thelbi i kësaj dispozite trajtohet nga Neni 17³⁵¹ dhe nga Ligji për Kundërvajtjet³⁵², por përsëritja nuk është problematike.

Neni 6

46. Në fund të kësaj dispozite, do të ishte e përshtatshme të zëvendësohej fjalia:

Me kusht që qëllimi të jetë legjitim dhe kërkesat proporcionale me qëllimin

me

nëse ajo dispozitë, kriter ose praktikë është e justifikuar nga një qëllim legjitim dhe ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të synuar.

³⁴⁸ Shihni Nenin 5 të Direktivës 2000/78/EC.

³⁴⁹ Shihni Nenin 1 të Protokollit Nr. 12 të Konventës Evropiane, Rekomandimi N°7 për Politikën e Përgjithshme të ECRI: legjislacioni kombëtar për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racor, miratuar nga ECRI në 13 Dhjetor 2002 dhe Çështjen C-303/06 S. Coleman v. Attridge La and Steve La [GC], 2008 ECR I-05603.

³⁵⁰ Shihni gjithashtu paragrafin 83.

³⁵¹ Shihni paragrafin 89.

³⁵² ‘Kundër një personi juridik dhe një personi përgjegjës në personin juridik bëhet vetëm një procedim, përveçse kur ekzistojnë shkaqe ligjore që procedura të kryhet vetëm kundër njërit prej tyre’.

Neni 7

47. Në fjalinë e parë të kësaj dispozite, fjala ‘e nevojshme’ dhe fraza ‘për parandalimin dhe përparimin e të drejtave të’ duhet të hiqet. Kjo fjali duhet të ndryshohet më tej që të lexojë:

Veprimet afirmative janë masa të marra me synimin e parandalimit ose kompensimit të disavantazheve të grupeve ose personave të lidhur me ndonjë prej shkaqeve të përcaktuara në Nenin 1 të këtij Ligji.

Neni 8

48. Të gjitha institucioneve – ndër subjektet e tjera – iu kërkohet nga Neni 1-3 të respektojnë dispozitat e Projektligjit. Krahas kësaj, detyrime specifike për hartimin e politikave dhe promovimin e Projektligjit (dhe vlerat e tij) parashikohet nga Nenet 9 dhe 10.
49. Megjithatë, do të ishte e pamundshme – siç parashikon Neni 1 – për të gjitha institucionet e Kosovës të promovojnë Projektligjin dhe të hartojnë dhe miratojnë “politika të përkohshme dhe specifike”. Një kriter i tillë do të rezultonte në prodhimin e tepërt të dokumenteve (kopjo+ngjit) pa ndonjë efekt real por me kosto të madhe.
50. Krahas kësaj, përgjegjësia e Avokatit të Popullit për ndërmarrjen e aktiviteteve promovionale trajtohet në Nenet 9 dhe 10 dhe krijon detyrimin për hartimin e politikave për Zyrën e Qeverisjes së Mirë.
51. Për rrjedhojë do të ishte më mirë që Neni 8 të riformulohej që të thoshte se të gjitha institucionet duhet t’i përmbahen parimeve të Projektligjit në përmbushjen e detyrimeve të tyre, gjë së cilës do t’i jepej efekt nëpërmjet një amendamenti për statutet e institucioneve në fjalë.

Neni 9

52. Titulli “Kompetencat e Avokatit të Popullit” për këtë dispozitë duhet të ndryshohet në “Avokati i Popullit” sepse trajton edhe kompetencat edhe detyrimet.

53. Nuk ka asnjë përkufizim të Institucionit të Avokatit të Popullit në paragrafin 1 por vetëm një frazë që ai është një “organ i autorizuar”. Megjithatë, duhet të thuhet shprehimisht se ky institucion është organi qendror dhe i pavarur kombëtar i barazisë si pjesë e përgjegjësisë së tij për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Siç shpjegoi dhe Komisioneri për të Drejtat e Njeriut Thomas Hammarberg:

Pavarësia është e rëndësishme për efektivitetin e strukturave kombëtare në promovimin e barazisë. Pavarësia e organeve mund të kuptohet në drejtim të të qenit në gjendje të caktimit të burimeve sipas situatës, të marrjes së vendimeve në lidhje me stafin vetjak, të përcaktimit të prioritetëve vetjake dhe ushtrimit të kompetencave si dhe kur çmohet e nevojshme³⁵³.

54. Në nën-paragrafin 1.1 duhet të parashikohet përpara “dhënies së mendimit” se Institucioni i Avokatit të Popullit mund “të kryejë ndërmjetësim”. Krahas kësaj, fjalët “nëse procedimi gjyqësor nuk është filluar akoma” duhet të futen pas fjalës “personat” për të qartësuar këtë kufi të kompetencës së Avokatit të Popullit të Kosovës.
55. Nënparagrafi 1.2 duket i paplotë sepse ka procedime të tjera që mund të ndërmerren veçmas nga ato në gjykatë, të tilla si procedimet administrative dhe procedurat e brendshme të mosmarrëveshjeve të punës. Për rrjedhojë, paragrafi duhet të rezultojë si më poshtë:

Jep informacion të nevojshëm personave që kanë depozituar një ankesë për diskriminim në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe mundësitë e gjykatës si dhe mjete të tjera të mbrojtjes.

Nën-paragrafi 1.3 nuk është i qartë, përderisa nuk e shpjegon kuptimin e termit “autoritete kompetente”. Fjala “autoritete” lidhet dhe tregon organet administrative, por këto janë tashmë të përfshira në

³⁵³Opinion për Strukturat Kombëtare të Promovimit të Barazisë; <https://cd.coe.int/VieDoc.jsp?id=1761031&Site=COE&BackColorInternet=B9BDEE&BackColorIntranet=FFCD4F&BackColorLogged=FFC679>.

paragrafin 1.1. Nëse kuptimi i këtij nënparagrafi ishte t'i jepej Avokatit të Popullit kompetenca e depozitimit të një padie (padi kolektive), ajo duhet të parashikohej në një nen të veçantë³⁵⁴. Për rrjedhojë, ky nën-paragraf duhet të hiqet dhe të zëvendësohet me kompetencat e mëposhtme:

I drejtohet organeve të prokurorisë dhe të hetimit direkt me një kërkesë për fillimin e hetimit të kundërvajtjeve dhe veprave penale dhe kërkon fillimin e procedimit disiplinor të zbatueshëm.

Argumenti për futjen e kësaj dispozite është nevoja për pasjen e një instrumenti efektiv për goditjen e diskriminimit në përgjithësi, por gjithashtu edhe për shkak të faktit se ky Ligj zbatohet për sektorin privat, ndryshe nga Ligji për Avokatin e Popullit.

56. Fjalët 'për autoritetet publike' në nën-paragrafin 1.6 duhet të hiqen sepse Avokati i Popullit duhet të jetë në gjendje gjithashtu të lëshojë rekomandime për entet private.

57. Në nën-paragrafin 1.9 kompetencat e bashkëpunimit duhet t'i drejtohen dhe partnerëve social, OJQ-ve që merren me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe institucioneve dhe organizatave fetare të regjistruara në Kosovë.

58. Në nën-paragrafin 1.10, duhet të përcaktohet se:

Do të raportojë për zbatimin e Ligjit në këtë Raport Vjetor tek Asambleja dhe gjithashtu mund të lëshojë raporte të posaçme për zbatimin e tij.

59. Paragrafi ekzistues 2 duhet të hiqet në linjë me rekomandimet që kanë të bëjnë me buxhetin në Opinionin e Ligjit Nr. 03/I-195 për Avokatin e Popullit dhe Projektligjin për Ndryshim-plotësimin e Ligjit Nr. 03/I-195 për Avokatin e Popullit.

Neni 10

60. Në nën-paragrafin 1.2, do të ishte e përshtatshme të shtohen fjalët 'strategji dhe plane veprimi pas fjalës 'politikat'.

61. Megjithatë, si një parakusht për hartimin e çdo politike, ekziston një nevojë për krijimin e një baze të dhënash për grupet kryesore të ndjeshme dhe nevoja për krijimin e kësaj baze duhet të specifikohet për përgjegjësinë e mbledhjes së të dhënave në Nenin 10.1.4³⁵⁵. Zyra e Qeverisjes së Mirë duhet të mbledhë të dhëna të zbërthyer për përqindjen e punësimit, statusin social dhe edukativ të pjesëtarëve të të gjitha minoriteteve kombëtare, grave dhe personave me paafësi. Avokati i Popullit duhet të ketë qasje tek këto të dhëna.

62. Një nën-paragraf i ri duhet të futet tek paragrafi 1, me kusht që Zyra e Qeverisjes së Mirë të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në lidhje me diskriminimin³⁵⁶.

63. Paragrafi 2 duhet të hiqet sepse nuk ka arsye të justifikuar për një trajtim të ndryshëm të nëpunësve në institucionet publike.

64. Nuk është e qartë nëse paragrafi 4 është i nevojshëm ose se cila do të ishte përmbajtja e rregullave të përmendura përderisa Projektligji duhet të japë udhëzime mjaft të qarta për ministritë dhe komunat. Për rrjedhojë ky paragraf duhet të hiqet.

Nenet 11 dhe 12

65. Dispozitat që lidhen me ankesat tek Avokati i Popullit, paditë dhe mosmarrëveshjet administrative, si dhe procedimet për kundërvajtjet, duhet të trajtohen në Nene të veçanta dhe jo të përzihen siç bëhet me dispozitat ekzistuese. Nuk ka nevojë për paragrafin ekzistues 1 të Nenit 11, nëse ka

³⁵⁴ Shihni paragrafin 86.

³⁵⁵ Shihni fjalinë e fundit të Rekomandimit Nr.1 për Politikën e Përgjithshme të ECRI në adresën: http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/activities/GPR/EN/Recommendation_N1/Rec01en.pdf.

³⁵⁶ Kjo duhet të përmendet në mënyrë të prezumuar në Rregullin NO. 16/2013 për strukturën organizative të Zyrave të PM.

një titull të përshtatshëm për dispozitat që përcaktojnë procedimet respektive.

66. Neni 11 duhet të trajtojë vetëm procedimet përpara Avokatit të Popullit dhe duhet të titullohet 'Ankimet për Diskriminim'. Formulimi në paragrafin 2 që thotë ngre një padi në institucionin e Avokatit të Popullit është i gabuar sepse paditë mund të ngrihen vetëm në Gjykata.

67. Paragrafi i parë i Nenit 11 duhet të përcaktojë se:

Çdo person apo grup personash mund të bëjë ankim tek Avokati i Popullit për sjelljen diskriminuese për shkaqe të përmendura në Nenin 1 nëse nuk është filluar akoma procedimi gjyqësor.

68. Një paragraf i ri 2 duhet të specifikojë se depozitimi dhe trajtimi i ankimeve për diskriminim nga Avokati i Popullit duhet të kryhet në përputhje me procedurat e specifikuar në Kapitujt III dhe IV të Ligjit për Avokatin e Popullit.

69. Një paragraf i ri 3 duhet të parashikojë se IAP ka kompetencat shtesë të kërkojë brenda 30 ditëve të jepet i gjithë informacioni dhe dokumentacioni që lidhet me ankimin për diskriminim të bërë sepse, pa një kompetencë të tillë, i gjithë sistemi nuk do të jetë efektiv.

70. Neni i ri 12 duhet të titullohet 'Paditë për mosmarrëveshje për diskriminim'.

71. Paragrafi 1 i Nenit të ri 12 duhet të thotë:

Çdo person apo grup personash që ankohen se janë diskriminuar për shkaqe të përmendura në Nenin 1, mund të ngrenë padi në gjykatën kompetente.

72. Paragrafi 3 i Nenit ekzistues 11 duhet të bëhet paragrafi 2 i Nenit të ri 12.

73. Paragrafi 5 i Nenit ekzistues 11 duhet të bëhet paragrafi 3 i Nenit të ri 12.

Neni 13

74. Është shumë kufizuese për paragrafin 1 të përcaktojë një afat prej një viti për depozitimin e padisë, veçanërisht duke pasur parasysh se në procedimet e tjera afati është përgjithësisht më i gjatë se një vit, një periudhë që zbatohet sipas ligjit për Marrëdhëniet me Detyrime vetëm për çështje të tilla si pretendimet për furnizimin me energji elektrike³⁵⁷. Nuk është e pranueshme të krahasohen pretendimet për furnizimin me energji elektrike me pretendimet për sjellje diskriminuese, gjë e cila është një e keqe shumë e rëndë civile e ndaluar nga Kushtetuta. Krahas kësaj, në përputhje me të njëjtin Ligj për Marrëdhëniet me Detyrime, afati për depozitimin e padisë për dëmshpërblim për dëme ndaj një makine është 3 vjet. Një periudhë e tillë do të ishte gjithashtu një afat i mjaftueshëm për pretendime që kanë të bëjnë me trajtimin diskriminues të pretenduar, veçanërisht sepse ka raste ku viktimat nuk reagojnë për ca kohë për arsye të justifikuar të tilla si frika, gjendja shëndetësore dhe mosdashja e dëshmitarëve për mbështetjen e pretendimeve të tyre. Së fundi, duhet të vërehet se afati në Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë për ngritjen e padisë për diskriminim është tre vjet.

75. Paragrafi 2 duhet të ketë fjalinë e dytë të mëposhtme sepse paragrafi 4 duhet të hiqet pas heqjes së rekomanduar të Nenit 2.3:

Për persona jo rezident ose përkohësisht ose përgjithmonë, gjykata kompetente është Gjykata e Themelit e Prishtinës.

76. Paragrafi 3 duhet të hiqet sepse është në kundërshtim me Ligjin për Gjykatat (nenet 14 dhe 16), por gjithashtu dhe me Ligjin për Procedurat Administrative dhe Ligjin për Procedurën e Kundërshtimit. Departamenti i çështjeve Administrative të Gjykatës së Themelit nuk ka juridiksion për

³⁵⁷ Shihni Nenin 360 të Ligjit Nr.04/l-077:Ligji për Marrëdhëniet me Detyrime (<http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,911>): '1. Të mëposhtmet do të parashkruhen pas një (1) viti:

1.1. Pretendimet për furnizimin me energji elektrike, energji termale, gaz, dhe ujë, për shërbimet e pastrimit të oxhakëve dhe për shërbimet e pastrimeve nga komuna, nëse furnizimi ose shërbimi kryhet për nevojat e familjeve;...'

procedimet civile. Paditë për përcaktimin e diskriminimit sigurisht nuk mund të konsiderohen si mosmarrëveshje administrative. Heqja e paragrafit 3 do të zgjidhë problemin, sepse përmendet tashmë në paragrafin 1 që padia do të depozitohet në gjykatën kompetente (dhe Ligji për Gjykatat rregullon se cila gjykatë është kompetente).

77. Problemi i sjelljes diskriminuese është specifik në mosmarrëveshjet dhe procedurat administrative. Kur një person është palë në një procedurë administrative, çështja kryesore nuk është një pretendim për vërtetimin e faktit se diskriminimi ka ndodhur por diçka tjetër (p.sh. një leje ndërtimi) dhe duhet të jetë e mundshme të kërkohet mbrojtja nga diskriminimi në atë procedurë ose në apel. Megjithatë, me gjithë zbulimin se diskriminimi ka ndodhur, vendimi përkatës ka një impakt vetëm në këtë çështje të caktuar dhe nuk është e mundshme të kërkohet kompensim. Megjithatë duhet të shtohet një Nen i ri (pas Nenit 14), që thotë:

Çdo person që konsideron se e drejta e vet është shkelur si pasojë e diskriminimit, mund të kërkojë këtë formë mbrojtjeje në procedimin administrativ krahas çdo kërkesë për mbrojtje në procedimet e posaçme të parashikuara nga Neni 14 i këtij Ligji.

78. Në përputhje me paragrafin 5, një Gjykatë mund të ftojë Avokatin e Popullit të veprorë si mik i gjykatës por nuk është e qartë që kjo ftesë mund të hidhet poshtë. Ky paragraf duhet të ndryshohet që të konfirmojë se kjo është e mundshme sepse Avokati i Popullit është i pavarur dhe duhet të jetë i lirë të vendosë sesi t'i përgjigjet një ftese të tillë.

Neni 14

79. Paragrafët ekzistues të këtij neni lidhen vetëm me procedimet civile.
80. Megjithatë, paragrafi 1 është problematik në atë që ai autorizon viktimat e mundshme për t'i kërkuar gjykatës të vërtetojë faktin që sjellja diskriminuese ka ndodhur (një padi për përcaktimin e diskriminimit) por asgjë tjetër; d.m.th., ata nuk mund të kërkojnë kompensim apo ndonjë gjë tjetër. Krahas kësaj, vendimet gjyqësore duhet të respektojnë Ligjin e Procedurave të Kundërshtimit dhe të vendosin në mënyrë strikte brenda limiteve të asaj që është kërkuar konkretisht në pretendim nga paditësi³⁵⁸. Për rrjedhojë pas 'mënyrës së veprimit' në fund të paragrafit 1 duhet të shtohet

Dhe gjithashtu të kërkojë çdo apo të gjitha mjetet ligjore të specifikuar në paragrafin pasues.

81. Meqë edhe ndërtimi i padisë edhe kompetencat kompensuese duhet të jenë më të detajuara, nën-paragrafët ekzistues 2.1-2.3 në paragrafin 2 duhet të zëvendësohen nga të mëposhtmet:

- 2.1 të ndalojë kryerjen e aktiviteteve që shkelin ose mund të shkelin të drejtën e paditësit për trajtim të barabartë, ose të kryejë aktivitete që eliminojnë diskriminimin ose pasojat e tij (*padija për ndalimin ose eliminimin e diskriminimit*);
- 2.2 të kompensojë për dëme monetare ose morale³⁵⁹ të shkaktuara nga shkelja e të drejtave të mbrojtura nga ky Ligj (*padi për dëmshpërblim*)³⁶⁰;
- 2.3 të urdhërojë masa provizore (nëse pretenduesi e bën të besueshme se e drejta e vet për trajtim të barabartë është shkelur, dhe nëse është e nevojshme që të jepet një masë me synimin e eliminimit të rreziqeve të dëmeve të pariparueshme, veçanërisht të shkeljeve të rënda të të drejtave për trajtim të barabartë, ose me synimin e parandalimit të dhunës);
- 2.4 të jepet afati për zbatimin e vendimit gjyqësor më i shkurtër sesa ai i përcaktuar në Ligjin për Procedurat e Zbatimit³⁶¹;
- 2.5 të publikohet në media vendimi gjyqësor që vendos se ka pasur shkelje të të drejtës për trajtim të barabartë, me

358 Neni 2.1 i Ligjit për Procedurën e Kundërshtimit (Ligji Nr. 03/L-006) parashikon se: 'Gjykata e procedurës së kundërshtimit vendos brenda kufijve të pretendimeve të depozituara nga palët ndërgjyqëse'.

359 Shihni Nenet 182-189 të Ligjit Nr. 04/L-077: Ligji për Marrëdhëniet me Detyrime (<http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,911>).

360 Këto dëmshpërblime priten të mbulojnë të gjitha humbjet financiare që lindin nga diskriminimi (veçanërisht pagat ose rrogat e humbura), kompensimi për prekjet e ndjenjave (të tilla si lëndimet ose shqetësimet) e pësuar si rezultat i diskriminimit, kompensimi për lëndimet personale (të tilla si stresi dhe depresioni) që mund të tregohen se janë shkaktuar nga diskriminimi dhe interesi për shumat në fjalë.

361 <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191>; Ligji për Procedurën e Ekzekutimit: Ligji Nr. 03/L-008.

shpenzimet e të paditurit.

82. Krahas kësaj, me qëllimin për të parandaluar çdo sjellje arbitrare në procesin e zbatimit, në fund të paragrafit 4 duhet të shtohet fraza “në përputhje me Ligjin e Procedurave të Zbatimit”.

83. Një paragraf i ri 5 duhet të futet të marrë në konsideratë shtesën e dispozitës për format e rënda të diskriminimit, i cili duhet të thotë se:

Në përcaktimin e dhënies së kompensimit për dëme morale, gjykata duhet të ketë parasysh nëse çështja në fjalë ka të bëjë me një formë më të rëndë të diskriminimit.

84. Për hir të sigurisë ligjore ekziston nevoja për të sqaruar se çfarë saktësisht synohet me paragrafin 5 ekzistues – i cili duhet të bëhet paragrafi 6 – në referencë me “vendosjen e masave nga ligjet e tjera”.

85. Duhet të ketë dhe një paragraf shtesë – paragrafin 7 – që parashikon se procedimet për çështjet e diskriminimit janë urgjente.

Nen i ri për padinë kolektive

86. Pas Nenit 14 duhet të ketë një nen tërësisht të ri për të zëvendësuar dhe zhvilluar paragrafin ekzistues 4 të Nenit 11, duke autorizuar një formë të re padie, pikërisht, padinë kolektive. Rastet e diskriminimit që prekin grupe personash mund të jenë shumë domethënëse por pjesëtarët e grupeve të tilla jo gjithmonë nisin procedime gjyqësore për shumë arsye: vulnerabiliteti i tyre, kostot financiare, mbrojtja e jetës së tyre private, mungesa e besimit tek gjyqësori dhe kohëzgjatja e procedurave në fjalë. Megjithatë, problemet e tyre mund të trajtohen nëpërmjet një padie kolektive të ndërmarrë në emër të tyre nga organizatat jo-qeveritare dhe Avokati i Popullit, dhe në raste të tilla, pëlqimi i pjesëtarëve të grupit nuk kërkohet³⁶².

87. Për shkak të rëndësisë së tyre, padi të tilla në disa vende ngrihen në Gjykatën e Komunës ose në Gjykatën e Apelit, me pretendimet e mëposhtme:

- Të vërtetojë se sjellja e të paditurit ka shkelur të drejtën për trajtim të barabartë në lidhje me pjesëtarët e grupit;
- Të ndalojë ndërmarrjen e aktiviteteve që shkelin ose mund të shkelin të drejtën për trajtim të barabartë, ose të realizojë aktivitete që eliminojnë diskriminimin ose pasojat e tij në lidhje me pjesëtarët e grupit;
- Të publikojë në media vendimin që përcakton shkeljen e të drejtës për trajtim të barabartë me shpenzimet e të paditurit.

Në këto procedime, nuk mund të kërkohet asnjë dëmshpërblim, pronë bazë të vendimit gjyqësor në çështjen e padisë kolektive, personat që i përkasin grupit në fjalë mund të ngrenë një padi dhe të kërkojnë kompensim. Avokati i Popullit nuk do të ishte në gjendje të vepronte si mik i gjykatës³⁶³ në raste të tilla. Krahas kësaj, ngritja e një padie kolektive nga Avokati i Popullit do të ishte përjashtuese dhe e kufizuar tek çështjet e rëndësishme përkundrejt kërkesave të tjera për burimet e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Neni 15

88. Kjo dispozitë – që ka të bëjë me barrën e provës – nuk tregon natyrën e procedimit që do të zbatohet dhe, meqë Neni ekzistues 11.2 i referohet ‘ndjekjes ligjore’, është e mundshme që ka për qëllim të zbatohet procedimet penale ose për kundërvajtjet. Kjo nuk do të ishte në përputhje me Standardet Evropiane sipas Nenit 10 të Direktivës 2000/78/EC. Shteteve anëtare nuk u kërkohet ta zbatojnë parimin e zhvendosjes së dëshmisë në procedura penale dhe nëse këtë do ta bënin do të ishin në kundërshtim me Nenin 6(2) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Meqë parimet e procedurës penale janë gjithashtu bazë për procedimet për kundërvajtjet, ky parim nuk duhet të zbatohet

³⁶² *Argumentat mund të gjenden në çështjen e famshme, të filluar nga Organi Belg për Barazinë, Çështja C-11/04 - Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding v. Firma Feryn NV, 10 Korrik 2008 (<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:62007J0054:EN:HTML>).*

³⁶³ *Shihni paragrafin 78.*

het në ato procedura gjithashtu. Një paragraf i tretë për dispozitën aktuale duhet të parashikojë që:
Paragrafi 1 nuk zbatohet për procedimet penale dhe procedimet për kundërvajtjet.

Për më tej, do të ishte më mirë nëse fjala ‘fakt’ në Nenin 15.1 zëvendësohet me ‘dëshmi’.

Neni 16

89. Kjo dispozitë është ndoshta e panevojshme sepse të gjithë kanë të drejtën të zgjidhin mosmarrëveshjen nëpërmjet ndërmjetësimit në përputhje me Ligjin për Ndërmjetësimin³⁶⁴por njëkohësisht është një kujtesë e dobishme e meritave për gjetjen e zgjidhjes në këtë mënyrë.

Neni 17

90. Kjo dispozitë është ndoshta më problematikja tek Projektligji. Sanksionet dhe kompensimet janë elemente thelbësore të sistemit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të kërkuara nga të gjitha dokumentet ndërkombëtare. Kjo dispozitë është e ngatërruar në atë që synon të rregullojë gjobat dhe kompensimet në një mënyrë që nuk mund të zbatohet. Viktimat nuk do të jenë në gjendje të kuptojnë këtë dispozitë dhe sesi ta përdorin atë për mbrojtjen e tyre. Kompensimi dhe gjoba janë dy kategori ligjore të ndryshme dhe vendimet që lidhen me to merren në procedime të ndryshme nga gjykata të ndryshme. Gjykatat civile nuk mund të vendosin gjobë sepse kjo është një çështje për gjykatat penale (me përjashtim të rasteve të sjelljeve të mosrespektimit të gjykatës ose për ndonjë shkelje të Ligjit për Procedurën e Kundërshtimit). Viktimat mund të kërkojnë një vendim për kompensim financiar në procedimet civile, penale³⁶⁵dhe të kundërvajtjeve³⁶⁶por shuma e kompensimit duhet të gjykohet në përputhje me rrethanat e çështjes konkrete dhe nuk mund të përcaktohet me ligj. Pretendimet për kompensime nuk mund të vendosen në procedimet administrative.
91. Për rrjedhojë, dispozita ekzistuese duhet të ketë të bëjë vetëm me vepra të vogla që lindin nga shkelje të Projektligjit. Krahas kësaj, ekziston nevoja që projektligji të përmbajë një dispozitë që përcakton se një shkelje e Neneve specifike të Projektligjit është një kundërvajtje dhe se personi përgjegjës do të ndëshkohet me gjobë (dhe të ketë të përcaktuara shumat më të vogla dhe më të mëdha). Neni ekzistues 17 duhet të hiqet dhe të formulohet duke përdorur të njëjtën metodologji siç është përdorur për Nenin 29 (Dispozitat e Shkeljeve) të Projektligjit për Barazinë Gjinore.
92. Krahas kësaj, dispozita e rishkruar duhet gjithashtu të përmbajë një paragraf që specifikon se një shkelje e detyrimit të propozuar që kërkon dhënien brenda 30 ditëve të të gjithë informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me një ankim për diskriminim³⁶⁷është një kundërvajtje dhe se keqbërësi do të gjobitet (në shumën prej x EUR) në mënyrë që të nënvizohet fakti se zhdukja e diskriminimit ka prioritet.

Sanksione specifike

93. Duhet të përfshihet një Nen i ri që parashikon dy sanksione të posaçme.
94. I pari duhet të jetë për kontraktorët që marrin pjesë në prokurimet publike, siç ekziston tashmë në Nenin 6.3 të Ligjit Ekzistues. Kjo duhet të thotë që:
Një kontratë publike nga një organ publik duhet të shpallet e pavlefshme nga organi që e jep në rastet kur kontraktori në fjalë ka shkelur ndonjë prej dispozitave të këtij ligji.

Mbajtja e listës së këtyre kontraktorëve dhe vendosja e saj në faqet e Internetit duhet të jetë përgjegjësi

³⁶⁴ Ligji Nr. 03/L-057.

³⁶⁵ Neni 62 i Ligjit për Procedurën Penale parashikon: 1. Pala e dëmtuar duhet të ketë të drejtat e mëposhtme: ... 1.4. Pala e lënduar ka të drejtën për kompensim të arsyeshëm të urdhëruar nga gjykata nga një i pandehur ose të pandehur që kanë pranuar ose janë shpallur fajtorë për dëme financiare, fizike dhe emocionale, të shkaktuara nga kryerja e veprës penale për të cilën i pandehuri ose të pandehurit janë shpallur fajtorë.

³⁶⁶ Neni 118 i Ligjit për Kundërvajtjet parashikon: Një person i dëmtuar, përpara marrjes së vendimit për një vepër, mund të ngrejë padi për kompensim të dëmit, që i shkaktohet atij/asaj nga kjo kundërvajtje, d.m.th. kompensim i sendeve të marra nga ai/ajo. Në një vendim për një vepër për të cilën shpallet ndëshkimi ose masa mbrojtëse duhet gjithashtu të vendoset brenda pretendimit pronësor-ligjor.”

³⁶⁷ Shihni paragrafin 69.

e Zyrës për Qeverisje të Mirë dhe Agjencisë për Barazinë Gjinore.

95. Gjithashtu, në përputhje me Nenin 14 të Direktivës 2000/43/E, Nenin 16 të Direktivës 2000/78/EC, Nenin 13 të Direktivës 2004/113/EC dhe Nenin 23 të Direktivës 2006/54/EC, dhe në konformitet me Nenin 23 të Projektligjit për Barazinë Gjinore, duhet të ketë një paragraf që përcakton se:

Çdo dispozitë në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë, që është e përfshirë në marrëveshjet ose kontratat kolektive ose individuale, rregullore të brendshme të sipërmarrjeve, rregulloreve të shoqatave fitimprurëse ose jo-fitimprurëse dhe organizatave të nëpunësve ose punëdhënësve, janë ose mund të shpallen të pavlefshme ose duhet të ndryshohen.

Neni 18

96. Kjo dispozitë është disi jo e kompletuar dhe duhet të riformulohet për të marrë parasysh Nenin 27 të Direktivës 2006/54/EC³⁶⁸.

Neni 19

97. Kjo dispozitë është në përputhje me standardet e BE-së, por, siç është vënë re tashmë, aktivitetet për vetëdijesimin publik duhet të organizohen në mënyrë të vazhdueshme.

98. Megjithatë, kjo dispozitë mund të zëvendësohet mirë nga një tjetër që kërkon që të gjitha organet publike të vendosin një njoftim në faqen e tyre të Internetit me të dhëna për mundësinë e dorëzimit të ankesës që ka të bëjë me diskriminimin tek Avokati i Popullit dhe duke dhënë dhe detajet e kontaktit.

Neni 20

99. Siç vërehet tashmë në lidhje me Nenin 10³⁶⁹, nuk është e qartë nëse kërkohet ndonjë legjislacion dytësor dhe, në mungesë të një sqarimi të mëtejshëm, kjo dispozitë duhet të hiqet.

Neni 21

100. Udhëzimi Administrativ (UA) Nr. 04/2006 (në lidhje me organin kompetent, afatin prej 30 ditësh, procedurën e apelimit dhe procedurën për mosmarrëveshjet administrative) nuk përshtatet me sistemin e propozuar nga Projektligji dhe për rrjedhim duhet të shfuqizohet. Kjo duhet të kryhet duke shtuar pas fjalës “implementim” në dispozitën ekzistuese, frazën “si dhe Udhëzimi Administrativ (UA) Nr. 04/2006”.

5. PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE

101. Projektligjit duhet t'i bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Neni 1 duhet të riformulohet që të jetë si Neni 1 i Direktivës 2000/78/EC por me shtesën e të gjitha shkaqeve të përmendura në Nenin 3 të Projektligjit plus lindjen, gjininë, mendimet politike dhe mendimet e tjera si dhe trashëgiminë gjenetike (paragrafi 33);
2. Neni 2 duhet të përmbajë vetëm paragrafin 4 me një fjali hapjeje të rishkruar dhe një referencë specifike për shkencën, sportin, dhe krijimet artistike dhe kulturore (paragrafët 35 dhe 36);
3. Neni 3 duhet të rishkruhet për të ndjekur konceptin e Nenit 2 të Direktivës 2000/78/EC, me titullin “Koncepti i diskriminimit” (paragrafi 37);
4. Përkufizimi i diskriminimit në paragrafin 1.1 të Nenit 4 duhet të hiqet por mbrojtja nga viktimizimi në nën-paragrafin 1.6 duhet të zgjerohet që të përfshijë mbrojtjen e çdo individi që nuk përfshihet në ankim për diskriminim por që besohet ta ketë bërë atë dhe ky Nen duhet të përfshijë gjithashtu tre lloje të tjera të trajtimit të barabartë që lidhen me mosofrimin e përshtatjes/sistemimit të arsyeshem

³⁶⁸ 1. Shtetet Anëtare mund të paraqesin ose të mbajnë dispozita që janë më të favorshme për mbrojtjen e parimit të trajtimit të barabartë sesa ato që janë vënë në këtë Direktivë. 2. Zbatimi i kësaj Direktive nën kurrfarë rrethanash nuk mund të jetë bazë e mjaftueshme për uljen e nivelit të mbrojtjes së punëtorëve në fushat ku është e aplikueshme, pa i paragjykuar të drejtat e Shteteve Anëtare për t'iu përgjigjur ndryshimeve në situatë duke prezantuar ligje, rregullore dhe dispozita administrative që dallojnë nga ato në fuqi mbi notifikimin e kësaj direktive, me kusht që janë ndjekur dispozitat e kësaj Direktive.

³⁶⁹ Shihni paragrafin 64.

- për personat e paaftë fizikisht, një keqkonceptim i ekzistencës së shkaqeve të diskriminimit të referuara në Projektligj dhe diskriminimin me lidhje (paragrafët 38-42);
5. Një nen i ri duhet të shtohet pas nenit 4 që të përcaktojë se çfarë duhet të konsiderohet si formë e rëndë e diskriminimit (paragrafët. 43 dhe 44);
 6. Neni 6 duhet të riformulohet (paragrafi 46);
 7. Neni 7 duhet të riformulohet (paragrafi 47);
 8. Neni 8 duhet të riformulohet (paragrafi 51);
 9. Në Nenin 9 duhet të thuhet se IAP është organizmi qendror dhe i pavarur për barazinë, nënparagrafët 1.1, 1.2 , 1.3, 1.6, 1.9 dhe 1.10 duhet të riformulohen dhe paragrafi 2 të hiqet (paragrafët 52-59);
 10. Në nenin 10 nën-paragrafi 1.2 duhet të riformulohet, nën-paragrafi 1.4 duhet të përcaktojë mbledhjen e të dhënave si më të detajuar, të futet një nën-paragraf i ri dhe paragrafët 2 dhe 4 të hiqen (paragrafët 60-64);
 11. Neni 11 duhet të trajtojë vetëm ankimet në IAP dhe të gjitha dispozitat ekzistuese duhet të zëvendësohen me tre paragrafe të reja (paragrafët 65-69);
 12. Neni 12 duhet të trajtojë paditë dhe mosmarrëveshjet administrative dhe duke përfshirë një paragraf tërësisht të ri 1 dhe paragrafët e mëparshëm 3 dhe 5 të tekstit origjinal të Nenit 11 (paragrafët 70-73);
 13. Paragrafët 1, 2 dhe 5 të Nenit 13 duhet të modifikohen, dhe paragrafi 3 duhet të hiqet (paragrafët 74-78);
 14. Paragrafët 1, 2 dhe 4 i Nenit 14 duhet të modifikohen, një paragraf i ri 5 duhet të futet, paragrafi ekzistues 5 duhet të qartësohet dhe të bëhet paragrafi 6, dhe duhet të shtohet një paragraf i ri 7 ku të përcaktohet se procedimet e çështjeve të diskriminimit janë urgjente. (paragrafët 79-85)
 15. Një nen i ri duhet të shtohet pas nenit 14 ku të përcaktohet procedura për padinë kolektive (paragrafët 86-87);
 16. Në paragrafin 1 të Nenit 15 fjala ‘fakt’ të zëvendësohet me fjalën ‘dëshmi’ (paragrafi 88);
 17. Një paragraf i tretë duhet të shtohet tek Neni ekzistues 15 për përjashtimin e zbatimit të tij për procedimet penale dhe procedimet për kundërvajtjet (paragrafi 88);
 18. Neni ekzistues 16 duhet të hiqet (paragrafi 89);
 19. Neni 17 duhet të zëvendësohet nga një dispozitë tërësisht e re (paragrafët 90-92);
 20. Një nen i ri duhet të shtohet pas Nenit 17 në lidhje me anulimin e kontratave publike dhe dispozitave në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë (paragrafët 93-95);
 21. Neni 18 duhet të riformulohet për të marrë parasysh Nenin 27 të Direktivës 2006/54/EC (paragrafi 96);
 22. Neni 19 duhet të zëvendësohet nga një dispozitë tërësisht e re (paragrafët 97-98);
 23. Neni 20 duhet të qartësohet dhe mundësisht të hiqet (paragrafi 99); dhe
 24. Faza “,si dhe Udhëzimi Administrativ (UA) Nr. 04/2006” duhet të futet tek Neni 21 pas fjalës “implementim” (paragrafi 100).

6. PËRFUNDIMI

102. Projektligji pa dyshim përfshin pothuaj të gjitha standardet Evropiane për mbrojtjen e parimit të barazisë. Megjithatë, ka akoma nevojë të garantohet se ai ka dispozita identike me Projektligjin për Barazinë Gjinore për sa i takon përkufizimit dhe llojeve të diskriminimit.
103. Në mënyrë më thelbësore, ekziston nevoja e bërjes së ndryshimeve substanciale në mekanizmat e implementimit të këtyre standardeve dhe, në veçanti, për garantimin e kompensimit për viktimat e diskriminimit. Derisa të korrigjohen të metat e identikuara, Projektligji nuk do të jetë më shumë se një instrument deklarativ. Aktualisht, Projektligji nuk siguron mekanizma koherent dhe efektiv që duhen për trajtimin e pabarazisë, diçka që është gjithashtu dhe tipari përcaktues i Projektligjit që synohet ta zëvendësojë atë.
104. Autori ka parë opinionet për Projektligjin për Barazinë Gjinore dhe Ligjin Nr.03/L – 195 për Avokatin e Popullit dhe Projektligjin për Ndryshim-plotësimin e Ligjit Nr. 03/L – 195 për Avokatin e Popullit të Korrikut 2013 dhe nënshkruan konkluzionet dhe rekomandimet në to.

SHTOJCA IV

Projekti i Përbashkët ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës me titull
“Përmirësimi i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Kosovë”

Misioni i Parë i Vlerësimit³⁷⁰**17 Qershor-5 Korrik 2013**Agienda

Data/Koha	Qëllimi	Vendi	Pjesëmarrësit
E Hënë, 17 Qershor 2013			
11.00-12.30	Takim me Grupin e Projektit të Këshillit të Evropës (KiE)	KiE (Zyra e vogël për takimet)	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti - Zj. Remzije Istrefi, Zyrtare Projekti <u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent
12.30-14.30	Pushim për drekë		
14.30-16.00	Takim i brendshëm	KiE (Zyra e vogël për takimet)	<u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Grupi 2:</u> - Zj. Jelena Besedic, Konsulente
E Martë, 18 Qershor 2013			

³⁷⁰ Misioni i parë vlerësues për hartimin e propozimit për reformën e aktivizimit të institucioneve jo-gjyqësore të të drejtave të njeriut në Kosovë realizohet në kuadër të Projektit të Përbashkët. Ekspertët e përfshirë janë Z. Arben Hajrullahu, Z. Bardhyl Hasanpapaj, Zj. Gülcan Yeröz, dhe Zj. Natyra Avniu.

08.00-09.00	Takim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Kosovë	Bari përkundrejt zyrave të UNDP-it	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti <u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesi i UNDP-it:</u> - Z. D. Christopher Decker, Koordinator Programi	
09.10-10.00	Takim me Misionin e Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Përkohshëm në Kosovë (UNMIK)	KiE (Zyra e vogël për takimet)	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti <u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesit e UNMIK-ut:</u> - Zj. Almaz Zerihun, Konsulent i komanduar i Lartë për të Drejtat e Njeriut - Zj. Chiara Sponzilli, Zyrtare për të Drejtat e Njeriut	

10.10-11.00	Takim me Zyrën e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (ZKLDNJ) Zyra e Vetme në Kosovë	Ambientet e ZKLDNJ	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti <u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesi i ZKLDNJ:</u> - Zj. Theodora Krumova, Zyrtare për të Drejtat e Njeriut	
11.10-12.10	Takim me Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) Zyra e Kosovës	Ambientet e UNICEF	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti <u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesit e UNICEF:</u> - Zj. Laila Omar Gad, Drejtuese e Misionit - Z. Dren Rexha, Zyrtar për Politikë Sociale - Zj. Beate Dastel, Specialiste për Monitorimet dhe Vlerësimet	
12.30-13.30	Pushim për drekë			

14.00-15.00	Takim me Organizatën për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë(OSBE) Misioni në Kosovë	Ambientet e OSBE	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti <u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente <u>Përfaqësuesit e OSBE:</u> - Z. Hjortur Sverrisson, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Komuniteteve, Drejtor - Zj. Jasna Dobricik, Shefe e Seksionit të Barazisë, Mosdiskriminimit dhe Antitrafikut (ENA) - Zj. Beata Ristoka, Koordinatore Terreni	
15.15-16.15	Takim me Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), Misioni i Kosovës	Ambientet e UNHCR	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti <u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesit e UNHCR-së:</u> -Z. Luca Curci, Zyrtar i Lartë për Mbrojtjen -Zj. Merita Ahma, Zyrtar i Asociuar për Mbrojtjen -Zj. Fahrunnisa Akbatur, Zyrtar për Mbrojtjen	
E Mërkurë, 19 Qershor 2013				

10.15-11.15	Takim me Entin Statistikor, Kosovë (ESK)	Ambientet e KAS	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent për Gjuhësorën <u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent <u>Përfaqësuesi i KAS:</u> - Z. Bashkim Bellaqa, Departamenti i Statistikave Sociale, Drejtor
11.30-12.30	Pushim për drekë		
13.00-14.00	Takim me Zyrën për Çështjet e Komuniteteve (ZÇK)/Zyra e Kryeministrit (ZKM)	Zyrat e Çështjeve të Komuniteteve, Godina Qeveritare, kati 6	<u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesi i ZÇK:</u> - Z. Srdjan Popovic, Drejtor i ZÇK/Konsulent i Lartë për Kryeministrinë

15.30-16.30	Takimi me Këshillin e Komuniteteve (CCC)/ Zyra e Presidencës	Godina e Asamblesë S105	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent për Gjuhësorën <u>Grupi 1:</u> - Zj.Gülcan Yeröz, Konsulent - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësues i CCC:</u> - Z. Petar Miletic, ish-Kryetar i CCC/Aktualisht Zv/Kryetar i Asamblesë dhe Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Politike ‘SLS’	
E Martë, 20 Qershor 2013				

09.00-11.00	Takim i grupit të fokusit me organizatat e shoqërisë civile (OSHC)	KiE (Dhoma e madhe e Takimeve)	<p><u>Grupi i Projektit të KiE:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti - Zj. Remzije Istrefi, Zyrtare Projekti - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent për Gjuhësorën <p><u>Grupi 1:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulent - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <p><u>Zyra e BE-s për Kosovës/Përfaqësuesi i Posaçëm i BE-s:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Patrick Schmelzer, Zyrtar për Politikat <p><u>Përfaqësuesit e OSHC:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zj. Raba Gjoshi, Inisiativa Rinore për të Drejtat e Njeriut (IRDNJ), Drejtore Ekzekutive - Zj. Fatmire Haliti, Qendra e Rehabilitimit të Kosovës për Viktimat e Torturës (KRCT), Menaxhere Projekti /Juriste - Zj. Vatra Abrashi, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (CDHRF), Koordinator - Z. Bekim Blakaj, Qendra e Ligji Humanitar (QLH), Drejtor Ekzekutiv
-------------	--	--------------------------------	---

11.15-12.00	Takim me Ministrinë e Integritit Evropian (MIE)	Ambientet e MIE, Zyra e Zv/Ministrit	<p><u>Grupi i Projektit të KiE:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent për Gjuhësorën <p><u>Grupi 1:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulent - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <p><u>Zyra e BE-së në Kosovë/Përfaqësuesi i Posaçëm i BE-së:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Patrick Schmelzer, Zyrtar për Politikat <p><u>Përfaqësuesit e MIE:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Gëzim Kasapolli, Zv/Ministër - Z. Besnik Vasolli, Koordinator Teknik për Liberalizimin e Vizave
12.15-13.25	Pushim për drekë		
13.30-14.30	Takim me Grupin e Projektit të KiE	KiE (Dhoma e vogël e Takimeve)	<p><u>Grupi i Projektit të KiE:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti - Zj. Remzije Istrefi, Zyrtare Projekti <p><u>Grupi 1:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulent - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <p><u>Grupi 1 & 2, Koordinator:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Jeremy McBride, Konsulent

15.00-16.00	Takim me Zyrën e BE-së në Kosovë	Ambientet e Zyrës së BE-së në Kosovë	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti <u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulent - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent <u>Koordinatori i Grupit 1 & 2:</u> - Z. Jeremy McBride, Konsulent <u>Zyra e BE-së në Kosovë/Përfaqësuesi i Posaçëm i BE-së:</u> - Z. Patrick Schmelzer, Zyrtar për Politikat - Z. Samir Selimi, Menaxher - Z. Visar Bivolaku, Këshilltar për të Drejtat e Njeriut	
16.30-17.30	Takim në Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës (IAP)	Ambientet e AP	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti <u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent <u>Koordinatori i Grupit 1 & 2:</u> - Z. Jeremy McBride, Konsulent <u>Përfaqësuesit e AP:</u> - Z. Sami Kurteshi, Avokati i Popullit - Zj. Shqipe Ibraj-Mala, Zv/ Avokati i Popullit - Zj. Arberita Kryeziu, Asistente për Avokatin e Popullit	

20.00-21.30	Darkë Pune	Hotel Sirius Restaurant, Kati i 8	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Pro- jekti <u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente <u>Koordinatori i Grupit 1 & 2:</u> - Z. Jeremy Mc- Bride, Konsulent
E premte, 21 qershor 2013			
09.00-10.00	Takim në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (GjK)	Ambientet e GjK	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Andre Forde, Zv/Drejtuës i Zyres - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Pro- jekti - Z. Rrahim Syle- jmani, Asistent Gjuhësore <u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrul- lahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Kon- sulent <u>Koordinatori i Grupit 1 & 2:</u> - Z. Jeremy Mc- Bride, Konsulent <u>Përfaqësuesit e GjK:</u> - Zj. Arbëresha Raça Shala, Sekretare e Përg- jithshme - Z. Milot Vokshi, Drejtor i Komand- duar i Departam- entit të Financës - Zj. Besarta Osma- ni, Asistent Zyre

10.15-11.00	Takim në Kuvendin e Kosovës (KiK) me Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, Personat e Humbur dhe Peticionet	Godina e KK, Zyra nr. 6	<p><u>Grupi i Projektit t KiE:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Andre Forde, Zv/Drejtues i Zyrës - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekt - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësore <p><u>Grupi 1:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <p><u>Koordinator për Grupin 1 & 2:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Jeremy McBride, Konsulent <p><u>Zyra e BE në Kosovë/Përfaqësuesi i Posaçëm i BE:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Patrick Schmelzer, Zyrtar për Politikat <p><u>Përfaqësuesja e Komisionit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zj. Suzan Novobrdali, Drejtuese
-------------	--	-------------------------	---

11.15-12.15	Takim në Ministrinë e Administratës Publike (MAP)	MAP, Kabineti i Ministrave, Kati i 5	<p><u>Grupi i Projektit të KiE:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Andre Forde, Zv/Drejtuës i Zyrës - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësore <p><u>Grupi 1:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <p><u>Koordinator i Grupi 1 & 2:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Jeremy McBride, Konsulent <p><u>Zyra e BE në Kosovë/Përfaqësuesi i Posaçëm i BE:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Patrick Schmelzer, Zyrtar për Politikat Përfaqësuesit <p><u>MAP:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Fitim Sadiku, Sekretar i Përgjithshëm - Z. Fatos Mustafa, Departamenti për Menaxhimin e Reformës në Administratën Publike, Drejtor
-------------	---	--------------------------------------	---

12.30-13.25	Drekë Pune	Amelie	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Andre Forde, Zv/Drejtues i Zyrës - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti - Zj. Remzije Istrefi, Zyrtare Projekti <u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulent <u>Koordinator i Grupit 1 & 2:</u> - Z. Jeremy McBride, Konsulent
-------------	------------	--------	---

13.30-14.30	Takim në Ministrinë e Administratës dhe Pushtetit Lokal (MAPL)	MAPL, Godina Rilindja, Kati 10	<p><u>Grupi i Projektit të KiE:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti - Zj.Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësore <p><u>Grupi 1:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zj.Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <p><u>Koordinator i Grupit 1 & 2:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Jeremy McBride, Konsulent <p><u>Përfaqësuesit e MLGA:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Blerim Hasani, Drejtues i Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm - Zj.Faketa Kuka, Drejtuese e Divizionit për Përpelimin e të Drejtave të Njeriut në Komunë - Z. Xhevat Tafa, Drejtues i Divizionit për Monitorimin e Komuneve 	
-------------	--	--------------------------------	---	--

14.35-16.00	Takim me Zyrën Juridike (ZJ)/ZKM	ZJ, Godina Qeveritare, Kati i 5-t	<p><u>Grupi i Projektit të KiE:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti - Zj. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësore <p><u>Grupi 1:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <p><u>Koordinator i Grupit 1 & 2:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Jeremy McBride, Konsulent <p><u>Zyra e BE në Kosovë/Përfaqësuesi i Posaçëm i BE:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Patrick Schmelzer, Zyrtar për Politikat <p><u>Përfaqësuesi i ZJ:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Besim M. Kajtazi, Drejtor
15.30-16.30	Takimi me Zyrën e Zhvillimit Strategjik (ZZHS)/ZKM	ZZHS, Godina Qeveritare, Kati i 5-t	<p><u>Grupi i Projektit të KiE:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti <p><u>Koordinator i Grupit 1 & 2:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Jeremy McBride, Konsulent <p><u>Zyra e BE në Kosovë/Përfaqësuesi i Posaçëm i BE:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Patrick Schmelzer, Zyrtar për Politikat <p><u>Përfaqësuesi i OSD:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Ruzhdi Halili, Drejtor i ZZHS

16.35-17.30	Takimi me Zyrën e Qeverisjes së Mirë (ZQM)/ZKM	ZQM, Godina Qeveritare, Kati i 6-t	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti - Zj.Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësore <u>Grupi 1:</u> - Zj.Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Koordinator i Grupit 1 & 2:</u> - Z. Jeremy McBride, Konsulent <u>Zyra e BE në Kosovë/Përfaqësuesi i Posaçëm i BE:</u> - Z. Patrick Schmelzer, Zyrtar për Politikat <u>Përfaqësuesi i ZQM:</u> - Z. Habit Hajredini, Drejtor i ZQM	
17.45-18.30	Takim i brendshëm - Përmbledhje e Raportit - Struktura e Raportimit Javor	KiE (Dhoma e vogël e Takimeve)	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti <u>Grupi 1:</u> - Zj.Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent - Zj.Natyra Avdiu, Konsulente <u>Koordinator i Grupit 1 & 2:</u> - Z. Jeremy McBride, Konsulent	
E Hënë 24 Qershor 2013				

09.00-12.00	Takim i brendshëm - Plani i javës 2: hartimi i pyetjeve gjysmë të strukturuar për Njësitë Ministrore të të Drejtave të Njeriut, duke finalizuar agjendën - Plani i javës 3: ndarja e ngarkesës së punës, hartimi i agjendës	KiE (Dhoma e vogël e Takimeve)	<u>Grupi 1:</u> - Zj.Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj.Natyra Avdiu, Konsulente	
12.15-13.25	Pushim për drekë			
13.30-14.45	Takimi me MLGA NjD-Nj	Ambientet e MLGA	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Përkthyes <u>Grupi 1:</u> - Zj.Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj.Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesit e MLGA:</u> - Zj.Faketa Kuka, Drejtuese e Divizionit për Përpërimin e të Drejtave të Njeriut në Komuna - Z. Shkelzen Gashi, Zyrtar i të Drejtave të Njeriut	
E Martë 25 Qershor 2013				
09.00-10.00	Takim me MIENjDNj	KiE (Dhoma e vogël e Takimeve)	<u>Grupi 1:</u> - Zj.Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent - Zj.Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesi MIE:</u> - Z. Besnik Vasolli, Koordinator Teknik për Liberalizimin e Vizave	

10.30-11.30	Takim me Ministrinë e Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural (MB-PZHR) NjDNj	Ambientet e MBPZHR	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Përkthyes <u>Grupi 1:</u> - Zj.Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesi i MB-PZHR:</u> - Zj.Sherife Sekiraca, Zyrtare për Mundësitë e Barabarta dhe të Drejtat e Fëmijëve
12.00-13.00	Pushim për Drekë		
13.30-14.30	Takim me Ministrinë e Financave (MeF) NjDNj	KiE (Dhoma e vogël e Takimeve)	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Zj.Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti - Z. Rrahim Sylejmani, Përkthyes <u>Grupi 1:</u> - Zj.Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesit e MF:</u> - Z. Xhevat Shabani, Koordinator në NjDNj - Zj.Minire Qyqalla, Zyrtare NjDNj - Zj.Hasime Bardhi, Zyrtare NjDNj

15.00-16.00	Takim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) Koordinatori i NjDNj	Ambientet e MPMS	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1b:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesi i MPMS:</u> - Zj. Ferinaze Isufi, Zyrtare për Barazinë Gjinore dhe Mundësitë e Barabarta
15.00 – 16.	Takim me Ministrinë e Shëndetësisë (MSh) NjDNj	Ambientet e MSh	<u>Grupi 1a:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesi i MSh:</u> - Zj. Sanie Kiçmari, Koordinatore e NjDNj
E Mërkurë 26 Qershor 2013			
09.00-10.00	Takimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit të Hapësirës (MMPH) NjDNj	MMPH, Ndërtesa Rilindja, Kati i 14-t	<u>Grupi 1a:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesit e MMPH:</u> - Zj. Shpresa Sheremeti, Koordinatore e NjDNj - Zj. Sevim Berveniku, Zyrtare për Antidiskriminimin

10.30-11.30	Takimi me Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthimit (MKK) NjDNj	Ambientet e MKK, Fushë Kosovë	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1b:</u> - Zj.Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesit e MKK:</u> - Zj.Emsal Misini, Zyrtar për të Drejtat e Fëmijëve, Personave me Paaftësi dhe Antitrafikimi - Zj.Liljana Peric, Zyrtar për të Drejtat e Minoriteteve, të të Kthyerve dhe Antikorrupsionit - Zj.Besa Qirezi, Zyrtar për Baraziminë Gjinore - Zj.Shkurte Pllana, Zyrtare për të Drejtat e Njeriut	
	Takim me Ministrinë e Infrastrukturës (MI) NjDNj	Ambientet e MI	<u>Grupi 1a:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj.Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesi i MI:</u> - Zj.Mirdit Emini, Koordinator i NjDNj	
12:00-13:00	Pushim për Drekë			

13:30-14:30	Takim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) NjDNj	Ambientet e MKRS	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1b:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesit e MKRS:</u> - Zj. Fatmire Sahiti, Koordinatore për NjDNj	
	Takim me Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) NjDNj	KiE (Dhoma e vogël e Takimeve)	<u>Grupi 1a:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesit e MFSK:</u> - Zj. Halime Morina-Lupçi, Koordinatore NjDNj	
15.00-16.00	Takim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) NjDNj	Ambientet e Ministrisë (Godina Toskana)	<u>Grupi 1a:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesit e MZHE:</u> - Zj. Arbërore Bërnica, Koordinatore e NjDNj - Zyrtari për të Drejtat e Komunitetit; - Zyrtari për Baraziminë Gjinore.	

	Takim me Ministrinë e Diasporës (MeD) NjDNj	Ambientet e Ministrisë	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1b:</u> - Zj.Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesit e MD:</u> - Zj.Elmas Shufta, Zyrtare për Barazinë Gjinore dhe të Drejtat e Njeriut	
E Enjte, 27 Qershor 2013				
09.20-10.45	Takim me Ministrinë e Administratës Publike (MAP) NjDNj	KiE (Dhoma e vogël e Takimeve)	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1:</u> - Zj.Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesi i MAP:</u> - Z. Armend Rugova, Koordinator për NjDNj	
10.15-11.15	Takim me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) NjDNj	KiE (Dhoma e madhe e Takimeve)	<u>Grupi 1a:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj.Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesi i MPB:</u> - Z. Ismail Musa, Koordinator për NjDNj - Zj. Rrezan Zborca, Zyrtare për komunitetet	

11.30-12.00	Takim i brendshëm - Shkëmbim i të dhënave për takimet e javës së 2-të	KiE (Dhoma e vogël e Takimeve)	<u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulente	
12.10-13.45	Dreکہ Pune	Restorant Fresco	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Zj. Tea Jaliashvili, Menaxhere Projekti - Zj. Remzije Istrefi, Zyrtare Projekti <u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente <u>Këshilltar i Lartë Ligjor Ndërkombëtar:</u> - Z. Ronald Hooghiemstra, Gjykata Kushtetuese	
15.00-16.00	Takim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) NjDNj	Ambientet e Ministrisë, Kati i 2-të	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesi i MASHT:</u> - Zj. Merita Jonuzi, Koordinatore e NjDNj.	

16.15-18.00	Takim me Zyrën e BE-së në Kosovë	KiE (Dhoma e vogël e Takimeve)	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulente <u>Zyra e BE në Kosovë/Përfaqësuesi i Posaçëm i BE:</u> - Z. Patrick Schmelzer, Zyrtar për Politikat
E Premte 28 Qershor 2013			
09.00-10.00	Takim me Këshillin e Komuniteteve (KK)/ Zyra e Kryetarit	Ambientet e KK	<u>Grupi 1:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesit e KK:</u> - Z. Selim Selimi, Drejtues i komanduar i KK - Zj. Nafije Gash, Sekretare - Z. Avni Gashi, Këshilltar Ligjor
10.30-11.30	Takim i brendshëm - Hartimi i pyetjeve për takimet e strukturuar të javës së 3-të (NjDNj të komunave, zyrat rajonale të AP dhe OSHC)	KiE (Dhoma e vogël e Takimeve)	<u>Grupi 1:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulente
E Hënë 1 Korrik 2013			
<u>Grupi 1a:</u> Arben Hajrullahu dhe Natyra Avni (Vizitë në Gjilan)			

09.30-10.45	Takim me Kryetarin e Komunës së Gjilanit	Zyra e Kryetarit të Komunës	<u>Grupi 1a:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesi i Komunës:</u> - Z. Qemajl Mustafa, Kryetari i Komunës	
11.00-12.00	Takim me Koordinatorin e Njësisë për të Drejtat e Njeriut në Komunë (NjDNj)	Zyrat e Koordinatorit të NjDNj	<u>Grupi 1a:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesi i Komunës:</u> - Z. Fazli Abdullahu, Koordinatorin i NjDNj	
12.00-13.30	Pushim për Drekë			
14.00-15.00	Takim me përfaqësuesit e zyrës rajonale të Institutit të Avokatit të Popullit (IAP) në Gjilan	Zyra Rajonale IAP në Gjilan	<u>Grupi 1a:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesi i IAP:</u> - Z. Kadrush Sylja, Këshilltar Ligjor	
15.30-17.00	Takim me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) të rajonit të Gjilan	Misioni i OSBE në Kosovë, Qendra Rajonale në Gjilan, Dhoma e Konferencave	<u>Grupi 1a:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesit e OSHC:</u> - Zj. Besime Tusha, Drejtore Ekzekutive–Rrjeti i Lëvizjes për Paqe - Z. Nebojša Sibic, President i CDKS/KPAN - Zj. Shyrehte Stublla, Organizata Liria - Zj. Imrane Ramadani, Organizata Liria	
<u>Grupi 1b: Gulcan Yeroz dhe Bardhyl Hasanpapaj (Vizitë në Prizren)</u>				

09.30-09.50	Takim me Kryetarin e Komunës së Prizrenit	Godina e Komunës 'hite House', Zyra e Kryetarit	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1b:</u> - Zj.Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesit e Komunës:</u> - Z. Ramadan Muja, Kryetar i Komunës - Zj.Mybexhele Zhuri, Koordinator e NjDNj	
09.55-11.00	Takim me koordinatorin e NjDNj	Godina e Komunës 'hite House', Dhoma e takimit të Komitetit të Financave	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1b:</u> - Zj.Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesit e komunës:</u> - Zj.Mybexhele Zhuri, Koordinator e NjDNj	

12.00-13.30	Dreکہ pune me stafin e zyrës rajonale të OSBE-së	Vila 100, Qendër Prizren	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1b:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesit e OSBE-së:</u> - Zj. Sehida Miftari, Grupi i Komuniteteve - Z. Umit Aynaci, Grupi i Komuniteteve - Zj. Georgia Tasiopoulou, Grupi i komunave	
14.00-15.00	Takim me përfaqësuesit e zyrës rajonale të Institucionit të Avokatit të Popullit në Prizren	Zyrat rajonale të IAP n Prizren	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1b:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesi i IAP:</u> - Zj. Fitnete Mala, Këshilltare Ligjore	

15.30-17.00	Takim me përfaqësuesit e OSHC për rajonin e Prizrenit	Misioni i OSBE në Kosovë, Zyra Rajonale në Prizren, Dhoma e Konferencave	<p><u>Grupi i Projektit të KiE:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <p><u>Grupi 1b:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <p><u>Përfaqësuesit e OShC:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zj. Krenare Hajradini, SH.F.SH - Zj. Drita Vukshinaj, “FFAK” - Zj. Shpresa Siqera, “Shtjefen Gjeçovi” - Z. Shaip Kryeziu, HANDIKOS - Z. Isak Meta, Bosnjacki Saojet Kosova - Z. Amil Kaplani, “OAL” - Z. Sanela Lutvic, “Equality” - Z. Lavdim Bajraktari, “Programi i të Drejtave Civile Kosovë” - Z. Nexhip Meveshe, “Durmish Aslano” - Z. Refik Kasi, “ICEC” <p><u>Përfaqësuesit e OSBE:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Sehida Miftari, Grupi i Komuniteteve - Z. Umit Aynaci, Grupi i Komuniteteve - Zj. Georgia Tasiopoulou, Grupi i komunave 	
E Martë 2 Korrik 2013				
<u>Grupi 1a:</u> Arben Hajrullahu dhe Natyra Avniu (Vizitë në Pejë)				

09.30-10.00	Takim me Kryetarin e Komunës së Pejës	Zyra e Kryetarit	<u>Grupi 1a:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj.Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesi i Komunës:</u> - Z. Ali Berisha, Kryetar	
10.00-11.30	Takimi me Koordinatorin e NjDNj	Zyra e Koordinatorit	<u>Grupi 1a:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj.Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesi i Komunës:</u> - Z. Sebahate-Qorkadiu, Koordinatorin e NjDNj.	
12.00-13.00	Pushim për drekë			
13.30-14.30	Takim me përfaqësuesit e zyrës rajonale të Institutit të Avokatit të Popullit në Pejë	Zyra Rajonale e IAP në Pejë	<u>Grupi 1a:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj.Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesi i IAP:</u> - Zj.Naile Alaj, Zyrtare Ligjore	
15.30-17.00	Takim me përfaqësuesit e OSHC në rajonin e Pejës	Misioni i OSBE-së në Kosovë, Qendra Rajonale në Pejë, dhoma e konferencave	<u>Grupi 1a:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj.Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesi i OSHC:</u> - Z. Sahit Kandic, "OAZA"	
<u>Grupi 1b: Gulcan Yeroz dhe Bardhyl Hasanpapaj (Vizitë në Graçanicë)</u>				

09.45-10.15	Takim me Kryetarin e Komunës së Graçanicës	Zyra e Kryetarit	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1b:</u> - Zj.Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesi i Komunës:</u> - Z. Bojan Stojanevic, Kryetar	
10.20-11.30	Takim me zyrtarin për komunitetet/NjDNj	Restoranti i Komunës	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1b:</u> - Zj.Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesi i Komunës:</u> - Z. Edi Ibrahim, Zyrtar për komunitetet në NjDNj	
12.00-13.30	Drekë pune me stafin e zyrës rajonale të OSBE-së në Prishtinë	Restorant ‘Ciao’, Çagllavicë	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1b:</u> - Zj.Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesit e OSBE-së:</u> - Zj.Elibetta Iberni, Grupi i Komuniteteve - Z. Neil Tobin, Drejtuesi i Zyrës/ Zyrtar i lartë për të drejtat e njeriut	

13.45-14.45	Takim me përfaqësuesit e zyrës rajonale të Institutit të Avokatit të Popullit në Graçanicë	Zyra rajonale IAP në Graçanicë	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1b:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesit e IAP:</u> - Zj. Aleksandra Dimitrijevic, Juriste - Z. Bogoljub Stalctoviq, Zv/Avokat i Popullit
15.30-17.00	Takim me përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile në Graçanicë	Misioni i OSBE në Kosovë, Zyra Rajonale në Prishtinë, Dhoma e Konferencës	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1b:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesit e OSHC:</u> - Z. Nenad Maksimovic, “Qendra për Paqe dhe Tolerancë”
E Mërkurë, 3 Korrik 2013			
<u>Grupi 1a: Arben Hajrullahu dhe Natyra Avniu (Vizitë në Mitrovicë)</u>			
10.30-11.00	Takim me Zv/Kryetarin e Komunës së Mitrovicës	Zyra e Zv/Kryetarit	<u>Grupi 1a:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Natyra Avdiu, Konsulent <u>Përfaqësuesi i Komunës:</u> - Z. Riza Haziri, Zv/Kryetar

11.00-12.00	Takim me Koordinatorin e NjDNj	Zyra e Koordinatorit të NjDNj	<u>Grupi 1a:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Natyra Avdiu, Konsulent <u>Përfaqësuesi i Komunës:</u> - Z. Fitim Rama, Koordinator i NjDNj - Z. Enes Koçapor, Zyrtar për Komunitetet	
12.00-13.00	Pushim për drekë			
13.30-14.30	Takim me përfaqësuesit e zyrës rajonale të Institucionit të Avokatit të Popullit në Mitrovicë	Zyra Rajonale e IAP në jug të Mitrovicës	<u>Grupi 1a:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesi i IAP:</u> - Z. Arber Berisha, Këshilltar Ligjor - Zj. Makfire Krasniqi, Këshilltare Ligjor	
15.30-17.00	Takim me përfaqësuesit e OSHC në Mitrovicë	Misioni i OSBE në Kosovë, Qendra Rajonale në Mitrovicë, Dhoma e Konferencave	<u>Grupi 1a:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesit e OSHC:</u> - Zj. Hilminjeta Apuk, Drejtor Ekzekutiv i Njerëzve të Vegjël të Kosovës - Zj. Vetone Veliu, Shoqata e Grave të Mitrovicës	
<u>Grupi 1b: Gulcan Yeroz (Vizita në Prishtinë dhe Fushë Kosovë)</u>				

09.45-10.00	Takim me Koordinatorin e NjDNj	Ndërtesa e Komunës 'hite House', dhoma e takimeve e Komitetit të Financës dhe Politikave	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1b:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente <u>Përfaqësuesi i Komunës:</u> - Zj. Premtime Preniqi, Koordinator i NjDNj.
10.00-10.45	Takim me Zv/Kryetarin e komunës së Prishtinës	Zyra e Zv/Kryetarit të Komunës	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1b:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente <u>Përfaqësuesit e Komunës:</u> - Z. Abdullah Hoti, Zv/Kryetari i Komunës
12.00-13.30	Pushim për Drekë		
14.00-15.00	Takim me përfaqësuesit e komunës së Fushë Kosovës	Zyra e Kryetarit	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1b:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente <u>Përfaqësuesit e Komunës:</u> - Z. Burim Berisha, Kryetar i Komunës - Z. Afrim Krasniqi, Drejtor i Administrimit të Përgjithshëm - Zj. Nuriye Fazliu, Zyrtar për Integrimin Evropian - Z. Hasan Gjyrevci, Shefi i Personelit

16.00-17.00	Takim pasues me OS-BE-në për Projektligjin për Antidiskriminimin	Ambientet e OSBE-së	<u>Grupi 1b:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente <u>Përfaqësuesit e OSBE:</u> - Zj. Jasna Dobricik, Shefe e Seksionit të Barazisë, Mosdiskriminimit dhe Antitrafikut (ENA)	
E Enjte 4 Korrik 2013				
<u>Grupi 1a: Arben Hajrullahu dhe Natyra Avniu (Vizitë në Ferizaj)</u>				
14.00-15.00	Takim me koordinatorin e NjDNj.	Zyra e koordinatorit të NjDNj	<u>Grupi 1a:</u> - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulente <u>Përfaqësuesit e Komunës:</u> - Zj. Vjollca Krasniqi, Koordinator i NjDNj.	
<u>Grupi 1b: Gulcan Yeroz dhe Bardhyl Hasanpapaj (Vizitë në Obiliq/Obiliç)</u>				
09.55-11.00	Takim me stafin e NjDNj	Zyra e NjDNj	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1b:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesit e Komunës:</u> - Z. Nazmi Restelica, Koordinator i NjDNj - Zj. Jasmina Radanovic, Zyrtar për Komunitetet - Zj. Ganimete Aliu, Zyrtar në komunë për Barazinë Gjimore	

10.00-10.45	Takim me kryetarin e komunës së Obiliq/ Obilić	Zyra e kryetarit	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Rrahim Sylejmani, Asistent Gjuhësor <u>Grupi 1b:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent <u>Përfaqësuesit e Komunës:</u> - Z. Mehmet Krasniqi, Kryetar i Komunës
E Premte, 5 Korrik 2013			
09.30-11.30	Takim i brendshëm - Ndarja e të dhënave nga takimet - Hedhja e ideve të reja për ecjen përpara/ propozim për reformat	KiE (dhoma e vogël e takimeve)	<u>Grupi i Projektit të KiE:</u> - Z. Andre Forde, Zv/Drejtues i Zyrës Lokale - Zj. Remzije Istrefi, Zyrtare Projekti <u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulente <u>Zyra e BE në Kosovë/Përfaqësuesi i Posaçëm i BE-së:</u> - Zj. Patrick Schmelzer, Zyrtar për politikat
11.45-12.30	Takim i brendshëm - Përcaktimi i afateve të brendshme, ngarkesës së punës etj.	KiE (dhoma e vogël e takimeve)	<u>Grupi 1:</u> - Zj. Gülcan Yeröz, Konsulente - Z. Arben Hajrullahu, Konsulent - Z. Bardhyl Hasanpapaj, Konsulent - Zj. Natyra Avdiu, Konsulente

SHTOJCA V

Projekti i Përbashkët ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës me titull
 “Përmirësimi i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Kosovë”

Misioni i Dytë i Vlerësimit³⁷¹

22-26 Korrik 2013

Agjenda

E Hënë, 22 Korrik		Vendi	Pjesmarrsit
10:00 -11:00	Takim me grupin e Projektit	Dhoma e vogël e Takimeve KiE	Grupi i Projektit, Konsulentët
11:00 – 12:30	Takim i brendshëm i Ekspertëve	Dhoma e vogël e Takimeve KiE	Z. Jeremy McBride; Z. Dejan Palić; Z. George Tugushi; Zj.Jelena Besedić; Zj.Jørgen Steen Sørensen; Zj.Natyra Avdiu; Z. Bardhyl Hasanpapaj;
12:30 – 13:30	Drekë pune me Zv/Drejtuuesin e Këshillit të Evropës në Prishtinë		Z. Andre Forde Z. Jeremy McBride; Z. Dejan Palić; Z. George Tugushi; Zj.Jelena Besedić; Z. Jørgen Steen Sørensen; Zj.Natyra Avdiu; Z. Bardhyl Hasanpapaj;
14:00–15:15	Takimi me Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë(IAP)	Zyrat e IAP	Z. Sami Kurteshi, Avokati i Popullit Z. Jeremy McBride; Z. Dejan Palić; Z. George Tugushi; Zj.Jelena Besedić; Z. Jørgen Steen Sørensen; Zj.Natyra Avdiu; Z. Bardhyl Hasanpapaj;

³⁷¹ Misioni për vlerësimin e dytë për ofrimin e ekspertizës legjislative për të tre projektligjet për anti-diskriminimin, barazinë gjinore dhe Avokatin e Popullit realizohet në kuadër të Projektit të Përbashkët. Ekspertët e përfshirë janë: Zj.Jelena Besedic, Z. Jeremy McBride, Z. Dejan Palic, Z. Jørgen Steen Sørensen dhe Z.George Tugushi.

15:30 – 16:30	Takim me përfaqësues të Zyrës së BE-së	Dhoma e vogël e Takimeve KiE	Z. Karin Marmsoler, Këshilltar për Politikën për Shtetin e së Drejtës; Z. Visar Bivolaku, Zyrtar për të Drejtat e Njeriut Z. Jeremy McBride; Z. Dejan Palić; Z. George Tugushi; Zj. Jelena Besedić; Z. Jørgen Steen Sørensen; Zj. Natyra Avdiu; Z. Bardhyl Hasanpapaj;
16:30 - 18:00	Takim i brendshëm i konsulentëve	Dhoma e vogël e Takimeve KiE	Z. Jeremy McBride; Z. Dejan Palić; Z. George Tugushi; Zj. Jelena Besedić; Z. Jørgen Steen Sørensen; Zj. Natyra Avdiu; Z. Bardhyl Hasanpapaj;
E Martë 23 Korrik			
10:00 -11:00	Takim me Zyrën Juridike të Kryeministrit	ZJGodinë Qeveritare	Z. Besim Kajtazi, Drejtues i LO Z. Jeremy McBride; Z. Dejan Palić; Z. George Tugushi; Zj. Jelena Besedić; Z. Jørgen Steen Sørensen; Zj. Natyra Avdiu; Z. Bardhyl Hasanpapaj;
11:00-12:30	Takim me Agjencinë për Barazin Gjinore (ABGj)	ABGJGodinë Qeveritare	Zj. Edona Hajrullahu, Drejtuese e ABGj Zj. Jelena Besedić; Z. Bardhyl Hasanpapaj.
11:00 –12:30	Takim me Zyrën për Qeverisjen e Mirë(ZQM)	ZQM Godinë Qeveritare	Z. Habit Hajredini, Drejtues i ZQM Z. Jeremy McBride; Z. George Tugushi; Z. Jørgen Steen Sørensen; Z. Dejan Palić; Zj. Natyra Avdiu.
12:30 – 13:30	Drekë		

14:00-15:00	Takim me Ministrinë e Administratës Publike (MAP)	Ambientet e MAP Godina Rilindja	Z. Fatos Mustafa, Drejtor për Reformën e Administratës Publike; Z. Armend Rugova, Koordinator i NjDNj. Z. Jeremy McBride; Z. Dejan Palić; Z. George Tugushi; Zj.Jelena Besedić; Z. Jørgen Steen Sørensen; Zj.Natyra Avdiu; Z. Bardhyl Hasanpapaj;
15:30 – 16:30	Takim me Ministrinë e Integrimit Evropian (MIE)	Dhoma e vogël e Takimeve KiE	Z. Besnik Vasolli, Koordinator Teknik për Liberalizimin e Vizave Z. Jeremy McBride; Z. Dejan Palić; Z. George Tugushi; Zj.Jelena Besedić; Z. Jørgen Steen Sørensen; Zj.Natyra Avdiu; Z. Bardhyl Hasanpapaj;
16:30- 17:30	Takim me Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Baraziminë Gjimore, Personat e Humbur dhe Peticionet	Godina e Asamblesë, Dhoma S006	Zj.Suzan Novobrdali, Drejtuese e Komisionit Z. Jeremy McBride; Z. Dejan Palić; Z. George Tugushi; Zj.Jelena Besedić; Z. Jørgen Steen Sørensen; Zj.Natyra Avdiu; Z. Bardhyl Hasanpapaj;
E Mërkurë 24 Korrik			
10:00 -11:00	Takim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) Takimi nuk u zhvillua për shkak të padisponueshmërisë së stafit të MAPL për tu takuar me ekspertët	Ambientet e MAPL, Godina Rilindja	Z. Agron Maxhuni, Drejtues i Zyrës Juridike; Zj.Fakete Kukaj, Drejtues i Divizionit të të Drejtave të Njeriut. Z. Jeremy McBride; Z. Dejan Palić; Z. George Tugushi; Zj.Jelena Besedić; Z. Jørgen Steen Sørensen; Zj.Natyra Avdiu; Z. Bardhyl Hasanpapaj;
12:00–13:00	Drekë		

13:00 – 17:30	Takim pune teknik shumpalësh me komunitetin ndërkombëtar; Temat e diskutimit: Harmonizimi i sistemit, mënyra sesi ligjet lidhen me njëri tjetrin dhe arkitektura e përgjithshme e të drejtave të njeriut në Kosovë*; Ligji për Avokatin e Popullit.	Hotel Sirius	Prfaqësues t Kshillit t Evropës, Zyra e BE-s në Prishtinë, EULEX, ZKLDNj, OSBE, UNDP, UNHCR, UNICEF, UNMIK, UN Women.
E Enjte 25 Korrik			
10:00 – 12:45	Procesi multilateral i konsultimit të ekspertëve me komunitetin ndërkombëtar, Temat për tu diskutuar: projektligji për mbrojtjen nga diskriminimi	Hotel Sirius	Përfaqësues të KE, Zyra e BE-së në Prishtinë, EULEX, ZKLDNj, OSBE, UNDP, UNHCR, UNICEF, UNMIK, UN Women.
12:45 – 13:45	Drekë		
13:45 – 17:30	Proces multilateral konsultimi i ekspertëve me komunitetin ndërkombëtar. Tema e diskutuar: Projektligji për Barazinë Gjinore;	Hotel Sirius	Përfaqësues të KE, zyra e BE në Prishtinë, EULEX, ZKLDNj, OSBE, UNDP, UNHCR, UNICEF, UNMIK, UN Women.
E Premte 26 Korrik			
10:00-11:00	Informim me Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë	Zyrat e IAP	Z. Sami Kurteshi, Avokati i Popullit Z. Jeremy McBride; Z. Dejan Palić; Z. George Tugushi; Zj. Jelena Besedić; Z. Jørgen Steen Sørensen Zj. Natyra Avdiu; Z. Bardhyl Hasanpapaj;

11:15–12:30	Takim shumpalësh me OJQ-të	Dhoma e vogël e Takimeve e KE	<p>YIHR, Zj.Raba Gjoshi; ECMI, Z. Adrian Zeqiri (nuk ishte i disponueshëm) CDHRF, Z. Behxhet Shala; KRCT, Z. Alban Muriqi; CRPK, Z. Hilmi Jashari (nuk ishte i disponueshëm); Fondi për Ligjin Humanitar, Z. Betim Zllanoga; Rrjeti i Grave të Kosovës (nuk ishte i disponueshëm); Shoqata e Juristëve Norma; Qendra për Studimet Gjinore e Kosovës (nuk ishte i disponueshëm); Z. Jeremy McBride; Z. Dejan Palić; Z. George Tugushi; Zj.Jelena Besedić; Z. Jørgen Steen Sørensen Zj.Natyra Avdiu; Z. Bardhyl Hasanpapaj;</p>
12:30 – 13:30	Drekë		
14:00 – 15:30	Informim me ZKM, ZQM dhe MIE	Dhoma e vogël e Takimeve të KE	<p>Z. Besim Kajtazi, Drejtues i ZJ Z. Habit Hajredini, Drejtues i ZQM Z. Besnik Vasolli, Koordinator Teknik për Liberalizimin e Vizave Z. Jeremy McBride; Z. Dejan Palić; Z. George Tugushi; Zj.Jelena Besedić; Z. Jørgen Steen Sørensen; Zj.Natyra Avdiu; Z. Bardhyl Hasanpapaj;</p>
15:30 – 16:30	Informim me Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, Personat e Humbur dhe Peticionet	TBC	<p>Z. Suzan Novobrdali, Drejtuese e Komisionit Z. Jeremy McBride; Z. Dejan Palić; Z. George Tugushi; Zj.Jelena Besedić; Z. Jørgen Steen Sørensen Zj.Natyra Avdiu; Z. Bardhyl Hasanpapaj;</p>

17:00 – 18:00	Takim i Brendshëm Konk- ludues	Dhoma e vogël e Takimeve KE	Grupi i Projektit / Kon- sulentët
---------------	-----------------------------------	-----------------------------------	--------------------------------------

SHTOJCA VI

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

Projekt i Përbashkët ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës
Përmirësimi i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Kosovë

Tryezë e rumbullakët për propozimet e reformës për aktivizimin e institucioneve jogjyqësore të të drejtave të njeriut në Kosovë dhe ekspertizën legislative të të drejtave të njeriut që lidhet me paketën e projekligjit.

4 Tetor 2013,
Hotel Sirius, Prishtinë
Agjenda

4 Tetor, 2013	
9.15 – 9.30	Regjistrimi i pjesëmarrësve
9.30 – 9.45	Fjalët e hapjes/mirëseardhjes: Z. Tim Cartright, Kreu i Zyrës, Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë; Z/Zj. ..., Zyra e BE/Përfaqësuesi i Posaçëm i BE-së.
9.45– 11.15	Sesion Plenar–Propozimet për reformën, harmonizimi i sistemit, mënyra në të cilën ligjet lidhet me njëri tjetrin dhe arkitektura e përgjithshme e të drejtave të njeriut në Kosovë. Lehtësues – Z. Jeremy McBride, (bashkë-lehtësues - grupi1).
11.15 – 11.30	Pushim për kafe
11.30 – 12.45	Sesion Plenar – Opinion për Ligjin Ekzistues dhe Projektligjin për Ndryshimin dhe Shtesat në Ligjin Nr. 03/L – 195 për Avokatin e Popullit. Lehtësuesit– Z. George Tugushi; Z. Jørgen Steen Sørensen; (bashkë-lehtësues Zj. Natyra Avdiu; Z. Bardhyl Hasanpapaj).
12.45 – 13.45	Pushim për drekë
13.45 – 15.00	Sesion Plenar – Opinioni për Projektligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Lehtësuesit – Z. Dejan Palić; Z. Jeremy McBride (bashkë-lehtësues Zj. Natyra Avdiu; Z. Bardhyl Hasanpapaj)
15.00 – 15:15	Pushim për kafe
15.15 – 16:30	Sesion Plenar – Opinioni për Projektligjin për Barazinë Gjinore. Lehtësuesit – Z. Jelena Basedić; Z. Jeremy McBride (bashk-lehtsues Zj. Natyra Avdiu; Z. Bardhyl Hasanpapaj)
16:30- 17:00	Komentet e mbylljes dhe rrugët në të ardhmen; kush bën çfarë?

